

32009L0138

DIREKTIVA 2009/138/KE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25 NËNTOR 2009, "PËR FILLIMIN DHE ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE TË SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT" (DIREKTIVA PËR AFTËSINË PAGUESE II)

(riformulim)

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian dhe, në veçanti nenin 47, paragrafi 2 dhe nenin 55,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social

Pas konsultimit me Komitetin e Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të traktatit,

Meqë:

1. Një numër i konsiderueshëm ndryshimesh duhet të kryhen në Direktivën e Parë të Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit të drejtpërdrejtë, me përjashtim të sigurimit të jetës"; Direktivën e Këshillit 78/473/KEE, datë 30 maj 1978, "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me bashkë-sigurimin Komunitar"; Direktivën e Këshillit 87/344/KEE, datë 22 qershor 1987, "Për koordinimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të dispozitave administrative lidhur me sigurimin e shpenzimeve ligjore"; Direktivën e Dytë të Këshilli 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, me përjashtim të sigurimit të dhe që përcakton dispozitat për lehtësimin e ushtrimit efikas të lirisë për ofrimin e shërbimeve"; Direktivën e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, "Për koordinimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, me përjashtim të sigurimit të jetës (Direktiva e tretë për sigurimet jojetë)"; Direktivën 98/78/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 tetor 1998; Direktivën 2001/17/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 mars 2001, "Për riorganizimin dhe likuidimin e sipërmarrjeve të sigurimit"; Direktivën 2002/83/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 nëntor 2002, në lidhje me sigurimet jetë; dhe Direktivën 2005/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, "Për risigurimin". Për hir të qartësisë, këto direktiva duhet të riformulohen.

2. Për të lehtësuar fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit, duhet të eliminohen ndryshimet kryesore ndërmjet ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me rregullat që zbatohen për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit. Për rrjedhojë, duhet të

parashikohet kuadri ligjor sipas të cilit shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të kryejnë veprimtaritë e sigurimit në të gjithë tregun e brendshëm, duke ndihmuar kështu shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që kanë zyrat qendrore në Komunitet që të mbulojnë rreziqet dhe angazhimet që ndodhen aty.

3. Është në interesat e funksionimit të mirë të tregut të brendshëm që të përcaktohen rregulla të koordinuara në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e kreditorëve dhe riorganizimin dhe procedurat e likuidimit për shoqëritë e sigurimit.

4. Duhet që disa shoqëri të caktuara, të cilat ofrojnë shërbime sigurimi, të mos mbulohen nga sistemi i themeluar nga kjo direktivë për shkak të statusit të tyre ligjor, natyrës së tyre, të cilat i lidhin ato ngushtë me sistemet e sigurimit publik, ose për shkak të shërbimeve specifike që ato ofrojnë. Për më tepër, kërkohet që në disa shtete të përjashtohen disa institucione të caktuara veprimtaritë e të cilëve mbulojnë vetëm një sektor tepër të kufizuar dhe kufizohen me ligj në një territor specifik ose për persona të specifikuar.

5. Shoqëri shumë të vogla që përmbushin disa kushte të caktuara, duke përfshirë të ardhurat nga primet bruto nën 5 milion euro, përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Megjithatë, të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që janë licencuar tashmë sipas direktivave aktuale duhet të vazhdojnë të licencohen kur kjo direktivë të vihet në zbatim. Shoqëritë që përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive duhet të kenë mundësi të shfrytëzojnë liritë themelore që garantohen nga traktati. Këto shoqëri mund të kërkojnë autorizimin sipas kësaj direktive, me qëllim të përfitojnë nga licenca e vetme që parashikohet në këtë direktivë.

6. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje t'u kërkojnë shoqërive që zhvillojnë veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit dhe që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive, që të regjistrohen. Shtetet anëtare gjithashtu mund të kërkojnë që këto shoqëri t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe ligjore.

7. Direktiva e Këshillit 72/166/KEE, datë 24 prill 1972, "Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorike, dhe me zbatimin e detyrimit për t'u siguruar për një përgjegjësi të tillë"; Direktiva e Shtatë e Këshillit 83/349/KEE, datë 13 qershor 1983, bazuar në nenin 54, paragrafi 3, germa "g" të Traktatit për llogaritë e konsoliduara; Direktiva e Dytë e Këshillit 84/5/KEE, datë 30 dhjetor 1983, "Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorike"; Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 prill 2004, "Për tregjet e instrumenteve financiare"; dhe Direktiva 2006/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 qershor 2006, në lidhje me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të institucioneve të kreditit përcaktojnë rregullat e përgjithshme në fushat e kontabilitetit, sigurimit të përgjegjësisë së mbajtësve të automjetit, instrumenteve financiare dhe të institucioneve të kreditit dhe përcaktojnë përkufizimet në këto fusha. Disa nga përkufizimet që përcaktohen në këto direktiva mund të zbatohen për qëllimet e kësaj direktive.

8. Fillimi i veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak. Ndaj duhet të përcaktohen kushtet dhe procedura për dhënien e këtij autorizimi si dhe për çdo refuzim.

9. Direktivat e shfuqizuara nga kjo direktivë nuk përcaktojnë asnjë rregull, në lidhje me fushën e zbatimit të aktiviteve të risigurimit që një shoqëri sigurimi mund të jetë e autorizuar të zhvillojë. Rregullat për këtë qëllim u takon që t'i vendosin shtetet anëtare.

10. Referencat në këtë direktivë për shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit duhet të përfshijnë shoqëritë e mbyllura të sigurimit dhe shoqëritë e mbyllura të risigurimit, përveç se kur për këto shoqëri ka parashikime specifike.

11. Meqë kjo direktivë përbën një instrument thelbësor për arritjen e tregut të brendshëm, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që autorizohen në shtetet anëtare të origjinës së tyre duhet të lejohen të zhvillojnë, në të gjithë Komunitetin, secilën nga ose të gjitha veprimtaritë e tyre, duke themeluar degë ose duke ofruar shërbime. Ndaj duhet që të bëhet harmonizimi i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të arritur njohjen reciproke të autorizimeve dhe sistemeve mbikëqyrëse e cila rezulton në një autorizim të vetëm, të vlefshëm në të gjithë Komunitetin dhe që lejon që mbikëqyrja e shoqërisë të kryhet nga shteti anëtar i origjinës.

12. Direktiva 2000/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 maj 2000, "Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorike" (Direktiva e Katërt për sigurimin motorik) përcakton rregullat për emërimin e specialistëve të trajtimit të dëmeve. Këto rregulla duhet të zbatohen për qëllimet e kësaj direktive.

13. Shoqëritë e risigurimit duhet të kufizojnë objektin e punës së tyre në veprimtaritë e risigurimit dhe në operacionet e lidhura me to. Kjo kërkesë nuk duhet ta pengojë një shoqëri risigurimi që të zhvillojë veprimtari si ofrimi i këshillave statistikore ose aktuaristike, analiza e riskut ose studime për klientët e saj. Ajo gjithashtu mund të përfshijë funksionet dhe veprimtaritë e një shoqërie kontrolluese, në lidhje me veprimtaritë e sektorit financiar, sipas kuptimit të nenit 2, paragrafi 8, të Direktivës 2002/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2002, "Për mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, të shoqërive të sigurimit dhe të firmave të investimit në një konglomerat financiar". Në çdo rast, kjo kërkesë nuk lejon zhvillimin e veprimtarive bankare dhe financiare që nuk lidhen me to.

14. Mbrojtja e mbajtësve të policës presupozon që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të jenë objekt i kërkesave efektive për aftësinë paguese, të cilat rezultojnë në një shpërndarje efikase të kapitalit në të gjithë Bashkimin Evropian. Duke parë zhvillimet e tregut sistemi aktual nuk është më i përshtatshëm. Ndaj duhet të prezantohet një kuadër i ri rregullator.

15. Në përputhje me zhvillimet më të fundit në menaxhimin e rrezikut, në kontekstin e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve dhe me zhvillimet e fundit në sektorë të tjerë financiarë, duke të miratohet një qasje e bazuar në rrezik, e cila parashikon subvencione për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të cilat masin dhe menaxhojnë siç duhet rreziqet e

tyre. Harmonizimi duhet të rritet nëpërmjet parashikimit të rregullave specifike për vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë dispozitat teknike.

16. Objektivi kryesor i rregullimit dhe mbikëqyrjes së fushës së sigurimeve dhe risigurimeve është mbrojtja e përshtatshme e mbajtësve të policës dhe përfituesve. Termi "përfitues" mbulon çdo person fizik ose juridik të cilit i takon një e drejtë në zbatim të kontratës së sigurimit. Stabiliteti financiar dhe tregjet e ndershme të qëndrueshme janë objektiva të tjera të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sigurimit dhe të risigurimit, të cilat duhet të merren në konsideratë, por nuk duhet të zbehin objektivin kryesor.

17. Regjimi i aftësisë paguese që përcaktohet në këtë direktivë pritet që të rezultojë në një mbrojtje akoma më të madhe të mbajtësve të policës. Kjo do të bëjë që shtetet anëtare t'u ofrojnë autoriteteve mbikëqyrëse burime për përmbushjen e detyrimeve të tyre, siç përcaktohen në këtë direktivë. Këtu përfshihen të gjitha kapacitetet e nevojshme, duke përfshirë burimet financiare dhe njerëzore.

18. Ndaj, autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare duhet të kenë në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për të garantuar zhvillimin e rregullt të veprimtarive nga ana e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit në të gjithë Komunitetin, qoftë nëse zhvillohen sipas të drejtës së themelimit ose sipas lirisë për ofrimin e shërbimeve. Për të garantuar efikasitetin e mbikëqyrjes, të gjitha veprimet e marra nga autoritetet mbikëqyrëse duhet të jenë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që përfshin veprimtaria e sigurimit ose e risigurimit, pavarësisht rëndësisë së shoqërisë përkatëse për stabilitetin e përgjithshëm financiar të tregut.

19. Kjo direktivë nuk duhet të rezultojë në barra të tepërta për shoqëritë e vogla dhe të mesme të sigurimit. Një nga mjetet përmes të cilave arrihet ky objektivi është zbatimi i duhur i parimit të proporcionalitetit. Ky parim duhet të zbatohet si për kërkesat e vendosura për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit ashtu edhe për ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse.

20. Në veçanti, kjo direktivë nuk duhet të rezultojë në barra të tepërta për shoqëritë e sigurimit të specializuara në ofrimin e llojeve të caktuara të sigurimeve ose të shërbimeve për klientë që i përkasin segmenteve të caktuara, si dhe duhet të pranojë se një specializim i tillë mund të jetë një mjet të vlefshëm për menaxhimin efikas dhe efektiv të rrezikut. Për arritjen e këtij objektivi, si dhe për zbatimin e duhur të parimit të proporcionalitetit, duhet të ketë dispozita specifike që u lejojnë shoqërive që të përdorin të dhënat e veta për të kalibruar parametrat në modulet e rrezikut për marrjen në sigurim sipas formulës standarde të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese.

21. Kjo direktivë gjithashtu duhet të marrë në konsideratë natyrën specifike të shoqërive të mbyllura të sigurimit dhe të risigurimit. Duke qenë se këto shoqëri mbulojnë vetëm rreziqet që lidhen me grupin industrial ose tregtar të cilëve ato u përkasin, duhet të parashikohen qase të përshtatshme, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të cilat pasqyrojnë natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të tyre.

22. Mbikëqyrja e veprimtarisë së risigurimit duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të veprimtarive të risigurimit, dhe veçanërisht natyrën e tyre globale dhe faktin se vetë mbajtësit e policave janë shoqëri sigurimi ose risigurimi.

23. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të jenë në gjendje të marrin nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit informacionin që nevojitet për qëllimet e mbikëqyrjes, duke përfshirë, sipas rastit, informacionin e bërë publik nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi në kuadër të raportimit financiar, listimit dhe kërkesave të tjera ligjore ose rregullatore.

24. Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës duhet të jetë përgjegjës për monitorimin e sigurisë financiare të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit. Për këtë qëllim, ato duhet të kryejnë rregullisht rishikime dhe vlerësimet.

25. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të jenë në gjendje të marrin në konsideratë ndikimet që kanë kodet vullnetare të sjelljes dhe të transparencës, të zbatuara nga institucionet përkatëse që merren me instrumente investimi të parregulluara ose alternative, në menaxhimin e riskut ose të aktiveve.

26. Pika fillestare për mjaftueshmërinë e kërkesave sasiore në sektorin e sigurimeve është kërkesa për kapital dhe aftësi paguese. Ndaj, autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë fuqinë të vendosin një shtesë kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese vetëm në rrethana përjashtimore, në rastet e renditura në këtë direktivë, në vijim të procesit të rishikimit mbikëqyrës. Formula standarde për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese synon të pasqyrojë profilin e rrezikut të shumicës së shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit. Megjithatë, mund të ketë raste kur qasja e standardizuar nuk pasqyron siç duhet profilin e rrezikut tepër specifik të një shoqërie.

27. Vendosja e një shtese kapitali është përjashtimore duke qenë se ajo duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit, kur masat e tjera mbikëqyrëse janë të padobishme ose të papërshtatshme. Për më tepër, termi "përjashtimor" duhet të kuptohet në kontekstin e situatës specifike të secilës shoqëri dhe jo në lidhje me një sërë shtesash të kapitalit të vendosura në një treg specifik.

28. Shtesa e kapitalit duhet të mbahet për aq kohë sa vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat në të cilën ajo u vendos. Në rastin e mangësive të konsiderueshme në modelin e brendshëm të plotë ose të pjesshëm ose të dështimeve të konsiderueshme në sistemin rregullator, autoritetet mbikëqyrëse duhet të sigurohen që shoqëria në fjalë bën çdo përpjekje për të korrigjuar mangësitë që çuan në vendosjen e shtesës së kapitalit. Megjithatë, në rastin kur qasja e standardizuar nuk pasqyron siç duhet profilin tepër specifik të rrezikut të një shoqërie, shtesa e kapitalit mund të mbahet për vite me radhë.

29. Disa rreziqe mund të trajtohen siç duhet vetëm nëpërmjet kërkesave rregullatore dhe jo nëpërmjet kërkesave sasiore që pasqyrohen në kërkesën për kapital dhe aftësi paguese. Kështu, një sistem rregullator efikas është thelbësor për administrimin e përshtatshëm të shoqërisë së sigurimit dhe për sistemin rregullator.

30. Sistemi i rregullator përfshin funksionin e menaxhimit të rrezikut, funksionin e pajtueshmërisë, funksionin e auditit të brendshëm dhe funksionin aktuaristikës.

31. Një funksion është një kapacitet administrativ për të marrë përsipër detyra të caktuara rregullatore. Identifikimi i një funksioni të veçantë nuk e pengon shoqërinë që të vendosë lirisht për mënyrën e organizimit të funksionit në praktikë, përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë direktivë. Kjo nuk duhet të çojë në kërkesa tepër të rënda, sepse duhet të merret në konsideratë natyra, shkalla dhe kompleksiteti i operacioneve të shoqërisë. Ndaj këto funksione duhet të kryhen nga stafi i brendshëm, të merren këshilla nga ekspertë të jashtëm ose të nënkontraktohen tek ekspertë të jashtëm sipas kufizimeve që përcaktohen në këtë direktivë.

32. Gjithashtu, me përjashtim të funksionit të auditit të brendshëm, në shoqëritë e vogla dhe më pak komplekse, një individ ose një njësi organizative mund të kryejë më shumë se një funksion.

33. Funksionet e përfshira në sistemin rregullator konsiderohen si funksione kyçe dhe rrjedhimisht edhe si funksione të rëndësishme dhe kritike.

34. Të gjithë personat që kryejnë funksionet kyçe duhet të jenë të përshtatshëm për këtë funksion. Megjithatë, vetëm personat që kryejnë funksionet kyçe duhet të zbatojnë kërkesat për të njoftuar autoritetin mbikëqyrës.

35. Me qëllim vlerësimin e nivelit të kërkuar të kompetencës, kualifikimet dhe përvoja profesionale e personave që drejojnë faktikisht shoqërinë ose që kanë funksione të tjera kyçe duhet të merren në konsideratë si faktorë shtesë.

36. Të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të kenë, si pjesë e integruar e strategjisë së biznesit, një praktikë të rregullt për vlerësimin e nevojave të përgjithshme për aftësi paguese duke marrë në konsideratë profilin e tyre specifik të rrezikut (vlerësimi i rrezikut të vet dhe aftësisë paguese). Ky vlerësim nuk kërkon zhvillimin e një modeli të brendshëm dhe as nuk shërben për të llogaritur një kërkesë për kapital të ndryshme nga kërkesa për kapital dhe aftësi paguese ose kërkesa për kapital minimal. Rezultatet e çdo vlerësimi duhet t'i raportohen autoritetit mbikëqyrës si pjesë e informacionit që duhet të dorëzohet për qëllime mbikëqyrëse.

37. Për të garantuar mbikëqyrjen efektive të funksioneve ose veprimtarive të nënkontraktuara, është shumë e rëndësishme që autoritetet mbikëqyrëse të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që nënkontraktojnë këto funksione të kenë qasje në të gjitha të dhënat përkatëse që mbahen nga ofruesi i shërbimit të nënkontraktuar, pavarësisht nëse ky i fundit është një subjekt i rregulluar ose i parregulluar, si edhe të drejtën për të kryer inspektime në terren. Për të marrë në konsideratë zhvillimet e tregut dhe për të garantuar respektimin e kushteve për nënkontraktim, autoritetet mbikëqyrëse duhet të informohen paraprakisht për nënkontraktimin e funksioneve ose veprimtarive kritike ose të rëndësishme. Këto kërkesa duhet të marrin në konsideratë punën e forumit të përbashkët dhe të jenë në pajtim me rregullat dhe praktikatat aktuale të sektorit bankar dhe me Direktivën 2004/39/KE dhe zbatimin e saj për institucionet e kreditit.

38. Për të garantuar transparencën, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të nxjerrin publikisht, d.m.th. të vënë në dispozicion publikut ose në formë të printuar ose elektronike pa pagesë, të paktën një herë në vit, informacionet thelbësore për aftësinë e tyre

paguese dhe gjendjen e tyre financiare. Shoqëritë duhet të lejohen të bëjnë publike informacionet në mënyrë vullnetare.

39. Duhet të parashikohen dispozita për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve, të cilat, në bazë të funksionit të tyre, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit të sistemit financiar. Ndaj, është e nevojshme që të specifikohen kushtet, sipas së cilave mund të arrihen këto shkëmbime informacioni. Gjithashtu, nëse informacioni mund të nxirret vetëm me marrëveshje të shprehur të autoriteteve mbikëqyrëse, këto të fundit, sipas rastit, duhet të jenë në gjendje që ta bëjnë marrëveshjen e tyre objekt të kushteve të rrepta.

40. Duhet të nxitet konvergjenca mbikëqyrëse jo vetëm për sa i përket mjeteve mbikëqyrëse, por edhe praktikave mbikëqyrëse. Komiteti Evropian i Mbikëqyrjes për Sigurimet dhe Pensionet (CEIOPS), themeluar me Vendim të Komisionit 2009/79/KE duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim dhe t'i raportojë rregullisht Parlamentit dhe Komisionit për progresin e bërë.

41. Objektivi i informacionit dhe raportit që duhet të paraqitet nga CEIOPS në lidhje me shtesat e kapitalit nuk është kufizimi i përdorimit të tyre në kuadër të kësaj direktive, por dhënia e një kontributi për një konvergjencë më të lartë në mbikëqyrjen e shtesave të kapitalit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse në shtete anëtare të ndryshme.

42. Me qëllim kufizimin e barrës administrative dhe shmangien e dublikimit të detyrave, autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet statistikore kombëtare duhet të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion mes tyre.

43. Me qëllim forcimin e mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit dhe risigurimit dhe mbrojtjen e mbajtësve të policës, audituesit statutorë, sipas kuptimit të Direktivës 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 majit 2006 për auditet statutorë të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara duhet të jenë të detyruara të raportojnë menjëherë çdo fakt që mund të ketë një ndikim serioz në situatën financiare ose organizimin administrativ të një shoqërie sigurimi ose risigurimi.

44. Shoqëritë e sigurimit që zhvillojnë veprimtari të sigurimit jetë dhe jo jetë duhet t'i administrojnë këto veprimtari veçmas me qëllim që të mbrojnë interesat e mbajtësve të policës. Në veçanti, këto shoqëri duhet të jenë objekt i kërkesave për kapitalin të njëjta me ato që zbatohen për një grup sigurimi ekuivalent, i përbërë nga një shoqëri sigurimi jete dhe një shoqëri sigurimi jo jete, duke marrë në konsideratë transferueshmërinë e rritur të kapitalit në rastin e shoqërive të sigurimit të përbëra.

45. Vlerësimi i pozicionit financiar të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit duhet të bazohet mbi parime ekonomike të shëndosha dhe të shfrytëzojë sa më mirë informacionin që ofrohet nga tregjet financiare si edhe të dhënat e përgjithshme të disponueshme për rreziqet teknike të sigurimeve. Në veçanti, kërkesat për aftësinë paguese duhet të bazohen mbi një vlerësim ekonomik të të gjithë bilancit.

46. Standardet e vlerësimit për qëllime mbikëqyrëse duhet të jenë në pajtim me zhvillimet ndërkombëtare të kontabilitetit, deri në masën e mundshme, me qëllim që të kufizohet barra administrative për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit.

47. Në përputhje me këtë qasje, kërkesat për kapital duhet të mbulohen nga fondet e veta, pavarësisht nëse janë zëra të përfshirë ose jo në bilanc. Duke qenë se jo të gjitha burimet financiare ofrojnë një mbulim të plotë të humbjeve në rastin e likuidimit dhe vijimësisë së veprimtarisë, zërat e fondeve të veta duhet të klasifikohen në përputhje me kriteret e cilësisë në tre nivele, dhe shuma e fondeve të veta që duhet të për të mbuluar kërkesat për kapital duhet të kufizohet për sa më lart. Kufijtë që zbatohen për zërat e fondeve të veta duhet të zbatohen vetëm për të përcaktuar situatën e aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit dhe nuk duhet të kufizojë më tej lirinë e këtyre shoqërive në lidhje me administrimin e kapitalit të tyre të brendshëm.

48. Në përgjithësi, aktivet që janë të çliruara nga çdo detyrim i parashikueshëm janë të disponueshme për të përballuar humbjet për shkak të luhatjeve negative të biznesit gjatë vijimësisë së veprimtarisë dhe në rastin e likuidimit. Për këtë arsye, shumica dërrmuese e aktiveve që tejkalojnë pasivet, siç vlerësohen në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë direktivë, duhet të trajtohen si kapital me cilësi të lartë (Niveli 1).

49. Jo të gjitha aktivet brenda një shoqërie janë të pakufizuara. Në disa shtete anëtare, produktet specifike rezultojnë në struktura fondesh të mbrojtura përmes ndarjes të cilat i japin një kategori të mbajtësve të policave më shumë të drejta për aktivet brenda fondeve të veta. Edhe pse këto aktive përfshihen në llogaritjen e aktiveve që tejkalojnë pasivet për qëllimet e fondeve të veta, në fakt ato nuk mund të vihen në dispozicion për të zbutur rreziqet jashtë fondeve të mbrojtura përmes ndarjes. Për të ruajtur konsistencën me qasjen ekonomike, vlerësimi i nevojave për fonde të veta duhet të axhustohet sipas natyrës së ndryshme të aktiveve të cilat janë pjesë e një marrëveshje për mbrojtje përmes ndarjes. Në mënyrë të ngjashme, llogaritja e kërkesës për kapitalin e aftësisë paguese duhet të pasqyrojë uljen e grumbullimit ose diversifikimit në lidhje me këto fonde që mbrohen përmes ndarjes.

50. Në disa shtete anëtare shoqëritë e sigurimit shesin produkte sigurimi jete në lidhje me të cilat mbajtësit e policës dhe përfituesit kontribuojnë në kapitalin për rrezikun e shoqërisë në këmbim të të gjithë ose një pjese të kthimit për kontributet. Këto fitime të akumuluar janë fonde shtesë, të cilat janë në pronësi të subjektit juridik ku gjenerohen.

51. Fondet shtesë duhet të vlerësohen në përputhje me qasjen ekonomike që përcaktohet në këtë direktivë. Në këtë drejtim, nuk mjafton vetëm një referencë e thjeshtë për vlerësimin e fondeve shtesë në llogaritë statutores vjetore. Në përputhje me kërkesat për fonde të veta, fondet shtesë duhet të jenë objekt i kriterëve që përcaktohen në këtë direktivë për klasifikimin në nivele. Kjo, ndër të tjera, nënkupton se vetëm fondet shtesë që plotësojnë kërkesat për t'u klasifikuar në Nivelin 1, duhet të konsiderohen si kapital i Nivelit 1.

52. Shoqatat e ndërsjella me kontribute të ndryshme mund të kërkojnë kontribute plotësuese nga anëtarët e tyre (ftesa plotësuese për anëtarët) me qëllim që të rrisin shumën e burimeve financiare që ata kanë për të përballuar humbjet. Ftesat plotësuese për anëtarët mund të përfaqësojnë një burim të konsiderueshëm financiar për shoqatat e ndërsjella, përfshirë kur këto

shoqata përballen me luhatje negative të biznesit. Ftesat plotësuese për anëtarët duhet të pranohen si zëra ndihmës për fonde të veta dhe duhet të trajtohen siç duhet për qëllimet e aftësisë paguese. Në veçanti, në rastin shoqatave të ndërsjella të pronarëve të anijeve tregtare me kontribute të ndryshueshme që sigurojnë vetëm rreziqet detare, përdorimi i ftesave shtesë për anëtarët është një praktikë që është përdorur prej kohës, sipas masave specifike për rikuperim, dhe shuma e miratuar e këtyre ftesave për anëtarët duhet të trajtohet si kapital me cilësi të mirë (Niveli 2). Po ashtu, në rastin e shoqatave të tjera të ndërsjella ku ftesat shtesë për anëtarët kanë cilësi të ngjashme, shuma e miratuar e këtyre ftesave për anëtarët gjithashtu duhet të trajtohet si kapital me cilësi të mirë (Niveli 2).

53. Me qëllim që shoqërive të sigurimit dhe risigurimit t'u lejohet që të përmbushin angazhimet e tyre kundrejt mbajtësve të policave dhe përfituesve, shtetet anëtare duhet t'u kërkojnë këtyre shoqërive që të përcaktojnë provigjone teknike të përshtatshme. Parimet dhe metodologjitë aktuaristike dhe statistikore për llogaritjen e këtyre dispozitave teknike duhet të jenë të harmonizuara në të gjithë Komunitetin me qëllim që të arrihet një krahasueshmëri dhe një transparencë më e mirë.

54. Llogaritja e provigjoneve teknike duhet të jetë konsistente me vlerësimin e aseteve dhe pasiveve të tjera, konsistente me tregun dhe në harmoni me zhvillimet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe mbikëqyrjes.

55. Ndaj vlera e provigjoneve teknike duhet të përkojë me shumën që do të paguhet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi nëse ajo do t'i transferojë të drejtat dhe detyrimet e saj kontraktuale menjëherë drejt një shoqërie tjetër. Për rrjedhojë, vlera e provigjoneve teknike duhet të përkojë me shumën që pritet të kërkohej nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi (shoqëria referencë) për të marrë përsipër dhe për të përmbushur detyrimet përkatëse të marrjes në sigurim ose risigurim. Shuma e provigjoneve teknike duhet të pasqyrojë karakteristikat e portofolit përkatës të sigurimit. Ndaj, për llogaritjen e tyre duhet të përdoret informacioni specifik për shoqërinë, siç është informacioni për administrimin e dëmeve dhe shpenzimet vetëm deri në masën që ky informacion u mundëson shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të pasqyrojnë më mirë karakteristikat e portofolit përkatës të sigurimit.

56. Supozimet që bëhen për shoqërinë referencë që supozohet të marrë përsipër dhe të përmbushë detyrimet përkatëse të marrjes në sigurim dhe risigurim duhet të jenë të harmonizuara në të gjithë Komunitetin. Në veçanti, referencat e bëra për shoqërinë referencë që përcaktojnë nëse duhet ose jo, dhe nëse po deri në çfarë mase, të merren parasysh efektet e diversifikimit në llogaritjen e marzhit të rrezikut duhet të analizohen si pjesë e vlerësimit të ndikimit të masave zbatuese dhe më pas duhet të harmonizohen në nivel Komuniteti.

57. Me qëllim llogaritjen e provigjoneve teknike, duhet të mundësohet zbatimi i interpolimeve dhe ekstrapolimeve të arsyeshme nga vlerat e tregut që mund të vëzhgohen drejtpërsëdrejti.

58. Për të dhënë një vlerësim ekonomik të detyrimeve të marrjes në sigurim dhe risigurim, duhet që vlera aktuale e pritshme e pasiveve të sigurimit të llogaritet mbi bazën e informacionit aktual dhe të besueshëm dhe supozimeve reale, duke marrë në konsideratë

garancitë financiare dhe opsionet në kontratat e sigurimit dhe të risigurimit. Duhet të kërkohet përdorimi i metodologjive aktuaristike efektive dhe të harmonizuara.

59. Për të pasqyruar situatën specifike të shoqërive të vogla dhe të mesme, duhet të parashikohen qasje të thjeshtësuara për të llogaritur provigjonet teknike.

60. Regjimi mbikëqyrës duhet të parashikojë një kërkesë të ndjeshme ndaj rrezikut, e cila bazohet në përlllogaritjen prospektive për të garantuar ndërhyrjen e saktë dhe në kohë nga autoritetet mbikëqyrëse (kërkesa për kapital dhe aftësi paguese), dhe një nivel minimal të sigurisë, nën të cilin nuk duhet të bjerë sasia e burimeve financiare (kërkesa për kapital minimal). Të dyja kërkesat për kapital duhet të jenë të harmonizuara në të gjithë Komunitetin për të arritur një nivel uniform mbrojtjeje për mbajtësit e policave. Për mbarëvajtjen e kësaj direktive, ndërhyrjet për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe për kërkesën për kapital minimal duhet të bëhen sipas niveleve të përshtatshme.

61. Për të zbutur efektet prociklike të mundshme e të papërshtatshme të sistemit financiar dhe për të shmangur situatën ku shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit janë të detyruara të rrisin kapitalin ose të shesin investimet e tyre si rezultat i lëvizjeve negative të përkohshme në tregjet financiare, moduli i rrezikut të tregut për formulën standarde të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese duhet të përfshijë një mekanizëm simetrik axhustimi për sa i përket ndryshimeve të nivelit të çmimeve të kapitalit aksionar. Gjithashtu, në rastin e rënive të pazakonta në tregjet financiare dhe kur mekanizmi simetrik i axhustimit nuk mjafton për t'i mundësuar shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të përmbushin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, duhet të parashikohen dispozita që u lejojnë autoriteteve mbikëqyrëse që të zgjasin periudhën brenda të cilave shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit u kërkohet që të rivendosin nivelin e kualifikuar për fonde të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

62. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese duhet të pasqyrojë një nivel të tillë të fondeve të veta që u lejon shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që të përballojnë humbje të konsiderueshme dhe që japin garanci të arsyeshme mbajtësve të policave dhe përfituesve se pagesat do të bëhen sipas afatit.

63. Për të garantuar që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mbajnë fonde të veta të mjaftueshme që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në mënyrë të vazhdueshme, duke marrë në konsideratë çdo ndryshim në profilin e tyre të rrezikut, këto shoqëri duhet të llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të paktën çdo vit, ta monitorojnë atë vazhdimisht dhe ta rillogarisin atë sa herë që profili i rrezikut pëson ndryshime të konsiderueshme.

64. Për të nxitur menaxhimin e mirë të rrezikut dhe për të harmonizuar kërkesat për kapital rregullator me praktikën e industrisë, kërkesa për kapital dhe aftësi paguese duhet të përcaktohet si kapitali ekonomik që duhet të mbahet nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit për të garantuar që paaftësia paguese të mos ndodhë më shpesh se sa një herë në çdo 200 raste, ose, përndryshe, që këto shoqëri të jenë ende në gjendje, me një probabilitet të paktën 99,5%, që të përmbushin detyrimet e tyre ndaj mbajtësve të policave dhe përfituesve përgjatë 12 muajve pasardhës. Kapitali ekonomik duhet të llogaritet mbi bazën e profilit të vërtetë të rrezikut të

këtyre shoqërive, duke marrë në konsideratë ndikimin e teknikave të mundshme për zbutjen e rrezikut si edhe efektet e diversifikimit.

65. Duhet të parashikohen dispozita për përcaktimin e një formule standarde për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese në mënyrë që të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të kenë mundësi të vlerësojnë kapitalin e tyre ekonomik. Për strukturën e formulës standarde duhet të miratohet një qasje modulare, që do të thotë se si hap i parë duhet të vlerësohet ekspozimi individual ndaj çdo kategorie rreziku dhe më pas në një hap të dytë këto ekspozime të agregohen. Kur përdorimi i parametrave specifike për shoqërinë lejon pasqyrimin më të mirë të profilit të vërtetë të rrezikut të marrjes në sigurim për shoqërinë, atëherë këto parametra duhet të përdoren me kusht që të gjenerohen nëpërmjet një metodologjie të standardizuar.

66. Për pasqyrimin e rrethanave specifike të shoqërive të vogla dhe të mesme, duhet të parashikohen qasje të thjeshtësuara për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në përputhje me formulën standarde.

67. Në parim, një qasje e re e bazuar në rrezik nuk përfshin konceptin e kufizimeve sasiore në investime dhe kriteret për kualifikimin e aktiveve. Megjithatë, për trajtimin e rreziqeve që nuk mbulohen sa duhet nga një nënmodul i formulës standarde duhet të prezantohen kufizimet e investimeve dhe kriteret për kualifikimin e aktiveve.

68. Në përputhje me qasjen e orientuar drejt rrezikut ndaj kërkesave për kapital dhe aftësi paguese, në rrethana specifike, duhet të lejohet përdorimi i modeleve të pjesshme ose të plota për llogaritjen e kësaj kërkesë në vend të përdorimit të formulës standarde. Me qëllim që mbajtësve të policave dhe përfituesve t'u garantohet një nivel ekuivalent mbrojtjeje, këto modele të brendshme duhet të jenë objekt i miratimit paraprak pas mbikëqyrjes sipas proceseve dhe standardeve të harmonizuara.

69. Kur sasia e fondeve të veta bazë bie nën kërkesën për kapitalin minimal, autorizimi i shoqërive të sigurimit dhe risigurimit duhet të tërhiqet kur këto shoqëri nuk janë në gjendje të rivendosin shumën e fondeve të veta bazë që kërkohen në nivelin e kërkesës për kapital minimal brenda një periudhe të shkurtër kohore.

70. Kërkesa për kapital minimal duhet të garantojë një nivel minimal nën të cilin kjo sasi e burimeve financiare nuk duhet të bjerë. Duhet që niveli të llogaritet sipas një formule të thjeshtë, e cila është objekt i një dyshemeje dhe tavani sipas kërkesës për kapital dhe aftësi paguese bazuar në rrezik për të lejuar një mbikëqyrje të kategorizuar dhe ky nivel duhet të bazohet mbi të dhëna që mund të auditohen.

71. Shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit duhet të kenë aktive me cilësi të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e përgjithshme financiare. Të gjitha investimet në pronësi të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit duhet të administrohen në përputhje me parimin e "personit të kujdesshëm".

72. Shtetet anëtare nuk duhet t'i kërkojnë shoqërive të sigurimit ose të risigurimit që t'i investojnë aktivet e tyre në kategori të veçanta aktivesh, duke qenë se kjo kërkesë mund të mos jetë e pajtueshme me liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit që parashikohet në nenin 56 të traktatit.

73. Kur një marrës në sigurim është risiguruar nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi e autorizuar sipas kësaj direktive, ose nga një shoqëri e një vendi të tretë për rastet kur regjimi mbikëqyrës i atij vendi të tretë është konsideruar ekuivalenti, duhet që të ndalohet çdo dispozitë që i mundëson shteteve anëtare që të kërkojnë të lënë si garanci aktivet që mbulojnë provigjonet teknike të një shoqërie sigurimi ose risigurimi.

74. Deri më tani kuadri ligjor nuk ka parashikuar as kritere të detajuara për një vlerësim të kujdesshëm të një blerjeje të propozuar dhe as një procedurë për zbatimin e tyre. Për rrjedhojë nevojitet një sqarim i kritereve dhe i procesit të vlerësimit të kujdesshëm në mënyrë që të ofrohet siguria, qartësia dhe parashikueshmëria juridike e nevojshme për sa i përket procesit të vlerësimit si edhe rezultateve të tij. Këto kritere dhe procedura janë prezantuar nga dispozitat e Direktivës 2007/44/KE. Për sa i përket sigurimit dhe risigurimit këto dispozita duhet të kodifikohen dhe të integrohen në direktivë.

75. Ndaj harmonizimi maksimal i këtyre procedurave dhe vlerësimeve të kujdeshme në të gjithë Komunitetin është shumë i rëndësishëm. Megjithatë, dispozitat për pjesëmarrjet influencuese nuk duhet t'i pengojnë shtetet anëtare që të kërkojnë që autoritetet mbikëqyrëse të informohen për blerjen e pjesëmarrjeve nën cakun e përcaktuar në këto dispozita, për sa kohë që një shtet anëtar nuk vendos më shumë se një cak shtesë nën 10% për këtë qëllim. Këto dispozita nuk duhet të pengojnë as autoritetet mbikëqyrëse që të japin udhëzime të përgjithshme për rastet kur këto pjesëmarrje gjykohen se rezultojnë në influencë të konsiderueshme.

76. Me qëllim për të rritur lëvizshmërinë e qytetarëve të Bashkimit Evropian, sigurimi i detyrimit motorik po ofrohet gjithmonë e më shumë në nivel ndërkufitar. Për të garantuar mbarëvajtjen e vazhdueshme të sistemit të kartonit jeshil dhe marrëveshjeve ndërmjet byrove kombëtare të ofruesve të sigurimit motorik, duhet që shtetet anëtare të kenë mundësi t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit që ofrojnë sigurimin e detyrimit motorik në territorin e tyre nëpërmjet ofrimit të shërbimeve që të bashkohen me dhe të marrin pjesë në financimin e byrosë kombëtare si edhe të fondit të garancisë të krijuar në atë shtet anëtar. Shteti anëtar që siguron shërbimet duhet t'u kërkojë sipërmarrjeve që sigurojnë detyrimin e sigurimit motorik emërimin e një përfaqësuesi në territorin e tij për mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm, në lidhje me ankimet dhe për përfaqësimin e sipërmarrjes përkatëse.

77. Në kuadrin e tregut të brendshëm është në interes të mbajtësve të policave që ata të kenë qasje në një gamë sa më të gjerë të produkteve të sigurimit që ofrohen në Komunitet. Për rrjedhojë, shteti anëtar ku ndodhet rreziku ose shteti anëtar i angazhimit duhet të garantojnë se në territorin e tij nuk ka asgjë që të pengojë tregtimin e produkteve të sigurimit që ofrohen për shitje në Komunitet për sa kohë që këto produkte nuk bien në kundërshtim me dispozitat ligjore që mbrojnë të mirën e përgjithshme që janë në fuqi në atë shtet anëtar dhe për sa kohë që e mira e përgjithshme nuk mbrohet nga rregullat e shtetit anëtar të origjinës.

78. Duhet të parashikohet një sistem sanksionesh për rastet kur, në shtetin anëtar ku ndodhet rreziku ose në shtetin anëtar të angazhimit, një shoqëri sigurimi nuk vepron në pajtim me ndonjë dispozitë të zbatueshme që mbron të mirën e përgjithshme.

79. Në një treg të brendshëm për sigurimet, konsumatorët kanë një mundësi më të madhe dhe më të gjerë për të zgjedhur kontratat. Nëse ata duhet të marrin përfitime të plota nga kjo

larmi dhe nga konkurrenca e shtuar, konsumatorëve duhet t'u jepet gjithë informacioni i nevojshëm përpara lidhjes së një kontrate dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës në mënyrë që ata të kenë mundësi të zgjedhin kontratën që i përshtatet më së miri nevojave të tyre.

80. Një shoqëri sigurimi që ofron kontrata asistence duhet të zotërojë mjetet e nevojshme për të ofruar përfitimet në natyrë që ofron brenda një periudhe kohore të përshtatshme. Duhet të përcaktohen dispozita të veçanta për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi dhe për nivelin minimal absolut të kërkesës për kapital minimal, të cilat duhet të zotërohen nga kjo shoqëri.

81. Zhvillimi efikas i veprimtarive të bashkësigurimit në Komunitet për veprimtari të cilat për nga natyra ose përmasa e tyre mund të mbulohen nga bashkësigurimi ndërkombëtar, duhet të mbështetet me një harmonizim minimal me qëllim parandalimin e shtrembërimeve të konkurrencës dhe të trajtimit të diferencuar. Në këtë kontekst, shoqëria kryesuese e sigurimit duhet të vlerësojë dëmet dhe të caktojë shumën e provigjoneve teknike. Gjithashtu, në fushën e bashkësigurimit në Komunitet duhet të parashikohet bashkëpunimi i veçantë midis autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare dhe ndërmjet këtyre autoriteteve dhe Komisionit.

82. Për të mbrojtur interesin e personave të siguruar, duhet të harmonizohet legjislacioni i brendshëm në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore. Çdo konflikt interesi që lind, veçanërisht, nga fakti që një shoqëri sigurimi mbulon një person tjetër ose mbulon një person si për shpenzimet ligjore dhe për çdo kategori tjetër sigurimi duhet të mënjanohet sa më shumë që të jetë e mundur ose të eliminohet. Për këtë qëllim, niveli i përshtatshëm i mbrojtjes së mbajtësve të policave mund të arrihet nëpërmjet mjeteve të ndryshme. Cilado zgjidhje që të përdoret, interesi i personave që kanë mbulim për shpenzimet ligjore duhet të mbrohet nëpërmjet masave mbrojtëse ekuivalente.

83. Konfliktet ndërmjet personave të siguruar dhe shoqërive të sigurimit që mbulojnë shpenzimet ligjore duhet të zgjidhen në mënyrën më të drejtë dhe më të shpejtë të mundshme. Ndaj duhet që shtetet anëtare të parashikojnë një procedurë arbitrazhi ose një procedurë që ofron garanci të krahasueshme.

84. Në disa shtete anëtare, sigurimi privat ose vullnetar i shëndetit shërben si alternativë e pjesshme ose e plotë për mbulimin për shëndetin që ofrohet nga sistemet e sigurimeve shoqërore. Natyra e veçantë e këtyre sigurimeve shëndetësore e dallon atë nga kategoritë e tjera të sigurimit të përgjegjësive profesionale dhe sigurimit të jetës deri në masën që është e nevojshme për të garantuar që mbajtësit e policave kanë qasje efektive në sigurimin privat të shëndetit ose sigurimin e shëndetit të bërë mbi baza vullnetare pavarësisht moshës ose profilit të tyre të rrezikut. Për shkak të natyrës dhe pasojave sociale të kontratave të sigurimit të shëndetit, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhet rreziku duhet të kenë mundësi të kërkojnë njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policës në rastin e sigurimit privat ose vullnetar të shëndetit me qëllim që të verifikojnë nëse këto kontrata janë një alternativë e pjesshme ose e plotë e mbulimit të shëndetit që ofrohet nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Ky verifikim nuk duhet të jetë kusht paraprak për tregtimin e produkteve.

85. Për këtë qëllim, disa shtete anëtare kanë miratuar dispozita ligjore specifike. Për të mbrojtur të mirën e përgjithshme, këto dispozita ligjore duhet të miratohen dhe të mbeten në fuqi për sa kohë që nuk kufizojnë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën e themelimit ose lirinë për të

ofruar shërbime, duke e bërë të qartë se këto dispozita duhet të zbatohen në një mënyrë identike. Këto dispozita ligjore mund të ndryshojnë për nga natyra sipas kushteve në secilin shtet anëtar. Objektivi i mbrojtjes së të mirës së përgjithshme mund të arrihet edhe duke u kërkuar shoqërive që ofrojnë sigurim privat të shëndetit ose sigurim vullnetar të shëndetit që të ofrojnë polica standarde sipas mbulimit që ofrohet nga skemat statutoire të sigurimeve shoqërore me një nivel primi të barabartë ose më të vogël se sa maksimumi i përcaktuar dhe që të marrin pjesë në skemat për kompensimin e humbjeve. Si një opsion tjetër, mund të kërkohej që baza teknike e sigurimit privat ose vullnetar të shëndetit të jetë e ngjashme me atë të sigurimit të jetës.

86. Shtetet anëtare pritëse duhet të kenë mundësi që t'i kërkojnë çdo shoqërie sigurimi që ofron në territorin e tyre sigurim të detyrueshëm nga aksidentet në punë që, me rrezikun e vet, të respektojë dispozitat e përcaktuara në legjisllacionin e tyre të brendshëm për këtë sigurim. Megjithatë, kjo kërkesë nuk duhet të zbatohet për dispozitat në lidhje me mbikëqyrjen financiare, të cilat duhet të mbesin përgjegjësi ekskluzive e shtetit anëtar të origjinës.

87. Në disa shtete anëtare transaksionet e sigurimeve nuk janë objekt i asnjë forme tatimi indirekt, ndërsa në shumicën prej tyre zbatohen tatime të veçanta dhe forma të tjera kontributi, duke përfshirë mbitarifimet që synohen për organet e kompensimit. Struktura dhe niveli i këtyre taksave dhe kontributeve kanë ndryshime të konsiderueshme në shtetet anëtare të ndryshme ku ato zbatohen. Preferohet që ndryshimet ekzistuese që çojnë në shtrembërim të konkurrencës në shërbimet e sigurimeve midis shteteve anëtare të parandalohen. Deri në harmonizimin e mëvonshëm, ky problem mund të korrigjohet nga zbatimi i sistemeve tatimore dhe formave të tjera të kontributit që parashikohen nga shtetet anëtare ku ndodhet rreziku ose në shtetin anëtar të angazhimit dhe u takon shteteve anëtare që të marrin masa për të garantuar mbledhjen e këtyre taksave dhe kontributeve.

88. Ato shtete anëtare që nuk janë të detyruar të zbatojnë Rregulloren (KE) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 qershor 2008, "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore", në përputhje me këtë direktivë, duhet të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje për të përcaktuar legjisllacionin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit që përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

89. Për të marrë në konsideratë aspektet ndërkombëtare të risigurimeve duhet të parashikohen dispozita që mundësojnë lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me vende të treta me synimin për të përcaktuar mënyrat e mbikëqyrjes së subjekteve të risigurimit që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e çdo pale kontraktore. Gjithashtu, duhet të parashikohet një procedurë fleksibël që mundëson vlerësimin e ekuivalencës së kujdesshme të Komunitetit me vendet e treta me qëllim që të përmirësohet liberalizimi i shërbimeve të risigurimit në vendet e treta nëpërmjet themelimit të biznesit ose ofrimit të shërbimeve në nivel ndërkufitar.

90. Për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarive të risigurimit fundor, shtetet anëtare duhet të sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që hyjnë në kontrata risigurimi fundore ose që zhvillojnë veprimtari të risigurimit fundor të mund të identifikojnë matrin dhe të kontrollojnë siç duhet rreziqet që lindin nga këto kontrata ose veprimtari.

91. Duhet të parashikohen rregulla të përshtatshme për shoqëritë e qëllimit të veçantë që ndërmarrin rreziqe nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit pa qenë shoqëri sigurimi ose

risigurimi. Shumat e rikuperueshme nga një shoqëri e qëllimit të veçantë duhet të konsiderohen si shuma të zbritshme në zbatim të kontratave të risigurimit ose të retrocesionit.

92. Shoqëritë e qëllimit të veçantë që janë autorizuar përpara datës 31 tetor 2012 duhet të jenë objekt i legjislacionit të shtetit anëtar që ka autorizuar shoqërinë e qëllimit të veçantë. Megjithatë, për të shmangur arbitrazhin rregullator, çdo aktivitet i ri i nisur nga një shoqëri e qëllimit të veçantë pas datës 31 tetor 2012 duhet të jetë objekt i dispozitave të kësaj direktive.

93. Duke marrë në konsideratë natyrën ndërkufitare të veprimtarisë së sigurimeve, ndryshimet midis regjimeve të shteteve anëtare për shoqëritë e qëllimit të veçantë që janë objekt i dispozitave të kësaj direktive, duhet të ulen sa më shumë që të jetë e mundur, duke marrë në konsideratë strukturat e tyre mbikëqyrëse.

94. Për shoqëritë e qëllimit të veçantë duhet të kryhet punë e mëtejshme bazuar në punën e ndërmarrë në sektorët e tjerë financiarë.

95. Masat në lidhje me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit në një grup duhet t'u mundësojnë autoriteteve që mbikëqyrin një shoqëri sigurimi ose risigurimi që të formojnë një gjykim më të saktë për situatën e saj financiare.

96. Mbikëqyrja e këtij grupi duhet të marrë në konsideratë deri në masën që është e nevojshme shoqëritë kontrolluese të sigurimit dhe shoqëritë kontrolluese të sigurimit me veprimtari të përzier. Megjithatë, kjo direktivë nuk duhet të nënkuptojë në asnjë mënyrë se shteteve anëtare u kërkohet që të mbikëqyrin këto shoqëri në mënyrë individuale.

97. Ndërkohë që mbikëqyrja e shoqërive individuale të sigurimit dhe risigurimit mbetet parimi thelbësor i mbikëqyrjes së sigurimeve duhet që të përcaktohet se cilat shoqëri përfshihen në fushën e zbatimit të mbikëqyrjes në nivel grupi.

98. Sipas legjislacionit komunitar dhe atij të brendshëm, shoqëritë, në veçanti shoqatat e ndërsjella, duhet të jenë në gjendje të formojnë përqendrime ose grupe, jo nëpërmjet lidhjeve të kapitalit, por nëpërmjet marrëdhënieve të formalizuara të forta dhe të qëndrueshme, bazuar në njohje kontraktuale ose njohje të tjera të rëndësishme që garantojnë solidaritetin financiar ndërmjet këtyre shoqërive. Kur influenca dominuese ushtrohet nëpërmjet një koordinimi të centralizuar, këto shoqëri duhet të mbikëqyren në përputhje me të njëjtat rregulla që parashikohen për grupet që përbëhen nga lidhje të kapitalit me qëllim për të arritur një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje për mbajtësit e policave dhe rregulla të barabarta loje ndërmjet grupeve.

99. Mbikëqyrja e grupit, në çdo rast, duhet të zbatohet në nivel të shoqërisë mëmë që ka zyrën kryesore në Komunitet. Megjithatë, shtetet anëtare duhet t'u lejojnë autoriteteve të tyre mbikëqyrëse që të mbikëqyrin grupin me një numër të kufizuar të shoqërive të niveleve më të ulëta, kur ata e gjykojnë të nevojshme.

100. Aftësia paguese për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që janë pjesë e grupit duhet të llogaritet në nivel grupi.

101. Kërkesa e konsoliduar për kapital dhe aftësi paguese për një grup duhet të marrë në konsideratë diversifikimin global të rreziqeve që ekzistojnë në të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në atë grup për të pasqyruar siç duhet ekspozimet e këtij grupi ndaj rrezikut.

102. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që i përkasin një grupi duhet të jenë në gjendje të aplikojnë për miratimin e një modeli të brendshëm që mund të përdoret për llogaritjen e aftësisë paguese në nivel grupi dhe në nivel individual.

103. Disa dispozita të kësaj direktive parashikojnë shprehimisht një rol ndërmjetësues ose konsultativ të CEIOPS, por kjo s'e përjashton CEIOPS që të luajë një rol ndërmjetësues ose konsultativ edhe në lidhje me dispozita të tjera.

104. Kjo direktivë pasqyron një model mbikëqyrës novator ku mbikëqyrësit të grupit i caktohet një rol kyç, ndërkohë që pranohet dhe ruhet roli i rëndësishëm për mbikëqyrësin e vetëm. Kompetencat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësve janë të lidhura me llogaridhënien e tyre.

105. Të gjithë mbajtësit e policave dhe përfituesit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht kombësisë ose vendbanimit të tyre. Për këtë qëllim, çdo shtet anëtar duhet të garantojë se të gjitha masat e marra nga një autoritet mbikëqyrës bazuar në mandatin kombëtar të këtij autoriteti mbikëqyrës nuk konsiderohen si në kundërshtim me interesat e atij shteti anëtar ose të mbajtësve të policës ose përfituesve në atë shtet anëtar. Në të gjitha situatat e pagesës së dëmeve ose likuidimit, aktivet duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë mbajtësit përkatës të policave, pavarësisht kombësisë ose vendbanimit të tyre.

106. Duhet të garantohet se të gjitha fondet e veta shpërndahen siç duhet brenda grupit dhe janë të disponueshme për të mbrojtur mbajtësit e policave dhe përfituesit, kur është e nevojshme. Për këtë qëllim, shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit brenda një grupi duhet të kenë fonde të veta të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat për kapital dhe aftësi paguese.

107. Të gjithë mbikëqyrësit e përfshirë në mbikëqyrjen e grupit duhet të kuptojnë vendimet e marra, veçanërisht në rastin kur këto vendime merren nga mbikëqyrësi i grupit. Për rrjedhojë, sapo njëri prej mbikëqyrësve të marrë informacione të rëndësishme, ai duhet t'i ndajë ato me mbikëqyrësit e tjerë në mënyrë që të gjithë mbikëqyrësit të jenë në gjendje të formojnë një opinion bazuar mbi të njëjtat informacione të rëndësishme. Në rast se mbikëqyrësit në fjalë nuk arrijnë dot në një marrëveshje, për zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të kërkohen këshilla të kualifikuara nga CEIOPS.

108. Aftësia paguese e një filiali të një shoqërie sigurimi ose risigurimi, ose një shoqërie kontrolluese sigurimi, një shoqërie sigurimi ose risigurimi në një vend të tretë mund të ndikohet nga burimet financiare të grupit tek i cili ajo bën pjesë dhe nga shpërndarja e burimeve financiare brenda këtij grupi. Ndaj, autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë në dispozicion të njëjtat mjete për të ushtruar mbikëqyrjen e grupit dhe për të marrë masat e përshtatshme në nivelin e shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në rastet kur aftësia e saj paguese është ose mund të jetë në rrezik.

109. Përqendrimet e rrezikut dhe transaksionet brenda grupit mund të ndikojnë në pozicionin financiar të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit. Ndaj, autoritetet mbikëqyrëse duhet të jenë në gjendje të mbikëqyrin këto përqendrime rreziku dhe transaksione brenda grupit duke marrë në konsideratë natyrën e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të rregulluara si edhe

subjekteve të parregulluara, duke përfshirë shoqëritë kontrolluese të sigurimit dhe shoqëritë kontrolluese të sigurimit me veprimtari të përzier, dhe të marrin masat e përshtatshme në nivel shoqërie sigurimi dhe risigurimi kur aftësia e saj pagueuese është ose mund të jetë e rrezikuar.

110. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit brenda një grupi duhet të kenë sisteme rregullatore të përshtatshme të cilat duhet të jenë objekt i rishikimit mbikëqyrës.

111. Të gjitha grupet e sigurimit dhe risigurimit që janë objekt i mbikëqyrjes së grupit duhet të emërojnë një mbikëqyrës të grupit midis autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira. Të drejtat dhe detyrat e mbikëqyrësit të grupit duhet të përfshijnë kompetencat e përshtatshme koordinuese dhe vendimmarrëse. Autoritetet e përfshira në mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që i përkasin të njëjtit grup duhet të vendosin marrëveshje koordinimi.

112. Duke marrë në konsideratë kompetencat në rritje të mbikëqyrësve duhet të ketë garanci që parandalojnë anashkalimin arbitrar të kriterëve për zgjedhjen e mbikëqyrësit të grupit. Në veçanti, në rastet kur mbikëqyrësi i grupit përcaktohet duke marrë në konsideratë strukturën e grupit dhe rëndësinë relative të veprimtarive të sigurimit dhe risigurimit në tregje të ndryshme, transaksionet e brendshme të grupit si edhe risigurimi i grupit nuk duhet të llogariten dy herë gjatë vlerësimit të rëndësisë së tyre relative brenda një tregu.

113. Mbikëqyrësit nga të gjitha shtetet anëtare ku janë themeluar shoqëritë e grupit duhet të përfshihen në mbikëqyrjen e grupit nëpërmjet një kolegji mbikëqyrësish (Kolegji). Të gjithë ata duhet të kenë qasjen në informacionin e disponueshëm për autoritetet e tjera mbikëqyrëse brenda Kolegjit dhe ata duhet të përfshihen në vendimmarrje në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme. Duhet të vendoset bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit si edhe ndërmjet atyre autoriteteve dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e shoqërive që janë aktive në sektorë të tjerë financiar.

114. Veprimtaritë e Kolegjit duhet të jenë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve të qenësishme të veprimtarive të të gjitha shoqërive që janë pjesë e grupit dhe me dimensionin ndërkufitar. Kolegji duhet të krijohet për të garantuar zbatimin efektiv të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe proceseve të konsultimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të kolegjit, në pajtim me këtë direktivë. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të përdorin Kolegjin për të nxitur konvergjencën e vendimeve të tyre përkatëse dhe për të bashkëpunuar ngushtë për kryerjen e veprimtarive të tyre mbikëqyrëse në të gjithë grupin sipas kriterëve të harmonizuara.

115. Kjo direktivë duhet të parashikojë rolin konsultativ të CEIOPS. Këshillat që CEIOPS jep për mbikëqyrësin përkatës nuk duhet të jenë të detyrueshme për këtë mbikëqyrës kur ai merr vendimet e veta. Megjithatë, për marrjen e një vendimi mbikëqyrësi përkatës merr plotësisht në konsideratë këtë këshillë dhe shpjegon çdo devijim të konsiderueshëm prej saj.

116. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që janë pjesë e një grupi, kryesuesi i të cilit ndodhet jashtë Komunitetit, duhet t'i nënshtrohen masave ekuivalente dhe të përshtatshme për mbikëqyrjen e grupit. Ndaj, duhet që të parashikohen rregulla transparente dhe shkëmbimi i informacionit me autoritetet e vendeve të treta për të gjitha situatat përkatëse. Për të garantuar një qasje të harmonizuar për përcaktimin dhe vlerësimin e ekuivalencës së mbikëqyrjes së

sigurimeve dhe risigurimeve në një vend të tretë, duhet të parashikohet që Komisioni të marrë një vendim detyrues në lidhje me ekuivalencën e regjimeve të aftësisë paguese në vendet e treta. Për vendet e treta për të cilat Komisioni nuk ka marrë asnjë vendim, vlerësimi i ekuivalencës duhet të bëhet nga mbikëqyrësi i grupit pas konsultimeve me autoritetet e tjera mbikëqyrëse.

117. Meqenëse legjislacioni i brendshëm në lidhje me masat e riorganizimit dhe me procedurat e likuidimit nuk është i harmonizuar, duhet që, në kuadrin e tregut të brendshëm, të garantohet njohja e ndërsjellë e masave të riorganizimit dhe e legjislacionit për likuidimin të shteteve anëtare, në lidhje me shoqëritë e sigurimit, si dhe bashkëpunimi i nevojshëm, duke marrë në konsideratë nevojën për bashkim, universalitet, koordinim dhe reklamim të këtyre masave dhe të garantohet trajtimi ekuivalent dhe mbrojtja e kreditorëve në fushën e sigurimeve.

118. Duhet të garantohet që masat e riorganizimit që janë miratuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar me qëllim ruajtjen dhe rikuperimin e sigurisë financiare të një shoqërie sigurimi dhe për të parandaluar, sa më shumë që të jetë e mundur, situatën e likuidimit, të japin efekte të plota në të gjithë Komunitetin. Megjithatë, efektet e çdo mase të tillë të riorganizimit, si dhe procedurat e falimentimit vis-à-vis (ne krahasim) me vendet e treta nuk duhet të ndikohet.

119. Duhet të bëhet një dallim ndërmjet autoriteteve kompetente, për qëllimet e masave të riorganizimit dhe të procedurave të falimentimit, dhe autoritetet mbikëqyrëse të sipërmarrjeve të sigurimit.

120. Përkufizimi i një dege për qëllime të paaftësisë paguese, në përputhje me parimet ekzistuese për paaftësinë paguese, duhet të marrë në konsideratë vetëm personalitetin juridik të shoqërisë së sigurimit. Megjithatë, legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës duhet të përcaktojë mënyrën në të cilën aktivet dhe pasivet e një personi të pavarur që ka një autoritet të përhershëm për të vepruar në cilësinë e agjentit për një shoqëri sigurimi duhet të trajtohen në likuidimin e kësaj shoqërie sigurimi.

121. Duhet të përcaktohen kushte sipas të cilave procedurat e likuidimit, të cilat, pa u bazuar në paaftësinë paguese, përfshijnë një rendi përparësie për pagesën e dëmeve të sigurimit, të përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive. Pretendimet nga punonjësit e një shoqërie sigurimi që lindin nga kontratat e punësimit dhe marrëdhëniet e punësimit duhet të transferohen drejt një skeme kombëtare për garancinë e pagave. Këto pretendime të transferuara duhet të përfitojnë nga trajtimi i përcaktuar në legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës (lex concursus).

122. Masat e riorganizimit nuk përjashtojnë hapjen e procedurave të likuidimit. Për rrjedhojë, procedurat e likuidimit duhet të jenë në gjendje të hapen në mungesë të, ose në vijim të miratimit të masave për riorganizimin dhe ato mund të përfundojnë në shlyerjen e pjesshme të borxhit ose masa të tjera analoge, duke përfshirë masat për riorganizim.

123. Vetëm autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës duhet të kenë autoritetin për të marrë vendime në lidhje me procedurat e likuidimit për shoqëritë e sigurimit. Këto vendime duhet të kenë ndikim në të gjithë Komunitetin dhe duhet të pranohen nga të gjitha shtetet anëtare. Vendimet duhet të publikohen në përputhje me procedurat e shtetit anëtar të origjinës dhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Informacioni duhet të vihet në

dispozicion edhe të kreditorëve të njohur që banojnë në Komunitet, të cilët duhet të kenë të drejtë të ankohen dhe të dorëzojnë komente.

124. Të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë së sigurimit duhet të merren në konsideratë gjatë procedurave të likuidimit.

125. Të gjitha kushtet për hapjen, kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit duhet të rregullohen përmes legjislacionit të shtetit anëtar të origjinës.

126. Për të garantuar koordinimin e veprimeve ndërmjet shteteve anëtare, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar dhe ato të të gjitha shteteve të tjera anëtare, duhet të informohen urgjentisht për hapjen e procedurave të likuidimit.

127. Është tejet e rëndësishme që personat e siguar, mbajtësit e policave, përfituesit dhe çdo palë e dëmtuar që ka të drejtë veprimi kundër shoqërisë së sigurimit për një pretendim që lind nga operacionet e marrjes në sigurim të mbrohen gjatë procedurave të likuidimit, sigurisht duke nënkuptuar se kjo mbrojtje nuk përfshin pretendimet që lindin jo nga kontratat e sigurimit ose operacionet e marrjes në sigurim, por nga përgjegjësia civile e shkaktuar nga një agjent, i cili, gjatë negociimit të kësaj kontrate ose këtyre operacioneve, sipas ligjit të zbatueshëm për kontratën ose operacionin e sigurimit, agjenti nuk mban asnjë përgjegjësi sipas kontratës ose operacioneve të sigurimit. Për të arritur këtë objektiv, shtetet anëtare duhet të kenë mundësi të zgjedhin ndërmjet metodave ekuivalente për të garantuar trajtim të veçantë për kreditorët e sigurimit, ku asnjëra prej këtyre metodave të mos e pengojë një shtet anëtar që të bëjë një klasifikim të pretendimeve për sigurim në kategori të ndryshme. Gjithashtu, duhet të garantohet ekuilibri i përshtatshëm ndërmjet mbrojtjes së kreditorëve të sigurimit dhe kreditorëve të tjerë të privilegjuar që mbrohen në zbatim të legjislacionit të shtetit anëtar në fjalë.

128. Hapja e procedurave të likuidimit duhet të përfshijë tërheqjen e autorizimit për të kryer veprimtari, i cili i është dhënë shoqërisë së sigurimit, nëse kjo nuk ka ndodhur ende.

129. Kreditorët duhet të kenë të drejtë të paraqesin pretendime ose të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim gjatë procedurave të likuidimit. Pretendimet e paraqitura nga kreditorët që banojnë në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si pretendimet ekuivalente në shtetin anëtar të origjinës pa bërë asnjë diskriminim mbi bazën e kombësisë ose vendbanimit.

130. Për të mbrojtur pritshmëritë legjitime dhe sigurinë e disa transaksioneve në shtete anëtare të ndryshme nga shteti anëtar i origjinës, duhet të përcaktohet ligji i zbatueshëm për efektet e masave të riorganizimit dhe procedurave të likuidimit për çështjet ligjore që janë në pritje dhe për masat individuale të zbatimit që lindin nga çështjet ligjore.

131. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit.

132. Në veçanti, Komisioni duhet të ketë autoritetin që të miratojë masat në lidhje me përshtatjen e shtojcave dhe masave që specifikojnë, në veçanti, kompetencat mbikëqyrëse dhe veprimet që duhet të ndërmerren dhe që përcaktojnë kërkesat më të detajuara në fusha të tilla si

sistemi rregullator, publikimi, kriteret e vlerësimit në lidhje me pjesëmarrjet influencuese, llogaritja e provigjoneve teknike dhe kërkesave të kapitalit, rregullat e investimit dhe mbikëqyrja e grupit. Komisioni gjithashtu duhet të ketë autoritetin të miratojë masat zbatuese që i japin vendeve të treta statusin e ekuivalencës me dispozitat e kësaj direktive. Duke qenë se këto masa kanë fushë të përgjithshme zbatimi dhe janë hartuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj rregulloreje, ndër të tjera, duke e plotësuar atë me elemente jothelbësore të reja, ato duhet të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të parashikuar në nenin 5/a të Vendimit 1999/468/KE.

133. Meqenëse objektivat e kësaj direktive nuk mund të arrihen plotësisht nga shtetet anëtare në mënyrë individuale, por për shkak të shkallës dhe efekteve të tyre, mund të arrihen më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiarititetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave.

134. Direktiva e Këshillit 64/225/KEE, datë 25 shkurt 1964, “Për shfuqizimin e kufizimeve mbi lirinë e themelimit dhe lirinë për ofrimin e shërbimeve, në lidhje me risigurimin dhe retrocesionin”; Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 korrik 1973, që shfuqizon kufizimet për lirinë e themelimit në biznesin e sigurimit të drejtpërdrejtë, të ndryshëm nga sigurimet jetë; Direktiva e Këshillit 76/580/KEE, datë 29 qershor 1976, që ndryshon Direktivën 73/239/KEE “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit të drejtpërdrejtë, të ndryshme nga sigurimet jetë”; dhe Direktiva e Këshillit 84/641/KEE, datë 10 dhjetor 1984, “Për ndryshimin, veçanërisht për sa i përket mbështetjes së turistëve”, Direktivën e Parë (73/239/KEE) “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit të drejtpërdrejtë, të ndryshme nga sigurimet jetë” nuk janë më të përdorshme dhe për pasojë duhet të shfuqizohen.

135. Detyrimi për transpozimin e kësaj direktive në legjislacionin e brendshëm duhet të kufizohet në ato dispozita që paraqesin ndryshime thelbësore krahasuar me direktivën e mëparshme. Detyrimi për transpozimin e dispozitave të pandryshuara është parashikuar në direktivat e mëparshme.

136. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë detyrimet e shteteve anëtare për afatin kohor për transpozim në legjislacionin e brendshëm të direktivave të përcaktuara në shtojcën VI, pjesa B.

137. Komisioni do të rishikojë mjaftueshmërinë e skemave ekzistuese të garancisë në sektorin e sigurimeve dhe do të bëjë një propozim legjislativ të përshtatshëm.

138. Neni 17, paragrafi 2 i Direktivës 2003/41/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, datë 3 qershor 2003, “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve për ofrimin e pensionit profesional” i referohet dispozitave legjislative ekzistuese për nivelet e aftësisë pague. Këto referenca duhet të ruhen me qëllim që të ruhet "status quo"-ja. Komisioni duhet të kryejë rishikimin e Direktivës 2003/41/KE sipas nenit 21, paragrafi 4 të saj sa më shpejt që të jetë e mundur. Komisioni, me mbështetjen e CEIOPS, duhet të përgatisë një sistem të përshtatshëm për rregullat e aftësisë pague në lidhje me institucionet që ofrojnë pensione profesionale, ndërkohë

që pasqyron plotësisht dallimin thelbësor të sigurimit dhe për pasojë nuk duhet të paragjykojë detyrimin e këtyre institucioneve për të zbatuar këtë direktivë.

139. Miratimi i kësaj direktive ndryshon profilin e rrezikut të shoqërisë së sigurimit kundrejt mbajtësit të policës. Sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për çdo rast përpara fundit të vitit 2010, Komisioni duhet të paraqesë një propozim për rishikimin e Direktivës 2002/92/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, “Për ndërmjetësimin në sigurime”, duke marrë në konsideratë pasojat e kësaj direktive për mbajtësit e policave.

140. Ekziston një nevojë e madhe për një gamë të gjerë reformash për modelin rregullator dhe mbikëqyrës të sektorit financiar të BE-së dhe Komisioni duhet të paraqesë shumë shpejt propozime për këto duke marrë siç duhet në konsideratë përfundimet e paraqitura më datë 25 shkurt 2009 nga grupi i ekspertëve të kryesuar nga Jacques de Larosière. Komisioni duhet të propozojë legjislacionin që nevojitet për të trajtuar mangësitë e identifikuar në lidhje me dispozitat për mbikëqyrjen e koordinuar dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.

141. Duhet të kërkohet këshilla e CEIOPS për mënyrën më të mirë të trajtimit të çështjeve për një mbikëqyrjen të përmirësuar të grupit dhe për administrimin e kapitalit brenda një grupi të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit. CEIOPS duhet të ftohet që të japë këshilla që do të ndihmojnë Komisionin të përgatisë propozimet e tij sipas kushteve që janë konsistente me një nivel të lartë mbrojtjeje të mbajtësve të policave (dhe përfituesve) dhe që ruajnë stabilitetin financiar. Për këtë qëllim, CEIOPS duhet të ftohet që të këshillojë Komisionin për strukturën dhe parimet që mund të udhëzojnë ndryshimet e mundshme të kësaj direktive që mund të nevojiten për të zbatuar ndryshimet që mund të propozohen. Komisioni duhet të dorëzojë një raport të ndjekur nga një propozim i përshtatshëm për Parlamentin Evropian dhe Këshillin për regjime alternative për mbikëqyrjen e kujdesshme të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit brenda grupeve që rrisin administrimin efikas të kapitalit brenda grupeve nëse krijohet bindja se është ngritur një kuadër rregullator mbështetës i përshtatshëm për futjen e një regjimi të tillë.

Në veçanti, preferohet që regjimi në mbështetje të grupit të funksionojë mbi baza të shëndosha që bazohen në ekzistencën e një skeme të harmonizuar për garancitë e sigurimeve, të themeluar siç duhet; një kuadër të harmonizuar dhe detyrues për autoritetet kompetente, bankat qendrore dhe ministritë e financave në lidhje me menaxhimin e krizës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ndarjen e barrës fiskale që harmonizon kompetencat mbikëqyrëse dhe përgjegjësitë fiskale; një kuadër ligjor detyrues për ndërmjetësimin në rastet e mosmarrëveshjeve për mbikëqyrjen; një kuadër të harmonizuar për ndërhyrjen e hershme; dhe në një kuadër të harmonizuar për transferimin e aktiveve, paaftësinë paguese dhe procedurat e likuidimit që eliminon barrierat përkatëse në të legjislacionin e brendshëm për kompanitë dhe korporatat për transferimin e aktiveve. Në raportin e tij Komisioni duhet të marrë në konsideratë edhe trendin e efekteve të diversifikimit përgjatë kohës dhe rrezikun që shoqëron të qenit pjesë e një grupi, praktikën në administrimin e përqendruar të rrezikut në grup, funksionimin e modeleve të brendshme të grupit si edhe mbikëqyrjen e transaksioneve dhe përqendrimeve të rrezikut brenda grupit.

142. Në përputhje me paragrafin 34 të Marrëveshjes ndër-institucionale për hartim më të mirë të legjislacionit, shtetet anëtare nxiten që të hartojnë, për veten e tyre dhe në interes të

Komunitetit, tabela që ilustrojnë, aq sa është e mundur, përputhshmërinë ndërmjet kësaj direktive dhe masave për transpozim dhe t'i bëjnë ato publike.

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

TABELA E LËNDËS

TITULLI I RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR FILLIMIN DHE ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT TË DREJTPËRDREJTË

KAPITULLI I Objekti, fusha e zbatimit dhe përkufizime

SEKSIONI 1 Objekti dhe fusha e zbatimit

SEKSIONI 2 Përjashtimet nga fusha e zbatimit

Nëseksioni 1 Të përgjithshme

Nëseksioni 2 Sigurimi jo-jetë

Nëseksioni 3 Sigurimi jetë

Nëseksioni 4 Risigurimi

SEKSIONI 3 Përkufizime

KAPITULLI II Nisja e veprimtarive

KAPITULLI III Autoritetet mbikëqyrëse dhe rregullat e përgjithshme

KAPITULLI IV Kushtet që rregullojnë veprimtarinë

SEKSIONI 1 Përgjegjësia e organit administrativ, organit drejtues ose atij mbikëqyrës

SEKSIONI 2 Sistemi rregullator

SEKSIONI 3 Bërja publike

SEKSIONI 4 Pjesëmarrjet influencuese

SEKSIONI 5 Sekreti profesional, shkëmbimi i informacionit dhe nxitja e konvergencës së mbikëqyrjes

SEKSIONI 6 Detyrat e audituesve

KAPITULLI V Zhvillimi i veprimtarisë së sigurimit jetë dhe jojetë

KAPITULLI VI Rregullat lidhur me vlerësimin e aktiveve dhe të pasiveve, të provigjoneve teknike, të fondeve të veta, të kërkesave për kapital dhe aftësi paguese, kërkesave për kapital minimal dhe të rregullave të investimit

SEKSIONI 1 Vlerësimi i aktiveve dhe pasiveve

SEKSIONI 2 Rregullat që lidhen me provigjonet teknike

SEKSIONI 3 Fondet e veta

Nëseksioni 1 Përcaktimi i fondeve të veta

Nëseksioni 2 Klasifikimi i fondeve të veta

Nëseksioni 3 Kualifikimi i fondeve të veta

SEKSIONI 4 Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese

Nëseksioni 1 Dispozitat e përgjithshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese duke përdorur formulën standarde ose një model të brendshëm

Nëseksioni 2 Formula standarde e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese

Nëseksioni 3 Modelet e brendshme të plota dhe të pjesshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese

SEKSIONI 5 Kërkesa për kapital minimal

SEKSIONI 6 Investime

KAPITULLI VII Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në vështirësi ose në situata jo të rregullta

KAPITULLI VIII Liria e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve

SEKSIONI 1 Themelimi nga shoqëritë e sigurimit

SEKSIONI 2 Liria e ofrimit të shërbimeve: nga shoqëritë e sigurimit

Nëseksioni 1 Dispozita të përgjithshme

Nëseksioni 2 Detyrimi i mjeteve motorike nga palët e treta

SEKSIONI 3 Kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës

Nëseksioni 1 Sigurimet

Nëseksioni 2 Risigurimet

SEKSIONI 4 Informacione statistikore

SEKSIONI 5 Trajtimi i kontratave të degëve në procedurat e falimentimit

KAPITULLI IX Degët e themeluara brenda komunitetit në pronësi të shoqërive të sigurimit ose risigurimit me zyra qendrore që ndodhen jashtë komunitetit

SEKSIONI 1 Fillimi i veprimtarive

SEKSIONI 2 Risigurimet

KAPITULLI X Filialet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që rregullohen nga ligjet e një vendi të tretë ose blerja e pjesëmarrjeve nga këto shoqëri

TITULLI II DISPOZITA SPECIFIKE PËR SIGURIMET DHE RISIGURIMET

KAPITULLI I Legjislacioni i zbatueshëm dhe kushtet e kontratave të sigurimit të drejtpërdrejtë

SEKSIONI 1 Ligji i zbatueshëm

SEKSIONI 2 Sigurimi i detyrueshëm

SEKSIONI 3 E mira e përgjithshme

SEKSIONI 4 Kushtet e kontratave të sigurimit dhe nivelet e primeve

SEKSIONI 5 Informacion për mbajtësit e policave

Nënsesioni 1 Sigurimi jo-jetë

Nënsesioni 2 Sigurimi jetë

KAPITULLI II Dispozita specifike për sigurimin jo-jetë

SEKSIONI 1 Dispozita të përgjithshme

SEKSIONI 2 Bashkë-sigurimi komunitar

SEKSIONI 3 Asistenca

SEKSIONI 4 Sigurimi i shpenzimeve ligjore

SEKSIONI 5 Sigurimi i shëndetit

SEKSIONI 6 Sigurimi nga aksidentet në punë

KAPITULLI III Dispozita specifike për sigurimin jetë

KAPITULLI IV Rregullat specifike për risigurimin

TITULLI III MBIKËQYRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT
NË NJË GRUP

KAPITULLI I Mbikëqyrja e grupit: përkufizime, rastet e zbatimit, fusha e zbatimit dhe nivelet

SEKSIONI 1 Përkufizime

SEKSIONI 2 Rastet e zbatimit dhe fusha e zbatimit

SEKSIONI 3 Nivelet

KAPITULLI II Pozicioni financiar

SEKSIONI 1 Aftësia paguese e grupit

Nëseksioni 1 Dispozita të përgjithshme

Nëseksioni 2 Zgjedhja e metodës së llogaritjes dhe parime të përgjithshme

Nëseksioni 3 Zbatimi i metodave të llogaritjes

Nëseksioni 4 Metodatat e llogaritjes

Nëseksioni 5 Mbikëqyrja e aftësisë paguese të grupit për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që janë filiale të një shoqërie sigurimi kontrolluese

Nëseksioni 6 Mbikëqyrja e aftësisë paguese të grupit për grupet me menaxhim të centralizuar të rrezikut

SEKSIONI 2 Përqendrimi i rrezikut dhe transaksionet brenda grupit

SEKSIONI 3 Menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm

KAPITULLI III Masat që lehtësojnë mbikëqyrjen e grupit

KAPITULLI IV Vendet e treta

KAPITULLI V Shoqëri sigurimi kontrolluese me veprimtari të përzier

TITULLI IV RIORGANIZIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

KAPITULLI I Fusha e zbatimit dhe përkufizime

KAPITULLI II Masat e riorganizimit

KAPITULLI III Procedurat e likuidimit

KAPITULLI IV Dispozita të përgjithshme

TITULLI V DISPOZITA TË TJERA

TITULLI VI DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

KAPITULLI I Dispozita kalimtare

SEKSIONI 1 Sigurimet

SEKSIONI 2 Risigurimet

KAPITULLI II Dispozitat përfundimtare

SHTOJCA I KLASAT E SIGURIMIT JOJETË

A. Klasifikimi i rreziqeve sipas klasave të sigurimit

B. Përshkrimi i autorizimeve të dhëna për më shumë se një klasë sigurimi

SHTOJCA II KLASAT E SIGURIMIT JETË

SHTOJCA III FORMAT JURIDIKE TË SHOQËRIVE

A. Format e shoqërisë së sigurimit jo-jetë:

B. Format e shoqërisë së sigurimit jetë:

C. Format e shoqërisë së risigurimit:

SHTOJCA IV FORMULA STANDARDE E KËRKESËS PËR KAPITAL DHE AFTËSI
PAGUESE (SCR)

1. Llogaritja e kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese

2. Llogaritja e marrjes në sigurim për modulën jo-jetë

3. Llogaritja e modulit të rrezikut për sigurimin jetë

4. Llogaritja e modulit të rrezikut të tregut

SHTOJCA V GRUPET E KLASAVE TË SIGURIMIT JO-JETË PËR QËLLIMET E
NENIT 159

SHTOJCA VI

Pjesa A Direktivat e shfuqizuara me listat e ndryshimeve pasardhëse (e përmendur në
nenin 310)

Pjesa B Lista e afateve kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm (e përmendur në nenin 310)

SHTOJCA VII TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

TITULLI I

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR FILLIMIN DHE ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE TË SIGURIMIT TË DREJTPËRDREJTË DHE RISIGURIMIT

KAPITULLI I

OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

SEKSIONI 1

OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Objekti

Kjo direktivë përcakton rregullat në lidhje me sa më poshtë:

1. fillimin dhe zhvillimin, brenda Komunitetit, e veprimtarive të sigurimit të drejtpërdrejtë dhe risigurimit;
2. mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe risigurimit;
3. riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive të sigurimit të drejtpërdrejtë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë zbatohet për shoqëritë e sigurimit të drejtpërdrejtë jetë dhe jojetë të themeluara në territorin e një shteti anëtar ose që dëshirojnë të themelohen atje.

Ajo gjithashtu zbatohet për shoqëritë e risigurimit që kryejnë vetëm veprimtari risigurimi dhe janë themeluar në territorin e një shteti anëtar ose që dëshirojnë që të themelohen aty, me përjashtim të titullit IV.

2. Në lidhje me sigurimin jo-jetë, direktiva zbatohet për veprimtaritë e klasave që përcaktohen në pjesën A të shtojcës I. Për qëllimet e nënparagrafit të parë të paragrafit 1, sigurimi jojetë përfshin veprimtaritë që përbëhen nga asistenca që u jepet personave që hasin në vështirësi gjatë udhëtimit, gjatë kohës që janë larg shtëpisë ose larg vendbanimit të tyre të zakonshëm. Ai përfshin një angazhim, kundrejt pagesës paraprake të një primi, për t'i ardhur menjëherë në ndihmë përfituesit sipas një kontrate për ndihmë, kur ai person është në vështirësi

pasi i ka ndodhur një ngjarje e rastësishme, në rastet dhe sipas kushteve që përcaktohen në kontratë.

Ndihma mund të përfshijë ofrimin e përfitimeve në para ose në natyrë. Ofrimi i përfitimeve në natyrë mund të bëhet edhe nëpërmjet stafit dhe pajisjeve të personit që i ofron ato.

Veprimtaria e asistencës nuk mbulon kryerjen e shërbimeve, mirëmbajtjen, shërbimin pas shitjes ose udhëzimin për ose ofrimin e ndihmës si ndërmjetës.

3. Në lidhje me sigurimin jetë, kjo direktivë zbatohet:

a) për veprimtaritë e mëposhtme të sigurimit jetë kur ato bëhen sipas një kontrate:

I. sigurimi jetë që përfshin sigurimin e jetës me mbijetesë vetëm për një moshë të parashikuar, sigurim jete vetëm pasi vdes i siguruari, sigurim jete me mbijetesë për një moshë të parashikuar ose pas vdekjes së parakohshme të të siguruarit, sigurimin jete me kthim të primeve, sigurim jete gjatë martesës, sigurimin e jetës gjatë lindjes;

II. pensionet vjetore;

III. sigurim plotësues përveç sigurimit të jetës, në veçanti, sigurimi nga lëndimet personale duke përfshirë paaftësinë për punë, sigurimin nga vdekja nga aksidentet dhe sigurimi nga aftësia e kufizuar që rezulton nga një aksident ose sëmundje;

IV. llojet e sigurimit të përhershëm të shëndetit që nuk mund të anulohet aktualisht ekzistojnë në Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar;

b) operacionet e mëposhtme, kur janë sipas një kontrate, për sa kohë që ato janë objekt i mbikëqyrjes nga autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurimeve private:

I. operacionet me anë të së cilave ngrihen shoqatat e të siguruarve me qëllimin për të kapitalizuar bashkërisht kontributet e tyre dhe më pas për të shpërndarë aktivet e grumbulluara midis të mbijetuarve ose midis përfituesve të të siguruarve që kanë vdekur (plane investimi);

II. operacionet e kompensimit me kapital bazuar në një llogaritje aktuaristike sipas të cilave në këmbim të një pagese të vetme ose pagesave periodike të miratuara paraprakisht, merren përsipër angazhime sipas një kohëzgjatjeje dhe shume të caktuar;

III. administrimi i fondeve të pensionit në grup, duke përfshirë administrimin e investimeve, dhe në veçanti i aktiveve që përfaqësojnë rezervat e subjekteve nga të cilat bëhen pagesa pas vdekjes së të siguruarit ose në rast mbijetese ose në rastin e ndërprerjes ose shkurtimit të veprimtarisë;

IV. operacionet e përmendura në pikën III kur shoqërohen me sigurim që mbulon ose ruajtjen e kapitalit ose pagesën e një interesi minimal;

V. operacionet që kryen nga shoqëritë e sigurimit jetë, si ato që përmenden në kapitullin 1, titulli 4 i librit IV të "Code des assurances" të Francës;

c) operacionet që lidhen me jetëgjatësinë e njeriut, të cilat përshkruhen ose parashikohen në legjislacionin për sigurimet shoqërore, për sa kohë që kryhen ose administrohen nga shoqëritë e sigurimit jetë në rrezikun e tyre dhe në përputhje me ligjet e një shteti anëtar.

SEKSIONI 2

PËRJASHTIMET NGA FUSHA E ZBATIMIT

NËNSEKSIONI 1

TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Sistemet statutore

Pa cenuar nenin 2, paragrafi 3, germa "c", kjo direktivë nuk zbatohet për sigurimet që janë pjesë e një sistemi statutor të sigurimeve shoqërore.

Neni 4

Përfshirja nga fusha e zbatimit për shkak të përmasës

1. Pa cenuar nenin 3 dhe nenet 5 deri në 10, kjo direktivë nuk zbatohet për një shoqëri sigurimi që përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të ardhurat vjetore të shoqërisë nga primi i shkruar bruto nuk tejkalojnë 5 milion Euro;

b) shuma e provigjoneve teknike të shoqërisë, shumat bruto të rikuperueshme nga kontratat e sigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë, siç përmenden në nenin 76, nuk tejkalojnë 25 milion Euro;

c) kur shoqëria i përket një grupi, totali i provigjoneve teknike të grupit, i përcaktuar si shuma bruto e rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë nuk tejkalon 25 milion Euro;

d) veprimtaritë e shoqërisë nuk përfshijnë veprimtaritë e sigurimit ose risigurimit që mbulojnë rreziqet nga sigurimi i përgjegjësisë, kredisë dhe garancisë, përveç se kur përbëjnë rrezik shtesë sipas kuptimit të nenit 16, paragrafi 1;

e) veprimtaritë e shoqërisë nuk përfshijnë operacionet e risigurimit në tejkallim të 0,5 milion Euro për të ardhurat nga primi i shkruar bruto ose 2,5 milion Euro të provigjoneve teknike bruto të shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë, ose më shumë se 10% e të ardhurave nga primi i shkruar bruto ose më shumë se 10% të provigjoneve teknike bruto të shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë.

2. Nëse ndonjë prej shumave që përcaktohet në paragrafin 1 tejkalohe për tre vite të njëpasnjëshme, kjo direktivë zbatohet duke nisur nga viti i katërt.

3. Duke shfuqizuar paragrafin 1, kjo direktivë zbatohet për të gjitha shoqëritë që kërkojnë autorizim për të zhvilluar veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit për të cilat të ardhurat nga primi i shkruar bruto ose provigjonet teknike bruto të shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë priten që të tejkalojnë ndonjë prej shumave që përcaktohen në paragrafin 1 brenda pesë viteve në vazhdim.

4. Kjo direktivë nuk zbatohet më për ato shoqëri sigurimi për të cilat autoriteti mbikëqyrës ka verifikuar se plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) asnjë prej caqeve të përcaktuara në paragrafin 1 nuk është tejkaluar për tre vitet e mëparshme; dhe

b) asnjë nga caqet e përcaktuara në paragrafin 1 nuk pritet që të tejkalohet për pesë vitet e ardhshme.

Për sa kohë që kjo shoqëri sigurimi zhvillon veprimtaritë sipas neneve 145 deri në 149, paragrafi 1 i këtij neni nuk gjen zbatim.

5. Paragrafët 1 dhe 4 nuk pengojnë asnjë shoqëri që të aplikojë për autorizim ose të vazhdojë të autorizohet në zbatim të kësaj direktive.

NËNSEKSIONI 2

SIGURIMI JOJETË

Neni 5

Veprimet

Në lidhje me sigurimin jojetë, kjo direktivë nuk zbatohet për operacionet e mëposhtme:

1. operacionet e kompensimit me kapital, siç përcaktohen nga legjislacioni i secilit shtet anëtar;

2. operacionet e institucioneve të kursimeve dhe përfitimeve të ndërsjella, përfitimet e të cilëve ndryshojnë sipas burimeve të disponueshme dhe ku kontributet e anëtarëve përcaktohen me një tarifë të sheshtë;

3. operacionet e kryera nga organizatat që nuk kanë personalitet juridik me qëllimin për të ofruar mbulim të ndërsjellë për anëtarët e tyre pa asnjë pagesë primesh apo krijimin e rezervave teknike; ose

4. operacionet e sigurimit të kredisë për eksport për llogari të ose të garantuara nga shteti, ose kur shteti është sigurues.

Neni 6

Asistenca

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për veprimtaritë e asistencës që përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) asistenca jepet në rast aksidenti ose defekti që përfshin një automjet rrugor kur aksidenti ose defekti ndodh në territorin e shtetit anëtar të shoqërisë që ofron mbulim me sigurim;

b) detyrimi për asistencë kufizohet me operacionet e mëposhtme:

I. shërbim i menjëhershëm për defektin për të cilin shoqëria që ofron mbulim me sigurim, në shumicën e rasteve, përdor stafin dhe pajisjet e veta;

II. transferimin e automjetit në vendndodhjen më të afërt ose më të përshtatshme ku mund të kryen riparime dhe shoqërimi i mundshëm, nëpërmjet të njëjtit automjet që ofroi asistencën, i shoferit dhe i pasagjerëve në vendndodhjen më të afërt nga ku ata mund të vazhdojnë udhëtimin me mjete të tjera; dhe

III. kur parashikohet nga shteti anëtar i origjinës së shoqërisë që ofron mbulimin me sigurim, transferimi i automjetit, mundësisht i shoqëruar nga shoferi dhe pasagjerët, në shtëpi, në pikën e nisjes ose në destinacionin fillestar brenda të njëjtit shtet; dhe

c) asistenca nuk kryhet nga një shoqëri që është objekt i kësaj direktive.

2. Në rastet e përmendura në pikat I dhe II të paragrafit 1, germa "B", kushti që aksidenti ose defekti duhet të kenë ndodhur në territorin e shtetit anëtar të shoqërisë që ofron mbulim me sigurim nuk zbatohet kur përfituesi është anëtar i organit që ofron mbulim dhe shërbimi për defektin ose transferimin e automjetit ofrohet thjesht me paraqitjen e kartës së anëtarësisë, pa paguar prim shtesë, nga një organ i ngjashëm në vendin në fjalë mbi bazën e një marrëveshjeje të ndërsjellë, ose, në rastin e Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, kur operacionet e asistencës ofrohen nga një organ i vetëm që funksionon në të dy shtetet.

3. Kjo direktivë nuk zbatohet në rastin e operacioneve që përmenden në pikën III të paragrafit 1, germa "b", kur aksidenti ose defekti ka ndodhur në territorin e Irlandës, ose në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, në territorin e Irlandës së Veriut dhe automjeti, mundësisht i shoqëruar nga shoferi dhe pasagjerët, transferohet në shtëpinë e tyre, në pikën e nisjes ose destinacionin fillestar brenda territorit përkatës.

4. Kjo direktivë nuk zbatohet për asistencën që jepet nga Klubi i Automobilëve të Dukatës së Madhe të Luksemburgut, kur aksidenti ose defekti i automjetit rrugor ka ndodhur jashtë territorit të Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe asistenca jepet duke transferuar automjetin që është përfshirë në atë aksident ose defekt, mundësisht shoqëruar nga shoferi dhe pasagjerët, në shtëpi.

Neni 7

Shoqëritë e përbashkëta

Kjo direktivë nuk zbatohet për shoqëritë e përbashkëta që zhvillojnë veprimtari të sigurimit jojetë dhe që kanë lidhur një marrëveshje me shoqëri të tjera të përbashkëta ku parashikohet risigurimi i plotë i policave të sigurimit të lëshuara prej tyre ose ku parashikohet se shoqëria pranuese duhet të përmbushë detyrimet që lindin nga këto polica në vend të shoqërisë lëshuese. Në këtë rast shoqëria pranuese është objekt i rregullave të kësaj direktive.

Neni 8

Institucionet

Kjo direktivë nuk zbatohet për institucionet e mëposhtme që zhvillojnë veprimtari të sigurimit jojetë, përveç se kur statutet e tyre ose ligji i zbatueshëm ndryshohen në lidhje me kapacitetin:

1. në Danimarkë, Falck Danmark;
2. në Gjermani, institucionet gjysmëpublike si më poshtë:
 - a) Postbeamtenkrankenkasse,
 - b) Krankenversorgung der Bundesbahnbeamten;
3. në Irlandë, Voluntary Health Insurance Board;
4. në Spanjë, Consorcio de Compensación de Seguros.

NËNSEKSIONI 3

SIGURIMI JETË

Neni 9

Operacionet dhe veprimtaritë

Në lidhje me sigurimin jetë, kjo direktivë nuk zbatohet për operacionet dhe veprimtaritë e mëposhtme:

1. operacionet e institucioneve të kursimeve dhe përfitimeve të ndërsjella, përfitimet e të cilëve ndryshojnë sipas burimeve të disponueshme dhe të cilët u kërkojnë secilit prej anëtarëve të kontribuojnë sipas një tarife të sheshtë;
2. operacionet që kryhen nga organizata, përveç shoqërive të përmendura në nenin 2, objekti i të cilave është që të ofrojnë përfitime për personat e punësuar ose të vetëpunësuar, të cilët i përkasin një shoqërie ose një grupi shoqërisht, ose një profesioni ose një grupi profesionesh, në rastin e vdekjes ose mbijetesës së të siguarit, ose ndërprerjes ose shkurtimit të veprimtarisë, qoftë kur angazhimet që lindin nga këto operacione janë plotësisht të mbuluara gjatë gjithë kohës nga provigjonet matematike ose jo;

3. veprimtaritë e për përfitim pensionit nga shoqëritë e sigurimit për përfitim pensioni që përshkruhen në ligjin për pensionin dhe legjislacione të tjera përkatëse në Finlandë nëse:

a) shoqëritë e sigurimit për përfitim pensioni të cilat në zbatim të legjislacionit finlandez janë të detyruara që të mbajnë llogari dhe sisteme administrimi të veçanta për veprimtaritë e tyre të pensionit, që nga data 1 janar 1995, themelojnë subjekte juridike për zhvillimin e këtyre veprimtarive; dhe

b) autoritetet finlandeze, në një mënyrë jo diskriminuese, u lejojnë të gjithë shtetasve dhe shoqërive të shteteve anëtare që sipas legjislacionit finlandez, të kryejnë të gjitha veprimtaritë e specifikuar në nenin 2 në lidhje me këtë përjashtim qoftë nëpërmjet zotërimit ose pjesëmarrjes në një shoqëri ose grup sigurimi ekzistues ose nëpërmjet krijimit ose pjesëmarrjes në shoqëri ose grupe sigurimi të reja, duke përfshirë shoqëritë e sigurimit për përfitim pensioni.

Neni 10

Organizatrat, shoqëritë dhe institucionet

Në lidhje me sigurimin jetë, kjo direktivë nuk zbatohet për organizatat, shoqëritë dhe institucionet e mëposhtme:

1. organizatat që ofrojnë përfitime vetëm në rast vdekjeje të të siguarit, kur shuma e këtyre përfitimeve nuk tejkalon kostot mesatare të funeralit për një vdekje të vetme ose kur përfitimet ofrohen në natyrë;

2. "Versorgungsverband deutscher Wirtschaftsorganisationen" në Gjermani, përveç se kur statutet e tyre ndryshohen për sa i përket fushës së zbatimit të kapacitetit të tyre;

3. "Consortio de Compensación de Seguros" në Spanjë, përveç se kur statutet e tyre ndryshohen për sa i përket fushës së zbatimit të kapacitetit të tyre;

NËNSEKSIONI 4

RISIGURIMI

Neni 11

Risigurimi

Për sa i përket risigurimit, kjo direktivë nuk zbatohet për veprimtarinë e risigurimit që kryhet ose garantohej plotësisht nga qeveria e një shteti anëtar kur kjo qeveri, për arsye të interesit të madh publik, vepron në cilësinë e risiguresit të fundit, duke përfshirë rrethanat kur ky rol kërkohet nga një situatë e krijuar në treg ku nuk mund të arrihet një mbulim tregtar i përshtatshëm.

Neni 12

Shoqëritë e sigurimit që mbyllin veprimtarinë e tyre

1. Shoqëritë e sigurimit të cilat përpara datës 10 dhjetor 2007 nuk kanë lidhur kontrata të reja risigurimi dhe administrojnë vetëm portofolin e tyre ekzistues për të ndërprerë veprimtarinë e tyre, nuk janë objekt i kësaj direktive.

2. Shtetet anëtare duhet të hartojnë një listë të këtyre shoqërive të sigurimit dhe t'ia komunikojë këtë listë të gjitha shteteve të tjera anëtare.

SEKSIONI 3

PËRKUFIZIME

Neni 13

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "shoqëri sigurimi" është një shoqëri sigurimi e drejtpërdrejtë në sektorin jetë ose jo-jetë që ka marrë një autorizim në përputhje me nenin 14;

2. "shoqëri sigurimi e mbyllur" është një shoqëri sigurimi e zotëruar ose nga një shoqëri financiare e ndryshme nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ose nga një grup i shoqërive të sigurimit ose risigurimit sipas kuptimit të nenit 212, paragrafi 1, germa "c", ose nga një shoqëri jofinanciare, qëllimi i së cilës është që të ofrojë mbulim me sigurim vetëm për rreziqet e shoqërisë ose shoqërive të cilave ajo u përket ose të shoqërisë ose shoqërive të një grupi anëtare e së cilit ajo është;

3. "shoqëri sigurimi e një vendi të tretë" është një shoqëri që do të kërkonte autorizim si shoqëri sigurimi në përputhje me nenin 14, nëse zyra e saj kryesore do të ndodhej në Komunitet;

4. "shoqëri risigurimi" është një shoqëri që ka marrë autorizim në përputhje me nenin 14 për të zhvilluar veprimtari risigurimi;

5. "shoqëri risigurimi e mbyllur" është një shoqëri risigurimi e zotëruar ose nga një shoqëri financiare e ndryshme nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ose nga një grup i shoqërive të sigurimit ose risigurimit sipas kuptimit të nenit 212, paragrafi 1, germa "c", ose nga një shoqëri jofinanciare, qëllimi i së cilës është që të ofrojë mbulim me risigurim vetëm për rreziqet e shoqërisë ose shoqërive të cilave ajo u përket ose të shoqërisë ose shoqërive të një grupi anëtare e së cilit ajo është;

6. "shoqëri risigurimi e një vendi të tretë" është një shoqëri që do të kërkonte autorizim si shoqëri risigurimi në përputhje me nenin 14, nëse zyra e saj kryesore do të ndodhej në Komunitet;

7. "risigurim" është secila nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) veprimtaria që ka të bëjë me pranimin e rreziqeve të ceduara nga një shoqëri sigurimi ose një shoqëri sigurimi e një vendi të tretë ose nga një shoqëri tjetër risigurimi ose nga një shoqëri risigurimi e një vendi të tretë; ose

b) në rastin e shoqatës së marrësve në sigurim të njohur si "Lloyd's", veprimtaria që ka të bëjë me pranimin e rreziqeve të ceduara nga çdo anëtar i "Lloyd's", nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi e ndryshme nga shoqata e marrësve në sigurim e njohur si "Lloyd's";

8. "shtet anëtar i origjinës" është secili nga më poshtë:

a) për sigurimin jo-jetë, shteti anëtar ku ndodhet zyra qendrore e shoqërisë së sigurimit që mbulon rrezikun;

b) për sigurimin jetë, shteti anëtar ku ndodhet zyra qendrore e shoqërisë së sigurimit që mbulon angazhimin; ose

c) për risigurimin, shteti anëtar ku ndodhet zyra qendrore e shoqërisë së risigurimit;

9. "shteti anëtar pritës" është shteti anëtar, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, ku shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ka një degë ose ofron shërbime; për sigurimi jetë dhe jo-jetë, shteti anëtar për ofrimet e shërbimeve nënkupton, përkatësisht, shtetin anëtar të angazhimit ose shtetin anëtar ku ndodhet rreziku, kur ky angazhim ose rrezik mbulohet nga një shoqëri sigurimi ose një degë që ndodhet në një shtet tjetër anëtar;

10. "autoritet mbikëqyrës" është autoriteti kombëtar ose autoritetet kombëtare të cilëve ligji ose rregulloret u japin autoritetin që të mbikëqyrin shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit;

11. "degë" është një agjenci ose degë e një shoqërie sigurimi ose risigurimi, e cila ndodhet në territorin e një shteti anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës;

12. "selia" e një shoqërie është zyra e saj kryesore ose secila prej degëve të saj;

13. "shteti anëtar ku ndodhet rreziku" është secili nga sa më poshtë:

a) shteti anëtar ku ndodhet prona, kur sigurimi lidhet me ndërtesat ose me ndërtesat dhe përmbajtjen e tyre, deri në masën që përmbajtja e tyre mbulohet nga e njëjta policë sigurimi;

b) shteti anëtar i regjistrimit, kur sigurimi lidhet me automjetet e çdo lloji;

c) shteti anëtar ku mbajtësi i policës ka prerë policën në rastin e policave me kohëzgjatje 4 mujore ose më të vogël që mbulojnë rreziqet gjatë udhëtimit ose pushimeve, të çfarëdo klase qofshin;

d) në të gjitha rastet që nuk mbulohen shprehimisht nga geramat "a", "b" ose "c", shteti anëtar ku ndodhet një nga sa më poshtë:

I. vendbanimi i zakonshëm i mbajtësit të policës; ose

II. nëse mbajtësi i policës është person juridik, selia e mbajtësit të policës me të cilën lidhet kontrata;

14. "Shteti anëtar i angazhimit" është shteti anëtar ku ndodhet secili nga sa më poshtë:

a) vendbanimi i zakonshëm i mbajtësit të policës;

b) nëse mbajtësi i policës është person juridik, selia e mbajtësit të policës me të cilën lidhet kontrata;

15. "shoqëria mëmë" është shoqëria mëmë sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 83/349/KEE;

16. "filial" është çdo filial sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 83/349/KEE, duke përfshirë filialet e vetë filialit;

17. "lidhje të ngushta" përshkruajnë një situatë ku dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur nëpërmjet kontrollit ose pjesëmarrjes, ose një situatë në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur në mënyrë të përhershme me një person, i cili është i njëjtë për të dy, nëpërmjet një marrëdhënieje kontrolli;

18. "kontroll" është marrëdhënia ndërmjet një shoqërie mëmë dhe një filiali, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 83/349/KEE, ose një marrëdhënie e ngjashme ndërmjet ;do personi fizik ose juridik dhe një shoqërie;

19. "transaksion brenda grupit" është çdo transaksion nëpërmjet së cilit një shoqëri sigurimi ose risigurimi, direkt ose indirekt, mbështetet tek shoqëritë e tjera brenda të njëjtit grup ose tek çdo person fizik ose juridik i lidhur me shoqëritë e atij grupi nëpërmjet lidhjeve të ngushta, për përmbushjen e një detyrimi, kontraktor ose jo, me ose pa pagesë;

20. "pjesëmarrje" është zotërimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes kontrollit, i 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të një shoqërie;

21. "pjesëmarrje influencuese" është pjesëmarrja direkte ose indirekte në një shoqëri, që përfaqëson 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës ose që mundëson ushtrimin e një ndikimi dominues mbi administrimin e asaj shoqërie;

22. "treg i rregulluar" është secili nga sa më poshtë:

a) në rastin e një tregu që ndodhet në një shtet anëtar, një treg i rregulluar siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1(14) i Direktivës 2004/39/KE; ose

b) në rastin e një tregu që ndodhet në një vend të tretë, një treg financiar që përmbush kushtet e mëposhtme:

I. njihet nga shteti anëtar i origjinës së shoqërisë së sigurimit dhe përmbush kërkesa që mund të krahasohen me ato që përcaktohen në Direktivën 2004/39/KE; dhe

II. instrumentet financiare që tregtohen në atë treg kanë cilësi të krahasueshme me instrumentet që tregtohen në tregjet e rregulluara ose në tregjet e shtetit anëtar të origjinës;

23. "byroja kombëtare" është byroja e siguruesve kombëtarë, siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 3 të Direktivës 72/166/KEE;

24. "fondi kombëtar i garancisë" është organi që përmendet në nenin 1, paragrafi 4 të Direktivës 84/5/KEE;

25. "shoqëri financiare" është një nga subjektet e mëposhtme:

a) një institucion krediti, një institucion financiar, ose një shoqëri për shërbime bankare ndihmëse, sipas kuptimit të nenit 4, paragrafi 1, 5 dhe 21 të Direktivës 2006/48/KE, përkatësisht;

b) një shoqëri sigurimi ose shoqëri risigurimi ose një shoqëri kontrolluese sigurimi sipas kuptimit të nenit 212, paragrafi 1, germa "f";

c) një firmë investimi ose një institucion financiar sipas kuptimit të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2004/39/KE; ose

d) një shoqëri financiare kontrolluese me aktivitet të përzier, sipas kuptimit të nenit 2, paragrafi 15 të Direktivës 2002/87/KE

26. "shoqëri e qëllimit të veçantë" është çdo shoqëri, e inkorporuar ose jo, përveç një shoqërie sigurimi ose risigurimi ekzistuese, e cila merr përsipër rreziqe nga shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit dhe që financon plotësisht ekspozimin e tyre ndaj këtyre rreziqeve nëpërmjet emetimit të borxhit ose ndonjë mekanizmi tjetër financues, ku të drejtat e ofruesit për shlyerjen e këtij borxhi ose mekanizmi financimi janë në vartësi të detyrimeve risiguroese të kësaj shoqërie.

27. "rrezik i madh" është:

a) rreziku i klasifikuar në Klasat 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12 në pjesën A të shtojcës I;

b) rreziqet e klasifikuara në klasat 14 dhe 15 në pjesën A të shtojcës I, kur mbajtësi i policës angazhohet profesionalisht në një veprimtari industriale ose tregtare ose në një nga profesionet e lira dhe rreziqet lidhen me këtë veprimtari;

c) rreziqet e klasifikuara në klasat 3, 8, 9, 10, 13 dhe 16 në pjesën A të shtojcës I për sa kohë që mbajtësi i policës tejkalon kufijtë e të paktën dy prej kriterëve të mëposhtme:

I. buxhet me total 6,2 milion Euro;

II. xhiro vjetore neto, sipas kuptimit të Direktivës së Katërt të Këshillit 78/660/KEE t 25 qershorit 1978, bazuar në nenin 54, paragrafi 3, germa "g" të Traktatit për llogaritë vjetore të disa lloj shoqërish, prej 12,8 milion Euro;

III. një numër mesatar prej 250 punonjësish gjatë një viti ushtrimor.

Nëse mbajtësi i policës i përket një grupi shoqërisht për të cilat përgatiten llogari të konsoliduara sipas kuptimit të Direktivës 83/349/KEE, kriteret e përcaktuara në germën "c" të nënparagrafit të parë zbatohen mbi bazën e llogarive të konsoliduara.

Kategorisë që përmendet në germën "c" të nënparagrafit të parë shtetet anëtare mund t'u shtojnë rreziqet e siguruar nga shoqëritë profesionale, sipërmarrjet e përbashkëta ose grupimet e përkohshme;

28. "nënkontraktim" është një marrëveshje e çdo forme ndërmjet një shoqërie sigurimi ose risigurimi dhe një ofruesi shërbimesh, i mbikëqyrur ose jo, nëpërmjet së cilës ky ofrues shërbimesh kryen një proces, një shërbim ose një veprimtari, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet nënkontraktimit të mëtejshëm, i cili në të kundërt do të kryhej nga vetë shoqëria e sigurimit ose e risigurimit;

29. "funksion", brenda një sistemi rregullator, është një kapacitet i brendshëm për të marrë përsipër detyra praktike; një sistem rregullator përfshin funksionin e menaxhimit të rrezikut, funksionin e pajtueshmërisë, funksionin e auditit të brendshëm dhe funksionin aktuaristik;

30. "rreziku i marrjes në sigurim" është rreziku i humbjes ose ndryshimit negativ të vlerës së përgjegjësisë të siguruar për shkak të vendosjes së çmimit të papërshtatshëm dhe supozimeve për provigjonet;

31. "rreziku i tregut" është rreziku i humbjes ose i ndryshimit negativ të gjendjes financiare, që rezulton, direkt ose indirekt, nga luhajtjet dhe paqëndrueshmëria e çmimit të tregut për aktivet, pasivet dhe instrumentet financiare;

32. "rreziku i kreditit" është rreziku i humbjes ose i ndryshimit negativ të gjendjes financiare që rezulton nga luhajtjet e pozicioneve të kreditit të emetuesve të titujve, kundërpalëve dhe ndonjë debitori, ndaj të cilit janë ekspozuar shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, në formën e rrezikut të paracaktuar të kundërpalës, rrezikut të shpërndarjes, ose përqendrimet e rrezikut të tregut;

33. "rreziku operacional" është rreziku i humbjes që lind nga proceset e brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, nga personeli ose nga sistemet ose nga ngjarjet e jashtme;

34. "rreziku i likuiditetit" është rreziku në rastet kur shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nuk mund të kryejnë investime ose aktive të tjera me qëllim që të shlyejnë detyrimet e tyre financiare në kohë;

35. "rreziku i përqendrimit" janë të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut me një potencial për humbje, i cili është aq i madh sa rrezikon aftësinë paguese ose pozicionin financiar të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit;

36. "teknika për zbutjen e rrezikut" janë të gjitha teknikat që i mundësojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të transferojnë një pjesë ose të gjithë rrezikun e tyre tek një palë tjetër;

37. "efektet e diversifikimit" është ulja e ekspozimit ndaj rrezikut për shoqërinë e sigurimit dhe të risigurimit dhe grupet në lidhje me diversifikimin e veprimtarive të tyre, që rezulton nga fakti se rezultati negativ nga një rrezik mund të kompensohet nga një rezultat më i favorshëm nga një rrezik tjetër, për rastet kur këto rreziqe nuk kanë ndonjë lidhje direkte;

38. "parashikimi i shpërndarjes së probabilitetit" është një funksion matematikor, i cili për një grup të caktuar ngjarjesh ekskluzive në të ardhmen përcakton një probabilitet realizimi;

39 "matja e rrezikut" është një funksion matematikor, i cili cakton një shumë monetare një parashikimi të caktuar për shpërndarjen e probabilitetit dhe rritet në mënyrë monotone me nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut që shoqëron këtë parashikim për shpërndarjen e probabilitetit.

KAPITULLI II

FILLIMI I VEPRIMTARIVE

Neni 14

Parimi i autorizimit

1. Fillimi i veprimtarive të sigurimit ose risigurimit të drejtpërdrejtë të mbuluara nga kjo direktivë duhet t'i nënshtrohen autorizimit paraprak.

2. Autorizimi që përmendet në paragrafin 1 kërkohet nga autoritetet mbikëqyrëse në shtetin anëtar të origjinës nga shoqëritë e mëposhtme:

a) një shoqëri që po ngre zyrën kryesore brenda territorit të atij shteti anëtar; ose

b) një shoqëri sigurimi e cila, pasi ka marrë një autorizim sipas paragrafit 1, dëshiron të zgjerojë veprimtarinë e saj për një klasë të tërë sigurimi ose për klasa sigurimi të ndryshme nga ato që tashmë janë autorizuar.

Neni 15

Fusha e zbatimit të autorizimit

1. Një autorizim i dhënë sipas nenit 14 është i vlefshëm për të gjithë Komunitetin. Ai u lejon shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të zhvillojnë veprimtaritë atje dhe ky autorizim mbulon gjithashtu të drejtën e themelimit dhe të drejtën e ofrimit të shërbimeve.

2. Në zbatim të nenit 14, autorizimi jepet për një klasë të caktuar sigurimi të drejtpërdrejtë, siç paraqiten në pjesën A të shtojcës I ose në shtojcën II. Ai mbulon të gjithë klasën, përveç se kur aplikuesi dëshiron të mbulojë vetëm disa nga rreziqet që i përkasin asaj klase.

Rreziqet që përfshihen në një klasë nuk përfshihen në ndonjë klasë tjetër, përveç rasteve që përmenden në nenin 16.

Autorizimi mund të jepet për dy ose më shumë klasa, kur legjislacioni i brendshëm i një shteti anëtar lejon zhvillimin e veprimtarive në këto klasa në të njëjtën kohë.

3. Në lidhje me sigurimin jo-jetë, shtetet anëtare mund të japin autorizim për grupet e klasave që paraqiten në pjesën B të shtojcës I.

Autoritetet mbikëqyrëse mund të kufizojnë autorizimin e kërkuar për një prej klasave me operacionet që përcaktohen në skemën e operacioneve që përmendet në nenin 23.

4. Shoqëritë që janë objekt i kësaj direktive mund të angazhohen në veprimtaritë e asistencës që përmenden në nenin 6 vetëm nëse ato kanë marrë autorizim për klasën 18 në pjesën A të shtojcës I, pa cenuar nenin 16, paragrafi 1. Në këtë rast, kjo direktivë zbatohet për operacionet në fjalë.

5. Në lidhje me risigurimin, autorizimi jepet për veprimtaritë e risigurimit jo-jetë, veprimtaritë e risigurimit jetë ose të gjitha llojet e veprimtarive të risigurimit.

Zbatimi për autorizim duhet të konsiderohet në lidhje me skemën e operacioneve që duhet të dorëzohet sipas nenit 18, paragrafi 1, germa "c", dhe në përmbushje të kushteve të përcaktuara për autorizim nga shteti anëtar prej të cilit kërkohet autorizimi.

Neni 16

Rreziqet shtesë

1. Një shoqëri sigurimi që ka marrë një autorizim për një rrezik kryesor që i përket njëres prej klasave ose një grupi klasash, siç përcaktohet në shtojcën I, mund të sigurojë edhe rreziqet që përfshihen në një klasë tjetër pa qenë nevoja që të marrë autorizim për këto rreziqe, nëse këto rreziqe përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) ata kanë lidhje me rrezikun kryesor;
- b) ata kanë lidhje me objekt që mbulohet nga rreziku kryesor; dhe
- c) ata mbulohen nga kontrata që siguron rrezikun kryesor.

2. Duke shfuqizuar paragrafin 1, rreziqet e përfshira në klasat 14, 15 dhe 17, pjesa A e shtojcës I nuk konsiderohen si rreziqe shtesë për klasat e tjera.

Megjithatë, sigurimi i shpenzimeve ligjore, siç përcaktohet në klasën 17, mund të konsiderohet si rrezik shtesë për klasën 18, kur përmbushen kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe secili prej kushteve të mëposhtme:

- a) rreziku kryesor lidhet vetëm me asistencën që i ofrohet personave që hasin në vështirësi gjatë udhëtimit, gjatë kohës që janë larg shtëpisë ose vendbanimit të tyre të zakonshëm; ose

b) sigurimi ka të bëjë me mosmarrëveshjet ose rreziqet që lindin nga ose në lidhje me përdorimin e një mjeti lundrimi.

Neni 17

Forma ligjore e shoqërisë së sigurimit ose risigurimit

1. Shteti anëtar i origjinës i kërkon çdo shoqërie për të cilën kërkohet autorizim sipas nenit 14 që të marrë një nga format ligjore që përcaktohet në shtojcën III.

2. Shtetet anëtare mund të krijojnë një shoqëri me një formë që rregullohet nga e drejta publike, nëse këto subjekte kanë si objekt operacionet e sigurimit ose risigurimit, sipas kushteve ekuivalente me ato që zbatohen për shoqëritë që rregullohen nga e drejta private.

3. Komisioni mund të miratojë masat zbatuese në lidhje me zgjerimin e listës së formave që përcaktohen në shtojcën III.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 18

Kushtet për autorizimin

1. Shteti anëtar i origjinës i kërkon çdo shoqërie për të cilën kërkohet autorizim:

a) në lidhje me shoqëritë e sigurimit, të kufizojnë objektet e tyre me veprimtaritë e sigurimit dhe operacionet që rrjedhin direkt prej tyre, duke përjashtuar të gjitha veprimtaritë e tjera tregtare;

b) në lidhje me shoqëritë e risigurimit, të kufizojnë objektet e tyre me veprimtaritë e risigurimit dhe operacioneve që lidhen me to; kjo kërkesë mund të përfshijë funksionin dhe veprimtaritë e një shoqërie kontrolluese në lidhje me veprimtaritë e sektorit financiar, sipas kuptimit të nenit 2, paragrafi 8 të Direktivës 2002/87/KE;

c) të dorëzojë një skemë operacionesh në përputhje me nenin 23;

d) të zotërojnë fondet e veta bazë që mund të mbulojnë dyshtemenë absolute të kërkesës për kapital minimal, parashikuar në nenin 129, paragrafi 1, germa "d";

e) të paraqesë prova se do të jetë në gjendje të mbajë fonde të veta të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, siç parashikohet në nenin 100 e në vijim;

f) të paraqesë prova se do të jetë në gjendje të mbajë fondet e veta bazë që mund të mbulojnë kërkesën për kapital minimal, siç parashikohet në nenin 128 e në vijim;

g) të paraqesë prova se do të jetë në gjendje të veprojë në pajtim me sistemin rregullator që përmendet në kapitullin IV, seksioni 2;

h) në lidhje me sigurimin jojetë, të komunikojë emrin dhe adresën e të gjithë specialistëve të trajtimit të dëmeve të emëruar sipas nenit 4 të Direktivës 2000/26/Ke në çdo shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar në të cilin kërkohet autorizimi nëse rreziqet që do të mbulohen klasifikohen në klasën 10, pjesa A të shtojcës I të kësaj direktive, përveç përgjegjësisë së transportuesit.

2. Një shoqërie sigurimi që kërkon autorizim për të zgjeruar veprimtaritë e saj në klasa të tjera ose për të zgjeruar një autorizim që mbulon vetëm disa prej rreziqeve që lidhen me një klasë, i kërkohet që të dorëzojë një skemë operacionesh në përputhje me nenin 23.

Gjithashtu, asaj i kërkohet që të paraqesë prova se zotëron fondet e veta të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal që parashikohen në paragrafin e parë të nenit 100 dhe në nenin 128.

3. Pa cenuar paragrafin 2, një shoqëri sigurimi që kryen veprimtari të sigurimit jetë dhe që kërkon autorizim për të zgjeruar veprimtaritë e saj për rreziqet që përcaktohen në klasat 1 ose 2, pjesa A të shtojcës I, siç përcaktohet në nenin 73, duhet të tregojë se:

a) zotëron fondet e veta bazë të mjaftueshme për të mbuluar dyshtemenë absolute të kërkesës për kapital minimal për shoqëritë e sigurimit jetë dhe dyshtemenë absolute të kërkesës për kapital minimal për shoqëritë e sigurimit jojetë, siç përcaktohet në nenin 129, paragrafi 1, germa "d"

b) angazhohet që të mbulojë detyrimet financiare minimale që përcaktohen në nenin 74, paragrafi 3 e në vijim.

4. Pa cenuar paragrafin 2, një shoqëri sigurimi që zhvillon veprimtari sigurimi jo-jetë për rreziqet e përcaktuara në klasën 1 ose 2, pjesa A të shtojcës I dhe që kërkon autorizim për të zgjeruar veprimtaritë e saj në rreziqet e sigurimit jetë, siç përcaktohet në nenin 73, duhet të tregojë se:

a) zotëron fondet e veta bazë të mjaftueshme për të mbuluar dyshtemenë absolute të kërkesës për kapital minimal për shoqëritë e sigurimit jetë dhe dyshtemenë absolute të kërkesës për kapital minimal për shoqëritë e sigurimit jojetë, siç përcaktohet në nenin 129, paragrafi 1, germa "d"

b) angazhohet që të mbulojë detyrimet financiare minimale që përcaktohen në nenin 74, paragrafi 3 e në vijim.

Neni 19

Lidhje të ngushta

Në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta ndërmjet shoqërisë së sigurimit ose shoqërisë së risigurimit dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, autoritetet mbikëqyrëse e japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet mbikëqyrëse e refuzojnë autorizimin nëse ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të tretë, të cilat rregullojnë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ka lidhje të ngushta ose kur vështirësitë për zbatimin e tyre, pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet mbikëqyrëse u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe risigurimit t'u japin atyre informacionin e nevojshëm për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme pajtueshmërinë me kushtet e përmendura në paragrafin e parë.

Neni 20

Zyra kryesore e shoqërive të sigurimit dhe shoqërive të risigurimit

Shtetet anëtare kërkojnë që zyrat qendrore të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit të vendosen në të njëjtin shtet anëtar me zyrat e tyre të regjistrimit.

Neni 21

Kushtet e policës dhe nivelet e primeve

1. Shtetet anëtare nuk kërkojnë miratimin paraprak ose njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policës, të niveleve të primeve, të bazave teknike që përdoren në veçanti për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike, ose të formularëve dhe dokumenteve të tjera të printuara që një shoqëri synon të përdorë gjatë marrëdhënieve me mbajtësit e policave ose me ndërmarrjet ceduese ose retroceduese.

Megjithatë, për sigurimet jetë dhe vetëm me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë me dispozitat kombëtare në lidhje me parimet aktuaristike, shteti anëtar i origjinës mund të kërkojë njoftimin sistematik të bazave teknike që përdoren për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike. Kjo kërkesë nuk përbën një kusht paraprak për autorizimin e shoqërisë së sigurimit jetë.

2. Shtetet anëtare nuk kërkojnë apo të prezantojnë njoftimin paraprak ose miratimin e rritjeve të propozuara të niveleve të primit përveç se si pjesë e sistemeve të përgjithshme për kontrollin e çmimit.

3. Shtetet anëtare mund t'i nënshtrojnë shoqëritë që kërkojnë ose që kanë marrë autorizim për klasën 18 të pjesës A të shtojcës I ndaj kontrolleve për burimet e tyre të drejtpërdrejta ose të tërthorta të stafit dhe pajisjeve, duke përfshirë kualifikimin e ekipeve të tyre mjekësore dhe cilësinë e pajisjeve të disponueshme që u shërbejnë këtyre shoqërive që të përmbushin angazhimet e marra për këtë klasë.

4. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi ose të prezantojnë ligje, rregullore ose dispozita administrative që kërkojnë miratimin e memorandumit dhe statutit dhe komunikimin e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

Neni 22

Kërkesat ekonomike të tregut

Nga pikëpamja e kërkesave ekonomike të tregut, shtetet anëtare nuk kërkojnë konsiderimin e ndonjë aplikimi për autorizim.

Neni 23

Skemat e operacioneve

1. Skema e operacioneve që përmendet në nenin 18, paragrafi 1, germa "c" përfshin detaje ose prova për sa më poshtë:

a) natyrën e rreziqeve ose angazhimeve që shoqëria e sigurimit ose risigurimit në fjalë propozon që të mbulojë;

b) llojin e marrëveshjeve të risigurimit që shoqëria e risigurimit propozon të bëjë me shoqëritë ceduese;

c) parimet udhëzuese për risigurimin dhe retrocesionin;

d) zërat bazë të fondeve të veta që përbëjnë dyshemenë absolute të kërkesës për kapital minimal;

e) parashikimet e kostove për krijimin e shërbimeve administrative dhe organizimin për sigurinë e veprimtarive; burimet financiare që synohen për të mbuluar këto kosto dhe, nëse rreziqet që do të mbulohen klasifikohen në klasën 18 të pjesës A të shtojcës I, burimet që shoqëria e sigurimit ka në dispozicion për të ofruar asistencën e premtuar;

2. Përveç kërkesave që përcaktohen në paragrafin 1, për tre vitet e para ushtrimore skema përfshin sa më poshtë:

a) një parashikim të bilancit;

b) parashikimet e kërkesës së ardhshme për kapital dhe aftësi paguese, siç parashikohet në kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 1, mbi bazën e bilancit të parashikuar që përmendet në germën "a", si edhe metodën e llogaritjes që është përdorur për të bërë këto parashikime;

c) parashikimet e kërkesës së ardhshme për kapital minimal, siç parashikohet në nenet 128 dhe 129, mbi bazën e bilancit të parashikuar në germën "a", si edhe metodën e llogaritjes që është përdorur për të bërë këto parashikime;

d) parashikimet e burimeve financiare që synohen të mbulojnë provigjonet teknike, kërkesën për kapital minimal dhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

e) në lidhje me sigurimin dhe risigurimin jojetë, edhe si në vijim:

I. parashikimet e shpenzimeve të administrimit përveç kostove të instalimit, në veçanti shpenzimet e përgjithshme dhe komisionet aktuale;

II. parashikimet e primeve ose kontributeve dhe dëmeve;

f) në lidhje me sigurimin jetë, edhe një plan ku shtjellohen parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtaritë e drejtpërdrejta, marrjet në risigurim dhe cedimet për risigurim.

Neni 24

Aksionarët dhe anëtarët e pjesëmarrjeve influencuese

1. Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës nuk japin autorizim për një shoqëri që të fillojë veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit, derisa të informohen mbi identitetin e aksionarëve ose të anëtarëve, direkt ose indirekt, qofshin persona fizikë ose juridikë, që kanë pjesëmarrje influencuese në atë shoqëri, dhe për shumat këtyre pjesëmarrjeve.

Këto autoritete refuzojnë autorizimin nëse, duke marrë në konsideratë nevojën për të garantuar administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të një shoqërie sigurimi ose risigurimi, nuk janë të bindur për kualifikimet e aksionarëve ose të anëtarëve.

2. Për qëllime të paragrafit 1, merren në konsideratë të drejtat e votës të përmendura në nenet 9 dhe 10 të Direktivës 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, “Për harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve, titujt e të cilëve pranohen për t’u tregtuar në një treg të rregulluar” si edhe kushtet për agregimin e tyre që përcaktohen në nenin 12, paragrafi 4 dhe 5 të kësaj direktive..

Shtetet anëtare nuk marrin në konsideratë të drejtat e votës ose aksionet e zotëruara nga firmat e investimit apo nga institucionet e kreditit, si rezultat i marrjes në sigurim të instrumenteve financiare dhe/ose caktimin e instrumenteve financiare në angazhimet e një firme të përfshirë sipas pikës 6, të seksionit A, të shtojcës I të Direktivës 2004/39/KE, me kusht që këto të drejta, nga njëra anë të mos ushtrohen ose të përdoren për ndërhyrjen në administrimin e emetuesit, dhe nga ana tjetër, të çlirohen brenda një viti nga blerja e tyre.

Neni 25

Refuzimi i autorizimit

Për çdo vendim për të refuzuar një autorizim deklarohen arsyet e plota dhe ky vendim i njoftohet shoqërisë në fjalë.

Çdo shtet anëtar parashikon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatave në rastet kur refuzohet autorizimi.

Diçka e tillë parashikohet edhe për rastet kur autoritetet mbikëqyrëse nuk e kanë trajtuar një aplikim për autorizim brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së tij.

Neni 26

Konsultimi paraprak me autoritetet e shteteve të tjera anëtare

1. Autoritetet mbikëqyrëse të çdo shteti tjetër anëtar konsultohen përpara dhënies së një autorizimi për:

- a) një filial të një shoqërie sigurimi ose risigurimi të autorizuar në atë shtet anëtar;
- b) një filial të shoqërisë mëmë të një shoqërie sigurimi ose risigurimi të autorizuar në atë shtet anëtar; ose
- c) një shoqëri të kontrolluar nga i njëjti person, qoftë fizik ose juridik, i cili kontrollon një shoqëri sigurimi ose risigurimi të autorizuar në atë shtet anëtar.

2. Autoritetet e shtetit anëtar të përfshirë që janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose firmave të investimit konsultohen përpara dhënies së autorizimit për një shoqëri sigurimi ose risigurimi, që ka formën e mëposhtme:

- a) filial i institucionit të kreditit ose firmës së investimit të autorizuar në Komunitet;
- a) filial i shoqërisë mëmë të institucionit të kreditit ose firmës së investimit të autorizuar në Komunitet;
- c) një shoqëri e kontrolluar nga i njëjti person, qoftë fizik ose juridik, i cili kontrollon institucionin e kreditit ose firmën e investimit të autorizuar në Komunitet.

3. Autoritetet përkatëse të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 këshillohen, në mënyrë të veçantë me njëri-tjetrin, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve dhe përshtatshmërisë dhe kërkesave përkatëse për të gjithë personat të cilët drejtojnë shoqërinë ose kanë funksione të tjera kyçe në administrimin e një subjekti tjetër të të njëjtit grup.

Ata informojnë njëri-tjetrin për çdo informacion që lidhet me përshtatshmërinë e aksionarëve dhe përshtatshmërinë dhe kërkesat përkatëse për të gjithë personat që drejtojnë shoqërinë ose kanë funksione të tjera kyçe, informacione të cilat janë me rëndësi për autoritetet e tjera kompetente për lëshimin e një autorizimi si edhe për vlerësimin e vazhdueshëm të pajtueshmërisë me kushtet operative.

KAPITULLI III

AUTORITETET MBIKËQYRËSE DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Neni 27

Objektivi kryesor i mbikëqyrjes

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse të kenë të gjitha mjetet e nevojshme dhe ekspertizën, kapacitetin dhe mandatin përkatës për të arritur objektivin kryesor të mbikëqyrjes, i cili është mbrojtja e mbajtësve të policave dhe përfituesve.

Neni 28

Stabiliteti financiar dhe procikliteti

Pa cenuar objektivin kryesor të mbikëqyrjes, siç përcaktohet në nenin 27, shtetet anëtare sigurohen që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të përgjithshme autoritetet mbikëqyrëse të marrin siç duhet në konsideratë ndikimin që mund të kenë vendimet e tyre në stabilitetin e sistemeve financiare në fjalë brenda Bashkimit Evropian, në veçanti në situata emergjente, duke marrë në konsideratë informacionin e disponueshëm në atë kohë.

Gjatë lëvizjeve të veçanta në tregjet financiare, autoritetet mbikëqyrëse marrin në konsideratë efektet e mundshme prociklike të veprimeve të tyre.

Neni 29

Parimet e përgjithshme të mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja bazohet në një qasje të mundshme dhe të bazuara në rrezik. Ajo përfshin verifikimin e vazhdueshëm të mirëfunksionimit të veprimtarive të sigurimit dhe risigurimit dhe të pajtueshmërisë së shoqërive të sigurimit dhe risigurimit me dispozitat mbikëqyrëse.

2. Mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit përfshin një kombinim të përshtatshëm të veprimtarive në zyrë dhe inspektimeve në terren.

3. Shtetet anëtare sigurohen që kërkesat e parashtuara në këtë direktivë zbatohen në një mënyrë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që shoqërojnë veprimtaritë e një shoqërie sigurimi ose risigurimi.

4. Komisioni sigurohet që në masat zbatuese të merret në konsideratë parimi i proporcionalitetit, duke garantuar kështu zbatimin proporcional të kësaj direktive, në veçanti për shoqëritë e vogla të sigurimit.

Neni 30

Autoritetet mbikëqyrëse dhe fusha e zbatimit të mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja financiare e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, duke përfshirë mbikëqyrjen e veprimtarive që ata zhvillojnë nëpërmjet degëve ose sipas lirisë për ofrimin e shërbimeve, është vetëm përgjegjësi e shtetit anëtar të origjinës.

2. Mbikëqyrja financiare sipas paragrafit 1 përfshin verifikimin, për të gjitha veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit dhe të risigurimit, e gjendjes së aftësisë pagueve, krijimit të provigjoneve teknike, të aktiveve dhe fondeve të veta të mjaftueshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara ose praktikatat e ndjekura në shtetin anëtar të origjinës, sipas dispozitave të miratuara në nivel Komuniteti.

Në rastet kur shoqëria e sigurimit në fjalë është autorizuar për të mbuluar rreziqet e klasifikuara në klasën 18 në pjesën A të shtojcës I, mbikëqyrja përfshin edhe monitorimin e

burimeve teknike që shoqëria e sigurimit ka në dispozicion me qëllim dhënien e asistencës që ka marrë përsipër të japë, kur legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës parashikon monitorimin e këtyre burimeve.

3. Nëse autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhet rreziku ose shteti anëtar i angazhimit ose, në rastin e një shoqërie risigurimi, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës, kanë arsye për të menduar se veprimtaritë e një shoqërie sigurimi ose risigurimi mund të ndikojnë në sigurinë e saj financiare, ata informojnë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës për këtë shoqëri.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës vendosin nëse shoqëria po vepron në pajtim me parimet e kujdesshme që përcaktohen në këtë direktivë.

Neni 31

Transparenca dhe llogaridhënia

1. Autoritetet mbikëqyrëse kryejnë detyrat e tyre në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme duke respektuar mbrojtjen e informacionit konfidencial.

2. Shtetet anëtare sigurohen që të publikohet informacioni i mëposhtëm:

a) tekstet e ligjeve, rregulloreve, rregulloreve administrative dhe udhëzimeve të përgjithshme në fushën e legjislacionit për sigurimet;

b) kriteret dhe metodat e përgjithshme, duke përfshirë instrumentet e zhvilluara në përputhje me nenin 34, paragrafi 4, që përdoren gjatë procesit të shqyrtimit mbikëqyrës, siç përcaktohet në nenin 36;

c) të dhënat statistikore të agreguara për aspektet kyçe të zbatimit të kuadrit të kujdesshëm;

d) mënyrën e ushtrimit të opsioneve që parashikohen nga kjo direktivë;

e) objektivat e mbikëqyrjes dhe funksionet dhe veprimtaritë kryesore të saj.

Nxjerrja e informacionit që parashikohet në nënparagrafin e parë duhet të jetë e mjaftueshme që të mundësojë një krahasim të qasjeve mbikëqyrëse që përdoren nga autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të ndryshme.

Informacioni nxirret sipas një formati të përbashkët dhe përditësohet rregullisht. Informacioni që përmendet në germat "a" deri në "e" të nënparagrafit të parë mund të gjendet në një vendndodhje të vetme elektronike në secilin prej shteteve anëtare.

3. Shtetet anëtare parashikojnë procedura transparente për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve qeverisëse dhe drejtuese të autoriteteve të tyre mbikëqyrëse.

4. Komisioni miraton masat zbatuese në lidhje me paragrafin 2 ku specifikohen aspektet kyçe sipas të cilave duhet të publikohen të dhënat statistikore të agregura, formati, struktura, lista e përmbajtjes dhe data e publikimit të informacionit të nxjerrë.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 32

Ndalimi i refuzimit të kontratave të risigurimit ose kontratave të retrocesionit

1. Shteti anëtar i origjinës së një shoqërie sigurimi nuk duhet të refuzojë një kontratë risigurimi të lidhur me një shoqëri risigurimi ose një shoqëri sigurimi e autorizuar në përputhje me nenin 14, për arsye që lidhen direkt me gjendjen financiare të asaj shoqërie risigurimi ose asaj shoqërie sigurimi.

2. Shteti anëtar i origjinës së një shoqërie risigurimi nuk duhet të refuzojë një kontratë retrocesioni të lidhur nga një shoqëri risigurimi me një shoqëri risigurimi ose një shoqëri sigurimi e autorizuar në përputhje me nenin 14, për arsye që lidhen direkt me gjendjen financiare të asaj shoqërie risigurimi ose asaj shoqërie sigurimi.

Neni 33

Mbikëqyrja e degëve të themeluara në një shtet tjetër anëtar

Shtetet anëtare parashikojnë që, kur një shoqëri sigurimi ose risigurimi e autorizuar në një shtet tjetër anëtar vazhdon veprimtarinë nëpërmjet një dege, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës, pasi të kenë informuar autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar pritës, mund të kryejnë vetë ose nëpërmjet personave të caktuar për këtë qëllim, verifikime në terren për informacionin e nevojshëm për kryerjen e mbikëqyrjes financiare të shoqërisë.

Autoritetet e shtetit anëtar pritës mund të marrin pjesë në këto verifikime.

Neni 34

Kompetencat e përgjithshme mbikëqyrëse

1. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse të kenë kompetencën për të marrë masa parandaluese dhe korigjuese për të garantuar pajtueshmërinë e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit me legjislacionet, rregulloret dhe dispozitat administrative me të cilat duhet të pajtohen në çdo shtet anëtar.

2. Autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencën për të marrë çdo masë të nevojshme, duke përfshirë sipas rastit, edhe ato me natyrë administrative ose financiare, në lidhje me shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit dhe me anëtarët e organit të tyre administrativ, menaxhues dhe mbikëqyrës.

3. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencën për të kërkuar të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer mbikëqyrjen në përputhje me nenin 35.

4. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse të kenë kompetencën për të zhvilluar, përveç llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese dhe sipas rastit, instrumentet e nevojshme sasiore si pjesë e procesit të shqyrtimit mbikëqyrës për të vlerësuar aftësinë e shoqërive të sigurimit ose risigurimit për të përballuar ngjarjet e mundshme ose ndryshimet e ardhshme të kushteve ekonomike që mund të kenë efekte jo të favorshme në situatën e tyre të përgjithshme financiare. Autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencën për të kërkuar që shoqëritë të kryejnë testimet përkatëse.

5. Autoritetet kompetente kanë kompetencën për të kryer hetime në terren në mjediset e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit.

6. Kompetencat mbikëqyrëse ushtrohen në kohën e duhur dhe në një mënyrë proporcionale.

7. Kompetencat në lidhje me shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që përmenden në paragrafët 1 deri në 5 janë të disponueshme edhe në lidhje me veprimtaritë e nënkontraktuara të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit.

8. Kompetencat e përmendura në paragrafët 1 deri në 5 dhe 7 ushtrohen, nëse është e nevojshme përmes zbatimit të ligjit, dhe kur është e përshtatshme, përmes rrugëve gjyqësore.

Neni 35

Informacioni që duhet të jepet për qëllime mbikëqyrëse

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që t'i dorëzojnë autoriteteve mbikëqyrëse informacionin e nevojshëm për qëllimet e mbikëqyrjes. Ky informacion përfshin të paktën informacionin e nevojshëm për aspektet e mëposhtme gjatë kryerjes së procesit që përmendet në nenin 36:

a) për të vlerësuar sistemin rregullator që zbatohet nga shoqëritë, veprimtaritë që ato zhvillojnë, parimet e vlerësimit që zbatohen për qëllimet e aftësisë paguese, rreziqet e hasura dhe sistemet për menaxhimin e rrezikut dhe strukturën e kapitalit, nevojat për kapital dhe administrimin e tij;

b) për të marrë vendime të përshtatshme që rezultojnë nga ushtrimi i të drejtave dhe detyrave mbikëqyrëse.

2. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse të kenë kompetencat e mëposhtme:

a) të përcaktojnë natyrën, fushën e zbatimit dhe formatin e informacionit që përmendet në paragrafin 1 që ata kërkojnë që të dorëzohet nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në momentet e mëposhtme:

I. në periudha të paracaktuara;

II. pas ndodhjes së ngjarjes së paracaktuar;

III. gjatë hetimeve në lidhje me situatën e një shoqërie sigurimi ose risigurimi;

b) për të marrë informacion në lidhje me kontratat që mbahen nga ndërmjetësit ose në lidhje me kontratat e lidhura me palë të treta; dhe

c) për të kërkuar informacion nga ekspertët e jashtëm, si audituesit dhe aktuarët.

3. Informacioni i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 përfshin sa më poshtë:

a) elementet cilësore ose sasiorë ose çdo kombinim të përshtatshëm të atyre;

b) elementet historike, aktuale ose të ardhshme, ose çdo kombinim të përshtatshëm të atyre; dhe

c) të dhënat nga burime të brendshme ose të jashtme, ose çdo kombinim të përshtatshëm të atyre.

4. Informacioni i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 duhet të jetë në pajtim me parimet e mëposhtme:

a) ai duhet të pasqyrojë natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të shoqërisë në fjalë dhe në veçanti rreziqet që shoqërojnë ato veprimtari;

b) duhet të jetë i aksesueshëm, i plotë në të gjitha aspektet e rëndësishme, i krahasueshëm dhe konsistent përgjatë kohës; dhe

c) duhet të ketë lidhje me fushën përkatëse, të jetë i besueshëm dhe i kuptueshëm.

5. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që të ngrenë sistemet dhe strukturat e përshtatshme për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 4 si edhe një politikë me shkrim, të miratuar nga organi administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit, e cila garanton përshtatshmërinë e vazhdueshme të informacionit të dorëzuar.

6. Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë informacionin e përmendur në paragrafët 1 deri 4 me qëllim që të garantojë deri në masën e nevojshme konvergencën e raportimeve mbikëqyrëse.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 36

Procesi i shqyrtimit mbikëqyrës

1. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse shqyrtojnë dhe vlerësojnë strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit që janë ngritur nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në pajtim me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara sipas kësaj direktive.

Ky shqyrtim dhe vlerësim përfshin vlerësimin e kërkesave cilësore në lidhje me sistemin rregullator, vlerësimin e rreziqeve me të cilët përballen ose mund të përballen shoqëritë në fjalë dhe vlerësimin e aftësisë së këtyre shoqërive për t'i vlerësuar këto rreziqe duke marrë në konsideratë mjedisin ku operojnë këto shoqëri.

2. Autoritetet mbikëqyrëse shqyrtojnë dhe vlerësojnë në veçanti pajtueshmërinë me sa më poshtë:

a) sistemin rregullator, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të vet dhe aftësisë paguese, siç përcaktohet në kapitullin IV, seksioni 2;

b) dispozitat teknike siç përcaktohen në kapitullin VI, seksioni 2;

c) kërkesat për kapital, siç përcaktohen në kapitullin VI, seksioni 4 dhe 5;

d) rregullat e investimit, siç përcaktohen në kapitullin VI, seksioni 6;

e) cilësinë dhe sasinë e fondeve të veta, siç përcaktohet në kapitullin VI, seksioni 3;

f) në rastet kur shoqëria e sigurimit ose risigurimit përdor një model të brendshëm të plotë ose të pjesshëm, pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat për modelet e brendshme të plota dhe të pjesshme, siç përcaktohen në kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 3.

3. Autoritetet mbikëqyrëse vendosin instrumente monitorimi të përshtatshme që u mundësojnë atyre të identifikojnë kushtet financiare të përkeqësuar në një shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe të monitorojnë se si korrigjohet ky përkeqësim.

4. Autoritetet mbikëqyrëse vlerësojnë përshtatshmërinë e metodave dhe praktikave që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit kanë përgatitur për të identifikuar ngjarjet e mundshme ose ndryshimet e ardhshme të kushteve ekonomike që mund të kenë efekte negative në pozicionin e përgjithshëm financiar të shoqërisë në fjalë.

Autoritetet mbikëqyrëse vlerësojnë aftësinë e sipërmarrjeve për t'u bërë ballë këtyre ngjarjeve të mundshme ose ndryshimeve të ardhshme të kushteve ekonomike.

5. Autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencat e nevojshme për t'u kërkuar shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të marrin masa për të korrigjuar pikat e dobëta ose mangësitë e identifikuar gjatë procesit të shqyrtimit mbikëqyrës.

6. Rishikimet, vlerësimet dhe shqyrtimet që përmenden në paragrafët 1, 2 dhe 4 kryhen rregullisht.

Autoritetet mbikëqyrëse përcaktojnë shpeshtësinë minimale dhe fushën e zbatimit të këtyre rishikimeve, vlerësimeve dhe shqyrtimeve duke pasur parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë.

Neni 37

Shtimi i kapitalit

1. Pas procesit të rishikimit mbikëqyrës, autoritetet mbikëqyrëse, në rrethana përjashtimore, mund të përcaktojnë një shtim kapitali për një shoqëri sigurimi ose risigurimi nëpërmjet një vendimi ku deklarohen edhe arsyet. Kjo mundësi ekziston vetëm për rastet e mëposhtme:

a) autoriteti mbikëqyrës del në përfundimin se profili i rrezikut të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit devijon në mënyrë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, siç llogaritet duke përdorur formulën standarde në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 2 dhe:

I. kërkesa për të përdorur një model të brendshëm sipas nenit 119 është e pavend ose nuk ka qenë efikase; ose

II. ndërkohë që po përgatitet një model i brendshëm i pjesshëm ose i plotë në përputhje me nenin 119;

b) autoriteti mbikëqyrës del në përfundimin se profili i rrezikut i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit devijon në mënyrë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, siç është llogaritur nëpërmjet një modeli të brendshëm ose një modeli të brendshëm të pjesshëm në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 3, për shkak se disa rreziqe sasiore mbulohen në mënyrë të pamjaftueshme dhe përshtatja e modelit sipas profilit të caktuar të rrezikut ka dështuar brenda një kuadri kohor të përshtatshëm; ose

c) autoriteti mbikëqyrës del në përfundimin se sistemi rregullator i një shoqërie sigurimi ose risigurimi devijon një mënyrë të konsiderueshme nga standardet e përcaktuara në kapitullin IV, seksioni 2, dhe se këto devijime nuk e lejojnë këtë shoqëri që të identifikojë, matë, monitorojë, administrojë dhe raportojë siç duhet rreziqet ndaj të cilëve është ekspozuar ose mund të ekspozohet dhe se zbatimi i masave të tjera në vetvete nuk ka gjasa të përmirësojë mangësitë aq sa duhet brenda një afati kohor të caktuar.

2. Në rrethanat e përcaktuara në germat "a" dhe "b" të paragrafit 1 shtimi i kapitalit llogaritet në mënyrë të tillë që të garantohet se shoqëria vepron në pajtim me nenin 101, paragrafi 3.

Në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 1, germa "c" shtimi i kapitalit është proporcional me rreziqet materiale që lindin nga mangësitë që kanë çuar në vendimin e autoritetit mbikëqyrës për të vendosur shtimin e kapitalit.

3. Në rastet e përcaktuara në germa "b" dhe "c" të paragrafit 1, autoriteti mbikëqyrës sigurohet që shoqëria e sigurimit ose risigurimit bën çdo përpjekje për të korrigjuar mangësitë që kanë çuar në vendosjen e shtimit të kapitalit.

4. Shtimi i kapitalit që përmendet në paragrafin 1 rishikohet të paktën një herë në vit nga autoriteti mbikëqyrës dhe hiqet kur shoqëria të ketë korrigjuar mangësitë që çuan në vendosjen e tij.

5. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese duke përfshirë shtimin e vendosur të kapitalit zëvendëson kërkesën e pamjaftueshme për kapital dhe aftësi paguese.

Pavarësisht nënparagrafit të parë, kërkesa për kapital dhe aftësi paguese nuk përfshin shtimin e kapitalit të vendosur në përputhje me paragrafin 1, germa "c" për qëllimet e llogaritjes së marzhit të rrezikut që përmendet në nenin 77, paragrafi 5.

6. Komisioni miraton masat zbatuese që përcaktojnë specifikime të mëtejshme për rrethanat në të cilat mund të vendoset shtimi i kapitalit dhe metodologjitë për llogaritjen e tij.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 38

Mbikëqyrja e funksioneve dhe veprimtarive të nënkontraktuara

1. Pa cenuar nenin 49, shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që nënkontraktojnë një funksion ose një veprimtari sigurimi ose risigurimi ndërmarrin hapat e nevojshëm për të garantuar përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

a) ofruesi i shërbimit duhet të bashkëpunojë me autoritetet mbikëqyrëse të shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit në lidhje me funksionin ose veprimtarinë e nënkontraktuar;

b) shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, audituesit e tyre dhe autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë qasje efektive në të dhënat që lidhen me funksionet ose veprimtaritë e nënkontraktuara;

c) autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë qasje efektive në ambientet e biznesit të ofruesit të shërbimit dhe duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë këto të drejta qasjeje.

2. Shteti anëtar ku ndodhet ofruesi i shërbimit u lejon autoriteteve mbikëqyrëse të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që të kryejnë vetë ose nëpërmjet ndërhyrjes së personave që ata emërojnë për këtë qëllim inspektime në terren në ambientet e ofruesit të shërbimit. Autoriteti mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit informon autoritetin përkatës të shtetit anëtar të ofruesit të shërbimit përpara se të kryejë inspektimin në terren. Në rastin e një subjekti të pambikëqyrur, autoriteti përkatës shërben si autoritet mbikëqyrës.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit mund t'ia delegojnë këto inspektive në terren autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhet ofruesi i shërbimit.

Neni 39

Transferimi i portofolit

1. Sipas kushteve që përcaktohen në legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare autorizojnë shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që kanë zyra qendrore brenda territorit të tyre që të transferojnë të gjitha ose në pjesë të portofolave të kontratave, të lidhura ose sipas të drejtës së themelimit ose sipas të drejtës për ofrimin e shërbimeve, drejt një shoqërie marrëse të themeluar brenda Komunitetit.

Ky transferim autorizohet vetëm nëse autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë marrëse vërtetojnë se pasi kanë marrë në konsideratë transferimin shoqëria marrëse zotëron fondet e veta të nevojshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, që përmendet në paragrafin e parë të nenit 100.

2. Në rastin e shoqërive të sigurimit zbatohen paragrafët 3 deri në 6.

3. Kur një degë propozon të transferojë të gjithë ose një pjesë të portofolit të kontratave, bëhen konsultime me shtetin anëtar ku ndodhet kjo degë.

4. Në rrethanat që përmenden në paragrafët 1 dhe 3, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së sigurimit që bënë transferimin autorizojnë transferimin pasi të kenë marrë miratimin e autoriteteve të shteteve anëtare ku janë lidhur kontratat, ose sipas të drejtës së themelimit ose sipas të drejtës së ofrimit të shërbimeve.

5. Autoritetet e shteteve anëtare të konsultuara japin mendimin ose miratimin e tyre për autoritetet e shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së sigurimit që bënë transferimin brenda tre muajve pas marrjes së kërkesës për konsultim.

Mungesa e ndonjë përgjigje brenda kësaj periudhe nga ana e autoriteteve të konsultuara konsiderohet si miratim në heshtje.

6. Transferimi i portofolit i autorizuar në përputhje me paragrafët 1 deri në 5 publikohet ose para ose pas autorizimit, siç përcaktohet në legjislacionin e brendshëm të shtetit anëtar të origjinës, të shtetit anëtar ku ndodhet rreziku ose të shtetit anëtar të angazhimit.

Këto transferime bëhen automatikisht të vlefshme kundrejt mbajtësve të policave, personave të siguruar dhe çdo personi tjetër që ka të drejta ose detyrime që lindin nga kontratat e transferuara.

Nënparagrafi i parë dhe i dytë i këtij paragrafi nuk ndikon në të drejtën e shteteve anëtare për t'u dhënë mbajtësve të policave opsionin për anulimin e kontratave brenda një periudhe kohore të caktuar pas transferimit.

KAPITULLI IV

KUSHTET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË

SEKSIONI 1

PËRGJEGJËSIA E ORGANIT ADMINISTRATIV, ORGANIT DREJTUES OSE ATIJ MBIKËQYRËS

Neni 40

Përgjegjësia e organit administrativ, organit drejtues ose atij mbikëqyrës

Shtetet anëtare sigurohen që organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit mban përgjegjësi të plotë për pajtueshmërinë, nga ana e shoqërisë në fjalë, me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara sipas kësaj direktive.

SEKSIONI 2

SISTEMI RREGULLATOR

Neni 41

Kërkesa rregulatore të përgjithshme

1. Shtetet anëtare u kërkojnë të gjitha shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të vendosin një sistem rregullator efektiv që parashikon administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të veprimtarive.

Ky sistem përfshin të paktën një strukturë organizative të përshtatshme dhe transparente me delegim të qartë dhe ndarje të përshtatshme të përgjegjësive dhe një sistem efektiv që garanton transmetimin e informacionit. Ai përfshin pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenet 42 deri në 49.

Sistemi rregullator është objekt i rishikimit të brendshëm të rregullt.

2. Sistemi rregullator është proporcional me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e operacioneve të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit.

3. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të kenë politika të shkruara të paktën në lidhje me menaxhimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm, auditin e brendshëm dhe, sipas rastit, nënkontraktimin. Ato garantojnë zbatimin e këtyre politikave.

Këto politika të shkruara duhet të rishikohen të paktën një herë në vit. Ato duhet të miratohen paraprakisht nga organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës dhe të përshtaten sipas ndryshimeve të konsiderueshme në sistem ose në fushën në fjalë.

4. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të ndërmarrin hapat e nevojshme për të siguruar vazhdueshmërinë dhe korrektësinë e kryerjes së veprimtarive të tyre, duke përfshirë përgatitjen e planeve të kontingjencës. Për këtë qëllim, shoqëria përdor sistemet, burimet, dhe procedurat e përshtatshme dhe proporcionale.

5. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë mjetet, metodat dhe kompetencat e duhura për të verifikuar sistemin rregullator të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit dhe për të vlerësuar rreziqet e krijuara që janë identifikuar nga këto shoqëri, të cilët mund të ndikojnë në sigurinë e tyre financiare.

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse të kenë kompetencat e nevojshme që të kërkojnë që sistemi rregullator të përmirësohet dhe të forcohet për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenet 42 deri në 49.

Neni 42

Kërkesat për përshtatshmërinë e personave që drejtojnë shoqërinë ose që kanë funksione të tjera kyçe

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit sigurohen që të gjithë personat që drejtojnë shoqërinë ose që kanë funksione të tjera kyçe gjatë gjithë kohës përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) kualifikimet e tyre profesionale, njohuritë dhe përvoja e tyre janë të përshtatshme për një administrim të mirë dhe të kujdesshëm; dhe

b) ata gëzojnë reputacion të mirë dhe integritet.

2. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit njoftojnë autoritetin mbikëqyrës për çdo ndryshim në identitetin e personave që drejtojnë shoqërinë ose që janë përgjegjës për funksione të tjera kyçe, së bashku me informacionin e nevojshëm për të vlerësuar përshtatshmërinë e çdo personi të ri që është emëruar për të drejtuar shoqërinë.

3. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit njoftojnë autoritetin e tyre mbikëqyrës nëse ndonjë prej personave të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 janë zëvendësuar për arsye se ata nuk i përmbushnin më kërkesat e përmendura në paragrafin 1.

Neni 43

Provat që vërtetojnë reputacionin e mirë

1. Kur një shtet anëtar kërkon nga shtetasi e tij prova që vërtetojnë reputacionin e mirë, prova për mungesë të një falimentimi të mëparshëm ose të dyja bashkë, ky shtet pranon si provë të mjaftueshme për shtetasi e shteteve të tjera anëtare ekstraktin nga regjistri gjyqësor, ose në mungesë të tij, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor ose administrativ në shtetin anëtar të origjinës ose në shtetin anëtar nga i cili vjen shtetasi i huaj, ku tregohet se këto kërkesa janë përmbushur.

2. Kur shteti anëtar i origjinës ose shteti anëtar nga i cili vjen shtetasi i huaj nuk lëshon dokumentin e përmendur në paragrafin 1, ai dokument mund të zëvendësohet nga një deklaratë nën betim, ose për shtetet anëtare ku nuk parashikohet deklarata nën betim, një deklaratë solemne, e hartuar nga shtetasi i huaj në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ, ose, sipas rastit, përpara një noteri në shtetin anëtar të origjinës ose në shtetin anëtar nga i cili vjen ai shtetas i huaj.

Ky autoritet ose ky noter lëshon një vërtetim ku vërteton autenticitetin e deklaratës së bërë nën betim ose të deklaratës solemne.

Deklarata e përmendur në nënparagrafin e parë në lidhje me mungesën e një falimentimi të mëparshëm mund të bëhet edhe përpara një organi kompetent profesional ose tregtar në shtetin anëtar në fjalë.

3. Dokumentet dhe certifikatat që përmenden në paragrafët 1 dhe 2 nuk paraqiten më vonë se tre muaj pas datës së lëshimit të tyre.

4. Shtetet anëtare përcaktojnë autoritetet dhe organet kompetente për lëshimin e dokumenteve të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 dhe për këtë informojnë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin.

Çdo shtet anëtar informon edhe shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin për autoritetet ose organet të cilave u dorëzohen dokumentet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 në mbështetje të një aplikimi për zhvillimin e veprimtarive të përmendura në nenin 2 në territorin e atij shteti anëtar.

Neni 44

Menaxhimi i rrezikut

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit ngrenë një sistem efektiv për menaxhimin e rrezikut i cili përfshin strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit që nevojiten për të identifikuar, matur, monitoruar, menaxhuar dhe raportuar vazhdimisht rreziqet, në nivel individual dhe të agreguar, ndaj të cilëve ato janë ekspozuar ose mund të ekspozohen dhe ndërvartësitë mes tyre.

Ky sistem për menaxhimin e rrezikut duhet të jetë efektiv dhe i mirintegruar në strukturën organizative dhe në proceset e vendimmarrjes së shoqërisë së sigurimit ose të risigurimit duke marrë në konsideratë siç duhet personat që drejtojnë shoqërinë ose kanë funksione kyçe brenda saj.

2. Sistemi për menaxhimin e rrezikut mbulon rreziqet që duhet të përfshihen për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi pague, siç përcaktohet në nenin 101, paragrafi 4 si edhe rreziqet që nuk përfshihen fare ose nuk përfshihen plotësisht në llogaritjen e kësaj kërkesë.

Sistemi për menaxhimin e rrezikut mbulon të paktën fushat e mëposhtme:

- a) marrjen në sigurim dhe krijimin e rezervave;
- b) menaxhimin e aktiveve dhe pasiveve;
- c) investimin, në veçanti derivatet dhe angazhimet e ngjashme;
- d) menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe përqendrimit;
- e) menaxhimin e rrezikut operacional;
- f) risigurimin dhe teknikat e tjera për zbutjen e rrezikut.

Politika e shkruar për menaxhimin e rrezikut që përmendet në nenin 41, paragrafi 3 përfshin politikat që lidhen me gerrat "a" deri në "f" të nënparagrafit të dytë të këtij paragrafi.

3. Për sa i përket rrezikut të investimit, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të tregojnë pajtueshmërinë e tyre me kapitullin VI, seksioni 6.

4. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit parashikojnë një funksion për menaxhimin e rrezikut i cili strukturohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë zbatimin e sistemit për menaxhimin e rrezikut.

5. Për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që përdorin një model të brendshëm të pjesshëm ose të plotë të miratuar në përputhje me nenet 112 dhe 113 funksioni i menaxhimit të rrezikut mbulon detyra të tjera si më poshtë:

- a) hartimin dhe zbatimin e modelit të brendshëm;
- b) testimin dhe miratimin e modelit të brendshëm;
- c) dokumentimin e modelit të brendshëm dhe çdo ndryshim pasues që i bëhet atij;
- d) analizimin e performancës së modelit të brendshëm dhe përgatitjen e raporteve përmbledhëse për të;
- e) informimin e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës për performancën e modelit të brendshëm duke sugjeruar fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe duke e përditësuar këtë organ për rezultatin e përpjekjeve për të përmirësuar dobësitë e identifikuara më parë.

1. Si pjesë e sistemit për menaxhimin e rrezikut çdo shoqëri sigurimi dhe çdo shoqëri risigurimi kryen vlerësimin e rrezikut të vet dhe aftësisë paguese.

Ky vlerësimi përfshin të paktën:

a) nevojat e përgjithshme për aftësi paguese duke marrë në konsideratë profilin specifik të rrezikut, kufijtë e miratuar të tolerancës ndaj rrezikut dhe strategjinë e biznesit që ka shoqëria;

b) pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat për kapital, siç përcaktohen në kapitullin VI, seksionet 4 dhe 5, dhe me kërkesat për provigjonet teknike, siç përcaktohen në kapitullin VI, seksioni 2;

c) shkallën në të cilën profili i rrezikut të shoqërisë në fjalë devijon nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, siç përcaktohet në nenin 101, paragrafi 3, e llogaritur sipas formulës standarde në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 2 ose sipas modelit e brendshëm të pjesshëm ose të plotë në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 3.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, germa "a", shoqëria në fjalë duhet të ketë ngritur procese proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që ekzistojnë në fushën e saj të veprimtarive dhe që i mundësojnë asaj që të identifikojë dhe të vlerësojë siç duhet rreziqet me të cilat përballet në një afat të shkurtër dhe të gjatë ndaj të cilëve është ekspozuar ose mund të ekspozohet. Shoqëria duhet të tregojë metodat e përdorura për këtë vlerësim.

3. Në rastin që përmendet në paragrafin 1, germa "c", kur përdoret një model i brendshëm, vlerësimi kryhet së bashku me rikalibrimin që transformon shifrat e rrezikut të brendshëm në matjen dhe kalibrimin e rrezikut të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese.

4. Vlerësimi i rrezikut të vet dhe aftësisë paguese është një pjesë integrale e strategjisë së biznesit dhe merret në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme për vendimet strategjike që merr shoqëria.

5. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit kryejnë vlerësimin që përmendet në paragrafin 1 rregullisht dhe menjëherë pas çdo ndryshimi të konsiderueshëm të profilit të tyre të rrezikut.

6. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit informojnë autoritetet mbikëqyrëse për rezultatet e çdo vlerësimi të rrezikut të vet dhe aftësisë paguese si pjesë e informacionit të raportuar në zbatim të nenit 35.

7. Vlerësimi i rrezikut të vet dhe aftësisë paguese nuk shërben për të llogaritur kërkesën për kapital. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese rregullohet vetëm në përputhje me nenet 37, 231 deri në 233 dhe 238.

Neni 46

Kontrolli i brendshëm

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit vendosin një kontroll efektiv për kontrollin e brendshëm.

Ky sistem përfshin të paktën procedurat administrative dhe të kontabilitetit, një kuadër të kontrollit të brendshëm, marrëveshje të përshtatshme për raportim në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe një funksion të pajtueshmërisë.

2. Funksioni i pajtueshmërisë përfshin këshillimin me organin administrativ, drejtues ose mbikëqyrës për pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara sipas kësaj direktive. Ai gjithashtu përfshin vlerësimin e ndikimit që mund të ketë çdo ndryshim në mjedisin ligjor në operacionet e shoqërisë në fjalë dhe identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pajtueshmërisë.

Neni 47

Auditi i brendshëm

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit parashikojnë një funksion efektiv të auditit të brendshëm.

Funksioni i auditit të brendshëm përfshin vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të elementeve të tjera të sistemit rregullator.

2. Funksioni i auditit të brendshëm duhet të jetë objektiv dhe i pavarur nga funksionet operacionale.

3. Të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm i raportohen organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, i cili përcakton se çfarë masash duhet të merren në lidhje me secilën prej gjetjeve dhe rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe sigurohet që këto masa të vihen në zbatim.

Neni 48

Funksioni aktuaristik

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit parashikojnë një funksion efektiv aktuaristik:

- a) për të koordinuar llogaritjen e provigjoneve teknike;
- b) për të garantuar përshtatshmërinë e metodologjive dhe modeleve mbështetëse që përdoren si edhe supozimeve të bëra për llogaritjen e provigjoneve teknike;
- c) për të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave që përdoren për llogaritjen e provigjoneve teknike;
- d) për të krahasuar parashikimet më të mira me përvojën e hasur;
- e) për të informuar organin administrativ, drejtues ose mbikëqyrës për besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e llogaritjes së provigjoneve teknike;

82; f) për të mbikëqyrur llogaritjen e provigjoneve teknike në rastet e përcaktuara në nenin

g) për të shprehur një mendim për politikën e përgjithshme të marrjes në sigurim;

h) për të shprehur një mendim për përshtatshmërinë e marrëveshjeve të risigurimit; dhe

i) për të kontribuar në zbatimin efektiv të sistemit për menaxhimin e rrezikut që përmendet në nenin 44, në veçanti në lidhje me mënyrën e parashikimit të rrezikut gjatë llogaritjes së kërkesave për kapital që përcaktohen në kapitullin VI, seksionet 4 dhe 5 dhe në lidhje me vlerësimin që përmendet në nenin 45.

2. Funkzioni aktuaristik kryhet nga persona të cilët kanë njohuri për matematikën aktuaristike dhe financiare të përshtatura me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që shoqërojnë veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit ose risigurimit dhe të cilët janë në gjendje të tregojnë përvojën e tyre përkatëse në përdorimin e standardeve të zbatueshme profesionale dhe standardeve të tjera.

Neni 49

Nënkontraktimi

1. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi të plotë për të gjitha detyrimet e tyre në zbatim të kësaj direktive kur ata nënkontraktajnë funksione ose ndonjë veprimtari sigurimi ose risigurimi.

2. Nënkontraktimi i funksioneve ose veprimtarive operacionale kritike ose të rëndësishme nuk kryhet në një mënyrë të tillë që çon në një nga situatat e mëposhtme:

a) dëmtimi material i cilësisë së sistemit rregullator në shoqërinë në fjalë;

b) rritja e papërshtatshme e rrezikut operacional;

c) dëmtimi i aftësisë së autoriteteve mbikëqyrëse për të monitoruar pajtueshmërinë e shoqërisë me detyrimet e saj;

d) cenimi i shërbimit të vazhdueshëm dhe të kënaqshëm për mbajtësit e policave.

3. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit njoftojnë në kohë autoritetet mbikëqyrëse përpara se të nënkontraktajnë funksione ose veprimtari kritike ose të rëndësishme si edhe për çdo zhvillim material pasues në lidhje me këto funksione ose veprimtari.

Neni 50

Masat zbatuese

1. Komisioni miraton masa zbatuese për specifikimin e mëtejshëm të:

a) elementeve të sistemit që përmenden në nenet 41, 44, 46 dhe 47 dhe në veçanti fushat që duhet të mbulohen nga politika për menaxhimin e aktiveve dhe pasiveve dhe për investimet, siç përmendet në nenin 44, paragrafi 2 të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit;

b) funksioneve që përmenden në nenet 44 dhe 46 deri në 48;

c) kërkesave që përcaktohen në nenin 42 dhe funksioneve që janë objekt i tyre;

d) kushteve sipas të cilave mund të kryhet nënkontraktimi, në veçanti për ofruesit e shërbimeve që ndodhen në vende të treta.

2. Kur kjo nevojitet për të garantuar konvergjencën e përshtatshme të vlerësimit që përmendet në nenin 45, paragrafi 1, germa "a", Komisioni mund të miratojë masat zbatuese për të specifikuar më tej elementet e këtij vlerësimi.

3. Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 3

BËRJA PUBLIKE

Neni 51

Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare: përmbajtja

1. Shtetet anëtare, duke marrë në konsideratë informacionin që kërkohet në paragrafin 3 dhe parimet që përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 35, u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të bëjnë publik, një herë në vit, një raport për aftësinë e tyre paguese dhe gjendjen e tyre financiare.

Ky raport përmban informacionin e mëposhtëm, qoftë plotësisht ose sipas referencave të informacionit të barasvlershëm, si për nga natyra ashtu dhe nga fusha e zbatimit, të nxjerrë në mënyrë publike sipas kërkesave të tjera ligjore ose rregullatore:

a) një përshkrim të veprimtarive dhe performancës së shoqërisë;

b) një përshkrim të sistemit rregullator dhe një vlerësim të përshtatshmërisë së tij me profilin e rrezikut të shoqërisë;

c) një përshkrim, të veçantë për çdo kategori rreziku, të ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit, zbutjes dhe sensitivitetit të rrezikut;

d) një përshkrim, të veçantë për aktivet, provigjonet teknike dhe pasiveve të tjera, të bazave dhe metodave të përdorura për vlerësimin e tyre së bashku me një shpjegim të ndryshimeve kryesore ndërmjet bazave dhe metodave që përdoren për vlerësimin e tyre në pasqyrat financiare;

e) një përshkrim të administrimit të kapitalit, duke përfshirë të paktën sa më poshtë:

I. strukturën dhe shumën e fondeve të veta dhe cilësinë e tyre;

II. shumat e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese dhe të kërkesës për kapital minimal;

II. opsionin që përcaktohet në nenin 304 i cili përdoret për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

IV. informacionin që mundëson të kuptohen ndryshimet kryesore ndërmjet supozimeve mbështetëse të formulës standarde dhe atyre të modelit të brendshëm që përdoren nga një shoqëri për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

V. shumën e çdo papajtueshmërie me kërkesën për kapital minimal ose të çdo papajtueshmërie të konsiderueshme me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese gjatë periudhës së raportimit, edhe nëse më vonë ajo është zgjidhur, me një shpjegim të origjinës së saj dhe pasojave dhe të çdo mase korrigjuese që është marrë.

2. Përshkrimi që përmendet në germën "e" pika I të paragrafit 1 përfshin një analizë të çdo ndryshimi të konsiderueshëm krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit si edhe një shpjegim të ndryshimeve kryesore në lidhje me vlerën e këtyre elementeve në pasqyrat financiare dhe një përshkrim të shkurtër të transferueshmërisë së kapitalit.

Në publikimin e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në germën "e" pika II tregohet veçmas shuma e llogaritur në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksionet 2 dhe 3 dhe çdo shtim i kapitalit i vendosur në përputhje me nenin 37 ose ndikimi i parametrave specifike që i kërkohet shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që të përdorin në përputhje me nenin 110, së bashku me informacionin konciz për justifikimin e tij nga ana e autoritetit mbikëqyrës përkatës.

Megjithatë, pa cenuar asnjë publikim që është i detyrueshëm sipas kërkesave të tjera ligjore ose rregullatore, shtetet anëtare mund të parashikojnë se, edhe pse kërkesa totale për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në germën "e", pika II të paragrafit 1 është publikuar, shtimi i kapitalit ose i parametrave specifike që kërkohen të përdoren nga shoqëritë e sigurimit ose risigurimit në përputhje me nenin 110, nuk kanë pse të publikohen veçmas gjatë një periudhe kalimtare që përfundon përpara datës 31 tetor 2017.

Publikimi i kërkesës për kapital dhe aftësi paguese shoqërohet, kur është e zbatueshme, nga një shënim që tregon se shuma e saj përfundimtare vazhdon të jetë objekt i vlerësimit mbikëqyrës.

Neni 52

Informacioni për dhe raportet nga CEIOPS

1. Shtetet anëtare u kërkojnë autoriteteve mbikëqyrëse që çdo vit t'i ofrojnë CEIOPS informacionin e mëposhtëm:

a) shtimin mesatar të kapitalit sipas shoqërive dhe shpërndarjen e shtimeve të kapitalit të vendosura nga autoriteti mbikëqyrës gjatë vitit të mëparshëm, të matur si përqindje e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, e treguar veçmas si më poshtë:

- I. për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit;
- II. për shoqëritë e sigurimit jetë;
- III. për shoqëritë e sigurimit jojetë;
- IV. për shoqëritë e sigurimit që kryejnë veprimtari sigurimi jetë dhe jojetë;
- V. për shoqëritë e risigurimit;

b) për secilin publikim që përcaktohet në germën "a", përqindjen e shtimeve të kapitalit të vendosur në zbatim të germave "a", "b" dhe "c" të nenit 37, paragrafi 1 përkatësisht.

2. CEIOPS-i nxjerr në mënyrë publike dhe çdo vit, informacionin si më poshtë:

a) për të gjitha shtetet anëtare së bashku, shpërndarjen totale të shtimeve të kapitalit, të matur si përqindje e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese për secilën nga sa më poshtë:

- I. të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit;
- II. shoqëritë e sigurimit jetë;
- III. shoqëritë e sigurimit jo-jetë;
- IV. shoqëritë e sigurimit që kryejnë veprimtari sigurimi jetë dhe jo-jetë;
- V. shoqëritë e risigurimit;

b) për secilin shtet anëtar në mënyrë të veçantë, shpërndarjen e shtimeve të kapitalit, të matur si përqindje të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, duke mbuluar të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në atë shtet anëtar;

c) për secilin publikim që përmendet në germet "a" dhe "b" përqindjen e shtimeve të kapitalit të vendosur në zbatim përkatësisht të germave "a", "b" dhe "c" të nenit 37, paragrafi 1.

3. CEIOPS i jep Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit informacionin e përmendur në paragrafin 2 së bashku me një raport ku përshkruhet shkalla e konvergencës së mbikëqyrjes në përdorimin e shtimeve të kapitalit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse në shtete anëtare të ndryshme.

Neni 53

Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare: parimet e zbatueshme

1. Autoritetet mbikëqyrëse lejojnë shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të mos nxjerrin informacione kur:

a) me nxjerrjen e këtij informacioni konkurrentët e shoqërisë do të fitonin një avantazh të konsiderueshëm e të papërshtatshëm;

b) ka detyrime ndaj mbajtësve të policave ose në marrëdhënie me palë të tjera që e detyrojnë një shoqëri të ruajë fshehtësinë ose konfidencialitetin e informacioneve.

2. Kur mosnxjerrja e informacionit lejohet nga autoriteti mbikëqyrës, shoqëritë e deklarojnë këtë fakt në raportin e tyre për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare dhe deklarojnë edhe arsyet.

3. Autoritetet mbikëqyrëse lejojnë shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, të përdorin, ose t'i referohen, nxjerrjes publike të informacionit të bërë në zbatim të kërkesave të tjera ligjore ose rregullatore, deri në masën që këto nxjerrje informacioni, nga natyra dhe fusha e zbatimit, janë të barasvlershme me informacionin që kërkohet sipas nenit 51.

4. Paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen për informacionin që përmendet në nenin 51, paragrafi 1, germa "e".

Neni 54

Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare: përditësimet dhe informacioni shtesë vullnetar

1. Në rastin e ndonjë zhvillimi të rëndësishëm që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në rëndësinë e informacionit të nxjerrë në përputhje me nenet 51 dhe 53, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nxjerrin informacionin e përshtatshëm për natyrën dhe efektet e këtij zhvillimi të rëndësishëm.

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, zhvillime të rëndësishme konsiderohen të paktën ngjarjet e mëposhtme:

a) vihet re papajtueshmëri me kërkesën për kapital minimal dhe autoritetet mbikëqyrëse gjykojnë se shoqëria ose nuk do të jetë në gjendje të dorëzojë një skemë financiare afatshkurtër reale ose nuk e marrin këtë skemë brenda një muaji nga data kur është vëzhguar papajtueshmëria;

b) vihet re papajtueshmëri e konsiderueshme me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe autoritetet mbikëqyrëse nuk marrin një plan realist rikuperimi brenda dy muajve nga data kur është vëzhguar papajtueshmëria.

Në lidhje me germën "a" të nënparagrafit të dytë, autoritetet mbikëqyrëse i kërkojnë shoqërisë në fjalë që të nxjerrë menjëherë shumën e papajtueshmërisë së bashku me një shpjegim të origjinës dhe pasojave të saj, duke përfshirë çdo masë korrigjuese që është marrë. Kur, pavarësisht një skeme financiare afatshkurtër e cila në fillim është gjykuar si realiste, papajtueshmëria me kërkesën për kapital minimal nuk është zgjidhur ende edhe tre muaj pasi

është vënë re, ajo bëhet publike në përfundim të kësaj periudhe së bashku me një shpjegim të origjinës dhe pasojave të saj, duke përfshirë çdo masë korrigjuese që është marrë si edhe çdo masë korrigjuese e mëtejshme që është planifikuar.

Në lidhje me germën "b" të nënparagrafit të dytë, autoritetet mbikëqyrëse i kërkojnë shoqërisë në fjalë që të nxjerrë menjëherë shumën e papajtueshmërisë së bashku me një shpjegim të origjinës dhe pasojave të saj, duke përfshirë çdo masë korrigjuese që është marrë. Kur, pavarësisht planit të rikuperimit i cili në fillim është gjykuar si realiste, papajtueshmëria e konsiderueshme me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese nuk është zgjidhur ende edhe gjashtë muaj pasi është vënë re, ajo bëhet publike në përfundim të kësaj periudhe së bashku me një shpjegim të origjinës dhe pasojave të saj, duke përfshirë çdo masë korrigjuese që është marrë si edhe çdo masë korrigjuese e mëtejshme që është planifikuar.

2. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të nxjerrin, në mënyrë vullnetare, çdo informacion ose shpjegim që lidhet me aftësinë e tyre paguese dhe gjendjen e tyre financiare, i cili nuk është kërkuar ende që të nxirret në përputhje me nenet 51 dhe 53 dhe paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 55

Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare: politika dhe miratimi

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të vendosin sisteme dhe struktura të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenet 51 dhe 53 dhe në nenin 54, paragrafi 1 si edhe që të kenë një politikë të shkruar që garanton përshtatshmërinë e vazhdueshme të çdo informacioni të nxjerrë në përputhje me nenet 51, 53 dhe 54.

2. Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare është objekt miratimi nga organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit dhe publikohet vetëm pas këtij miratimi.

Neni 56

Raporti për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare: masat zbatuese

Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë më tej informacionin që duhet nxjerrë dhe mënyrat me anë të së cilave duhet bërë diçka e tillë.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 4

PJESËMARRJET INFLUENCUESE

Neni 57

Blerjet

1. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik, ose personave të tillë, që veprojnë bashkërisht ("blerësi i propozuar"), të cilët vendosin qoftë për të blerë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese në një shoqërie sigurimi ose risigurimi, ose të rrisin më tej, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrjen influencuese në një shoqëri sigurimi ose risigurimi, si rezultat i së cilës përqindja të drejtave të votës ose e kapitalit të zotëruar do të arrinte ose tejkalonte 20%, 30% ose 50%, ose që shoqëria e sigurimit ose risigurimit do të bëhej filial i tij ("blerja e propozuar"), të njoftojë fillimisht me shkrim autoritetet mbikëqyrëse të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit, në të cilën ata kërkojnë të blejnë aksione ose të rrisin pjesëmarrjen influencuese, duke treguar përmasat e pjesëmarrjes së synuar dhe informacionin përkatës siç përmendet në nenin 59, paragrafi 4. Shtetet anëtare nuk janë të detyruar të zbatojnë kufirin e 30% në rastin kur ato zbatojnë kufirin e një të tretës, në përputhje me nenin 9, paragrafi 3, germa "a" të Direktivës 2004/109/KE.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik, që vendos të çlirohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga pjesëmarrja influencuese në shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit, njofton që në fillim me shkrim autoritetet kompetente, duke treguar përmasat e sipërmarrjes së atij personi pas çlirimit së synuar. Gjithashtu, ky person njofton autoritetet mbikëqyrëse, në rastin e vendimit për reduktimin e pjesëmarrjes së tij influencuese, në mënyrë që përqindja e të drejtave të votës ose e kapitalit të bjerë nën 20%, 30% ose 50%, ose në mënyrë që shoqëria e sigurimit ose e risigurimit të pushojë së qeni filial i atij personi. Shtetet anëtare nuk janë të detyruar të zbatojnë kufirin e 30% në rastin kur ato zbatojnë kufirin e një të tretës, në përputhje me nenin 9, paragrafi 3, germa "a" të Direktivës 2004/109/KE.

Neni 58

Periudha e vlerësimit

1. Autoritetet mbikëqyrëse, menjëherë dhe në çdo rast brenda dy ditëve pune nga marrja e njoftimit të kërkuar sipas nenit 57, paragrafi 1, si edhe pas marrjes pasuese të informacionit të përmendur në paragrafin 2, i konfirmojnë me shkrim marrjen e tyre blerësit të propozuar.

Autoriteteve mbikëqyrëse kanë në dispozicion një maksimum prej gjashtëdhjetë ditë pune nga data e konfirmimit me shkrim të marrjes së njoftimit dhe të gjitha dokumenteve që shteti anëtar kërkon që t'u bashkëngjiten njoftimit sipas listës së përmendur në nenin 59, paragrafi 4 ("periudha e vlerësimit"), për të kryer vlerësimin e parashikuar në nenin 59, paragrafi 1 (vlerësimi).

Gjatë konfirmimit të marrjes, autoritetet mbikëqyrëse njoftojnë blerësin e propozuar në lidhje me përfundimin e afatit të periudhës së vlerësimit.

2. Nëse është e nevojshme, gjatë periudhës së vlerësimit dhe përpara ditës së pesëdhjetë të punës gjatë kësaj periudhe, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë çdo informacion të mëtejshëm që nevojitet për të përfunduar vlerësimin. Kërkesa bëhet me shkrim dhe specifikon informacionin shtesë që nevojitet.

Nga dita kur autoritetet mbikëqyrëse dërgojnë kërkesën për informacion dhe deri në ditën e marrjes së një përgjigjeje nga blerësi i propozuar për këtë kërkesë periudha e vlerësimit ndërpritet. Kjo ndërprerje nuk tejkalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë tjetër e autoriteteve mbikëqyrëse për përfundimin ose qartësimin e informacionit i lihet gjykimit të tyre, por kjo kërkesë nuk çon në ndërprerjen e periudhës së vlerësimit.

3. Autoritetet mbikëqyrëse mund të zgjasin ndërprerjen e përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2 deri në 30 ditë pune, në rastin kur blerësi i propozuar:

a) ndodhet ose rregullohet jashtë Komunitetit; ose

b) është një person fizik ose juridik që nuk është objekt i mbikëqyrjes sipas kësaj direktive, Direktivës së Këshillit 85/611/KEE, datë 20 dhjetor 1985, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sipërmarrjet për investime kolektive në tituj të transferueshëm” (SIKTT)³², Direktiva 2004/39/KE, ose Direktiva 2006/48/KE.

4. Nëse pas përfundimit të vlerësimit, autoritetet mbikëqyrëse vendosin të kundërshtojnë blerjen e propozuar, ato informojnë me shkrim blerësin e propozuar, brenda dy ditësh pune dhe pa tejkalluar periudhën e vlerësimit, duke dhënë arsyet e tyre. Në zbatim të legjislacionit të brendshëm, me kërkesë të blerësit të propozuar, deklarata e përshtatshme e arsyeve që qëndrojnë pas vendimit mund të jetë e aksesueshme për publikun. Kjo nuk e pengon një shtet anëtar që, në mungesë të kërkesës së blerësit të propozuar, të lejojë autoritetin mbikëqyrës që të bëjë një publikim të tillë.

5. Nëse autoritetet mbikëqyrëse nuk kundërshtojnë me shkrim blerjen e propozuar gjatë periudhës së vlerësimit, ajo konsiderohet e miratuar.

6. Autoritetet mbikëqyrëse mund të caktojnë periudhën maksimale për përfundimin e blerjes së propozuar dhe ta zgjasin atë sipas rastit.

7. Në lidhje me njoftimin e blerjeve indirekte të të drejtave të votës ose kapitalit tek autoritetet kompetente dhe me miratimin e tyre nga ky i fundit, shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa që janë më të rrepta se ato që përcaktohen në këtë direktivë.

8. Komisioni miraton masat zbatuese duke specifikuar më tej rregullimet e kritereve që përcaktohen në nenin 59, paragrafi 1, me qëllim që të merren në konsideratë zhvillimet e ardhshme dhe të garantohet zbatimi uniform i neneve 57 deri në 63.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 59

Vlerësimi

1. Gjatë vlerësimit të njoftimit të parashikuar në nenin 57, paragrafi 1 dhe të informacionit të përmendur në nenin 58, paragrafi 2, me qëllim garantimin e administrimit të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në të cilën propozohet blerja dhe duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm të blerësit të propozuar në shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit, autoritetet kompetente vlerësojnë përshtatshmërinë e aksionarit të propozuar dhe stabilitetin financiar të blerjes së propozuar sipas të gjitha kriterëve të mëposhtme:

a) reputacionit të aksionarit të propozuar;

b) reputacionit dhe përvojës së çdo personi që do të drejtojë veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit ose risigurimit, si rezultat i blerjes së propozuar;

c) stabilitetit financiar të blerësit të propozuar, veçanërisht në lidhje me llojin e veprimtarisë së zhvilluar dhe të parashikuar të shoqërisë së sigurimit ose të risigurimit në të cilën propozohet blerja;

d) faktit nëse shoqëria e sigurimit ose risigurimit do të jetë në gjendje të përmbushë ose të vazhdojë të përmbushë kërkesat e kujdesshme të mbështetura në këtë direktivë dhe, aty ku është e zbatueshme, në direktiva të tjera, konkretisht në Direktivën 2002/87/KE, në veçanti faktin nëse grupi, pjesë e të cilit do të bëhet shoqëria, ka një strukturë të tillë që të mundësojë ushtrimin e mbikëqyrjes efikase, shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe përcaktimin e ndarjes së përgjegjësive ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse;

e) faktit nëse ka arsye të mundshme për të dyshuar, në lidhje me blerjen e propozuar, se po kryhet, është kryer ose ka pasur tentativa për të kryer pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit”, ose në rastin kur blerja e propozuar shton rrezikun e tyre.

2. Autoritetet mbikëqyrëse mund të kundërshtojnë blerjen e propozuar, vetëm nëse ka arsye të mjaftueshme për ta bërë diçka të tillë bazuar në kriteret e përcaktuara në paragrafin 1, ose në rastin kur informacioni i siguruar nga blerësi i propozuar është i paplotë.

3. Shtetet anëtare nuk caktojnë asnjë kusht paraprak në lidhje me nivelin e pjesëmarrjes që duhet blerë dhe as nuk lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse të shqyrtojnë blerjen e propozuar sipas nevojave ekonomike të tregut.

4. Shtetet anëtare bëjnë publike listën ku specifikohet informacioni, i cili nevojitet për të kryer vlerësimin dhe që duhet t’u jepet autoriteteve mbikëqyrëse në kohën e njoftimit të përmendur në nenin 57, paragrafi 1. Informacioni i kërkuar është proporcional dhe i përshtatur me natyrën e blerësit të propozuar dhe blerjes së propozuar. Shtetet anëtare nuk kërkojnë informacione që nuk kanë lidhje me vlerësimin e kujdesshëm.

5. Pavarësisht nenit 58, paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas të cilave dy ose më shumë propozime për blerjen ose rritjen e pjesëmarrjeve influencuese në të njëjtën shoqëri sigurimi ose risigurimi i njoftohen autoritetit mbikëqyrës, ky i fundit i trajton blerësit e propozuar në mënyrë jodiskriminuese.

Neni 60

Blerjet nga shoqëritë financiare të rregulluara

1. Gatë kryerjes së vlerësimit, autoritetet kompetente përkatëse punojnë në bashkëpunim të plotë me njëri-tjetrin, në rastin kur blerësi i propozuar është si më poshtë:

a) institucion krediti, shoqëri sigurimi ose risigurimi, firmë investimi ose shoqëri administruese sipas kuptimit që i jepet në pikën 2 të nenit 1a të Direktivës 85/611/KEE (shoqëria administruese e SIKTT-së), e autorizuar në një shtet tjetër anëtar ose sektorë të ndryshëm nga ai ku është propozuar blerja;

a) shoqëri mëmë e një institucioni krediti, shoqërie sigurimi ose risigurimi, firmë investimi ose shoqëri administruese e SIKTT-së e autorizuar në një shtet tjetër anëtar ose sektorë të ndryshëm nga ai ku është propozuar blerja; ose

c) person fizik ose juridik, që kontrollon një institucion krediti, një shoqëri sigurimi ose risigurimi, një firmë investimi ose një shoqëri administruese të SIKTT-së e autorizuar në një shtet tjetër anëtar ose në sektorë të ndryshëm nga ku është propozuar blerja.

2. Autoritetet mbikëqyrëse, pa vonesa të paarsyeshme, i japin njëri tjetrit çdo informacion thelbësor ose të rëndësishëm për vlerësimin. Në këtë drejtim, autoritetet mbikëqyrëse duhet t' i komunikojnë njëri tjetrit, sipas kërkesës, të gjitha informacionet përkatëse dhe, me iniciativën e tyre, të gjithë informacionin thelbësor. Vendimi i autoritetit mbikëqyrës që ka autorizuar shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit në të cilën propozohet blerja, tregon mbi pikëpamjet ose rezervat e shprehura nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për blerësin e propozuar.

Neni 61

Informacioni i shoqërive të sigurimit ose të risigurimit për autoritetin e mbikëqyrjes

Sapo vihen në dijeni, shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit informojnë autoritetin e mbikëqyrjes së shtetit anëtar të origjinës në lidhje me çdo blerje ose çlirim nga pjesëmarrjet në kapitalin e saj, që shkaktojnë tejkalimin nga ose rënien e këtyre pjesëmarrjeve nën kufijtë e përmendur në nenin 57 dhe nenin 58, paragrafi 1 deri në 7.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, të paktën një herë në vit, informojnë autoritetin e mbikëqyrjes në shtetin anëtar të origjinës së tyre, në lidhje me emrat e aksionarëve dhe të anëtarëve që zotërojnë pjesëmarrje influencuese dhe madhësinë e këtyre pjesëmarrjeve, për shembull, përmes informacionit të marrë nga mbledhjet e përgjithshme vjetore të aksionarëve dhe të anëtarëve, ose si rezultat i pajtueshmërisë me rregulloret në lidhje me kompanitë e listuara në bursa.

Neni 62

Pjesëmarrjet influencuese, kompetencat e autoritetit të mbikëqyrjes

Në rastin kur ndikimi i ushtruar nga personat e përmendur në nenin 57 ka gjasa të ndikojë negativisht në administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të shoqërisë së sigurimit ose të risigurimit, shtetet anëtare i kërkojnë autoritetit mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës së kësaj shoqërie në të kërkohet ose rritet pjesëmarrja influencuese, që të marrë masat e përshtatshme për t'i dhënë fund kësaj situate. Këto masa mund të përmbajnë, për shembull, urdhra, sanksione kundër drejtorëve ose menaxherëve, apo pezullimin e ushtrimit të së drejtës së votës për aksionet e zotëruara nga aksionarët ose anëtarët në fjalë.

Masa të ngjashme me to zbatohen për personat fizik ose juridik, të cilët nuk përmbushin detyrimin për njoftim, që përcaktohet sipas nenit 57.

Në rastet kur pjesëmarrja blihet pavarësisht kundërshtimit të autoriteteve mbikëqyrëse, shtetet anëtare, pavarësisht çdo sanksioni tjetër që duhet të miratohet, parashikojnë:

1. pezullimin e ushtrimit të të drejtave përkatëse të votës; ose
2. pavlefshmërinë e çdo vote të hedhur ose mundësinë e anulimit të tyre.

Neni 63

Të drejtat e votës

Për qëllimet e këtij seksioni, merren në konsideratë të drejtat e votës të përmendura në nenet 9 dhe 10 të Direktivës 2004/109/KE, si dhe kushtet në lidhje me agregimin e tyre, të përcaktuara në nenin 12, paragrafët 4 dhe 5 të kësaj direktive.

Shtetet anëtare nuk marrin në konsideratë të drejtat e votës ose aksionet që firmat e investimit ose institucionet e kreditit zotërojnë si rezultat i marrjes në sigurim të instrumenteve financiare dhe/ose caktimit të instrumenteve financiare në angazhimet e një firme që përfshihen në pikën 6, të seksionit A, të shtojcës I të Direktivës 2004/39/KE, nëse këto të drejta, nga njëra anë nuk ushtrohen apo përdoren për të ndërhyrë në administrimin e emetuesit, dhe nga ana tjetër, çlirohen brenda një viti nga blerja e tyre.

SEKSIONI 5

SEKRETI PROFESIONAL, SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE NXITJA E KONVERGJENCËS SË MBIKËQYRJES

Neni 64

Sekreti profesional

Shtetet anëtare parashikojnë që të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetet mbikëqyrëse, si dhe audituesit dhe ekspertët që veprojnë në emër të këtyre autoriteteve, të respektojnë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional.

Pa cenuar rastet e mbuluara nga e drejta penale, çdo informacion konfidencial, i marrë nga këta persona gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, nuk duhet t'i jepet asnjë personi ose autoriteti tjetër, përveçse në formë të përmbledhur ose të agreguar, në mënyrë të tillë që shoqëritë individuale të sigurimit dhe të risigurimit të mos identifikohen.

Megjithatë, kur një shoqëri sigurimi ose risigurimi deklarohet se ka falimentuar, ose është në likuidim të detyrueshëm, gjatë procedimit civil ose tregtar mund të jepet informacioni konfidencial që nuk lidhet me palët e treta të përfshira në përpjekjet e shpëtimit të kësaj sipërmarrjeje.

Neni 65

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare

Nenin 64 nuk përjashton shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare të ndryshme. Ky informacion mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional, i parashikuara në nenin 64.

Neni 66

Marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet e treta

Shtetet anëtare mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ku parashikohet shkëmbimi i informacionit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta ose me autoritetet ose organet e vendeve të treta të përcaktuara në nenin 68, paragrafi 1 dhe 2, vetëm nëse për informacioni e dhënë jepen garanci për sekretin profesional të paktën të barasvlershme me ato që përmenden në këtë seksion. Ky informacion shkëmbehet me qëllim që këto autoritete apo organe të kryejnë detyrën e mbikëqyrjes.

Kur informacioni që një shtet anëtar duhet t'i japë një vendi të tretë e ka origjinën në një shtet tjetër anëtar, ai nuk jepet pa miratimin e shprehur të autoritetit mbikëqyrës të atij shteti anëtar dhe, sipas rastit, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara nga ai autoritet.

Neni 67

Përdorimi i informacionit konfidencial

Autoritetet mbikëqyrëse, të cilat marrin informacion konfidencial sipas neneve 64 ose 65, mund ta përdorin këtë informacion vetëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe për qëllimet si më poshtë:

1. për verifikimin e përmbushjes së kushteve që rregullojnë fillimin e veprimtarive të sigurimit ose të risigurimit dhe lehtësimin e monitorimit të ushtrimit të këtyre veprimtarive,

veçanërisht në lidhje me monitorimin e provigjoneve teknike, kërkesën për kapital dhe aftësi pages, kërkesën për kapital minimal, dhe sistemin rregullator;

2. për vendosjen e sanksioneve;
3. në apelimet administrative kundër vendimeve të marra nga autoritetet mbikëqyrëse;
4. në proceset gjyqësore në zbatim të kësaj direktive.

Neni 68

Shkëmbimi i informacionit me autoritetet e tjera

1. Nenet 64 dhe 67 nuk përjashtojnë të mëposhtmet:

a) shkëmbimin e informacionit ndërmjet disa autoriteteve mbikëqyrëse në të njëjtin shtet anëtar në zbatim të funksioneve të tyre mbikëqyrëse;

b) shkëmbimin e informacionit, në zbatim të funksioneve të tyre mbikëqyrëse, ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe secilit prej organeve të mëposhtmet, të ndodhura në të njëjtin vend anëtar:

I. autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit dhe organizatave të tjera financiare, dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare;

II. organet e përfshira në likuidimin dhe falimentimin e shoqërive të sigurimit ose risigurimit, dhe në procedura të tjera të ngjashme;

III. personat përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të shoqërive të sigurimit, shoqërive të risigurimit, ose institucioneve të tjera financiare;

c) komunikimin e informacionit, te organet administruese të procedurave të detyrueshme të likuidimit ose të fondeve të garancisë, që nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre.

Shkëmbimet e informacionit të përmendura në gerat "b" dhe "c" mund të bëhen edhe ndërmjet shteteve të ndryshme anëtare.

Informacioni i marrë nga këto autoritete, organe dhe persona është objekt i detyrimit për të ruajtur sekretin profesional që përcaktohet në nenin 64.

2. Nenet 64 deri në 67 nuk pengojnë shtetet anëtare që të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe atyre si më poshtë:

a) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e shoqërive të sigurimit, shoqërive të risigurimit, dhe procedurave të tjera të ngjashme;

b) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të shoqërive të sigurimit, shoqërive të risigurimit, institucioneve të kreditit, firmave të investimit ose institucioneve të tjera financiare.

c) aktuarëve të pavarur të shoqërive të sigurimit ose të risigurimit, të cilët zhvillojnë mbikëqyrjen ligjore të këtyre shoqërive dhe organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre aktuarëve.

Shtetet anëtare që zbatojnë nënparagrafin e parë kërkojnë të paktën përmbushjen e kushteve si më poshtë:

a) informacioni duhet të merret me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes ose mbikëqyrjes ligjore të përmendur në nënparagrafin e parë;

b) informacioni i marrë duhet të jetë objekt i detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, të përcaktuar në nenin 64;

c) kur informacioni e ka origjinën nga një shtet tjetër anëtar, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoritetit mbikëqyrës nga i cili ai vjen dhe, sipas rastit, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara nga ky autoritet.

Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare, emrat e autoriteteve, personave dhe organeve që mund të marrin informacion në përputhje me nënparagrafin e parë dhe të dytë.

3. Nenet 64 deri në 67 nuk pengojnë shtetet anëtare që, me synimin për të përforcuar stabilitetin dhe integritetin e sistemit financiar, të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve ose organeve përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit për shoqëritë tregtare.

Shtetet anëtare që zbatojnë nënparagrafin e parë kërkojnë të paktën përmbushjen e kushteve si më poshtë:

a) informacioni duhet të shkëmbehet me qëllim zbulimin dhe hetimin që përmendet në nënparagrafin e parë;

b) informacioni i marrë duhet të jetë objekt i detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, të përcaktuar në nenin 64;

c) kur informacioni e ka origjinën nga një shtet anëtar tjetër, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoritetit mbikëqyrës nga i cili vjen dhe, sipas rastit, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara nga ky autoritet.

Në rastet kur në një shtet anëtar autoritetet ose organet e përmendura në nënparagrafin e parë kryejnë detyrën e zbulimit ose hetimit me ndihmën e personave të emëruar, sipas kompetencave të tyre specifike, për këtë qëllim dhe të papunësuar në sektorin publik, procesi i shkëmbimit të informacionit që parashikohet në nënparagrafin e parë, mund të përfshijë edhe këta persona, sipas kushteve të përcaktuara në nënparagrafin e parë.

Me qëllim zbatimin e germës "c" të nënparagrafit të dytë, autoritetet ose organet e përmendura në nënparagrafin e parë i komunikojnë autoritetit mbikëqyrës, nga i cili vjen informacioni, emrat dhe përgjegjësitë e sakta të personave të cilëve duhet t'u dërgohet ky informacion.

4. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare emrat e autoriteteve, personave ose organeve që mund të marrin informacion sipas paragrafit 3.

Neni 69

Komunikimi i informacionit për administratat qeveritare përgjegjëse për legjislacionin financiar

Nenet 64 dhe 67 nuk pengojnë shtetet anëtare që, sipas dispozitave të përcaktuara me ligj, të autorizojnë nxjerrjen e informacioneve të caktuara tek departamente të tjera të administratës së qeverisë qendrore përgjegjëse për legjislacionin për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit, institucioneve financiare, të shërbimeve të investimit dhe shoqërive të sigurimit ose të risigurimit, dhe tek inspektorët që veprojnë në emër të këtyre departamenteve.

Ky informacion mund të nxirret vetëm kur nevojitet për arsye të kontrollit të kujdesshëm. Megjithatë, shtetet anëtare parashikojnë që informacioni i marrë në zbatim të nenit 65 dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe informacioni i marrë përmes verifikimeve në terren, që përmenden në nenin 32, mund të nxirret vetëm përmes miratimit të shprehur të autoritetit mbikëqyrës, nga i cili ka origjinën informacioni ose të autoritetit mbikëqyrës të shtetit anëtar në të cilin zhvillohet verifikimi në terren.

Neni 70

Transmetimi i informacionit të bankat qendrore dhe autoritetet monetare

Pa cenuar këtë seksion, autoriteti mbikëqyrës mund të transmetojë informacionin që shërben për kryerjen e detyrave të tyre drejt organeve të mëposhtme:

1. bankave qendrore dhe organeve të tyre që kanë funksion të ngjashëm në cilësinë e tyre si autoritete monetare;

2. aty ku kërkohet, autoriteteve të tjera publike, përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave.

Këto organe ose autoritete gjithashtu mund t'ia komunikojnë këtë informacion autoriteteve mbikëqyrëse të cilëve mund t'iu nevojitet për qëllimet e nenit 67. Informacioni i marrë në këtë kontekst është objekt i dispozitave për ruajtjen e sekretit profesional, të përcaktuara në këtë seksion.

Neni 71

Konvergjencia mbikëqyrëse

1. Shtetet anëtare sigurohen që mandatet e autoriteteve mbikëqyrëse marrin siç duhet në konsideratë dimensionin e Bashkimit Evropian.

2. Shtetet anëtare sigurojnë që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre autoritetet mbikëqyrëse marrin në konsideratë konvergjencën në drejtim të instrumenteve mbikëqyrëse dhe praktikave mbikëqyrëse gjatë zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe kërkesave administrative të miratuara sipas kësaj direktive. Për këtë qëllim, shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse marrin pjesë në veprimtaritë e CEIOPS, sipas Vendimit 2009/79/Ke dhe marrin në konsideratë si duhet udhëzimet dhe rekomandimet e tij, siç përmenden në paragrafin 3 të këtij neni.

3. CEIOPS-i, aty ku është e nevojshme, parashikon udhëzime dhe rekomandime që nuk kanë forcë ligjore në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj direktive dhe masave të saj zbatuese me qëllim përmirësimin e konvergjencës së praktikave mbikëqyrëse. Gjithashtu, CEIOPS-i i raporton rregullisht, dhe të paktën çdo dy vjet, Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit në lidhje me ecurinë e konvergjencës mbikëqyrëse në Komunitet.

SEKSIONI 6

DETYRAT E AUDITUESVE

Neni 72

Detyrat e audituesve

1. Shtetet anëtare minimalisht parashikojnë që çdo person i autorizuar sipas kuptimit të Direktivës së Tetë të Këshilli 84/253/KEE, datë 10 prill 1984, bazuar në nenin 54, paragrafi 3, germa "g" të Traktit për miratimin e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve kontabël, të cilët kryejnë në shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit auditimin ligjor të përmendur në nenin 51 të Direktivës 78/660/KEE, në nenin 37 të Direktivës 83/349/KEE, ose në nenin 31 të Direktivës 85/611/KEE ose çdo detyrë tjetër ligjore, ka detyrimin që t'i raportojë menjëherë autoriteteve mbikëqyrëse çdo fakt apo vendim lidhur me shoqërinë në fjalë, për të cilin ka marrë dijeni gjatë kryerjes së kësaj detyre dhe që mund të rezultojë në:

a) shkelje të rëndë të ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative që përcaktojnë kushtet që rregullojnë autorizimin ose që rregullojnë konkretisht ushtrimin e aktiviteteve të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit;

b) dëmtim të funksionimit të vazhdueshëm të shoqërisë së sigurimit ose të risigurimit;

c) një refuzim për të vërtetuar llogaritë ose shprehjen e rezervave.

d) mospërputhje me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

e) mospërputhje me kërkesën për kapital minimal.

Personat e përmendur në nënparagrafin e parë raportojnë të gjitha faktet ose vendimet, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrës së përshkruar në nënparagrafin e parë në

një shoqëri e cila ka lidhje të ngushta të cilat rezultojnë nga një marrëdhënie kontrolli me shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit ku ata e kryejnë këtë detyrë.

2. Raportimi në mirëbesim i ndonjë fakti apo vendimi, të përmendur në paragrafin 1, tek autoritetet kompetente, nga persona të autorizuar në përputhje me Direktivën 84/253/KEE, nuk përbën shkelje të ndonjë kufizimi për dhënien e informacionit të përcaktuar në kontratë ose në ndonjë dispozitë ligjore, rregullatore ose administrative dhe nuk i ngarkon këta persona me asnjë lloj përgjegjësie.

KAPITULLI V

ZHVILLIMI I VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT JETË DHE JO-JETË

Neni 73

Zhvillimi i veprimtarisë së sigurimit jetë dhe jo-jetë

1. Shoqëritë e sigurimit nuk autorizohen për të zhvilluar, njëkohësisht, veprimtaritë e sigurimit jetë dhe jo-jetë.

2. Duke shfuqizuar paragrafin 1, shtetet anëtare mund të parashikojnë që:

a) shoqëritë e autorizuara për të zhvilluar veprimtaritë e sigurimit jetë mund të marrin autorizim për veprimtaritë e sigurimit jo-jetë për rreziqet e përcaktuara në klasat 1 dhe 2 në pjesën A të shtojcës I;

b) shoqëritë e autorizuara vetëm për rreziqet e përcaktuara në klasat 1 dhe 2 në pjesën A të shtojcës I mund të marrin autorizim për të zhvilluar veprimtari të sigurimit jetë.

Megjithatë, çdo veprimtari administrohet veçmas në përputhje me nenin 74.

3. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që shoqëritë e përmendura në paragrafin 2 të veprojnë në pajtim me rregullat e kontabilitetit që rregullojnë shoqëritë e sigurimit jetë për të gjitha veprimtaritë e tyre. Në pritje të koordinimit në këtë drejtim, shtetet anëtare gjithashtu mund të parashikojnë që, në lidhje me rregullat për likuidim, veprimtaritë që lidhen me rreziqet e përcaktuara në klasat 1 dhe 2 në pjesën A të shtojcës I që zhvillohen nga këto shoqëri të rregullohen nga rregullat që zbatohen për veprimtaritë e sigurimit jetë.

4. Kur një shoqëri sigurimi jo-jetë ka lidhje financiare, tregtare ose administrative me një shoqëri sigurimi jetë, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës sigurohen që llogaritë e shoqërive në fjalë të mos shtrembërohen nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet këtyre shoqërive ose nëpërmjet ndonjë marrëveshjeje që mund të ndikojë në ndarjen e shpenzimeve dhe të ardhurave.

5. Shoqëritë, të cilat në datat e mëposhtme kanë zhvilluar njëkohësisht veprimtaritë e sigurimit jetë dhe jojetë që mbulohen nga kjo direktivë, mund të vazhdojnë të zhvillojnë

njëkohësisht këto veprimtari, me kusht që secila veprimtari të administrohet veçmas në përputhje me nenin 74;

- a) 1 janar 1981 për shoqëritë e autorizuara në Greqi;
- b) 1 janar 1986 për shoqëritë e autorizuara në Spanjë dhe Portugali;
- c) 1 janar 1995 për shoqëritë e autorizuara në Austri, Finlandë dhe Suedi;
- d) 1 maj 2004 për shoqëritë e autorizuara në Republikën Çeke, Estoni, Qipro, Letoni, Lituani, Hungari, Maltë, Poloni, Sllovaki, dhe Slloveni;
- e) 1 janar 2007 për shoqëritë e autorizuara në Bullgari dhe Rumani;
- f) 15 mars 1979 për të gjitha shoqëritë e tjera.

Shteti anëtar i origjinës mund t'u kërkojë shoqërive të sigurimit që, brenda një periudhe që përcaktohet nga ai shtet anëtar, të ndalojnë zhvillimin e njëkohshëm të veprimtarive të sigurimit jetë dhe jo-jetë, të cilat ata i zhvillonin në datat e përmendura në nënparagrafin e parë.

Neni 74

Ndarja e administrimit të sigurimit jetë dhe jo-jetë

1. Administrimi i ndarë që përmendet në nenin 73 organizohet në mënyrë të tillë që veprimtaria e sigurimit jetë të dallojë nga veprimtaria e sigurimit jojetë.

Interesat përkatëse të mbajtësve të policave të sigurimit jetë dhe jojetë nuk paragjykoen dhe, në veçanti, mbajtësit e policës së sigurimit jetë marrin fitime nga sigurimi jetë njësoj sikur shoqëria e sigurimit jetë të zhvillonte vetëm veprimtaritë e sigurimit jetë.

2. Pa cenuar nenet 100 dhe 128, shoqëritë e sigurimit që përmenden në nenin 73, paragrafi 2 dhe 5 llogarisin:

a) një kërkesë nominale për kapitalin minimal për sigurimin jetë në lidhje me veprimtaritë e sigurimit ose të risigurimit jetë, e llogaritur njësoj sikur shoqëria në fjalë të zhvillonte vetëm këtë veprimtari, mbi bazën e llogarive të ndara, siç përmenden në paragrafin 6; dhe

b) një kërkesë nominale për kapitalin minimal për sigurimin jetë në lidhje me veprimtaritë e sigurimit ose të risigurimit jetë, e llogaritur sikur shoqëria në fjalë të zhvillonte vetëm atë veprimtari, mbi bazën e llogarive të ndara siç përmenden në paragrafin 6.

3. Si minimum, shoqëritë e sigurimit që përmenden në nenin 73, paragrafi 2 dhe 5 duhet të mbulojnë, përmes një shume ekuivalente të fondeve të veta bazë, sa më poshtë:

a) kërkesën nominale për kapitalin minimal për sigurimin jetë, në lidhje me veprimtarinë e sigurimit jetë;

b) kërkesën nominale për kapitalin minimal për sigurimin jo-jetë, në lidhje me veprimtarinë e sigurimit jo-jetë;

Detyrimet minimale financiare të përmendura në nënparagrafin e parë, në lidhje me aktivitetin e sigurimit jetë dhe jojetë, nuk mbarten nga ndonjë veprimtari tjetër.

4. Për aq kohë sa përmbushen detyrimet minimale financiare të përmendura në paragrafin 3 dhe me kusht që autoriteti mbikëqyrës të informohet, shoqëria, për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në nenin 100, mund të përdorë zërat e shprehura të fondeve të veta që janë ende të disponueshme për një veprimtari ose për veprimtarinë tjetër.

5. Autoritetet mbikëqyrëse analizojnë rezultatet e veprimtarive të sigurimit jetë dhe jo-jetë për t'u siguruar se janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 4.

6. Llogaritë përgatiten në mënyrë të tillë që të tregohet veçmas se si kanë dalë rezultatet për sigurimin jetë dhe jo-jetë. Të gjitha të ardhurat, në veçanti primet, pagesat nga të risiguruarit dhe të ardhurat nga investimet, dhe shpenzimet, në veçanti pagesat e dëmeve, shtimet e provigjoneve teknike, primet e risigurimit dhe shpenzimet operative në lidhje me veprimtarinë e sigurimit, ndahen sipas origjinës së tyre. Zërat që janë të përbashkët për të dyja veprimtaritë futen në llogari sipas metodave të ndarjes që duhet të pranohen nga autoriteti mbikëqyrës.

Në bazë të llogarive, shoqëritë e sigurimit përgatisin një pasqyrë ku identifikohen qartë, në përputhje me nenin 98, paragrafi 4, zërat e fondeve të veta bazë që mbulojnë çdo kërkesë nominale për kapitalin minimal, siç përcaktohet në paragrafin 2.

7. Nëse shuma e zërave bazë të fondeve të veta në lidhje me një prej veprimtarive nuk mjafton për të mbuluar detyrimet financiare minimale që përmenden në nënparagrafin e parë të paragrafit 3, për veprimtarinë që ka mangësi autoritetet mbikëqyrëse zbatojnë masat e parashikuara në këtë direktivë, cilatdo qofshin rezultatet në veprimtarinë tjetër.

Duke shfuqizuar nënparagrafin i dytë i paragrafit 3, këto masa mund të përfshijnë autorizimin e transferimit të zërave bazë eksplicitë të fondeve të veta nga një veprimtari tek tjetra.

KAPITULLI VI

RREGULLAT LIDHUR ME VLERËSIMIN E AKTIVEVE DHE TË PASIVEVE, TË PROVIGJONEVE TEKNIKE, TË FONDEVE TË VETA, TË KËRKESËS PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE, KËRKESËS PËR KAPITAL MINIMAL DHE TË RREGULLAVE TË INVESTIMIT

SEKSIONI 1

VLERËSIMI I AKTIVEVE DHE PASIVEVE

Neni 75

Vlerësimi i aktiveve dhe pasiveve

1. Shtetet anëtare sigurohen që, përveç se kur deklarohet ndryshe, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit t'i vlerësojnë aktivet dhe pasivet si në vijim:

a) aktivet vlerësohen sipas shumës me të cilën ato do të mund të shkëmbeheshin ndërmjet palëve të gatshme të informuara nëpërmjet një transaksioni sipas parimit të tregut;

b) pasivet vlerësohen sipas shumës me të cilën ata do të mund të transferoheshin, ose të shlyheshin, ndërmjet palëve të gatshme të informuara nëpërmjet një transaksioni sipas parimit të tregut.

Gjatë vlerësimit të pasiveve sipas germës "b" nuk bëhet asnjë axhustim për të marrë në konsideratë gjendjen e kredisë për shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit.

2. Komisioni miraton masa zbatuese për të përcaktuar metodat dhe supozimet që duhet të përdoren për vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve siç përcaktohet në paragrafin 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 2

RREGULLAT QË LIDHEN ME PROVIGJONET TEKNIKE

Neni 76

Dispozita të përgjithshme

1. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të krijojnë provigjone teknike në lidhje me të gjitha detyrimet e tyre të sigurimit dhe risigurimit ndaj mbajtësve të policave dhe përfituesve të kontratave të sigurimit dhe të risigurimit.

2. Vlera e provigjoneve teknike përkon me shumën aktuale që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit do të duhej të paguanin nëse do t'i transferonin detyrimet e tyre të marrjes në sigurim menjëherë drejt një shoqërie tjetër sigurimi ose risigurimi.

3. Llogaritja e provigjoneve teknike bazohet dhe është në pajtim me informacionin e marrë nga tregjet financiare dhe me të dhënat e disponueshme për rreziqet e marrjes në sigurim (konsistenca me tregun).

4. Provigjonet teknike llogariten në mënyrë të kujdesshme, të besueshme dhe objektive.

5. Sipas parimit të përcaktuar në paragrafët 2, 3 dhe 4 dhe duke marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në nenin 75, paragrafi 1, llogaritja e provigjoneve teknike kryhet në përputhje me nenet 77 deri në 82 dhe me nenin 86.

Neni 77

Llogaritja e provigjoneve teknike

1. Vlera e provigjoneve teknike është e barabartë me shumën e parashikimit më të mirë dhe marzhit të rrezikut që përcaktohet në paragrafët 2 dhe 3.

2. Parashikimi më i mirë përkon me mesataren e ponderuar me probabilitet të flukseve të ardhshme të parasë, duke marrë në konsideratë vlerën e parave në kohë (vlera aktuale e pritshme e flukseve të ardhshme të parasë) duke përdorur strukturën përkatëse të normës së interesit pa rrezik.

Llogaritja e parashikimit më të mirë bazohet në informacion të përditësuar dhe të besueshëm dhe në supozime realiste dhe kryhet duke përdorur metoda aktuaristike dhe statistikore të përshtatshme, të zbatueshme dhe përkatëse.

Parashikimi i fluksit të parasë që përdoret për llogaritjen e parashikimit më të mirë merr në konsideratë të gjitha flukset hyrëse dhe dalëse të parasë që kërkohen për të shlyer detyrimet e sigurimit dhe risigurimit përgjatë kohëzgjatjes së tyre.

Parashikimi më i mirë llogaritet bruto, pa zbritje të shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë. Këto shuma llogariten veçmas, në përputhje me nenin 81.

3. Marzhi i rrezikut është i tillë që garanton se vlera e provigjoneve teknike është e barasvlershme me shumën që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit priten që të kërkojnë për të marrë përsipër dhe për të përmbushur detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurim.

4. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit vlerësojnë veçmas parashikimin më të mirë dhe marzhin e rrezikut.

Megjithatë, kur flukset e ardhshme të parasë që shoqërojnë detyrimet e marrjes në sigurim ose risigurim mund të riprodhohet në mënyrë të besueshme duke përdorur instrumentet financiare për të cilat është vëzhguar një vlerë e besueshme tregu, vlera e provigjoneve teknike që shoqërojnë këto flukse të ardhshme të parasë përcaktohet mbi bazën e vlerës së tregut për këto instrumente financiare. Në këtë rast nuk kërkohen llogaritje të veçanta për parashikimin më të mirë dhe për marzhin e rrezikut.

5. Kur shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit vlerësojnë parashikimin më të mirë dhe marzhin e rrezikut në mënyrë të veçantë, marzhi i rrezikut llogaritet duke përcaktuar koston për ofrimin e një shume të fondeve të veta të barabartë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese e cila nevojitet për të përmbushur detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurim përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

Norma e përdorur në përcaktimin e koston së ofrimit të kësaj shume të fondeve të veta të kualifikuara (norma e koston së kapitalit) është e njëjtë për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit dhe rishikohet në mënyrë periodike.

Norma e koston së kapitalit që përdoret është e njëjtë me normën shtesë, mbi normën përkatëse të interesit pa rreziku, që një shoqëri sigurimi ose risigurimi do të merrte përsipër nëse do të zotëronte një shumë të fondeve të veta të kualifikuara, siç përcaktohet në seksionin 3, të

barabartë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që nevojitet për të përmbushur detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurimi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së këtyre detyrimeve.

Neni 78

Elemente të tjera që duhet të merren në konsideratë për të llogaritur provigjonet teknike

Përveç nenit 77, për të llogaritur provigjonet teknike shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit marrin në konsideratë sa më poshtë:

1. të gjitha shpenzimet që merren përsipër gjatë përmbushjes së detyrimeve të marrjes në sigurim dhe në risigurim;
2. inflacionin, duke përfshirë inflacionin e shpenzimeve dhe të dëmeve;
3. të gjitha pagesat për mbajtësit e policave dhe përfituesit, duke përfshirë bonuset e ardhshme diskrete, që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit presin që të paguajnë, qofshin këto pagesa të garantuara nëpërmjet një kontrate ose jo, përveç se kur këto pagesa mbulohen nga neni 91, paragrafi 2.

Neni 79

Vlerësimi i garancive financiare dhe opsioneve kontraktore të përfshira në kontratat e sigurimit dhe të risigurimit

Gjatë llogaritjes së provigjoneve teknike shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit arrin në konsideratë vlerën e garancive financiare dhe të çdo opsiioni kontraktor të përfshirë në policat e sigurimit dhe të risigurimit.

Çdo supozim që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit bëjnë në lidhje me gjasat që mbajtësit e këtyre policave të ushtrojnë opsionet kontraktore, duke përfshirë ndërprerjet dhe dorëzimet e policave të sigurimit, janë realiste dhe bazohen në informacion aktual dhe të besueshëm. Këto supozime marrin në konsideratë, në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, ndikimin që mund të kenë ndryshimet e ardhshme të kushteve financiare dhe jofinanciare në ushtrimin e këtyre opsioneve.

Neni 80

Segmentimi

Gjatë llogaritjes së provigjoneve teknike, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i segmentojnë detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurim në grupe rreziku homogjene dhe minimalisht sipas linjës së biznesit.

Neni 81

Shumat e rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë

Llogaritja nga ana e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit të shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë duhet të bëhet në pajtim me nenet 76 deri në 80.

Gjatë llogaritjes së shumave të rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit marrin në konsideratë ndryshimin kohor ndërmjet rikuperimeve dhe pagesave të drejtpërdrejta.

Rezultati nga kjo llogaritje axhustohet duke marrë në konsideratë humbjet e pritshme për shkak të mospagesës nga kundërpala. Ky axhustim bazohet në vlerësimin e probabilitetit të mospagesës nga kundërpala dhe humbjen mesatare që rezulton nga kjo mospagesë (humbje e shkaktuar nga mospagesa).

Neni 82

Cilësia e të dhënave dhe zbatimi i rrumbullakosjeve, duke përfshirë qasjet rast pas rasti, për provigjonet teknike

Shtetet anëtare sigurohen që sipërmarrjet e sigurimit dhe të risigurimit kanë procese dhe procedura të brendshme që garantojnë përshtatshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të përdorura për llogaritjen e provigjoneve të tyre teknike.

Në rastet kur, në rrethana të veçanta, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit kanë të dhëna cilësore të pamjaftueshme për të zbatuar një metodë aktuaristike të besueshme për një grup ose nëngrup të detyrimeve të tyre të marrjes në sigurim dhe risigurim, ose për shumat e rikuperueshme nga kontratat e risigurimit dhe shoqëritë e qëllimit të veçantë, për të llogaritur parashikimin më të mirë mund të përdoren rrumbullakosje të përshtatshme, duke përfshirë qasjet rast pas rasti.

Neni 83

Krahasimi me përvojën

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të kenë ngritur procese dhe procedura që garantojnë se parashikimet më të mira dhe supozimet që qëndrojnë pas llogaritjes së parashikimeve më të mira krahasohen rregullisht me përvojën e mëparshme.

Në rastet kur krahasimi nxjerr në pah devijime sistematike ndërmjet përvojës dhe llogaritjeve të parashikimit më të mirë nga ana e shoqërive të sigurimit ose risigurimit, shoqëria në fjalë bën axhustimet e përshtatshme të metodave aktuaristike që përdoren dhe/ose të supozimeve që bëhen.

Neni 84

Mjaftueshmëria e nivelit të provigjoneve teknike

Me kërkesë të autoriteteve mbikëqyrëse, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit tregojnë mjaftueshmërinë e nivelit të provigjoneve të tyre teknike si edhe zbatueshmërinë dhe

përshtatshmërinë e metodave të zbatuara dhe saktësinë e të dhënave statistikore mbështetëse që janë përdorur.

Neni 85

Rritja e provigjoneve teknike

Deri në masën që llogaritja e provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit nuk bëhet në pajtim me nenet 76 deri në 83, autoritetet mbikëqyrëse mund t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të rrisin sasinë e provigjoneve teknike në mënyrë që ato të përkojnë me nivelin e përcaktuar sipas këtyre neneve.

Neni 86

Masat zbatuese

Komisioni miraton masa zbatuese që përcaktojnë sa më poshtë:

a) metodologjitë aktuaristike dhe statistikore për llogaritjen e parashikimit më të mirë që përmendet në nenin 77, paragrafi 2;

b) strukturën përkatëse të normës së interesit pa rrezik që duhet të përdoret për të llogaritur parashikimin më të mirë që përmendet në nenin 77, paragrafi 2;

c) rrethanat në të cilat provigjonet teknike llogariten si një shumë e përgjithshme, ose si shumë e parashikimit më të mirë me marzhin e rrezikut, dhe metodat që duhet të përdoren në rastin kur provigjonet teknike llogariten si një shumë e përgjithshme;

d) metodat dhe supozimet që duhet të përdoren për llogaritjen e marzhit të rrezikut duke përfshirë përcaktimin e sasisë së fondeve të veta të kualifikuara që nevojiten për të përmbushur detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurim dhe kalibrimin e normës së kostos së kapitalit;

e) linjat e biznesit mbi bazën e të cilave duhet të ndahen detyrimet e marrjes në sigurim dhe risigurim me qëllim që të llogariten provigjonet teknike;

f) standardet që duhet të përmbushen në lidhje me garantimin e përshtatshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së të dhënave që përdoren në llogaritjen e provigjoneve teknike dhe rrethanat specifike ku do të ishte e përshtatshme të përdreshin rumbullakosjet, duke përfshirë qasjet rast pas rasti, për të llogaritur parashikimin më të mirë;

g) metodologjitë që duhet të përdoren për të llogaritur axhustimin e mospagesës nga kundërpala, siç përmendet në nenin 81, të cilat janë përgatitur për të përballuar humbjet e pritshme për shkak të mospagesës nga kundërpala;

h) sipas rastit, metodat dhe teknikat e thjeshtësuara për të llogaritur provigjonet teknike me qëllim për të garantuar se metodat aktuaristike dhe statistikore që përmenden në gerrat "a" dhe "d" janë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që mbulohen nga

shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, duke përfshirë shoqëritë e mbyllura të sigurimit dhe të risigurimit.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 3

FONDET E VETA

NËNSEKSIONI 1

PËRCAKTIMI I FONDEVE TË VETA

Neni 87

Fondet e veta

Fondet e veta përfshijnë shumën e fondeve të veta bazë, siç përmenden në nenin 88, dhe fondet e veta ndihmëse, siç përmenden në nenin 89.

Neni 88

Fondet e veta bazë

Fondet e veta bazë përfshijnë zërat e mëposhtëm:

1. aktivet që tejkalojnë pasivet, të vlerësuara në përputhje me nenin 75 dhe seksionin 2;
2. përgjegjësitë vartëse.

Sasia e tejkalimit që përmendet në pikën 1 reduktohet sipas sasisë së aksioneve të veta që zotëron një shoqëri sigurimi ose risigurimi.

Neni 89

Fondet e veta ndihmëse

1. Fondet e veta ndihmëse përfshijnë zëra të ndryshëm nga fondet e veta bazë, të cilët mund të përdoren për të përballuar humbjet.

Fondet e veta ndihmëse mund të përfshijnë zërat e mëposhtëm deri në masën që ata nuk janë fonde të veta bazë:

- a) kapital i pashpërndarë i aksioneve ose fondi fillestar që nuk është tërhequr;

b) letër kreditë dhe garancitë;

c) çdo angazhim tjetër që përfshin detyrim ligjor që merret nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit.

Në rastin e shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë me kontribute të ndryshme, fondet e veta ndihmëse mund të përfshijnë çdo pretendim të ardhshëm që shoqëria mund të shprehë kundrejt anëtarëve të saj duke i ftuar të japin kontribut shtesë, brenda 12 muajve në vazhdim.

2. Kur një zë i fondeve të veta ndihmëse është paguar ose mbledhur, ai trajtohet si pjesë e aktiveve dhe nuk është më pjesë e zërave të fondeve të veta ndihmëse.

Neni 90

Miratimi mbikëqyrës i fondeve të veta ndihmëse

1. Sasitë e zërave të fondeve të veta ndihmëse që duhet të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të fondeve të veta është objekt i miratimit paraprak mbikëqyrës.

2. Shuma që i caktohet çdo zëri të fondeve të veta ndihmëse pasqyron humbjen që mund të përballojë ai zë dhe bazohet në supozime të kujdesshme dhe realiste. Kur një zë i fondeve të veta ndihmëse ka një vlerë nominale të caktuar, shuma e këtij zëri është e barabartë me vlerën e tij nominale, që pasqyron siç duhet humbjen që mund të përballojë ai zë.

3. Autoritetet mbikëqyrëse miratojnë një nga pikat e mëposhtme:

a) një shumë monetare për secilin zë të fondeve të veta ndihmëse;

b) një metodë për llogaritjen e shumës së secilit zë të fondeve të veta ndihmëse, rast në të cilin autoriteti mbikëqyrës miraton për një periudhë kohore të specifikuar shumën e përcaktuar sipas kësaj metode.

4. Për çdo zë të fondeve të veta ndihmëse, autoritetet mbikëqyrëse e mbështesin miratimin e tyre në vlerësimin e pikave të mëposhtme:

a) statusin e kundërpalëve të përfshira për sa i përket aftësisë dhe vullnetit të tyre për të paguar;

b) mundësinë e rikuperimit të fondeve, duke marrë në konsideratë formën juridike të zërit si edhe çdo kusht që do ta pengonte pagesën ose grumbullimin e këtij zëri;

c) çdo informacion për rezultatin e thirrjeve të shkuara që shoqëritë e sigurimit ose risigurimit kanë bërë për fonde të veta ndihmëse, deri në masën që ky informacion mund të përdoret për të vlerësuar rezultatin e pritshëm të thirrjeve të ardhshme.

Neni 91

Fonde shtesë

1. Fondet shtesë konsiderohen si fitime të grumbulluara të cilat nuk i janë shpërndarë mbajtësve të policave dhe përfituesve.

2. Deri në masën që lejohet nga legjislacioni i brendshëm, fondet shtesë nuk konsiderohen si pasive sigurimi dhe risigurimi për sa kohë që përmbushin kriteret që përcaktohen në nenin 94, paragrafi 1.

Neni 92

Masat zbatuese

1. Komisioni miraton masa zbatuese që përcaktojnë sa më poshtë:

a) kriteret për dhënien e miratimit mbikëqyrës në përputhje me nenin 90;

b) trajtimin e pjesëmarrjeve, sipas kuptimit të nën paragrafit të tretë të nenit 212, paragrafi 2, në institucionet financiare dhe të kreditit me qëllim përcaktimin e fondeve të veta.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

2. Pjesëmarrjet në institucionet financiare dhe të kreditit, siç përmenden në paragrafit 1, germa "b", përfshijnë sa më poshtë:

a) pjesëmarrjet që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit zotërojnë në:

I. institucionet e kreditit dhe institucionet financiare sipas kuptimit të nenit 4, paragrafi 1 dhe 5 të Direktivës 2006/48/KE,

II. firmat e investimit sipas kuptimit të pikës 1 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2004/39/KE;

b) pretendimet dhe instrumentet vartëse që përmenden në nenin 63 dhe në nenin 64, paragrafi 3 të Direktivës 2006/48/KE, që shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit kanë në lidhje me subjektet që përcaktohen në germën "a" të këtij paragrafi ku ata zotërojnë një pjesëmarrje.

NËNSEKSIONI 2

KLASIFIKIMI I FONDEVE TË VETA

Neni 93

Karakteristikat dhe tiparet që përdoren për t'i klasifikuar fondet e veta në nivele

1. Fondet e veta klasifikohen në tre nivele. Klasifikimi i këtyre zërave varet nga fakti nëse ata janë fonde të veta bazë ose fonde të veta ndihmëse dhe nga masa në të cilën ata zotërojnë karakteristikat e mëposhtme:

a) zëri është i disponueshëm, ose mund të mblidhet sipas kërkesës, për të mbuluar plotësisht humbjet gjatë vijimësisë së veprimtarisë si edhe në rastin e likuidimit (disponueshmëri e përhershme);

b) në rastin e likuidimit, shuma totale e zërit është e disponueshme për të përballuar humbjet dhe shlyerja e këtij zëri për zotëruesin e tij refuzohet derisa të gjitha detyrimet e tjera, duke përfshirë detyrimet e sigurimit dhe risigurimit kundrejt mbajtësve të policave dhe përfituesve të kontratave të sigurimit dhe risigurimit janë shlyer (vartësia).

2. Kur vlerësohet shkalla në të cilën zërat e fondeve të veta kanë karakteristikat që përcaktohen në gërmat "a" dhe "b" të paragrafit 1, aktualisht dhe në të ardhmen, kohëzgjatja e këtij zëri merret në konsideratë siç duhet, në veçanti faktit nëse zëri ka një datë të caktuar ose jo. Kur zëri i fondeve të veta ka një datë të caktuar, merret në konsideratë kohëzgjatja relative e zërit krahasuar me kohëzgjatjen e detyrimeve të sigurimit dhe risigurimit (kohëzgjatje e mjaftueshme).

Gjithashtu, merren në konsideratë edhe tiparet e mëposhtme:

a) nëse për zërin e fondeve të veta ka ose jo kërkesa ose incentiva për të shlyer shumën nominale (mungesa e incentivave për shlyerje);

b) nëse për zërin e fondeve të veta ka ose jo tarifa të detyrueshme fikse (mungesa e kostove të detyrueshme të shërbimit);

c) nëse zëri i fondeve të veta është ose jo i çliruar nga barrët (mungesa e barrëve).

Neni 94

Kriteret kryesore të klasifikimit në nivele

1. Zërat e fondeve të veta bazë klasifikohen në Nivelin 1 kur ata në thelb zotërojnë karakteristikat e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 1, germa "a" dhe "b" duke marrë në konsideratë tiparet e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 2.

2. Zërat e fondeve të veta bazë klasifikohen në Nivelin 2 kur ata në thelb zotërojnë karakteristikën e përcaktuar në nenin 93, paragrafi 1, germa "b" duke marrë në konsideratë tiparet e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 2.

Zërat e fondeve të veta ndihmëse klasifikohen në Nivelin 2 kur ata në thelb zotërojnë karakteristikat e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 1, germa "a" dhe "b" duke marrë në konsideratë tiparet e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 2.

3. Çdo zë i fondeve të veta bazë dhe ndihmëse që nuk përfshihet në paragrafin 1 dhe 2 klasifikohet në Nivelin 3.

Neni 95

Klasifikimi i fondeve të veta në nivele

Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i klasifikojnë zërat e fondeve të veta sipas kritereve të përcaktuara në nenin 94.

Për këtë qëllim, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i referohen listës së zërave të fondeve të veta që përmendet në nenin 97, paragrafi 1, germa "a", kur kjo është e zbatueshme.

Kur një zë i fondeve të veta nuk është pjesë e asaj liste, shoqëria e sigurimit dhe e risigurimit e vlerëson atë dhe e klasifikon në përputhje me paragrafin e parë. Ky klasifikim duhet të miratohet nga autoriteti mbikëqyrës.

Neni 96

Klasifikimi i zërave të fondeve të veta specifike për fushën e sigurimeve

Pa cenuar nenin 95 dhe nenin 97, paragrafi 1, germa "a" për qëllimet e kësaj direktive zbatohen klasifikimet e mëposhtme:

- 1) fondet shtesë që përfshihen në nenin 91, paragrafi 2 klasifikohen në Nivelin 1;
- 2) letër kreditë dhe garancitë që mbahen nën kujdes në përfitim të kreditorëve të siguruar nga një administrator i besuar i pavarur dhe që ofrohen nga institucionet e kreditit të autorizuara në përputhje me Direktivën 2006/48/KE klasifikohen në Nivelin 2;
- 3) çdo pretendim i ardhshëm që shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë të pronarëve të anijeve me kontribute të ndryshueshme që sigurojnë vetëm rreziqet e përfshirë në klasat 6, 12 dhe 17 në pjesën A të shtojcës I, mund të kenë kundrejt anëtarëve të tyre nëpërmjet thirrjes për kontribute shtesë, brenda 12 muajve pasues, klasifikohet në Nivelin 2.

Në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 94, paragrafi 2, çdo pretendim i ardhshëm që shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë me kontribute të ndryshueshme mund të kenë kundrejt anëtarëve të tyre nëpërmjet thirrjes për kontribute shtesë, brenda 12 muajve pasues, të cilat nuk mbulohen nga pika 3 e nënparagrafit të parë klasifikohen në Nivelin 2 kur ato në thelb zotërojnë karakteristikat e përcaktuara në nenin 93, paragrafi 1, germa "a" dhe "b", duke marrë në konsideratë tiparet që përcaktohen në nenin 93, paragrafi 2.

Neni 97

Masat zbatuese

1. Komisioni miraton masa zbatuese që përcaktojnë sa më poshtë:
 - a) një listë të zërave të fondeve të veta, duke përfshirë ato që përmenden në nenin 96, që konsiderohen se përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 94, e cila përmban për çdo zë të fondeve të veta një përshkrim të saktë të tipareve që kanë përcaktuar klasifikimin e tij;

b) metodat që duhet të përdoren nga autoritetet mbikëqyrëse kur miratojnë vlerësimin dhe klasifikimin e zërave të fondeve të veta që nuk mbulohen nga lista e përmendur në germën "a".

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të intërsishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

2. Komisioni duhet të rishikojë rregullisht dhe, kur është e përshtatshme, të përditësojë listën e përmendur në paragrafin 1, germa "a", duke marrë parasysh zhvillimet e tregut.

NËNSEKSIONI 3

PRANUESHMËRIA E FONDEVE TË VETA

Neni 98

Pranueshmëria dhe kufijtë e zbatueshëm për nivelet 1, 2 dhe 3

1. Për sa i përket pajtueshmërisë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, shumat e pranueshme të zërave të nivelit 2 dhe 3 i nënshtrohen kufijve sasiore. Këto kufij janë të tillë që garantojnë të paktën përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

a) përqindja që zënë zërat e nivelit 1 në fondet e veta të pranueshme është më e lartë se një e treta e shumës totale të fondeve të veta të pranueshme;

b) shuma e pranueshme e zërave të nivelit 3 është më e ulët se një e treta e shumës totale të fondeve të veta të pranueshme.

2. Për sa i përket pajtueshmërisë me kërkesën për kapital minimal, shuma e zërave të fondeve të veta bazë të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital minimal, të cilët klasifikohen në nivelin 2, i nënshtrohet kufijve sasiore. Këto kufizime janë të tilla që të garantojnë se pjesa që zënë zërat e nivelit 1 në fondet e veta bazë të pranueshme është më e lartë se gjysma e shumës totale të fondeve të veta bazë të pranueshme;

3. Shuma e pranueshme e fondeve të veta për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, e përcaktuar në nenin 100, është e barabartë me shumën e nivelit 1, shumën e pranueshme të nivelit 2 dhe shumën e pranueshme të nivelit 3.

4. Shuma e pranueshme e fondeve të veta bazë për të mbuluar kërkesën për kapital minimal, e përcaktuar në nenin 128, është e barabartë me shumën e nivelit 1, shumën e pranueshme të zërave të fondeve të veta bazë që klasifikohen në nivelin 2.

Neni 99

Masat zbatuese

Komisioni miraton masa zbatuese që përcaktojnë:

a) kufizimet sasiore që përmenden në nenin 98, paragrafi 1 dhe 2;

b) axhustimet që duhet të bënin për të pasqyruar mungesën e transferueshmërisë së këtyre zërave të fondeve të veta, të cilët mund të përdoren vetëm për të mbuluar humbjet që lindin nga një segment i caktuar i përgjegjësive ose nga rreziqe të caktuara (fonde të mbrojtura përmes ndarjes)

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 4

KËRKESA PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE

NËNSEKSIONI 1

DISPOZITAT TË PËRGJITHSHME PËR KËRKESËN PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE DUKE PËRDORUR FORMULËN STANDARDE OSE NJË MODEL TË BRENDSHËM

Neni 100

Dispozita të përgjithshme

Shtetet anëtare kërkojnë që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të zotërojnë fonde të veta të pranueshme që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese llogaritet ose sipas formulës standarde në nënseksionin 2 ose duke përdorur një model të brendshëm, siç përcaktohet në nënseksionin 3.

Neni 101

Llogaritja e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese

1. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese llogaritet në përputhje me paragrafët 2 deri në 5.
2. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese llogaritet duke prezumuar se shoqëria do të vijojë të zhvillojë veprimtaritë e saj.
3. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese kalibrohet për të garantuar se merren në konsideratë të gjitha rreziqet sasiore ndaj të cilave ekspozohet një shoqëri sigurimi ose risigurimi. Ajo mbulon veprimtaritë ekzistuese si edhe veprimtaritë e reja që priten të merren në sigurim përgjatë 12 muajve të ardhshëm. Në lidhje me veprimtaritë ekzistuese, ajo mbulon vetëm humbjet e papritura.

Ajo përkon me vlerësimin e rrezikut të fondeve të veta bazë të një shoqërie sigurimi ose risigurimi duke iu nënshtruar një niveli besimi prej 99,5% përgjatë një periudhe një vjeçare.

4. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese mbulon të paktën rreziqet e mëposhtme:

- a) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin jo-jetë;
- b) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin jetë;
- c) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin e shëndetit;
- d) rrezikun e tregut;
- e) rrezikun e kreditit;
- F) rrezikun operacional.

Rreziku operacional, siç përmendet në gërmën "f" të nënparagrafit të parë përfshin rreziqet ligjore dhe nuk përfshin rreziqet që lindin nga vendimet strategjike dhe rreziqet e reputacionit.

5. Kur llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit marrin në konsideratë efektin e teknikave të zbutjes së rrezikut, nëse rreziku i kreditit dhe rreziqet e tjera që lindin nga përdorimi i këtyre teknikave pasqyrohen siç duhet në kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Neni 102

Shpeshtësia e llogaritjes

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të paktën një herë në vit dhe rezultatet e llogaritjes ia raportojnë autoriteteve mbikëqyrëse.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mbajnë fonde të veta të pranueshme që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që është raportuar për herë të fundit.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit monitorojnë vazhdimisht shumën e fondeve të veta të pranueshme dhe kërkesës për kapital dhe aftësi paguese.

Nëse profili i rrezikut i një shoqërie sigurimi ose risigurimi devijon në mënyrë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që është raportuar për herë të fundit, shoqëria në fjalë menjëherë llogarit përsëri kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe ia raporton atë autoriteteve mbikëqyrëse.

2. Kur ka prova që sugjerojnë se profili i rrezikut i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit ka pësuar ndryshime të konsiderueshme që nga data e raportimit të fundit të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, autoritetet kompetente mund t'i kërkojnë kësaj shoqërie që të llogarisë edhe një herë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

NËNSEKSIONI 2

FORMULA STANDARDE E KËRKESËS PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE

Neni 103

Struktura e formulës standarde

Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e llogaritur sipas formulës standarde është shuma e zërave të mëposhtëm:

- a) kërkesa bazë për kapital dhe aftësi paguese, siç përcaktohet në nenin 104;
- b) kërkesa për kapital për rrezikun operacional, siç përcaktohet në nenin 107;
- c) axhustimi për kapacitetin e provigjoneve teknike dhe detyrimeve tatimore të shtyra për të përballuar humbjen, siç specifikohen në nenin 108.

Neni 104

Përgatitja e kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese

1. Kërkesa bazë për kapital dhe aftësi paguese përfshin modulet individuale të rrezikut, të cilët agregohen sipas pikës 1 të shtojcës IV.

Ajo përfshin të paktën modulet e mëposhtme të rrezikut:

- a) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin jo-jetë;
- b) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin jetë;
- c) rrezikun e marrjes në sigurim për sigurimin e shëndetit;
- d) rrezikun e tregut;
- e) rrezikun e mospagesës nga kundërpala.

2. Për qëllimet e germave "a", "b" dhe "c" të paragrafit 1, operacionet e marrjes në sigurim ose risigurim shpërndahen tek moduli i rrezikut të marrjes në sigurim i cili pasqyron më mirë natyrën teknike të rrezikut shoqërues.

3. Koeficientët e përputhshmërisë për agregimin e moduleve të rrezikut që përmenden në paragrafin 1 si edhe kalibrimi i kërkesave për kapital për çdo modul rreziku bëjnë që kërkesa e përgjithshme për kapital dhe aftësi paguese të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 101.

4. Secili prej moduleve të rrezikut që përmendet në paragrafin 1 kalibrohet duke përdorur masën e vlerësimit të rrezikut, me një nivel besimi prej 99,5%, përgjatë një periudhe një vjeçare.

Sipas rastit, në përgatitjen e çdo moduli rreziku merren në konsideratë efektet e diversifikimit.

5. Për modulet e rrezikut të të gjitha shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit përdoret i njëjti model dhe të njëjtat specifikime si për sa i përket kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese ashtu edhe për llogaritjet e thjeshtësuara që përcaktohen në nenin 109.

6. Në lidhje me rreziqet që lindin nga katastrofat, për përgatitjen e moduleve të rrezikut për sigurimin jetë, jojetë dhe sigurimin e shëndetit mund të përdoren, sipas rastit, specifikimet gjeografike.

7. Duke iu nënshtruar miratimit nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse, gjatë llogaritjes së moduleve të rrezikut të sigurimit jetë, jojetë dhe të shëndetit, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, brenda modelit të formulës standarde mund të zëvendësojnë një nëngrup të parametrave të tij me parametra që janë specifike për shoqërinë në fjalë.

Këto parametra duhet të kalibrohen sipas të dhënave të brendshme të kësaj shoqërie ose sipas të dhënave që lidhen drejtpërsëdrejti me operacionet e kësaj shoqërie duke përdorur metodat e standardizuara.

Kur japin miratimin e tyre, autoritetet mbikëqyrëse verifikojnë plotësinë, saktësinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave të përdorura.

Neni 105

Llogaritja e kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese

1. Kërkesa bazë për kapital dhe aftësi paguese llogaritet në përputhje me paragrafët 2 deri në 6.

2. Rreziku i marrjes në sigurim për modulën jo-jetë pasqyron rrezikun që lind nga detyrimet e sigurimit jo-jetë në lidhje me rreziqet që mbulohen dhe proceset që përdoren për zhvillimin e veprimtarive.

Në këtë modul merret në konsideratë pasiguria e rezultateve të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit në lidhje me detyrimet ekzistuese të marrjes në sigurim dhe risigurim si edhe me veprimtaritë e reja që priten që të merren në sigurim përgjatë 12 muajve pasues.

Ai llogaritet në përputhje me pikën 2 të shtojcës IV, si kombinim i kërkesave për kapital të paktën për nënmodulet e mëposhtme:

a) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive që rezultojnë nga luhajtjet në kohën, shpeshhtësinë dhe shkallën e ngjarjeve të siguruar dhe në kohën dhe sasinë e dëmeve të paguara (rreziku i primit të sigurimit jojetë dhe i rezervave);

b) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të sigurimit të përgjegjësive i cili rezultojnë nga pasiguritë e konsiderueshme në supozimet për çmimin dhe provigjionet në lidhje me ngjarjet ekstreme ose të veçanta (rreziku i katastrofave në sigurimin jojetë).

3. Rreziku i marrjes në sigurim për modulin jetë pasqyron rrezikun që lind nga detyrimet e sigurimit jetë në lidhje me rreziqet që mbulohen dhe proceset që përdoren për zhvillimin e veprimtarive.

Ai llogaritet në përputhje me pikën 3 të shtojcës IV, si kombinim i kërkesave për kapital të paktën për nënmodulet e mëposhtme:

a) rrezikun e humbjes ose ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive që rezulton nga ndryshimet e nivelit, tendencës ose paqëndrueshmërisë së nivelit të vdekshmërisë, kur një rritje e nivelit të vdekshmërisë çon në rritje të vlerës së sigurimit të përgjegjësive (rreziku i vdekshmërisë);

b) rrezikun e humbjes ose ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive që rezulton nga ndryshimet e nivelit, tendencës ose paqëndrueshmërisë së nivelit të vdekshmërisë, kur një ulje e nivelit të vdekshmërisë çon në rritje të vlerës së sigurimit të përgjegjësive (rreziku i jetëgjatësisë);

c) rrezikun e humbjes ose ndryshimet negative të vlerës së sigurimit të përgjegjësive, që rezulton nga ndryshimet e nivelit, tendencës, paqëndrueshmërisë së aftësisë së kufizuar, sëmundjes dhe niveleve të sëmundshmërisë (rreziku i aftësisë së kufizuar, sëmundshmërisë);

d) rrezikun e humbjes ose ndryshimet negative të vlerës së sigurimit të përgjegjësive, që rezulton nga ndryshimet e nivelit, tendencës, paqëndrueshmërisë së shpenzimeve në përmbushje të kontratave të sigurimit ose risigurimit (rreziku i shpenzimeve jetësore);

e) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive që rezulton nga luhatjet në nivelin, tendencën ose paqëndrueshmëria e niveleve të rishikimeve që zbatohen për pensionet vjetore për shkak të ndryshimeve të mjedisit ligjor ose të gjendjes shëndetësore të personave të siguruar (rreziku i rishikimit);

f) rrezikun e humbjes ose të ndryshimeve negative të vlerës së sigurimit të përgjegjësive, që rezulton nga ndryshimet e nivelit ose paqëndrueshmëria e niveleve të ndërprerjeve, përfundimeve, rinovimeve dhe heqjeve dorë nga policat e sigurimit (rreziku i ndërprerjes);

g) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive i cili rezulton nga pasiguritë e konsiderueshme të supozimeve për çmimin dhe provigjonet në lidhje me ngjarjet ekstreme ose të çrregullta (rreziku i katastrofave në sigurimin jetë).

4. Moduli i rrezikut për sigurimin e shëndetit pasqyron rrezikun që lind nga marrja në sigurim e detyrimeve të sigurimit të shëndetit, kur kjo zhvillohet sipas kushteve teknike me sigurimin jetë ose jo, që lindin nga rreziqet e mbuluara dhe proceset e përdorura gjatë zhvillimit të veprimtarive.

Ajo mbulon të paktën rreziqet e mëposhtme:

a) rrezikun e humbjes ose të ndryshimeve negative të vlerës së sigurimit të përgjegjësive, që rezulton nga ndryshimet e nivelit, tendencës, ose nga paqëndrueshmëria e shpenzimeve në përmbushje të kontratave të sigurimit ose risigurimit;

b) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive që rezultojn nga luhajtjet në kohën, shpeshtësinë dhe shkallën e ngjarjeve të siguruara dhe në kohën dhe sasinë e dëmeve gjatë kohës së llogaritjes së provigjoneve;

c) rrezikun e humbjes ose të ndryshimit negativ të vlerës së sigurimit të përgjegjësive i cili rezulton nga pasiguritë e konsiderueshme të supozimeve për çmimin dhe provigjonet në lidhje me përhapjet e epidemive të mëdha si edhe me akumulimin e pazakontë të rreziqeve në këto rrethana ekstreme.

5. Moduli i rrezikut të tregut pasqyron rrezikun që lind nga niveli ose paqëndrueshmëria e çmimeve të tregut të instrumenteve financiarë, e të cilat ndikojnë në vlerën e aktiveve dhe pasiveve të një shoqërie. Ai pasqyron siç duhet mospërputhjen strukturore ndërmjet aktiveve dhe pasiveve, në veçanti në lidhje me kohëzgjatjen e tyre.

Ai llogaritet në përputhje me pikën 4 të shtojcës IV, si kombinim i kërkesave për kapital të paktën për nënmodulet e mëposhtme:

a) ndjeshmërinë e vlerave të aktiveve, pasiveve dhe instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve në strukturën e normave të interesit ose në qëndrueshmërinë e normave të interesit (rreziku i normës së interesit);

b) ndjeshmërinë e vlerave të aktiveve, pasiveve dhe instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve të nivelit ose qëndrueshmërisë së çmimeve të tregut për kapitalin e vet (rreziku i kapitalit të vet);

c) ndjeshmërinë e vlerave të aktiveve, pasiveve dhe instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve të nivelit ose qëndrueshmërisë së çmimeve të tregut për pronat e patundura (rreziku i pronës së patundur);

d) ndjeshmërinë e vlerave të aktiveve, pasiveve dhe instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve të nivelit ose qëndrueshmërisë së shpërndarjes së kredisë përgjatë strukturës së normës së interesit pa rrezik (rreziku i shpërndarjes);

e) ndjeshmërinë e vlerave të aktiveve, pasiveve dhe instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve të nivelit ose qëndrueshmërisë së normave të këmbimit valutor (rreziku i këmbimit valutor);

f) rreziqet shitesë të shoqërive të sigurimit ose risigurimit që lindin ose nga mungesa e diversifikimit në portofolin e aktiveve ose nga ekspozimi i madh ndaj rrezikut të mospagesës nga një emetues i vetëm i titujve ose një grup emetuesish që kanë lidhje me njëri tjetrin (përqendrimet e rrezikut të tregut).

6. Moduli i rrezikut të mospagesës nga kundërpala pasqyron humbjet e mundshme për shkak të mospagesës së paparashikuar, ose për shkak të përkeqësimit të gjendjes së kredisë, nga kundërpalët dhe debitorët e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit përgjatë 12 muajve në vazhdim. Moduli i rrezikut të mospagesës nga kundërpala mbulon kontratat për zbutjen e rrezikut, siç janë marrëveshjet e risigurimit, titullizimet dhe derivatet dhe shumat e arkëtueshme nga ndërmjetësit si edhe çdo ekspozim tjetër të kredisë që nuk mbulohet në nënmodulin e

rrezikut të shpërndarjes. Aty merret në konsideratë kolaterali ose tituj të tjerë që zotërohen nga ose për llogari të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit dhe rreziqet që i shoqërojnë ato.

Për çdo kundërpalë, moduli i rrezikut të mospagesës nga kundërpala merr në konsideratë ekspozimin e përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë ndaj rrezikut të kundërpalës për atë kundërpalë, pavarësisht formës ligjore të detyrimeve të saj ndaj shoqërisë.

Neni 106

Llogaritja e nënmodulit të rrezikut të kapitalit të vet: mekanizmi i axhustimit simetrik

1. Nënmoduli i rrezikut të kapitalit të vet i llogaritur sipas formulës standarde përfshin një axhustim simetrik të tarifës së kapitalit të vet që zbatohet për të mbuluar rrezikun që lind nga ndryshimet në nivelin e çmimeve të kapitalit të vet.

2. Axhustimi simetrik që i bëhet tarifës standarde të kapitalit të vet, i kalibruar në përputhje me nenin 104, paragrafi 4, që mbulon rrezikun që lind nga ndryshimet në nivelin e çmimeve të kapitalit të vet bazohet në një funksion të nivelit aktual të indeksit të përshtatshëm të kapitalit të vet dhe nivelin mesatar të ponderuar të këtij indeksi. Mesatarja e ponderuar llogaritet përgjatë një periudhe të përshtatshme kohore që duhet të jetë e njëjtë për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit.

3. Axhustimi simetrik që i bëhet tarifës standarde të kapitalit të vet që mbulon rrezikun që lind nga ndryshimet e nivelit të çmimeve të kapitalit të vet nuk rezulton në zbatimin e një tarife të kapitalit të vet e cila është 10 për qind më e ulët ose 10 për qind më e lartë se tarifa standarde e kapitalit të vet.

Neni 107

Kërkesa për kapital për rrezikun operacional

1. Kërkesa për kapital për rrezikun operacional pasqyron rreziqet operationale deri në masën që ato nuk janë pasqyruar tashmë në modulet e rrezikut që përmenden në nenin 104. Kjo kërkesë kalibrohet në përputhje me nenin 101, paragrafi 3.

2. Në lidhje me kontratat e sigurimit të jetës ku rreziku i investimit merret përsipër nga mbajtësit e policave, llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun operacional merr në konsideratë sasinë e shpenzimeve vjetore që mbulojnë në lidhje me këto detyrime sigurimi.

3. Në lidhje me veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit të ndryshme nga ato që përmenden në paragrafin 2, llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun operacional merr në konsideratë vëllimin e këtyre operationeve për sa u përket primeve të fituara dhe provigjoneve teknike që mbahen në lidhje me këto detyrime sigurimi dhe risigurimi. Në këtë rast, kërkesa për kapital për rreziqet operationale nuk tejkalon 30% të kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese në lidhje me këto operatione sigurimi dhe risigurimi.

Neni 108

Axhustimi i kapacitetit të provigjoneve teknike dhe detyrimeve tatimore të shtyra për të mbuluar humbjen

Axhustimi i përmendur në nenin 103, germa "c" për kapacitetin e provigjoneve teknike dhe tatimeve të shtyra për të mbuluar humbjen pasqyron kompensimin potencial të humbjeve të papritura nëpërmjet një uljeje të njëkohshme të provigjoneve teknike ose detyrimeve tatimore të shtyra ose një kombinim të të dyve.

Axhustimi merr në konsideratë efektin e zbutjes së rrezikut që sigurohet nga përfitimet e ardhshme diskrecionale të kontratave të sigurimit, deri në masën që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të përcaktojnë se ulja e këtyre përfitimeve mund të përdoret për mbulimin e këtyre humbjeve, kur ato ndodhin. Efekti i zbutjes së rrezikut që ofrohet nga përfitimet e ardhshme diskrecionale nuk është më i lartë se shumica e provigjoneve teknike dhe detyrimeve tatimore të shtyra në lidhje me këto përfitime të ardhshme diskrecionale.

Në zbatim të nënparagrafit të dytë, vlera e përfitimeve të ardhshme diskrecionale në rrethana negative krahasohet me vlerën e këtyre përfitimeve sipas supozimeve që mbështesin llogaritjen e parashikimit më të mirë.

Neni 109

Thjeshtësimi i formulës standarde

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të përdorin një llogaritje të thjeshtësuar për një nënmodul specifik ose një modul rreziku specifik kur natyra, shkalla dhe kompleksiteti i rreziqeve me të cilët këto shoqëri përballen e justifikon këtë përdorim dhe kur nuk do të ishte proporcionale që t'u kërkohej të gjitha shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që të përdorin një llogaritje të standardizuar.

Llogaritjet e thjeshtësuara kalibrohen në përputhje me nenin 101, paragrafi 3.

Neni 110

Devijime të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin llogaritjen sipas formulës standarde

Në rastet kur është e papërshtatshme që kërkesa për kapital dhe aftësi paguese të llogaritet sipas formulës standarde, siç specifikohet në nënseksionin 2, për shkak se profili i rrezikut të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë devijon në një shkallë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin llogaritjen sipas formulës standarde, autoritetet mbikëqyrëse, nëpërmjet një vendimi ku deklarohen arsyet, mund t'i kërkojnë kësaj shoqërie që gjatë llogaritjes së moduleve të rrezikut për sigurimin jetë, jo-jetë dhe sigurimin e shëndetit, që specifikohen në nenin 104, paragrafi 7, të zëvendësojë një nëngrup të parametrave që janë përdorur në llogaritjen sipas formulës standarde me parametra që janë specifike për atë shoqëri. Këto parametra specifike llogariten në një mënyrë të tillë që garanton që shoqëria të veprojë në pajtim me nenin 101, paragrafi 3.

Masat zbatuese

1. Për të garantuar trajtim të barabartë për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese sipas formulës standarde ose për të marrë në konsideratë zhvillimet e tregut, Komisioni miraton masa zbatuese që parashikojnë sa më poshtë:

- a) një formulë standarde në përputhje me dispozitat e neneve 101 dhe 103 deri në 109;
- b) çdo nënmodul të nevojshëm ose që mbulon në mënyrë më të saktë rreziqet që përfshihen në modulet përkatëse të rreziqeve që përmenden në nenin 104 si edhe çdo përditësim vijues të tyre;
- c) metodat, supozimet dhe parametrat standarde që duhet të përdoren për të llogaritur secilin prej moduleve ose nënmoduleve të rrezikut të kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese, që përcaktohen në nenin 104, 105 dhe 304, mekanizmin e axhustimit simetrik dhe periudhën e përshtatshme kohore, e shprehur në muaj, siç përmendet në nenin 106 dhe qasjen e përshtatshme për të integruar metodën e përmendur në nenin 304 në kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, siç llogaritet në përputhje me formulën standarde;
- d) parametrat e përputhshmërisë duke përfshirë, nëse është e nevojshme, parametrat e përcaktuara në shtojcën IV, dhe procedurat për përditësimin e këtyre parametrave;
- e) në rastet kur shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit përdorin teknikat për zbutjen e rrezikut, metodat dhe supozimet që duhet të përdoren për të vlerësuar ndryshimet në profilin e rrezikut të shoqërisë në fjalë dhe për të axhustuar llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese;
- f) kriteret sasiore që duhet të përmbushin teknikat për zbutjen e rrezikut, që përmenden në germën "e" me qëllim që të garantojnë se rreziku është transferuar me efikasitet tek një palë e tretë;
- g) metodat dhe parametrat që duhet të përdoren gjatë vlerësimit të kërkesës për kapital për rrezikun operacional të përcaktuar në nenin 107, duke përfshirë përqindjen e përmendur në paragrafin 3 të nenit 107;
- h) metodat dhe axhustimet që duhet të përdoren për të pasqyruar spektrin e reduktuar për diversifikimin e rrezikut të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit në lidhje me fondet e mbrojtura përmes ndarjes;
- i) metoda që duhet përdorur për të llogaritur axhustimin për kapacitetin e provigjoneve teknike ose detyrimeve tatimore të shtyra për të përballuar humbjen, siç specifikohen në nenin 108;
- j) nëngrupin e parametrave standarde të profilit të rrezikut në sigurimin jetë, jo-jetë dhe sigurimin e shëndetit që mund të zëvendësohen nga parametrat specifike për shoqërinë, siç specifikohen në nenin 104, paragrafi 7;

k) metodat e standardizuara që duhet të përdorin shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit për të llogaritur parametrat specifike për shoqërinë, që përmenden në germën "j", dhe çdo kriter që lidhet me plotësinë, saktësinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave të përdorura, që duhet të përmbushet përpara se të autoriteti mbikëqyrës të japë miratimin;

l) llogaritjet e thjeshtësuara të parashikuara për nënmodulet dhe modulet specifike të rrezikut si edhe kriteret që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, duke përfshirë shoqëritë e mbyllura të sigurimit dhe të risigurimit, duhet të përmbushin për të pasur të drejtë për të përdorur secilin prej këtyre thjeshtësimeve, siç përcaktohen në nenin 109;

m) qasjen që duhet të përdoret, për shoqëritë e varësisë sipas kuptimit të nenit 212, për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, në veçanti për llogaritjen e nënmodulit të rrezikut të kapitalit të vet, që përmendet në nenin 105, paragrafi 5, duke marrë në konsideratë reduktimin e mundshëm të paqëndrueshmërisë së vlerës së këtyre shoqërive që lind nga natyra strategjike e këtyre investimeve dhe influencës së ushtruar nga shoqëria pjesëmarrëse në këto shoqëri varësie.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

2. Komisioni mund të miratojë masat zbatuese që përcaktojnë kufizimet sasiore dhe kriteret për pranueshmërinë e aktiveve me qëllim që të trajtojë rreziqet që nuk mbulohen siç duhet nga një nënmodul. Këto masa zbatuese zbatohen për aktivet që mbulojnë provigjonet teknike, duke përjashtuar aktivet që zotërohen në lidhje me kontratat e sigurimit jetë, kur rreziku i investimit merret përsipër nga mbajtësit e policave. Këto masa do rishikohen nga Komisioni sipas zhvillimeve të formulës standarde dhe të tregjeve financiare.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

NËNSEKSIONI 3

MODELET E BRENDSHME TË PLOTA DHE TË PJESSHME PËR KËRKESËN PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE

Neni 112

Dispozita të përgjithshme për miratimin e modeleve të brendshme të plota dhe të pjesshme

1. Shtetet anëtare garantojnë që shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit të mund të llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese duke përdorur një model të brendshëm të plotë ose të pjesshëm, siç është miratuar nga autoritetet mbikëqyrëse.

2. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të përdorin modelet e brendshme të pjesshme për të llogaritur një nga të mëposhtmet:

a) një ose më shumë module rreziku ose nënmodule të kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese, siç përcaktohet në nenet 104 dhe 105;

b) kërkesën për kapital për rrezikun operacional, siç përcaktohet në nenin 107;

c) axhustimin e përmendur në paragrafin 108.

Gjithashtu, modeli i pjesshëm mund të zbatohet për të gjitha veprimtaritë e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit ose vetëm për një njësi ose për njësitë më kryesore të veprimtarive.

3. Në çdo aplikim për miratim, shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit dorëzojnë, minimalisht, dokumente që vërtetojnë se modeli i brendshëm përmbush kërkesat e përcaktuara në nenet 120 deri në 125;

Kur aplikimi për këtë miratim lidhet me një model të brendshëm të pjesshëm, kërkesat e përcaktuara në nenet 120 deri në 125 përshtaten për të marrë në konsideratë objektin e kufizuar të aplikimit të këtij modeli.

4. Autoritetet mbikëqyrëse marrin vendimin për miratim brenda gjashtë muajve nga marrja e aplikimit të plotë.

5. Autoritetet mbikëqyrëse japin miratimin për një aplikim vetëm nëse janë të bindur se sistemet e shoqërisë së sigurimit ose risigurimit për identifikimin, matjen, monitorimin, menaxhimin dhe raportimin e rrezikut janë të përshtatshëm dhe në veçanti se modeli i brendshëm i përmbush kërkesat që përmenden në paragrafin 3.

6. Në vendimin e autoriteteve mbikëqyrëse për të refuzuar aplikimin për përdorimin e një modeli të brendshëm deklarohen arsyet mbi të cilat bazohet ky vendim.

7. Pasi të kenë marrë miratimin e autoriteteve mbikëqyrëse për të përdorur një model të brendshëm, shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, nëpërmjet një vendimi ku deklarohen arsyet, u kërkohet që t'i dorëzojnë autoriteteve mbikëqyrëse një parashikim të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, i përcaktuar në përputhje me formulën standarde që përcaktohet në nënseksionin 2.

Neni 113

Dispozita specifike për miratimin e modeleve të brendshme të pjesshme

1. Në rastin e një modeli të brendshëm të pjesshëm, autoriteti mbikëqyrës e jep miratimin vetë kur ky model përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 112 dhe kushtet shtesë si më poshtë:

a) shoqëria justifikon siç duhet arsyen për fushën e kufizuar të zbatimit të modelit;

b) kërkesa rrjedhimore për kapital dhe aftësi paguese pasqyron në mënyrë më të përshtatshme profilin e rrezikut të shoqërisë dhe, veçanërisht, është në pajtim me parimet e përcaktuara në nënseksionin 1;

c) përgatitja e modelit është në pajtim me parimet e përcaktuara në nënseksionin 1 në mënyrë që të lejojë që modeli i brendshëm i pjesshëm të integrohet plotësisht në formulën standarde të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese.

2. Në rastet kur vlerësojnë një aplikim për përdorimin e modelit të brendshëm të pjesshëm që mbulon vetëm nënmodule të caktuara të një moduli rreziku specifik, ose disa prej njësive të veprimtarive të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në lidhje me një modul rreziku specifik, ose pjesë të të dyve, autoritetet mbikëqyrëse mund t'i kërkojnë këtyre shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që të dorëzojnë një plan kalimtar për të zgjeruar fushën e zbatimit të modelit.

Plani kalimtar përcakton mënyrën në të cilën shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit planifikojnë të zgjerojnë fushën e zbatimit të modelit për nënmodule të tjera ose njësi të tjera të veprimtarive për të garantuar që modeli të mbulojë një pjesë dominuese të veprimtarive të tyre të sigurimit në lidhje me këtë modul specifik të rrezikut.

Neni 114

Masat zbatuese

Komisioni miraton masat zbatuese që përcaktojnë:

1. procedurën që duhet të ndiqet për miratimin e një modeli të brendshëm;
2. përshtatjet që duhet t'i bëhen standardeve të përcaktuara në nenet 120 deri në 125 për të marrë në konsideratë fushën e kufizuar të zbatimit të modelit të brendshëm të pjesshëm.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 115

Politika për ndryshimin e modeleve të brendshme të plota dhe të pjesshme

Si pjesë e procesit fillestar të miratimit të një modeli të brendshëm, autoritetet mbikëqyrëse miratojnë politikën për ndryshimin e modelit të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të ndryshojnë modelin e tyre të brendshëm në përputhje me këtë politikë.

Politika përfshin një specifikim të ndryshimeve të vogla dhe të mëdha të modelit të brendshëm.

Ndryshimet e mëdha të modelit të brendshëm, si edhe ndryshimet e kësaj politike, i nënshtrohen miratimit paraprak nga autoritetet mbikëqyrëse, siç përcaktohet në nenin 112.

Ndryshimet e vogla të modelit të brendshëm nuk i nënshtrohen miratimit paraprak nga autoritetet mbikëqyrëse, deri në masën që ato zhvillohen në përputhje me këtë politikë.

Neni 116

Përgjegjësitë e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse

Organet administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit miratojnë aplikimin e bërë përpara autoriteteve mbikëqyrëse për miratimin e modelit të brendshëm që përmendet në nenin 112, si edhe aplikimin për miratimin e çdo ndryshimi të madh të këtij modeli të bërë në vijimësi.

Organet administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse kanë si përgjegjësi që të ngrenë sisteme që garantojnë mbarëvajtjen e vazhdueshme të modelit të brendshëm.

Neni 117

Rikthimi te formula standarde

Pasi të kenë marrë miratimin në përputhje me nenin 112, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nuk i kthehen llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, të plotë ose të pjesshme, në përputhje me formulën standarde, siç specifikohet në nënseksionin 2, përveç se në rrethana të justifikuara siç duhet dhe pas miratimit nga autoritetet mbikëqyrëse.

Neni 118

Papajtueshmëria e modelit të brendshëm

1. Nëse, pasi kanë marrë miratimin nga autoritetet mbikëqyrëse për të përdorur një model të brendshëm, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit reshtin si qeni në pajtim me kërkesat e përcaktuara në nenet 120 deri në 125, ata menjëherë ose i paraqesin autoriteteve mbikëqyrëse një plan për rikuperimin e pajtueshmërisë brenda një periudhe kohore të arsyeshme, ose tregojnë se efekti i papajtueshmërisë është i papërfillshëm.

2. Në rast se shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nuk arrijnë të zbatojnë planin e përmendur në paragrafin 1, autoritetet mbikëqyrëse mund t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që t'i kthehen llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese sipas formulës standarde, siç përcaktohet në nënseksionin 2.

Neni 119

Devijime të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin llogaritjen sipas formulës standarde

Në rastet kur është e papërshtatshme që kërkesa për kapital dhe aftësi paguese të llogaritet sipas formulës standarde, siç specifikohet në nënseksionin 2, për shkak se profili i rrezikut të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë devijon në një shkallë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin llogaritjen sipas formulës standarde, autoritetet mbikëqyrëse, nëpërmjet një vendimi ku deklarohen arsyet, mund t'i kërkojnë kësaj shoqërie që të përdorë një model të brendshëm për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ose modulet përkatëse të rrezikut të kësaj shoqërie.

Neni 120

Testi i përdorimit

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të vërtetojnë se modeli i brendshëm përdoret gjerësisht dhe luan një rol të rëndësishëm në sistemin e tyre rregullator, që përmendet në nenin 41 deri në 50, në veçanti për:

a) sistemin e tyre për menaxhimin e rrezikut, siç përcaktohet në nenin 44, dhe në proceset e tyre vendimmarrëse;

b) proceset e tyre për vlerësimin dhe alokimin e kapitalit të tyre ekonomik dhe të aftësisë paguese, duke përfshirë vlerësimin e përmendur në nenin 45.

Gjithashtu, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të vërtetojnë se shpeshësia e llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese nëpërmjet modelit të brendshëm është konsistent me shpeshësinë me të cilën ata përdorin modelin e tyre të brendshëm për qëllime të tjera që mbulohen nga paragrafi i parë.

Organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës është përgjegjës për të garantuar përshtatshmërinë e vazhdueshme të dizajnit dhe operacioneve të modelit të brendshëm dhe që të garantojnë se modeli i brendshëm vazhdon të pasqyrojë siç duhet profilin e rrezikut të këtyre shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit.

Neni 121

Standardet e cilësisë statistikore

1. Modeli i brendshëm dhe në veçanti parashikimi për shpërndarjen e probabilitetit që e mbështet këtë model, është në pajtim me kriteret e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 9.

2. Metodatat e përdorura për të llogaritur parashikimin për shpërndarjen e probabilitetit bazohen në teknika aktuaristike dhe statistikore të përshtatshme, të zbatueshme dhe përkatëse dhe janë konsistente me metodatat që përdoren për të llogaritur provigjonet teknike.

Metodat që përdoren për të llogaritur parashikimin për shpërndarjen e probabilitetit bazohen në informacione aktuale dhe të besueshme dhe në supozime realiste.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të jenë në gjendje që të justifikojnë përpara autoriteteve mbikëqyrëse supozimet që mbështesin modelin e tyre të brendshëm.

3. Të dhënat që përdoren për modelin e brendshëm duhet të jenë të sakta, të plota dhe të përshtatshme.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit përditësojnë, të paktën një herë në vit, grupet e të dhënave që përdoren për të llogaritur parashikimin për shpërndarjen e probabilitetit.

4. Nuk parashikohet asnjë metodë e veçantë për të llogaritur parashikimin për shpërndarjen e probabilitetit.

Pavarësisht metodës së llogaritjes që është zgjedhur, mundësia që modeli i brendshëm të rendisë rrezikun sipas rëndësisë duhet të jetë e mjaftueshme për të garantuar përdorimin e gjerë të modelit dhe rolin e tij të rëndësishëm në sistemin rregullator të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, në veçanti sistemin e tyre për menaxhimin e rrezikut dhe proceset e tyre të vendimmarrjes dhe alokimit të kapitalit në përputhje me nenin 120.

Modeli i brendshëm mbulon të gjitha rreziqet materiale ndaj të cilëve ekspozohen shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit. Modelet e brendshme mbulojnë të paktën rreziqet e përcaktuara në nenin 101, paragrafi 4.

5. Për sa i përket efekteve të diversifikimit, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të marrin në konsideratë modelin e tyre të brendshëm të vartësisë brenda dhe ndërmjet kategorive të rrezikut, nëse autoritetet mbikëqyrëse binden se sistemi i përdorur për matjen e këtyre efekteve të diversifikimit është i përshtatshëm.

6. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të marrin në konsideratë efektin që kanë teknikat e zbutjes së rrezikut në modelin e tyre të brendshëm, për sa kohë që rreziku i kredisë dhe rreziqe të tjera që lindin nga përdorimi i teknikave të zbutjes së rrezikut pasqyrohen siç duhet në modelin e brendshëm.

7. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit vlerësojnë me saktësi rreziqet e veçanta që shoqërojnë garancitë financiare dhe çdo opsion kontraktor në modelin e tyre të brendshëm, kur janë të konsiderueshme. Ato gjithashtu vlerësojnë rreziqet që shoqërojnë opsionet e mbajtësve të policave dhe opsionet kontraktore për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit. Për këtë qëllim, ato marrin në konsideratë ndikimin që mund të kenë ndryshimet e ardhshme të kushteve financiare dhe jofinanciare në ushtrimin e këtyre opsioneve.

8. Në modelin e tyre të brendshëm, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të marrin në konsideratë veprimet e ardhshme menaxhuese që ato presin të ndërmarrin në rrethana specifike.

Në rastin e specifikuar në nënparagrafin e parë, shoqëria në fjalë i zbaton këto veprime në kohën e përshtatshme.

9. Në modelin e tyre të brendshëm, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit marrin në konsideratë të gjitha pagesat që ato presin të bëjnë për mbajtësit e policave dhe përfituesit, qofshin ato të garantuara ose jo me kontratë.

Neni 122

Standardet e kalibrimit

1. Për qëllimet e përgatitjes së modelit të brendshëm, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit mund të përdorin një periudhë kohore të ndryshme ose masa të ndryshme rreziku nga ato që përcaktohen në nenin 101, paragrafi 3, për sa kohë që këto shoqëri mund t'i përdorin

rezultatet e modelit të brendshëm për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në një mënyrë që u garanton mbajtësve të policave dhe përfituesve një nivel mbrojtjeje ekuivalent me atë që përcaktohet në nenin 101.

2. Kur është e zbatueshme, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit e llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese direkt nga parashikimi për shpërndarjen e probabilitetit të gjeneruar nga modeli i brendshëm i këtyre shoqërive, duke përdorur masën e vlerësimit të rrezikut, që përcaktohet në nenin 101, paragrafi 3.

3. Kur shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nuk mund ta llogarisin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese direkt nga parashikimi për shpërndarjen e probabilitetit i gjeneruar nga modeli i brendshëm, autoritetet mbikëqyrëse mund të lejojnë përdorimin e rrumbullakosjeve në procesin e llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese, për sa kohë që këto shoqëri mund t'u vërtetojnë autoriteteve mbikëqyrëse se mbajtësve të policave u ofrohet një mbështetje ekuivalente me atë që parashikohet në nenin 101.

4. Autoritetet mbikëqyrëse mund t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të zbatojnë modelin e tyre të brendshme për portofolat e referencës dhe të përdorin supozime të bazuara në të dhëna të jashtme dhe jo të brendshme për të konfirmuar kalibrimin e modelit të brendshëm dhe për të kontrolluar se specifikimi i tij është në pajtim me praktikën e tregut gjerësisht të pranuar.

Neni 123

Ndarja e fitimit dhe humbjes

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit rishikojnë, të paktën një herë në vit, shkaqet dhe burimet e fitimeve dhe humbjeve për çdo njësi kryesore të biznesit.

Ata vërtetojnë se si kategorizimi i rrezikut që është zgjedhur në modelin e brendshëm shpjegon shkaqet dhe burimet e fitimeve dhe humbjeve. Kategorizimi i rrezikut dhe ndarja e fitimeve dhe humbjeve pasqyron profilin e rrezikut të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit.

Neni 124

Standardet e miratimit

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit kanë një cikël të rregullt për miratimin e modelit i cili përfshi monitorimin e performancës së modelit të brendshëm, duke rishikuar përshtatshmërinë e vazhdueshme të specifikimit të tij dhe duke i krahasuar rezultatet e tij me përvojën.

Procesi i miratimit të modelit përfshin një proces statistikor efikas për miratimin e modelit të brendshëm që i mundëson shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që t'u vërtetojë autoriteteve të tyre mbikëqyrëse se kërkesat për kapital që rezultojnë prej tyre janë të përshtatshme.

Metodat statistikore që zbatohen testojnë përshtatshmërinë e parashikimit për shpërndarjen e probabilitetit krahasuar jo vetëm me humbjet e kaluara por edhe me të gjitha të dhënat e reja të rëndësishme dhe informacionin që lidhet me ta.

Procesi për miratimin e modelit përfshin një analizë të stabilitetit të modelit të brendshëm dhe në veçanti testimin e ndjeshmërisë së rezultateve të modelit të brendshëm ndaj ndryshimeve të supozimeve kyçe mbështetëse. Ai gjithashtu përfshin një vlerësim të saktësisë, plotësisë dhe përshtatshmërisë së të dhënave që përdoren nga modeli i brendshëm.

Neni 125

Standardet e dokumentacionit

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit dokumentojnë dizajnin dhe detajet operationale të modelit të tyre të brendshëm.

Dokumentacioni tregon pajtueshmërinë me nenet 120 deri në 124.

Dokumentacioni ofron një paraqitje të detajuar të teorisë, supozimeve dhe bazave matematikore dhe empirike që mbështesin modeli e brendshëm.

Dokumentacioni tregon çdo rrethanë në të cilën modeli i brendshëm nuk punon me efikasitet.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit dokumentojnë të gjitha ndryshimet kryesore të modelit të tyre të brendshëm, siç përcaktohen në nenin 115.

Neni 126

Modelet dhe të dhënat e jashtme

Përdorimi i një modeli ose i të dhënave të marra nga një palë e tretë nuk konsiderohet si justifikim për përjashtim nga ndonjë prej kërkesave për modelin e brendshëm që specifikohen në nenet 120 deri në 125.

Neni 127

Masat zbatuese

Për të garantuar një qasje të harmonizuar ndaj përdorimit të modeleve të brendshme në të gjithë Komunitetin dhe për të përmirësuar vlerësimin e profilit të rrezikut dhe menaxhimin e veprimtarive të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, Komisioni miraton masat zbatuese në lidhje me nenet 120 deri në 126.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të intërsishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 5

KËRKESA PËR KAPITAL MINIMAL

Neni 128

Dispozita të përgjithshme

Shtetet anëtare kërkojnë që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të zotërojnë fonde të veta bazë të pranueshme që mbulojnë kërkesën për kapital minimal.

Neni 129

Llogaritja e kërkesës për kapital minimal

1. Kërkesa për kapital minimal llogaritet në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) llogaritet në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë dhe në një mënyrë të tillë që të garantojnë se kjo kërkesë të mund të auditohet;

b) ajo përkon me një shumë të fondeve të veta bazë të pranueshme nën të cilën mbajtësit e policave dhe përfituesit ekspozohen ndaj një niveli rreziku të papranueshëm nëse shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit lejohen që të vazhdojnë operacionet e tyre;

c) funksioni linear, i përmendur në paragrafin 2, që përdoret për të llogaritur kërkesën për kapital minimal kalibrohet sipas vlerësimit të rrezikut të fondeve të veta bazë të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit duke iu nënshtruar një niveli besimi prej 85% përgjatë një periudhe një vjeçare;

d) niveli dysHEME absolut është:

I. 2 200 000 euro për shoqëritë e sigurimit jojetë, duke përfshirë shoqëritë e mbyllura të sigurimit, përveç rastit kur mbulohen të gjitha ose disa nga rreziqet e përfshira në një nga klasat 10 deri në 15 në pjesën A të shtojcës 1, rast në të cilin niveli dysHEME nuk duhet të jetë më i ulët se 3 200 000 euro,

II. 3 200 000 euro për shoqëritë e sigurimit jetë, duke përfshirë shoqëritë e mbyllura të sigurimit,

III. 3 200 000 euro për shoqëritë e risigurimit, përveç rastit të shoqërive të mbyllura të risigurimit, ku kërkesa për kapital minimal është jo më e ulët se 1 000 000 euro,

IV. shuma e sasive të përcaktuara në pikat I dhe II për shoqëritë e sigurimit që përmenden në nenin 73, paragrafi 5.

2. Sipas paragrafit 3, kërkesa për kapital minimal llogaritet si një funksion linear i një grupi ose nëngrupi të variablave në vijim: provigjoneve teknike, primeve të shkruara, kapitalit të rrezikuar, detyrimeve tatimore të shtyra dhe shpenzimeve administrative të shoqërisë. Variablat që përdoren maten si neto e risigurimit.

3. Pa cenuar paragrafin 1, germa "d", kërkesa për kapital minimal nuk duhet të bjerë nën 25% as të tejkalojë 45% të kërkesës për kapital minimal të shoqërisë, e llogaritur në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksionet 2 ose 3, dhe duke përfshirë çdo shtim të kapitalit të vendosur në përputhje me nenin 37.

Për një periudhë që përfundon jo më vonë se data 31 tetor 2014, shtetet anëtare i lejojnë autoriteteve të tyre mbikëqyrëse që t'i kërkojnë një shoqërie sigurimi ose risigurimi që të zbatojë përqindjet e përmendura në nënparagrafin e parë ekskluzivisht për kërkesën për kapital minimal për shoqërinë e llogaritur në përputhje me kapitullin VI, seksioni 4, nënseksioni 2.

4. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit llogarisin kërkesën për kapital minimal të paktën çdo tre mujor dhe rezultatin e llogaritjes ia raportojnë autoriteteve mbikëqyrëse.

Në rastet kur kërkesën për kapital minimal për një shoqëri e përcakton një nga kufizimet e përmendura në paragrafin 3, shoqëria i paraqet autoritetin mbikëqyrës informacionin që i mundëson këtij të fundit të kuptojë arsyet e këtij fakti.

5. Komisioni i dorëzon Parlamentit Evropian dhe Komitetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve, i themeluar me Vendimin e Komisionit 2004/9/KE, përpara datës 31 tetor 2017, një raport për rregullat e shteteve anëtare dhe praktikatat e autoriteteve mbikëqyrëse të miratuara sipas paragrafëve 1 deri në 4.

Ky raport trajton, në veçanti, përdorimin dhe nivelin e tavanit dhe nivelit dysheme të përcaktuar në paragrafin 3 si edhe çdo problem të hasur nga autoritetet mbikëqyrëse dhe shoqëritë për zbatimin e këtij neni.

Neni 130

Masat zbatuese

Komisioni miraton masa zbatuese që specifikojnë llogaritjen e kërkesës për kapital minimal, që përmendet në nenet 128 dhe 129.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore, sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 131

Marrëveshjet kalimtare në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesën për kapital minimal

Duke shfuqizuar nenet 139 dhe 144, në rastet kur shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit veprojnë në pajtim me nivelin e kërkuar të aftësisë pagueuse që përmendet në nenin 28 të Direktivës 2002/83/KE, nenin 16a të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 37, 38 ose 39 të Direktivës 2005/68/KE, përkatësisht më datë 31 tetor 2012, por nuk zotërojnë fonde bazë të pranueshme që të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën për kapital minimal, këto shoqëri duhet të veprojnë në pajtim me nenin 128 përpara datës 31 tetor 2013.

Kur një shoqëri nuk arrin të pajtohet e nenin 128 brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë, autorizimi i shoqërisë tërhiqet, sipas proceseve të zbatueshme që parashikohen në legjislacionin e brendshëm.

SEKSIONI 6

INVESTIMET

Neni 132

Parimi i "personit të kujdesshëm"

1. Shtetet anëtare garantojnë që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i investojnë të gjitha aktivet e tyre në përputhje me parimin e "personit të kujdesshëm, siç specifikohet në paragrafët 2, 3 dhe 4.

2. Në lidhje me të gjithë portofolin e aktiveve, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit investojnë vetëm për aktive dhe instrumente rreziqet e të cilave mund të identifikohen, maten, monitorohen, menaxhohen, kontrollohen dhe raportohen nga kjo shoqëri, dhe të cilat shoqëria mund t'i marrë në konsideratë siç duhet gjatë vlerësimit të nevojave të saj të përgjithshme për aftësi paguese, në përputhje me germën "a" të nënparagrafit të dytë të nenit 45, paragrafi 1.

Të gjitha aktivet, në veçanti ato që mbulojnë kërkesën për kapital minimal dhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, investohen në mënyrë të tillë që garanton siguri, cilësi, likuiditet dhe fitime për portofolin në tërësi. Gjithashtu, vendndodhja e këtyre aktiveve duhet të garantojë disponueshmërinë e tyre.

Edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, duhen investuar në një mënyrë që të përshatet me natyrën dhe kohëzgjatjen e detyrimeve të sigurimit dhe risigurimit. Këto aktive investohen në interesin më të mirë të mbajtësve të policave dhe përfituesve, duke marrë në konsideratë çdo objektiv të publikuar të politikave.

Në rast të një konflikti interesi, shoqëritë e sigurimit ose subjekti që administron portofolin e tyre, sigurohet që investimi të bëhet vetëm në interes të mbajtësve të policave dhe përfituesve.

3. Pa cenuar paragrafin 2, në lidhje me aktivet që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës, kur rreziku i investimit mbulohet nga mbajtësit e policave, zbatohen paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt i këtij paragrafi.

Nëse përfitimet e parashikuara nga një kontratë lidhen drejtpërsëdrejti me vlerën e njësieve në një SIKTT, siç përcaktohet në Direktivën 85/611/KEE, ose me vlerën e aktiveve që mbahen në një fond të brendshëm të shoqërive të sigurimit, zakonisht të ndarë në njësi, provigjonet teknike për këto përfitime duhet të përfaqësohen sa më saktësisht nga këto njësi ose, në rastin kur këto njësi nuk janë krijuar, nga këto aktive.

Kur përfitimet e parashikuara nga një kontratë lidhen direkt me një indeks aksionesh ose ndonjë vlerë tjetër referencë e ndryshme nga ato që përmenden në nënparagrafin e dytë,

provigjonet teknike për këto përfitime duhet të përfaqësohen sa më saktësisht nga njësitë që konsiderohen se përfaqësojnë vlerën referencë, ose, në rastin kur këto njësi nuk janë krijuar, nga aktivet që kanë siguri dhe tregtueshmëri të mjaftueshme të cilat përkojnë sa më shumë me ato mbi të cilat bazohet vlera referencë e veçantë.

Kur përfitimet e përmendura në nënparagrafin e dytë dhe të tretë përfshinë një garanci për performancën e investimit ose ndonjë përfitim tjetër të garantuar, aktivet që mbulojnë provigjonet teknike përkatëse shtesë i nënshtrohen paragrafit 4.

4. Pa cenuar paragrafin 2, në lidhje me aktive të ndryshme nga ato që mbulohen nga paragrafi 3, zbatohet paragrafi i dytë deri te i pesti.

Përdorimi i instrumenteve derivative lejohet për sa kohë që ato kontribuojnë në uljen e rreziqeve ose lehtësojnë administrimin efikas të portofolit.

Investimet dhe aktivet që nuk pranohen për tregtim në një treg të rregulluar financiar mbahen në nivele të matura.

Aktivitet diversifikohen në mënyrë të tillë që të shmanget varësia e tepërt nga ndonjë aktiv i veçantë, emetues ose grup shoqërisht, zonë gjeografike dhe akumulimi i tepërt i rreziqeve në portofolin në tërësi.

Investimet në aktivet e emetuara nga i njëjti emetues ose nga emetues që i përkasin të njëjtit grup nuk duhet ta ekspozojnë shoqërinë e sigurimit ndaj përqendrimit të tepërt të rrezikut.

Neni 133

Liria e investimit

1. Shtetet anëtare nuk u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që të investojnë në kategori të veçanta aktivesh.

2. Shtetet anëtare nuk i bëjnë objekt të miratimeve paraprake të çdo lloji apo të kërkesave për njoftim sistematik, vendimet për investime të një shoqërie sigurimi apo të administratorit të saj të investimit.

3. Ky nen nuk cenon kërkesat e shteteve anëtare për të kufizuar llojet e aktiveve ose vlerat referencë me të cilat mund të lidhen përfitimet nga polica. Këto rregulla zbatohen vetëm kur rreziku i investimit mbulohet nga një mbajtës police, i cili është person fizik, dhe ato nuk duhet të jenë më kufizuese se ato që përcaktohen në Direktivën 85/611/KEE.

Neni 134

Vendndodhja e aktiveve dhe ndalimi i barrësimit të aktiveve

1. Në lidhje me rreziqet e sigurimit që ndodhen në Komunitet, shtetet anëtare nuk kërkojnë që aktivet për të mbuluar provigjonet teknike që lidhen me këto rreziqe të ndodhen brenda Komunitetit ose në ndonjë shtet anëtar të veçantë.

Gjithashtu, në lidhje me shumat e arkëtueshme nga kontratat e risigurimit kundrejt shoqërive të autorizuara në përputhje me këtë direktivë ose që kanë zyrën kryesore në një vend të tretë ku regjimi i aftësisë paguese konsiderohet si ekuivalent, në përputhje me nenin 172, shtetet anëtare nuk kërkojnë që asetet që përfaqësojnë këto shuma të rikuperueshme të ndodhen brenda Komunitetit.

2. Kur risiguruesi është një shoqëri sigurimi ose risigurimi e autorizuar në përputhje me këtë direktivë, shtetet anëtare, në lidhje me krijimin e provigjoneve teknike nuk vendosin ose nuk kërkojnë krijimin e një sistemi me rezerva bruto, i cili kërkon barrësimin e aktiveve për të mbuluar provigjonet për primet e pafituara ose dëmet e papaguara.

Neni 135

Masat zbatuese

1. Për të garantuar zbatimin uniform të kësaj direktive, Komisioni mund të miratojnë masa zbatuese që specifikojnë kërkesat cilësore në fushat e mëposhtme:

a) identifikimin, matjen, monitorimin, menaxhimin dhe raportimin e rreziqeve që lindin nga investimet në lidhje me nënparagrafin e parë të nenit 132, paragrafi 2;

b) identifikimin, matjen, monitorimin, menaxhimin dhe raportimin e rreziqeve specifike që lindin nga investimi në instrumentet derivative dhe aktivet e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 132, paragrafi 4;

2. Për të garantuar konsistencën ndërsektoriale dhe për të shmangur mosharmonizimin ndërmjet interesave të firmave që "ripaketojnë" kreditë në tituj të tregtueshëm dhe instrumente të tjera financiare (iniciatorë) dhe interesat e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit që investojnë në këto tituj ose instrumente, Komisioni miraton masat zbatuese që përcaktojnë:

a) kërkesat që duhet të përmbushë iniciatori me qëllim që një shoqëri sigurimi ose risigurimi t'i lejohet të investojë në këto tituj ose instrumente të emetuar pas datës 1 janar 2011, duke përfshirë kërkesat që garantojnë se iniciatori mban një interes ekonomik neto prej jo më pak se 5%;

b) kërkesat cilësore që duhet të përmbushin shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që investojnë në këto tituj ose instrumente.

3. Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

KAPITULLI VII

SHOQËRITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT NË VËSHTIRËSI OSE NË SITUATA JO TË RREGULLTA

Neni 136

Identifikimi dhe njoftimi i kushteve financiare të përkeqësuar nga shoqëria e sigurimit dhe risigurimit

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit duhet të vendosin procedura për të identifikuar kushtet financiare të përkeqësuar dhe njoftojnë menjëherë autoritetet mbikëqyrëse kur ndodh ky përkeqësim.

Neni 137

Papajtueshmëria me provigjonet teknike

Kur një shoqëri sigurimi ose risigurimi nuk vepron në pajtim me kapitullin VI, seksioni 2, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit të saj të origjinës mund të ndalojnë lirin pa pagesë të aktiveve të saj pasi t'i kenë komunikuar synimet e tyre autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare pritëse. Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës përcaktojnë aktivet që mbulohen nga këto masa.

Neni 138

Papajtueshmëria me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit informojnë autoritetin mbikëqyrës sapo të vëzhgojnë se është prishur pajtueshmëria me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, ose në rastet kur ekziston rreziku i papajtueshmërisë për tre muajt e ardhshëm.

2. Brenda dy muajve nga vëzhgimi i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, shoqëria e sigurimit ose risigurimit në fjalë i dorëzon për miratim autoritetit mbikëqyrës një plan rikuperimi realist.

3. Autoriteti mbikëqyrës i kërkon shoqërisë së sigurimit ose të risigurimit në fjalë që të marrë masat e nevojshme për të arritur, brenda gjashtë muajve nga vëzhgimi i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, rivendosjen e nivelit të fondeve të veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ose uljen e profilit të saj të rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Sipas rastit, autoriteti mbikëqyrës mund ta shtyjë këtë periudhë me tre muaj.

4. Në rastin e një rënieje përjashtimore në tregjet financiare, autoriteti mbikëqyrës mund të shtyjë periudhën e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 3 me një periudhë kohore të përshtatshme duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës.

Shoqëria e sigurimit ose risigurimit në fjalë, çdo tre muaj, i dorëzon autoritetit të saj mbikëqyrës një raport progresi ku përcaktohen masat e marra dhe progresi i bërë për të rivendosur nivelin e fondeve të veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ose për të ulur profilin e rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Shtyrja e përmendur në nënparagrafin e parë tërhiqet kur ky raport progresi tregon se nga data e vëzhgimit të papajtueshmërisë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe deri në datën e dorëzimit të raportit të progresit nuk është bërë asnjë progres i konsiderueshëm për të rivendosur nivelin e fondeve të veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ose për të ulur profilin e rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

5. Në rrethana përjashtimore, kur autoriteti mbikëqyrës mendon se situata financiare e shoqërisë në fjalë do të vazhdojë të përkeqësohet, ai gjithashtu mund të kufizojë ose ndalojë çlirimin e pakushtëzuar të aktiveve të kësaj shoqërie. Ky autoritet mbikëqyrës informon autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare pritëse për çdo masë që ka marrë. Me kërkesë të autoritetit mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës, autoritetet e shteteve anëtare pritëse marrin të njëjtat masa. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës përcakton aktivet që duhet të mbulohen nga këto masa.

Neni 139

Papajtueshmëria me kërkesën për kapital minimal

1. Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit informojnë autoritetin mbikëqyrës sapo të vëzhgojnë se është prishur pajtueshmëria me kërkesën për kapital minimal, ose në rastet kur ekziston rreziku i papajtueshmërisë për tre muajt e ardhshëm.

2. Brenda një muaji nga vëzhgimi i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital minimal, shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në fjalë i dorëzon autoritetit mbikëqyrës për miratim një skemë financiare afatshkurtër dhe realiste për të rikuperuar, brenda tre muajve pas këtij vëzhgimi, fondet e veta bazë, të paktën deri në nivelin e kërkesës për kapital minimal, ose për të ulur profilin e rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital minimal.

3. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës gjithashtu mund të kufizojë ose ndalojë çlirimin e pakushtëzuar të sipërmarrjeve të sigurimit ose të risigurimit. Ai informon autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare pritëse për sa më lart. Me kërkesë të autoritetit mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës, këto autoritete marrin të njëjtat masa. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës përcakton aktivet që duhet të mbulohen nga këto masa.

Neni 140

Ndalimi i çlirimit të pakushtëzuar të aktiveve që ndodhen brenda territorit të një shteti anëtar

Për rastet e parashikuara në nenet 137 deri në 139 dhe në nenin 144, paragrafi dy, me kërkesë të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë, shtetet anëtare marrin masat e nevojshme që, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të ndalojnë çlirimin e pakushtëzuar të aktiveve që ndodhen brenda territorit të tyre.

Neni 141

Kompetencat mbikëqyrëse në kushtet financiare të përkeqësuar

Pavarësisht neneve 138 dhe 139, kur pozicioni i aftësisë paguese të shoqërisë vazhdon të përkeqësohet, autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencën që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur interesat e mbajtësve të policave në rastin e kontratave të sigurimit ose detyrimet që lindin nga kontratat e risigurimit.

Këto masa janë proporcionale kështu që pasqyrojnë nivelin dhe kohëzgjatjen e përkeqësimit të pozicionit të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë.

Neni 142

Plani i rikuperimit dhe skema financiare

1. Plani i rikuperimit që përmendet në nenin 138, paragrafi 2 dhe skema financiare që përmendet në nenin 139, paragrafi 2, përfshijnë të paktën detaje ose prova në lidhje me sa më poshtë:

a) parashikimet e shpenzimeve të administrimit, në veçanti shpenzimet dhe komisionet aktuale të përgjithshme;

b) parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me biznesin e drejtpërdrejtë, pranimet në risigurim dhe cedimet në risigurim;

c) një parashikim të bilancit;

d) parashikimet e burimeve financiare që synohen të mbulojnë provigjonet teknike, kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal;

e) policën e përgjithshme të risigurimit.

2. Kur autoritetet mbikëqyrëse kanë kërkuar një plan rikuperimi që përmendet në nenin 138, paragrafi 2, ose një skemë financiare që përmendet në nenin 139, paragrafi 2, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ata refuzojnë të lëshojnë një certifikatë në përputhje me nenin 39 për sa kohë që gjykojnë se janë cenuar të drejtat e mbajtësve të policave ose detyrimet kontraktuale të shoqërisë së risigurimit.

Neni 143

Masat zbatuese

Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë faktorët që duhet të merren në konsideratë për zbatimin e nenit 138, paragrafi 4, duke përfshirë periudhën kohore maksimale, e shprehur në numër total të muajve, e cila duhet të jetë e njëjtë për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, siç përmendet në nënparagrafin e parë të nenit 138, paragrafi 4.

Kur kjo nevojitet për të përmirësuar konvergjencën, Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që përcaktojnë specifikime të mëtejshme në lidhje me planin e rikuperimit që përmendet në nenin 138, paragrafi 2, skemën financiare që përmendet në nenin 139, paragrafi 2 dhe në lidhje me nenin 141, në një mënyrë që shmang efektet prociklike.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 144

Heqja e autorizimit

1. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës mund të tërheqë autorizimin e dhënë për një shoqëri sigurimi ose risigurimi në rastet e mëposhtme:

a) shoqëria në fjalë nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht atë, ose nuk zhvillon veprimtaritë e saj për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës parashikon ndërprerjen e autorizimit për këto raste;

b) shoqëria në fjalë nuk i përmbush më kushtet për autorizim;

c) shoqëria në fjalë shkel rëndë detyrimet e saj që rrjedhin nga rregulloret të cilave ajo u nënshtrohet.

Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës tërheq autorizimin e dhënë për një shoqëri sigurimi ose risigurimi në rast se shoqëria nuk vepron në pajtim me kërkesën për kapital minimal dhe autoriteti mbikëqyrës gjykon se skema financiare që ajo ka dorëzuar është qartësisht e papërshtatshme ose se shoqëria në fjalë nuk vepron në pajtim me skemën e miratuar brenda tre muajve nga vëzhgimi i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital minimal.

2. Në rastin e tërheqjes ose ndërprerjes së autorizimit, autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës njofton autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera anëtare për sa më lart dhe këto autoritete marrin masat e përshtatshme për të penguar shoqërinë e sigurimit ose të risigurimit që të nisë operacione të reja brenda territoreve të tyre.

Autoriteti Mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës, së bashku me këto autoritete, marrin të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur interesat e personave të siguruar dhe, në veçanti, kufizojnë çlirimin e pakushtëzuar të aktiveve të shoqërisë së sigurimit në përputhje me nenin 140.

3. Për çdo vendim për të tërhequr një autorizim deklarohen arsyet e plota dhe ky vendim i njoftohet shoqërisë së sigurimit ose risigurimit në fjalë.

KAPITULLI VIII

E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

SEKSIONI 1

THEMELIMI NGA SHOQËRITË E SIGURIMIT

Neni 145

Kushtet për themelimin e degëve

1. Shtetet anëtare sigurohen që një shoqëri sigurimi që propozon të themelojë një degë brenda territorit të një shteti tjetër anëtar të njoftojë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës së saj.

Çdo prani e përhershme e një shoqërie në territorin e një shteti anëtar trajtohet njësoj si një degë, edhe kur prania nuk merr formën e një dege por përbëhet vetëm nga në zyrë e administruar nga vetë stafi i shoqërisë ose nga një person që është i pavarur por ka autoritet të përhershëm për të vepruar për shoqërinë siç do të bënte një agjenci.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo shoqërie sigurimi që propozon të themelojë një degë brenda territorit të një shteti tjetër anëtar që të japë informacionet e mëposhtme, në rastet kur dërgohet njoftimi i parashikuar në paragrafin 1:

- a) shtetin anëtar brenda territorit të të cilit shoqëria propozon të themelojë një degë;
- b) një program të operacioneve ku përcaktohen, të paktën, llojet e veprimtarive të parashikuara dhe organizimi strukturor i degës;
- c) emrin e një personi që zotëron kompetenca të mjaftueshme për të detyruar, kundrejt palëve të treta, shoqërinë e sigurimit, ose, në rastin e Lloyd's, marrësit përkatës në sigurim dhe për të përfaqësuar atë ose ata përpara autoriteteve dhe gjykatave të shtetit anëtar pritës (agjent i autorizuar);
- d) adresën në shtetin anëtar pritës nga ky mund të merren dhe ku mund të dërgohen dokumente, duke përfshirë të gjitha komunikimet me agjentin e autorizuar.

Në lidhje me Lloyd's, në rastin e çështjeve ligjore në shtetin anëtar pritës që lindin nga angazhimet e marrjes në sigurim, personat e siguruar nuk trajtohen ndryshe nga sa mund të trajtoheshin nëse çështja ligjore do të ishte paraqitur kundër bizneseve të një lloji më tradicional.

3. Kur një shoqëri sigurimi jo-jetë synon që dega e saj të mbulojë rreziqet e klasës 10 në Pjesën A të shtojcës I, me përjashtim të përgjegjësisë së transportuesit, ajo përgatit një deklaratë ku deklaron se është bërë anëtare e byrosë kombëtare dhe fondit kombëtar të garancisë në shtetin anëtar pritës.

4. Në rast ndryshimi të detajeve të komunikuar sipas germës "b", "c" ose "d" të paragrafit 2, shoqëria e sigurimit njofton me shkrim për këtë ndryshim autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës dhe të shtetit anëtar ku ndodhet dega të paktën një muaj përpara se ta bëjë një ndryshim të tillë me qëllim që autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës dhe autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhet dega të kenë mundësi të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse në zbatim të nenit 146.

1. Përveç se kur autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës kanë arsye për të dyshuar në përshtatshmërinë e sistemit rregullator ose të situatës financiare të shoqërisë së sigurimit ose për kërkesat e përshtatshme, të parashikuara në nenin 42, për agjentin e autorizuar, duke marrë në konsideratë veprimtaritë e planifikuara, brenda tre muajve nga marrja e informacionit të përmendur në nenin 145, paragrafi 2, ata ia komunikojnë këtë informacion autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës dhe informojnë shoqërinë e sigurimit në fjalë për sa më lart.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës gjithashtu konfirmojnë nëse shoqëria e sigurimit mbulon kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal, të llogaritura në përputhje me nenet 100 dhe 129.

2. Kur autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës refuzojnë t'i komunikojnë autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës informacionin e përmendur në nenin 145, paragrafi 2, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit, ata i paraqesin shoqërisë përkatëse të sigurimit arsyet e refuzimit.

Refuzimi ose çdo moskthim përgjigjeje çon në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave në shtetin anëtar të origjinës.

3. Përpara se dega e shoqërisë së sigurimit të nisë veprimtarinë, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës, sipas rastit, brenda dy muajve nga marrja e informacionit të përmendur në paragrafin 1, informojnë autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës kushtet sipas të cilave duhet të zhvillohet kjo veprimtari në shtetin anëtar pritës, në interes të së mirës së përgjithshme. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës ia komunikon këtë informacion shoqërisë së sigurimit në fjalë.

Shoqëria e sigurimit mund të themelojë degën dhe të nisë veprimtarinë që nga data në të cilën autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës ka marrë këtë komunikim, dhe, nëse nuk merret asnjë komunikim, në përfundim të periudhës së parashikuar në nënparagrafin e parë.

SEKSIONI 2

LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE: NGA SHOQËRITË E SIGURIMIT

NËNSEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 147

Njoftimi paraprak për shtetin anëtar të origjinës

Çdo shoqëri sigurimi që synon të zhvillojë veprimtari për herë të parë në një ose më shumë shtete anëtare në zbatim të lirisë për të ofruar shërbime, fillimisht njofton autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës, duke treguar natyrën e rreziqeve ose angazhimeve që ajo propozon të mbulojë.

Njoftimi nga shteti anëtar i origjinës

1. Brenda një muaji nga njoftimi i parashikuar në nenin 147, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës i komunikojnë shtetit ose shteteve anëtare në territorin e të cilëve një shoqëri sigurimi synon të zhvillojë veprimtaritë në zbatim të lirisë për të ofruar shërbime, sa më poshtë:

a) një certifikatë që vërteton se shoqëria e sigurimit mbulon kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal të llogaritur sipas neneve 100 dhe 129;

b) klasat e sigurimit që shoqëria e sigurimit është autorizuar të ofrojë;

c) natyrën e rreziqeve ose angazhimeve që shoqëria e sigurimit propozon të mbulojë në shtetin anëtar pritës.

Në të njëjtën kohë, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës informojnë shoqërinë e sigurimit në fjalë për këtë komunikim.

2. Shtetet anëtare në territorin e të cilëve një shoqëri sigurimi jojetë synon që, në zbatim të lirisë për të ofruar shërbime, të mbulojë rreziqet e klasës 10 në pjesën A të shtojcës I, përveç përgjegjësisë së transportuesit, mund t'i kërkojnë kësaj shoqërie sigurimi që të dorëzojë sa më poshtë:

a) emrin dhe adresën e përfaqësuesit që përmendet në nenin 18, paragrafi 1, germa "h";

b) një vërtetim që tregon se është bërë anëtare e zyrës kombëtare dhe fondit kombëtar të garancisë së shtetit anëtar pritës.

3. Nëse autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës nuk komunikojnë informacionin e përmendur në paragrafin 1 brenda periudhës së përcaktuar në atë paragraf, brenda së njëjtës periudhë ata i paraqesin shoqërisë së sigurimit arsyet e refuzimit.

Refuzimi ose çdo moskthim përgjigjeje çon në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave në shtetin anëtar të origjinës.

4. Shoqëria e sigurimit mund të nisë veprimtarinë që nga data në të cilën njoftohet për komunikimin e parashikuar në nënparagrafin e parë të paragrafit 1.

Ndryshimet në natyrën e rreziqeve ose angazhimeve

Çdo ndryshim që shoqëria e sigurimit synon t'i bëjë informacionit të përmendur në nenin 145 i nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenet 147 dhe 148.

SIGURIMI I MJETEVE MOTORIKE NDAJ PËRGJEGJËSISË SË PALËVE TË TRETA

Neni 150

Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike ndaj përgjegjësive të palëve të treta

1. Kur një shoqëri sigurimi jo-jetë, nëpërmjet një zyre që gjendet në një shtet anëtar, mbulon një rrezik, me përjashtim të përgjegjësive të transportuesit, që klasifikohet në klasën 10 në Pjesën A të shtojcës I që ndodhet në një shtet tjetër anëtar, shteti anëtar pritës i kërkoj kësaj shoqërie që të bëhet anëtare dhe të marrë pjesë në financimin e byrosë së tij kombëtare dhe fondit kombëtar të garancisë.

2. Kontributi financiar që përmendet në paragrafin 1 bëhet vetëm në lidhje me rreziqet, përveç përgjegjësive të transportuesit, në klasën 10 në Pjesën A të shtojcës I që mbulohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve. Ky kontribut llogaritet njësoj edhe për shoqëritë e sigurimit jo-jetë që mbulojnë këto rreziqe nëpërmjet një dege të ndodhur në atë shtet anëtar.

Llogaritja bëhet mbi bazën e të ardhurave nga primi nga kjo klasë rreziqesh ose mbi bazën e numrit të rreziqeve të kësaj klase që mbulohen në shtetin anëtar pritës.

3. Shteti anëtar pritës mund t'i kërkojë një shoqërie sigurimi që ofron shërbime që të veprojnë në pajtim me rregullat e atij shteti anëtar në lidhje me mbulimin e rreziqeve më të rënda, për sa kohë që ato zbatohen për shoqëritë e sigurimit jo-jetë në atë shtet.

Neni 151

Mosdiskriminimi i personave që paraqesin pretendim për dëme

Shteti anëtar i kërkon shoqërisë së sigurimit jo jetë që të garantojë se personat që paraqesin pretendim për dëme që lindin nga ngjarjet që ndodhin në territorin e tij nuk trajtohen në mënyrë më pak të favorshme nga fakti që shoqëria mbulon një rrezik, përveç përgjegjësive të transportuesit, që klasifikohet në klasën 10 të Pjesës A të shtojcës I nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe jo nëpërmjet një zyre të ndodhur në atë shtet.

Neni 152

Përfaqësuesi

1. Për qëllimet e përmendura në nenin 151, shteti anëtar pritës i kërkon shoqërisë së sigurimit jo-jetë që të emërojë një përfaqësues të përhershëm ose të themeluar në territorin e tij i cili do të mbledhë informacionet e nevojshme në lidhje me dëmet dhe i cili duhet të zotërojë kompetenca të mjaftueshme për ta përfaqësuar shoqërinë në lidhje me personat që pësojnë dëme ose që mund të ngrenë pretendime për dëme, duke paguar pagesën e këtyre dëmeve, dhe për ta përfaqësuar atë, ose kur është e nevojshme, për t'i kërkuar dikujt ta përfaqësojë shoqërinë përpara gjykatave dhe autoriteteve të atij shteti anëtar në lidhje me këto pretendime.

Këtij përfaqësuesi gjithashtu mund t'i kërkohej që të përfaqësojë shoqërinë e sigurimit jo-jetë përpara autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës, në lidhje me kontrollin e ekzistencës dhe të vlefshmërisë së policave të sigurimit të përgjegjësishë për mjetet motorike.

2. Shteti anëtar pritës nuk i kërkon këtij përfaqësuesi që të ndërmarrë veprimtari në emër të shoqërisë së sigurimit jo-jetë që e ka emëruar atë, përveç veprimtarive të përcaktuara në paragrafin 1.

3. Emërimi i përfaqësuesit në vetvete nuk përfaqëson hapjen e një dege për qëllimin e nenit 145.

4. Kur shoqëria e sigurimit nuk ka arritur të emërojë një përfaqësues, shtetet anëtare mund të japin miratimin e tyre që përfaqësuesi për trajtimin e dëmeve, i emëruar në përputhje me nenin 4 të Direktivës 2000/26/KE, të marrë përsipër funksionin e përfaqësuesit që përmendet në paragrafin 1 të këtij neni.

SEKSIONI 3

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE MBIKËQYRËSE TË SHTETIT ANËTAR PRITËS

NËNSEKSIONI 1

SIGURIMET

Neni 153

Gjuha

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës mund të kërkojnë që informacioni të cilin ata janë të autorizuar të kërkojnë në lidhje me veprimtarinë e shoqërive të sigurimit që veprojnë në territorin e atij shteti anëtar t'u jepet atyre në gjuhën ose gjuhët zyrtare të atij vendi.

Neni 154

Njoftimi paraprak dhe miratimi paraprak

1. Shteti anëtar pritës nuk miraton dispozita që kërkojnë miratimin paraprak ose njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policës, të niveleve të primeve, ose në rastin e sigurimit jetë, të bazave teknike që përdoren në veçanti për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike, ose të formularëve dhe dokumenteve të tjera që një shoqëri sigurimi synon të përdorë gjatë marrëdhënieve me mbajtësit e policave.

2. Një shoqëri sigurimi që propozon të zhvillojë veprimtari sigurimi në territorin e tij, shteti anëtar pritës i kërkon që të bëjë njoftimin josistematik të kushteve të policës dhe dokumenteve të tjera me qëllim që të verifikojë pajtueshmërinë e dispozitat e tij kombëtare në lidhje me kontratat e sigurimit dhe kjo kërkesë nuk përbën një kusht paraprak për zhvillimin e veprimtarive nga kjo shoqëri sigurimi.

3. Shtetet anëtare nuk kërkojnë apo të prezantojnë kërkesën për njoftim paraprak ose miratimin e rritjeve të propozuara të niveleve të primit përveç se si pjesë e sistemeve të përgjithshme për kontrollin e çmimit.

Neni 155

Shoqëritë e sigurimit që nuk veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore

1. Kur autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës vendosin se një shoqëri sigurimi që ka një degë ose që zhvillon veprimtari sipas lirisë për të ofruar shërbime në territorin e tij nuk vepron në pajtim me dispozitat ligjore të zbatueshme në atë shtet anëtar, ata i kërkojnë kësaj shoqërie sigurimi që të korrigojë këtë parregullsi.

2. Kur kjo shoqëri sigurimi nuk arrin të marrë masat e nevojshme, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar në fjalë njoftojnë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës për sa më lart.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës, sapo të kenë mundësi, marrin të gjitha masat e përshtatshme për të garantuar që shoqëria e sigurimit në fjalë korrigjon këtë situatë të parregullt.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës njoftojnë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës lidhur me masat e marra.

3. Nëse, pavarësisht masave të marra nga shteti anëtar i origjinës ose për shkak se këto masa janë të papërshtatshme ose mungojnë në këtë shtet anëtar, shoqëria e sigurimit vazhdon të shkelë dispozitat ligjore në fuqi në shtetin anëtar pritës, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës, pasi informojnë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës, mund të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar ose penalizuar parregullsitë e mëtejshme duke përfshirë, deri në masën e nevojshme, parandalimin e kësaj shoqërie që të vazhdojë të lidhë kontrata të reja sigurimi brenda territorit të shtetit anëtar pritës.

Shtetet anëtare duhet të sigurohen që brenda territoreve të tyre të ekzistojnë dokumentet ligjore të nevojshme për këto masa ndaj shoqërive të sigurimit.

4. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk ndikojnë në kompetencën e shteteve anëtare në fjalë që të marrë masat emergjente të përshtatshme për të parandaluar ose penalizuar parregullsitë në territoret e tyre. Kjo kompetencë përfshin mundësinë për të parandaluar shoqëritë e sigurimit që të lidhin kontrata të reja sigurimi në territoret e tyre.

5. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk ndikojnë në kompetencën e shteteve anëtare për të parandaluar shkeljet në territoret e tyre.

6. Kur një shoqëri sigurimi që ka kryer një shkelje ka një zyrë ose zotëron prona në shtetin anëtar në fjalë, autoritetet mbikëqyrëse të këtij shteti anëtar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, mund të zbatojnë penalitetet administrative kombëtare që parashikohen për këtë shkelje duke i zbatuar ato kundrejt asaj zyre ose prone.

7. Çdo masë e marrë sipas paragrafëve 2 deri në 6 që përfshin kufizimet për kryerjen e veprimtarive të sigurimit duhet të arsyetohet siç duhet dhe t'i komunikohet shoqërisë së sigurimit në fjalë.

8. Shoqëritë e sigurimit i dorëzojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës, me kërkesë të tyre, të gjitha dokumentet që ata kërkojnë për qëllimet e paragrafëve 1 deri në 7 deri në masën që shoqëritë e sigurimit që kanë zyrën kryesore në atë shtet anëtar gjithashtu janë të detyruar të bëjnë të njëjtën gjë.

9. Shtetet anëtare e informojnë Komisionin për numrin dhe llojin e rasteve që kanë çuar në refuzimet sipas neneve 146 dhe 148, për të cilat janë marrë masa sipas paragrafit 4 të këtij neni.

Mbi bazën e këtij informacioni Komisioni informon çdo dy vjet Komitetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve.

Neni 156

Publiciteti

Shoqëritë e sigurimit me zyra kryesore në shtetet anëtare mund të reklamojnë shërbimet e tyre nëpërmjet të gjitha mjeteve të disponueshme në shtetin anëtar pritës sipas rregullave që rregullojnë formën dhe përmbajtjen e këtij reklamimi, të miratuar në interes të së mirës së përgjithshme.

Neni 157

Tatimet mbi primet

1. Pa cenuar asnjë harmonizim vijues, çdo kontratë sigurimi i nënshtrohet në mënyrë ekskluzive tatimeve indirekte dhe tarifave parafiskale për primet e sigurimit në shtetin anëtar ku ndodhet rreziku ose në shtetin anëtar të angazhimit.

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, pronat e patundshme që përfshihen në një ndërtesë që ndodhet në territorin e një shteti anëtar, përveç mallrave në transit tregtar, konsiderohen si rrezik që ndodhet në atë shtet anëtar, edhe kur ndërtesa dhe ajo çka përmban nuk mbulohet nga e njëjta policë sigurimi.

Në rastin e Spanjës, një kontratë sigurimi i nënshtrohet edhe tarifave shtesë të përcaktuara në ligj në favor të "Consortio de Compensación de Seguros" të Spanjës për përmbushjen e funksioneve të saj në lidhje me kompensimin e humbjeve që lindin nga ngjarjet e jashtëzakonshme që ndodhin në atë shtet anëtar.

2. Ligji i zbatueshëm për kontratën në zbatim të nenit 178 të kësaj direktive dhe të Rregullores (KE) nr. 593/2008 nuk ndikon marrëveshjet fiskale të zbatueshme.

3. Çdo shtet anëtar zbaton dispozitat e tij kombëtare për ato shoqëri sigurimi që mbulojnë rreziqe ose angazhime që ndodhen brenda territorit të tij për sa i përket masave për mbledhjen e tatimeve indirekte dhe tarifave parafiskale që duhen paguar sipas paragrafit 1.

NËNSEKSIONI 2

RISIGURIMI

Neni 158

Shoqëritë e risigurimit që nuk veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore

1. Kur autoritetet mbikëqyrëse të një shteti anëtar vendosin se një shoqëri risigurimi që ka një degë ose që zhvillon veprimtari sipas lirisë për të ofruar shërbime në territorin e tij nuk vepron në pajtim me dispozitat ligjore të zbatueshme në atë shtet anëtar, ai i kërkon kësaj shoqërie risigurimi që të korrigjojë këtë parregullsi. Në të njëjtën kohë, ato i referohen gjetjeve të autoritetit mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës.

2. Nëse, pavarësisht masave të marra nga shteti anëtar i origjinës ose për shkak se këto masa janë të papërshtatshme, shoqëria e risigurimit vazhdon të shkelë dispozitat ligjore që zbatohen për të në shtetin anëtar pritës, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar pritës, pasi informojnë autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës, mund të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar ose penalizuar parregullsitë e mëtejshme duke përfshirë, deri në masën e nevojshme, parandalimin e kësaj shoqërie risigurimi që të vazhdojë të lidhë kontrata të reja risigurimi brenda territorit të shtetit anëtar pritës.

Shtetet anëtare duhet të sigurohen që brenda territoreve të tyre, të ekzistojnë dokumentet ligjore të nevojshme për këto masa ndaj shoqërive të risigurimit.

3. Çdo masë e marrë sipas paragrafëve 1 dhe 2 që përfshin sanksione ose kufizime për kryerjen e veprimtarive të risigurimit duhet të arsyetohet siç duhet dhe t'i komunikohet shoqërisë së risigurimit në fjalë.

SEKSIONI 4

INFORMACIONI STATISTIKOR

Neni 159

Informacioni statistikor për veprimtaritë ndërkufitare

Çdo shoqëri sigurimi informon autoritetin mbikëqyrës kompetent të shtetit anëtar të origjinës së saj, veçmas, në lidhje me transaksionet e kryera sipas të drejtës së themelimit dhe me ato që kryhen sipas lirisë për të ofruar shërbime, në sasinë e primeve, dëmeve dhe komisioneve, pa zbritjen e risigurimit, sipas shtetit anëtar dhe si në vijim:

a) për sigurimin jojetë, sipas grupit të klasave, siç përcaktohet në shtojcën V;

b) për sigurimin jetë, sipas secilës prej klasave I deri në IX, siç përcaktohet në shtojcën II;

Për sa i përket klasës 10 në pjesën A të shtojcës I, me përjashtim të përgjegjësisë së transportuesit, shoqëria në fjalë informon autoritetin mbikëqyrës edhe për shpeshtësinë dhe koston mesatare të dëmeve.

Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës e përcjell informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë dhe të dytë, brenda një kohe të arsyeshme dhe në formë të agreguar, tek autoritetet mbikëqyrëse të secilit prej shteteve anëtare, me kërkesë të këtyre të fundit.

SEKSIONI 5

TRAJTIMI I KONTRATAVE TË DEGËVE NË PROCEDURAT E FALIMENTIMIT

Neni 160

Likuidimi i shoqërive të sigurimit

Kur një shoqëri sigurimi hyn në proces likuidimi, angazhimet që lindin nga kontratat e marra në sigurim nëpërmjet një dege ose sipas lirisë për të ofruar shërbime përbushen njësoj si ato që lindin nga kontrata të tjera sigurimi të kësaj shoqërie, pa bërë dallim kombësie për sa u përket personave të siguruar dhe përfituesve.

Neni 161

Likuidimi i shoqërive të risigurimit

Kur një shoqëri risigurimi hyn në proces likuidimi, angazhimet që lindin nga kontratat e marra në risigurim nëpërmjet një dege ose sipas lirisë për të ofruar shërbime përbushen njësoj si ato që lindin nga kontrata të tjera risigurimi të kësaj shoqërie.

KAPITULLI IX

DEGËT E THEMELUARA BRENDË KOMUNITETIT DHE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT OSE RISIGURIMIT ME ZYRA QENDRORE QË NDODHEN JASHTË KOMUNITETIT

SEKSIONI 1

FILLIMI I VEPRIMTARIVE

Neni 162

Parimi dhe kushtet e autorizimit

1. Me anë të një autorizimi shtetet anëtare i japin akses në veprimtaritë e përmendura në nënparagrafin e parë të nenit 2, paragrafi 1, çdo shoqërie që ka zyrën qendrore jashtë Komunitetit.

2. Një shtet anëtarë mund të japë autorizimin kur shoqëria përmbush të paktën kushtet e mëposhtme:

- a) ka të drejtë të zhvillojë veprimtari sigurimi sipas legjislacionit të saj të kombëtar;
- b) themelon një degë në territorin e shtetit anëtar ku kërkohet autorizimi;
- c) merr përsipër të hapë në vendin e menaxhimit të degës llogari specifike për biznesin që zhvillon atje dhe të mbajë aty të gjitha të dhënat në lidhje me veprimtaritë e përfunduara;
- d) emëron një përfaqësues të përgjithshëm që duhet të miratohet nga autoritetet mbikëqyrëse;
- e) zotëron në shtetin anëtar ku kërkohet autorizimi, aktive në një sasi të paktën të barabartë me gjysmën e vlerës dysHEME absolute, të përcaktuar në nenin 129, paragrafi 1, germa "d", për kërkesën për kapital minimal dhe depoziton në formë titujsh një të katërtën e kësaj vlere dysHEME absolute;
- f) merr përsipër të mbulojë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal në përputhje me kërkesat e përmendura në nenet 100 dhe 128;
- g) komunikon emrin dhe adresën e përfaqësuesve të trajtimit të dëmeve të emëruar në çdo shtet anëtar përveç shtetit anëtar në të cilin kërkohet autorizimi nëse rreziqet që do të mbulohen klasifikohen në klasën 10, pjesa A të shtojcës I të kësaj Direktive, përveç përgjegjësisë së transportuesit.
- h) dorëzon një skemë operacionesh në përputhje me dispozitat e nenit 163;
- i) përmbush kërkesat rregullatore që përcaktohen në kapitullin IV, seksioni 2.

3. Për qëllimet e këtij kapitulli, "degë" është një prani e përhershme në territorin e një shteti anëtar për një shoqëri që përmendet në paragrafin 1, e cila merr autorizim në atë shtet anëtar dhe që zhvillon veprimtari sigurimi.

Neni 163

Skema e operacioneve të degës

1. Në skemën e operacioneve të degës, që përmendet në nenin 162, paragrafi 2, germa "h" përcaktohet:

- a) natyra e rreziqeve ose angazhimeve që shoqëria propozon të mbulojë;
- b) parimet udhëzuese për risigurimin;
- c) parashikimet e kërkesës së ardhshme për kapital dhe aftësi paguese, siç parashikohet në kapitullin VI, seksioni 4, mbi bazën e bilancit të parashikuar, si edhe metoda e llogaritjes që është përdorur për të bërë këto parashikime;

d) parashikimet e kërkesës së ardhshme për kapital minimal, siç parashikohet në kapitullin VI, seksioni 5, mbi bazën e bilancit të parashikuar, si edhe metoda e llogaritjes që është përdorur për të bërë këto parashikime;

e) gjendja e fondeve të veta të pranueshme dhe fondeve të veta bazë të pranueshme të shoqërisë në lidhje me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesën për kapital minimal, siç përmendet në kapitullin VI, seksionet 4 dhe 5;

f) parashikimet e kostove për krijimin e shërbimeve administrative dhe organizimin për sigurinë e veprimtarive, burimet financiare që synohen për të mbuluar këto kosto dhe, nëse rreziqet që do të mbulohen klasifikohen në klasën 18 të pjesës A të shtojcës I, burimet e disponueshme për të ofruar asistencën e premtuar;

g) informacionin për strukturën e sistemit rregullator.

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1, skema e operacioneve, për tre vitet e para ushtrimore, përfshin sa më poshtë:

a) një parashikim të bilancit;

b) parashikimet e burimeve financiare që synohen të mbulojnë provigjonet teknike, kërkesën për kapital minimal dhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

c) për sigurimin jo-jetë:

I. parashikimet e shpenzimeve të administrimit përveç kostove të instalimit, në veçanti shpenzimet e përgjithshme dhe komisionet aktuale;

II. parashikimet e primeve ose kontributeve dhe dëmeve;

d) për sigurimin jetë, një plan ku shtjellohen parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtaritë e drejtpërdrejta, marrjet në risigurim dhe cedimet për risigurim.

3. Në lidhje me sigurimin jetë, shtetet anëtare mund t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit që të dorëzojnë një njoftim sistematik të bazave teknike që janë përdorur për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike, duke mos e kthyer këtë kërkesë në kusht paraprak që shoqëria e sigurimit të zhvillojë veprimtarinë e saj.

Neni 164

Transferimi i portofolit

1. Sipas kushteve që përcaktohen në legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare autorizojnë degët e krijuara në territorin e tyre dhe që mbulohen nga ky krye që të transferojnë të gjithë ose një pjesë të portofolave të tyre të kontratave drejt një shoqërie marrëse të themeluar në të njëjtin shtet anëtar, kur autoritetet mbikëqyrëse të këtij shteti anëtar, ose, sipas rastit, të shtetit anëtar që përmendet në nenin 167 vërtetojnë pas marrjes në konsideratë të transferimit shoqëria

marrëse zotëron fonde të veta të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në paragrafin e parë të nenit 100.

2. Sipas kushteve që përcaktohen në legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare autorizojnë degët e krijuara në territorin e tyre dhe që mbulohen nga ky krye që të transferojnë të gjithë ose një pjesë të portofolave të tyre të kontratave drejt një shoqërie sigurimi me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, kur autoritetet mbikëqyrëse të këtij shteti anëtar vërtetojnë pas marrjes në konsideratë të transferimit shoqëria marrëse zotëron fonde të veta të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në paragrafin e parë të nenit 100.

3. Në rastet kur, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm, një shtet anëtar autorizon degët e themeluara brenda territorit të tij dhe që mbulohen nga ky krye që të transferojnë të gjithë ose një pjesë të portofolave të tyre të kontratave drejt një dege që mbulohet nga ky krye dhe që është themeluar brenda territorit të një shteti tjetër anëtar, ai garanton që autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të shoqërisë pritëse, ose, sipas rastit, të shtetit anëtar që përmendet në nenin 167, të vërtetojnë se:

a) pasi merret në konsideratë transferimi shoqëria pritëse zotëron fondet e veta të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese;

b) legjislacioni i shtetit anëtar të shoqërisë pritëse e lejon një transferim të tillë; dhe

c) ai shtet anëtar ka rënë dakord për transferimin.

4. Në rrethanat e përmendura në paragrafët 1 deri në 3, shteti anëtar ku ndodhet dega transferuese autorizon transferimin pasi të ketë marrë miratimin e autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhen rreziqet, ose të shtetit anëtar të angazhimit, kur ky shtet është i ndryshëm nga shteti anëtar në të cilin ndodhet dega transferuese.

5. Autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të konsultuara japin mendimin ose miratimin e tyre për autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës së degës transferuese brenda tre muajve pas marrjes së kërkesës. Mungesa e përgjigjes nga autoritetet e konsultuara brenda kësaj periudhe konsiderohet si mendim mbështetës ose miratim në heshtje.

6. Transferimi i autorizuar në përputhje me paragrafët 1 deri në 5 publikohet siç përcaktohet në legjislacionin e brendshëm të shtetit anëtar ku ndodhet rreziku ose të shtetit anëtar të angazhimit.

Këto transferime bëhen automatikisht të vlefshme kundrejt mbajtësve të policave, personave të siguruar dhe çdo personi që ka të drejta ose detyrime që lindin nga kontratat e transferuara.

Neni 165

Provigjonet teknike

Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive që të krijojnë provigjone teknike të përshtatshme për të mbuluar detyrimet e sigurimit dhe risigurimit që ato kanë marrë përsipër në territoret e tyre, të llogaritura në përputhje me kapitullin VI, seksioni 2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive që të vlerësojnë aktivet dhe pasivet në përputhje me kapitullin VI, seksioni 1 dhe të përcaktojnë fondet e veta në përputhje me kapitullin VI, seksioni 3.

Neni 166

Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesa për kapital minimal

1. Për degët e krijuara në territorin e tij, çdo shtet anëtar kërkon një sasi të fondeve të veta të pranueshme në pajtim me zërat e përmendur në nenin 98, paragrafi 3.

Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese dhe kërkesa për kapital minimal llogaritet në përputhje me dispozitat e kapitullit VI, seksionet 4 dhe 5.

Megjithatë, për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese dhe të kërkesës për kapital minimal, për sigurimin jetë dhe jo-jetë, merren në konsideratë vetëm operacionet që kryhen nga dega në fjalë.

2. Shuma e pranueshme e fondeve të veta bazë që kërkohet për të mbuluar kërkesën për kapital minimal dhe vlera dysheme absolute e kësaj kërkesë për kapital minimal përcaktohen në përputhje me nenin 98, paragrafi 4.

3. Shuma e pranueshme e fondeve të veta bazë nuk duhet të jetë më e ulët se sa gjysma e vlerës dysheme absolute që kërkohet sipas nenit 129, paragrafi 1, germa "d".

Depozita e bërë në përputhje me nenin 162, paragrafi 2, germa "e" llogaritet kundrejt këtyre fondeve të veta bazë të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital minimal.

4. Aktivet që përfaqësojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese mbahen renda shtetit anëtar ku zhvillohen veprimtaritë deri në shumën që mbulon kërkesën për kapital minimal, dhe ato që janë tepër mbahen brenda Komunitetit.

Neni 167

Avantazhet për shoqëritë e autorizuara në më shumë se një shtet anëtar

1. Çdo shoqëri që ka kërkuar ose marrë autorizim nga më shumë se një shtet anëtar mund të aplikojë për avantazhet e mëposhtme, të cilat mund të jepen vetëm bashkërisht:

a) kërkesa për kapital dhe aftësi paguese që përmendet në nenin 166 llogaritet në lidhje me të gjitha veprimtaritë që zhvillohen brenda Komunitetit;

b) depozita që kërkohet sipas nenit 162, paragrafi 2, germa "e" bëhet vetëm në një prej këtyre shteteve anëtare;

c) aktivet që përfaqësojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, sipas nenit 134, vendosen në një prej shteteve anëtare ku shoqëria zhvillon veprimtaritë e saj.

Në rastet që përmenden në germën "a" të nënparagrafit të parë, për qëllimet e kësaj llogaritjeje, merren në konsideratë vetëm operacionet që kryhen nga degët e themeluara brenda Komunitetit.

2. Aplikimi për të përfituar avantazhet e parashikuara në nenin 1 bëhet tek autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare përkatëse. Në aplikim deklarohet autoriteti i shtetit anëtar i cili do të mbikëqyrë aftësinë paguese të të gjitha veprimtarive të degëve të themeluara brenda Komunitetit. Shoqëria duhet të deklarojë arsyet për zgjedhjen e një autoriteti të caktuar.

Depozitat e përmendura në nenin 162, paragrafi 2, germa "e", bëhen në atë shtet anëtar.

3. Avantazhet e parashikuara në paragrafin 1 mund të jepen vetëm kur ato miratohen nga autoritetet e të gjitha shteteve anëtare ku është bërë aplikimi.

Këto avantazhe hyjnë në fuqi që nga koha kur autoriteti mbikëqyrës i përzgjedhur informon autoritetet e tjera mbikëqyrëse se ai do të mbikëqyrë gjendjen e aftësisë paguese për të gjitha veprimtaritë e degëve brenda Komunitetit.

Autoriteti mbikëqyrës që është zgjedhur merr nga shtetet e tjera anëtare informacionin që i nevojitet për të mbikëqyrur aftësinë e përgjithshme paguese të degëve të themeluara në territorin e tyre.

4. Me kërkesë të një ose më shumë shteteve anëtare, avantazhet e dhëna sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 tërhiqen njëkohësisht nga të gjitha shtetet anëtare përkatëse.

Neni 168

Informacioni kontabël, i kujdesshëm dhe statistikor dhe shoqëritë në vështirësi

Për qëllimet e këtij seksioni zbatohet neni 34, neni 139, paragrafi 3 dhe nenet 140 dhe 141.

Për sa i përket zbatimit të neneve 137 deri në 139, kur një shoqëri kualifikohet për avantazhet e parashikuara në nenin 167, paragrafi 1, 2 dhe 3, autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për verifikimin e aftësisë paguese të degëve të themeluara brenda Komunitetit në lidhje me të gjitha veprimtaritë trajtohet në të njëjtën mënyrë si autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar në territorin e të cilit është ngritur zyra qendrore e një shoqërie brenda Komunitetit.

Neni 169

Ndarja e veprimtarive të sigurimit jetë dhe jo-jetë

1. Degët e përmendura në këtë seksion nuk duhet të zhvillojnë njëkohësisht veprimtari sigurimi jetë dhe jojetë në të njëjtin shtet anëtar.

2. Duke shfuqizuar paragrafin 1 shtetet anëtare mund të parashikojnë që degët e përmendura në këtë seksion, të cilat në datën përkatëse që përmendet në nënparagrafin e parë të nenit 73, paragrafi 5, zhvillonin njëkohësisht të dyja veprimtaritë brenda një shteti anëtar mund të vazhdojnë të bëjnë diçka të tillë me kusht që çdo veprimtari të administrohet veçmas në përputhje me nenin 74.

3. Çdo shtet anëtar, i cili sipas nënparagrafit të dytë të nenit 73, paragrafi 5, i kërkon shoqërive të themeluara në territorin e tij që të ndalojë zhvillimin e njëkohshëm të veprimtarive në të cilat kanë qenë të angazhuara në datën përkatëse që përmendet në nënparagrafin e parë të nenit 73, paragrafi 5 duhet gjithashtu që ta vendosin këtë kërkesë edhe për degët e përmendura në këtë seksion, të cilat janë themeluar brenda territorit të tij dhe zhvillojnë njëkohësisht aty të dyja veprimtaritë.

Shtetet anëtare mund të parashikojnë që degët e përmendura në këtë seksion, zyra kryesore e të cilëve zhvillon njëkohësisht të dyja veprimtaritë dhe që në datën e përmendur në nënparagrafin e parë të nenit 73, paragrafi 5 zhvillonte në territorin e një shteti anëtar vetëm veprimtari të sigurimit jetë, mund të vazhdojnë veprimtarinë e tyre atje. Kur shoqëria dëshiron të kryejë veprimtari të sigurimit jo-jetë në atë territor, ajo mund të zhvillojë veprimtari të sigurimit jetë vetëm nëpërmjet një filiali.

Neni 170

Tërheqja e autorizimit për shoqëritë e autorizuara në më shumë se një shtet anëtar

Në rastin e tërheqjes së autorizimit nga autoriteti që përmendet në nenin 167, paragrafi 2, ky autoritet njofton autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera anëtare ku operon shoqëria dhe këto autoritete marrin masat e përshtatshme.

Kur arsyeja për këtë tërheqje është pamjaftueshmëria e aftësisë së përgjithshme paguese, e caktuar nga shtetet anëtare që kanë miratuar kërkesën e përmendur në nenin 167, shtetet anëtare që kanë dhënë miratimin e tyre bëjnë gjithashtu tërheqjen e autorizimeve të tyre.

Neni 171

Marrëveshjet me vende të treta

Në kushte reciprociteti, me qëllim garantimin e mbrojtjes së mjaftueshme për mbajtësit e policave dhe personave të siguruar në shtetet anëtare, Komuniteti, nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura sipas Traktatit me një ose më shumë vende të treta, mund të bjerë dakord për zbatimin e dispozitave të ndryshme nga ato që parashikohen në këtë seksion.

SEKSIONI 2

RISIGURIMI

Neni 172

Ekivalenca

1. Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë kriteret për të vlerësuar nëse regjimi i aftësisë paguese së një vendi të tretë që zbatohet për veprimtaritë e risigurimit të shoqërive me zyrë qendrore në këtë vend të tretë është ekuivalent me regjimin e përcaktuar në titullin 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

2. Në përputhje me procedurën rregullatore që përmendet në nenin 301, paragrafi 2 dhe duke marrë në konsideratë kriteret e miratuara në përputhje me paragrafin 1, Komisioni mund të vendosë nëse regjimi i aftësisë paguese të një vendi të tretë që zbatohet për veprimtaritë e risigurimit të shoqërive me zyrë qendrore në atë vend të tretë është ekuivalente me atë që përcaktohet në titullin 1.

Këto vendime rishikohen rregullisht.

3. Në rastet kur në përputhje me paragrafin 2 regjimi i aftësisë paguese të një vendi të tretë konsiderohet si ekuivalent me atë që përcaktohet në këtë direktivë, kontratat e risigurimit të lidhura me shoqëritë që kanë zyrën kryesore në atë vend të tretë trajtohen në të njëjtën mënyrë si kontratat e risigurimit që lidhen me shoqëritë e autorizuara në përputhje me këtë direktivë.

Neni 173

Ndalimi i barrësimit të aktiveve

Kur risiguresi është një shoqëri sigurimi ose risigurimi e një vendi të tretë, e ndodhur në një vend ku regjimi i aftësisë paguese konsiderohet si ekuivalent me atë që përcaktohet në këtë direktivë, në përputhje me nenin 172, shtetet anëtare, në lidhje me krijimin e provigjoneve teknike nuk vendosin ose nuk kërkojnë krijimin e një sistemi me rezerva bruto, i cili kërkon barrësimin e aktiveve për të mbuluar provigjonet për primet e pafituara ose dëmet e papaguara.

Neni 174

Parimi dhe kushtet për kryerjen e veprimtarisë së risigurimit

Shtetet anëtare, për shoqëritë e risigurimit në vendet e treta që fillojnë ose zhvillojnë veprimtari risigurimi në territorin e tij, nuk zbatojnë dispozita të cilat rezultojnë në një trajtim më të favorshëm se sa ai që u bëhet shoqërive të risigurimit, të cilat kanë zyrën qendrore në atë shtet anëtar.

Neni 175

Marrëveshjet me vende të treta

1. Komisioni mund t'i dorëzojë Këshillit propozime për negocimin e marrëveshjeve me një ose më shumë vende të treta në lidhje me mjetet për ushtrimin e mbikëqyrjes për sa më poshtë:

a) shoqëritë e risigurimit të vendeve të treta, të cilat kryejnë veprimtari risigurimi në Komunitet;

b) shoqëritë e risigurimit të Komunitetit, të cilat kryejnë veprimtari risigurimi në territorin e një vendi të tretë.

2. Marrëveshjet që përmenden në paragrafin 1 kërkojnë në veçanti të garantojnë, sipas kushteve të ekuivalencës së rregullimit të kujdesshëm, qasje efektive në treg për shoqëritë e risigurimit në territorin e secilës palë kontraktore dhe të parashikojnë njohjen e ndërsjellë të rregullave dhe praktikave mbikëqyrëse për risigurimet. Ata gjithashtu kërkojnë që të garantojnë si më poshtë:

a) që autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen e shoqërive të risigurimit që kanë zyrat kryesore në Komunitet dhe zhvillojnë veprimtari në territorin e vendit të tretë në fjalë;

b) që autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen e shoqërive të risigurimit që kanë zyrat kryesore brenda territorit të tyre dhe zhvillojnë veprimtari në Komunitet.

3. Pa cenuar nenin 300, paragrafi 1 dhe 2 të Traktatit, Komisioni, me ndihmën e Komitetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve, shqyrton rezultatin e negociatave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe situatën pasuese.

KAPITULLI X

FILIALET E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT QË RREGULLOHEN NGA LIGJET E NJË VENDI TË TRETË OSE BLERJA E PJESËMARRJEVE NGA KËTO SHOQËRI

Neni 176

Informacioni nga shtetet anëtare për Komisionin

Autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare informojnë Komisionin dhe autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera anëtare për çdo autorizimi të një filiali direkt ose indirekt, shoqëritë mëmë të së cilëve rregullohen nga ligjet e një vendi të tretë.

Ky informacion tregon edhe strukturën e grupit përkatës.

Kur një shoqëri që rregullohet nga legjislacioni i një vendi të tretë blen një pjesëmarrje në një shoqëri sigurimi ose risigurimi të autorizuar në Komunitet, gjë e cila e kthen këtë shoqëri sigurimi ose risigurimi në një filial të asaj shoqërie të vendit të tretë, autoritetet mbikëqyrëse të

shtetit anëtar të origjinës informojnë Komisionin dhe autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera anëtare.

Neni 177

Trajtimi i shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit të Komunitetit nga vendet e treta

1. Shtetet anëtare informojnë Komisionin për çdo vështirësi të përgjithshme që hasin shoqëritë e tyre të sigurimit ose risigurimit për të hapur degë dhe për të operuar në një vend të tretë ose për të zhvilluar veprimtari në një vend të tretë.

2. Komisioni i dorëzon Këshillit një raport periodik ku shqyrtohet trajtimi që i bëhet një vendet e treta shoqërive të sigurimit ose të risigurimit të autorizuar në Komunitet, për aspektet e mëposhtme:

a) themelimin në vendet e treta të shoqërive të sigurimit ose të risigurimit të autorizuar në Komunitet;

b) blerjen e pjesëmarrjeve në shoqëritë e sigurimit ose risigurimit të vendeve të treta;

c) zhvillimin e veprimtarive të risigurimit ose risigurimit nga këto shoqëri të themeluara;

d) ofrimin ndërkufitar të veprimtarive të sigurimit ose risigurimit nga Komuniteti drejt vendeve të treta.

Komisioni ia dorëzon këto raporte Këshillit së bashku me propozimet ose rekomandimet përkatëse.

TITULLI II

DISPOZITA SPECIFIKE PËR SIGURIMET DHE RISIGURIMET

KAPITULLI I

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE KUSHTET E KONTRATAVE TË SIGURIMIT TË DREJTPËRDREJTË

SEKSIONI 1

LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 178

Ligji i zbatueshëm

Çdo shtet anëtar që nuk i nënshtrohet zbatimit të Rregullores (KE) nr. 593/2008 zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit që përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI 2

SIGURIMI I DETYRUESHËM

Neni 179

Detyrimet përkatëse

1. Shoqëritë e sigurimit jojetë mund të ofrojnë dhe të lidhin kontrata sigurimi të detyrueshëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Kur një shtet anëtar vendos një detyrim për të marrë sigurim, kontrata e sigurimit nuk e përmbush këtë detyrim nëse nuk është në pajtim me dispozitat specifike në lidhje me sigurimin e përcaktuar nga ai shtet anëtar.

3. Kur një shtet anëtar vendos një sigurim të detyrueshëm dhe shoqërisë së sigurimit i kërkohet që të njoftojë autoritetet mbikëqyrëse për çdo përfundim të mbulimit, ky përfundim mund të përdoret kundër palëve të treta të dëmtuara vetëm në rrethanat e përcaktuara nga ky shtet anëtar.

4. Çdo shtet anëtar i komunikon Komisionit rreziqet kundër të cilëve legjislacioni i tij parashikon sigurim të detyrueshëm, duke deklaruar:

a) dispozitat ligjore specifike në lidhje me këtë sigurim;

b) veçantitë që duhet të përfshihen në certifikatën që duhet të lëshojë shoqëria e sigurimit jo-jetë për personin e siguruar kur ky shtet anëtar kërkon prova se është përmbushur detyrimi për të marrë sigurim.

Një shtet anëtar mund të kërkojë që veçantitë e përmendura në germën "b" të nënparagrafit të parë të përfshijnë një deklaratë nga shoqëria e sigurimit që vërteton se kontrata përmbush dispozitat specifike që lidhen me këtë sigurim.

Komisioni i publikon veçantitë e përmendura në germën "b" të nënparagrafit të parë në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

SEKSIONI 3

E MIRA E PËRGJITHSHME

Neni 180

E mira e përgjithshme

As shteti anëtar ku ndodhet një rrezik dhe as shteti anëtar i angazhimit nuk e pengojnë një mbajtës të policës që të lidhë një kontratë me një shoqëri sigurimi të autorizuar sipas kushteve të nenit 14 për sa kohë që lidhja e kësaj kontrate nuk bie në kundërshtim me dispozitat ligjore që mbrojnë të mirën e përgjithshme në shtetin anëtar ku ndodhet rreziku ose në shtetin anëtar të angazhimit.

SEKSIONI 4

KUSHTET E KONTRATAVE TË SIGURIMIT DHE NIVELET E PRIMEVE

Neni 181

Sigurimi jojetë

1. Shtetet anëtare nuk kërkojnë miratimin paraprak ose njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policës, të niveleve të primeve, ose të formularëve dhe dokumenteve të tjera të printuara që një shoqëri sigurimi synon të përdorë gjatë marrëdhënieve me mbajtësit e policave.

Shtetet anëtare mund të kërkojnë njoftimin josistematik të këtyre kushteve të policës dhe dokumenteve të tjera me qëllim që të verifikohet pajtueshmëria me dispozitat kombëtare në lidhje me kontratat e sigurimit. Këto kërkesa nuk përbëjnë një kusht paraprak për zhvillimin e veprimtarive nga një shoqëri sigurimi.

2. Një shtet anëtar që e bën sigurimin të detyrueshëm mund t'u kërkojë shoqërive të sigurimit që t'i komunikojnë autoritetit të tyre mbikëqyrës kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të këtij sigurimi para se ta hedhë atë në qarkullim.

3. Shtetet anëtare nuk kërkojnë apo të prezantojnë detyrimin e njoftimit paraprak ose miratimit paraprak të rritjeve të propozuara të niveleve të primit, përveç se si pjesë e sistemeve të përgjithshme për kontrollin e çmimit.

Neni 182

Sigurimi jetë

Shtetet anëtare nuk kërkojnë miratimin paraprak ose njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policës, të niveleve të primeve, të bazave teknike që përdoren në veçanti për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike, ose të formularëve dhe dokumenteve të tjera të printuara që një shoqëri sigurimi jete synon të përdorë gjatë marrëdhënieve me mbajtësit e policave.

Megjithatë, vetëm me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë me dispozitat kombëtare në lidhje me parimet aktuaristike, shteti anëtar i origjinës mund të kërkojë komunikimin sistematik të bazave teknike që përdoren veçanërisht për të llogaritur nivelet e primeve dhe provigjonet teknike. Këto kërkesa nuk përbëjnë një kusht paraprak për zhvillimin e veprimtarive nga një shoqëri sigurimi.

SEKSIONI 5
INFORMACION PËR MBAJTËSIT E POLICAVE
NËNSEKSIONI 1
SIGURIMI JOJETË

Neni 183

Informacion i përgjithshëm për mbajtësit e policave

1. Përpara se të lidhë një kontratë të sigurimit jojetë, shoqëria e sigurimit jo-jetë informon mbajtësin e policës për sa më poshtë:

- a) ligjin e zbatueshëm për kontratën, kur palët nuk janë të lira për të zgjedhur;
- b) faktin që palët janë të lira për të zgjedhur ligjin e zbatueshëm dhe ligjin që siguroesi propozon që të zgjedhë.

Shoqëria e sigurimit gjithashtu informon mbajtësin e policës për marrëveshjet për trajtimin e ankesave të mbajtësve të policave në lidhje me kontratat, duke përfshirë, sipas rastit, ekzistencën e një organi për ankesat, pa cenuar të drejtën e mbajtësit të policës për të nisur procedura ligjore.

2. Detyrimet e përmendura në paragrafin 1 zbatohen vetëm kur mbajtësi i policës është person fizik.

3. Rregullat e detajuara për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 përcaktohen nga shteti anëtar në të cilin ndodhet rreziku.

Neni 184

Informacioni shtesë në rastin e sigurimit jojetë i ofruar sipas të drejtës së themelimit ose lirisë për të ofruar shërbime.

1. Kur sigurimi jojetë ofrohet në zbatim të së drejtës së themelimit ose lirisë për të ofruar shërbime, mbajtësi i policës, përpara se të marrë ndonjë angazhim, informohet për shtetin anëtar ku ndodhet zyra kryesore ose, sipas rastit, dega me të cilën do të lidhet kontrata.

Çdo dokument i lëshuar për mbajtësin e policës duhet të përmbajë informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë.

Detyrimet e vendosura në nënparagrafin e parë dhe të dytë nuk zbatohen për rreziqet e mëdha.

2. Kontrata ose çdo dokument tjetër që ofron mbulim, së bashku me propozimin e sigurimit kur ai është detyruar për mbajtësin e policës, deklarojnë adresën e zyrës kryesore ose, sipas rastit, të degës së shoqërisë së sigurimit jo-jetë që ofron mbulimin.

Shtetet anëtare mund të kërkojnë që emri dhe adresa e përfaqësuesit të shoqërisë së sigurimit jo-jetë që përmendet në nenin 148, paragrafi 2, germa "a" të përmenden në dokumentin e përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

NËNSEKSIONI 2

SIGURIMI JETË

Neni 185

Informacion për mbajtësit e policave

1. Përpara se të lidhet kontrata e sigurimit të jetës, mbajtësit të policës i komunikohet të paktën informacioni i përmendur në paragrafët 2 deri në 4.

2. Atij i komunikohet informacioni i mëposhtëm për shoqërinë e sigurimit jetë:

a) emri i shoqërisë dhe forma e saj ligjore;

b) emri i shtetit anëtar ku ndodhet zyra kryesore dhe, sipas rastit, dega me të cilën lidhet kontrata;

c) adresa e zyrës kryesore dhe, sipas rastit, e degës me të cilën lidhet kontrata;

d) një referencë konkrete për raportin për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare, siç përcaktohet në nenin 51, e cila i jep mbajtësit të policës qasje të lehtë në këtë informacion.

3. Në lidhje me angazhimin komunikohet informacioni i mëposhtëm:

a) përkufizimi i çdo përfitimi dhe çdo opsioni;

b) kohëzgjatja e kontratës;

c) mënyrat e ndërprerjes së kontratës;

d) mënyrat e pagesës së primeve dhe kohëzgjatja e pagesave;

e) mënyrat e llogaritjes dhe shpërndarjes së bonuseve;

f) informacion për heqjen dorë nga polica e sigurimit dhe vlerat e paguara dhe masën deri në të cilën ato garantohen;

g) informacion për primet për çdo përfitim, si përfitimet kryesore edhe ato plotësuese, sipas rastit;

- h) për policat e lidhura me njësitë, përkufizimi i njësive me të cilat lidhen përfitimet;
- i) një informacion për natyrën e aktiveve mbështetëse për politikat e lidhura me njësitë;
- j) masat për zbatimin e periudhës transitore;
- k) informacion i përgjithshëm për procedurat tatimore që zbatohen për llojin e policës;

l) procedurat për trajtimin e ankesave në lidhje me kontratat nga mbajtësit e policave, personat që kanë siguruar jetën ose përfituesit e kontratave, duke përfshirë, sipas rastit, ekzistencën e një organi për ankesat, pa cenuar të drejtën për të nisur procedura ligjore;

m) ligji i zbatueshëm për kontratën kur palët nuk janë të lira për të zgjedhur, ose kur palët janë të lira të zgjedhin ligjin e zbatueshëm, ligjin që shoqëria e sigurimit jetë propozon që të zgjedhë.

4. Gjithashtu, ofrohet informacion specifik në mënyrë që të kuptohen mirë rreziqet e kontratës të cilat merren përsipër nga mbajtësi i policës.

5. Mbajtësi i policës mbahet i informuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për çdo ndryshim në lidhje me informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policës;
- b) emrin e shoqërisë së sigurimit jetë, formën e saj ligjore ose adresën e zyrës së saj kryesore dhe, sipas rastit, të degës me të cilën është lidhur kontrata;
- c) të gjithë informacionin e paraqitur në geramat "d" deri në "j" të paragrafit 3 në rast ndryshimi të kushteve të policës ose ndryshimi të ligjit të zbatueshëm për kontratën;
- d) çdo vit, informacionin për gjendjen e bonuseve.

Kur në lidhje me një ofertë ose me lidhjen e një kontrate të sigurimit të jetës, siguruesi ofron shifra për sasinë e pagesave të mundshme që tejkalojnë pagesat e rëna dakord me kontratë, siguruesi i jep mbajtësit të policës një kopje të llogaritjes sipas të cilës është përcaktuar maturimi i pagesës së mundshme duke zbatuar bazën për llogaritjen e primit duke përdorur tre norma të ndryshme interesi. Kjo nuk zbatohet për sigurimet dhe kontratat me afat. Siguruesi informon mbajtësin e policës në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme se kopja e llogaritjes është vetëm një model llogaritjeje bazuar në supozime konceptuale dhe se mbajtësi i policës nuk duhet të ngrejë asnjë pretendim kontraktual për shkak të kopjes së llogaritjes.

Në rastin e sigurimeve me pjesëmarrje në fitim, siguruesi njofton çdo vit me shkrim mbajtësin e policës për gjendjen e dëmeve të mbajtësit të policës, duke përfshirë pjesëmarrjen në fitim. Gjithashtu, kur siguruesi ka ofruar shifra për zhvillimin e mundshëm të pjesëmarrjes në fitim në të ardhmen, siguruesi informon mbajtësin e policës për ndryshimet ndërmjet zhvillimit real dhe të dhënave fillestare.

6. Informacioni i përmendur në paragrafët 2 deri në 5 jepet në një mënyrë të qartë dhe të saktë, me shkrim, në një gjuhë zyrtare të shtetit anëtar të angazhimit.

Megjithatë, ky informacion mund të jetë në një gjuhë tjetër nëse kjo kërkohet nga mbajtësi i policës dhe lejohet nga legjislacioni i shtetit anëtar ose nëse mbajtësi i policës ka lirinë të zgjedhë ligjin e zbatueshëm.

7. Shteti anëtar i angazhimit mund t'u kërkojë shoqërive të sigurimit jetë që të japin informacione të tjera përveç atyre që paraqiten në paragrafët 2 deri në 5 vetëm nëse kjo nevojitet që mbajtësi i policës të kuptojë siç duhet elementet thelbësore të angazhimit.

8. Rregullat e detajuara për zbatimin e paragrafëve 1 deri në 7 përcaktohen nga shteti anëtar i angazhimit.

Neni 186

Periudha e anulimit

1. Për mbajtësit e policave që lidhin kontrata individuale për sigurimin e jetës, shtetet anëtare parashikojnë një periudhë nga 14 deri në 30 ditë nga koha kur ata janë njoftuar se kontrata është lidhur, brenda së cilës ata mund të anulojnë kontratën.

Njoftimi i anulimit nga mbajtësit e policave ka fuqinë që t'i çlirojë ata nga çdo detyrim i ardhshëm që lind nga kontrata.

Fuqitë e tjera ligjore dhe kushtet e anulimit përcaktohen nga ligji i zbatueshëm për kontratën, kryesisht në lidhje me marrëveshjet për të informuar mbajtësin e policës për lidhjen e kontratës.

2. Në rastet e mëposhtme shtetet anëtare mund të zgjedhin të mos e zbatojnë paragrafin 1:

a) kur kontrata zgjat gjashtë muaj ose më pak;

b) kur, për shkak të statusit të mbajtësit të policës ose rrethanave në të cilat lidhet kontrata, mbajtësi i policës nuk ka nevojë për mbrojtje të veçantë.

Kur shtetet anëtare shfrytëzojnë opsionin e përcaktuar në nënparagrafin e parë ata e specifikojnë këtë fakt në legjislacionin e tyre.

KAPITULLI II

DISPOZITA SPECIFIKE PËR SIGURIMIN JO-JETË

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 187

Kushtet e policës

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policës nuk përfshijnë asnjë kusht që synon të përmbushë, në një rast individual, karakteristikat e veçanta të rrezikut që duhet të mbulohet.

Neni 188

Shfuqizimi i monopoleve

Shtetet anëtare sigurohen që monopolet për fillimin e veprimtarive në klasa të caktuara të sigurimit, që i janë dhënë organeve të themeluara brenda territorit të tyre dhe që përmenden në nenin 8, të shfuqizohen.

Neni 189

Pjesëmarrja në skemat kombëtare të garancisë

Shtetet anëtare pritëse mund t'u kërkojnë shoqërive të sigurimit jo-jetë që t'i bashkohen dhe të marrin pjesë, me të njëjtat kushte si shoqëritë e sigurimit jo-jetë të autorizuara në territoret e tyre, në çdo skemë të projektuar për të garantuar pagesën e dëmeve të siguruar për personat e siguruar dhe palët e treta të dëmtuara.

SEKSIONI 2

BASHKËSIGURIMI KOMUNITAR

Neni 190

Operacionet e bashkësigurimit Komunitar

1. Ky seksion zbatohet për operacionet e bashkë-sigurimit Komunitar që janë ato operacione bashkësigurimi që lidhen me një ose më shumë rreziqe që klasifikohen në klasën 3 deri në 16 në pjesën A të shtojcës I dhe që përmbushin kushtet si më poshtë:

a) rreziku është i madh;

b) rreziku mbulohet nga një kontratë e vetme me një prim të përgjithshëm për të njëjtën periudhë nga dy ose më shumë shoqëri sigurimi, secila për pjesën e saj si bashkë-sigures, ku njëra prej tyre është shoqëria kryesuese e sigurimit;

c) rreziku ndodhet brenda Komunitetit;

d) me qëllim mbulimin e rrezikut, shoqëria kryesuese e sigurimit trajtohet si të ishte shoqëri sigurimi që mbulon të gjithë rrezikun;

e) të paktën një prej bashkësiguresve merr pjesë në kontratë nëpërmjet zyrës qendrore ose një dege të themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i shoqërisë kryesuese të sigurimit;

f) shoqëria kryesuese e sigurimit merr përsipër plotësisht rolin e drejtuesit në praktikën e bashkë-sigurimit dhe në veçanti përcakton kushtet e sigurimit dhe vlerësimin.

2. Nenet 147 deri në 152 zbatohen vetëm për shoqërinë kryesuese të sigurimit.

3. Operacionet e bashkë-sigurimit që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 mbeten objekt i dispozitave të kësaj direktive, me përjashtim të këtij seksioni.

Neni 191

Pjesëmarrja në bashkë-sigurimin Komunitar

E drejta e shoqërive të sigurimit për pjesëmarrje në bashkë-sigurimin Komunitar nuk është objekt i asnjë dispozite, përveç dispozitave të këtij seksioni.

Neni 192

Provigjonet teknike

Sasia e provigjoneve teknike përcaktohet nga bashkë-sigurues të ndryshëm sipas rregullave të përcaktuara nga shteti anëtar i origjinës së tyre ose, në mungesë të këtyre rregullave, sipas praktikës së zakonshme në atë shtet.

Megjithatë, provigjonet teknike duhet të jenë të paktën të barabarta me ato që janë përcaktuar nga siguruesi kryesues sipas rregullave të shtetit anëtar të origjinës së tij.

Neni 193

Të dhënat statistikore

Shtetet anëtare të origjinës garantojnë që bashkë-siguruesit të mbajnë të dhënat statistikore që tregojnë masën e operacioneve të bashkësigurimit Komunitar ku ata marrin pjesë dhe shtetet anëtare përkatëse.

Neni 194

Trajtimi i kontratave të bashkë-sigurimit në procedurat e likuidimit

Në rast likuidimi të një shoqërie sigurimi, detyrimet që lindin nga pjesëmarrja në kontrata të bashkë sigurimit komunitar përmbushen njësoj si ata që lindin nga kontrata të tjera sigurimi të kësaj shoqërie pa bërë dallim ndërmjet kombësisë së të siguruarve dhe përfituesve.

Neni 195

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse

Me qëllim zbatimin e këtij seksioni, autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare, në kuadër të bashkëpunimit të përmendur në titullin I, kapitulli IV, seksioni 5, i japin njëri-tjetrit të gjithë informacionin e nevojshëm.

Neni 196

Bashkëpunimi për zbatimin

Komisioni dhe autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtë me qëllim shqyrtimin e çdo vështirësie që mund të lindë në zbatimin e këtij seksioni.

Gjatë këtij bashkëpunimi ata shqyrtojnë në veçanti çdo praktikë që mund të tregojë se shoqëria kryesuese e sigurimit nuk merr rolin e kryesuesit në një praktikë bashkë-sigurimi ose se rreziqet nuk kërkojnë qartësisht pjesëmarrjen e dy ose më shumë siguruesve për mbulimin e tyre.

SEKSIONI 3

ASISTENCA

Neni 197

Veprimtaritë e ngjashme me mbështetjen e turistëve

Shtetet anëtare mund të parashikojnë mbështetjen e personave që hasin vështirësi në rrethana të ndryshme nga ato që përmenden në nenin 2, paragrafi 2 sipas kësaj direktive.

Kur një shtet anëtar e parashikon diçka të tillë, këtë veprimtari ai e trajton sikur të klasifikohen në klasën 18 në pjesën A të shtojcës I.

Paragrafi i dytë nuk ndikon në asnjë lloj mënyre mundësitë për klasifikimin e përcaktuar në shtojcën I për veprimtaritë të cilat përfshihen qartësisht në klasa të tjera.

SEKSIONI 4

SIGURIMI I SHPENZIMEVE LIGJORE

Neni 198

Fusha e zbatimit të këtij seksioni

1. Ky seksion zbatohet për sigurimin e shpenzimeve ligjore, që përmenden në klasën 17 në pjesën A të shtojcës I, me anë të së cilit shoqëria e sigurimit premtion, kundrejt pagesës së një primi, që të mbulojë kostot e procedurave ligjore dhe që të ofrojë shërbime të tjera që lidhen drejtpërsëdrejti me mbulimin me sigurim, në veçanti me qëllim:

a) për të siguruar kompensimin për humbjen, dëmtimin ose lëndimin e pësuar nga personi i siguruar, nëpërmjet marrëveshjeve jashtë gjykate ose nëpërmjet procedurave civile ose penale;

b) për të mbrojtur ose përfaqësuar personin e siguruar në procedura civile, penale, administrative ose të tjera ose në lidhje me çdo pretendim të ngritur kundër atij personi.

2. Ky seksion nuk zbatohet për:

a) sigurimin e shpenzimeve ligjore kur ky sigurim ka të bëjë me mosmarrëveshjet ose rreziqet që lindin nga ose në lidhje me përdorimin e mjeteve të lundrimit.

b) veprimtaritë që zhvillohen nga një shoqëri sigurimi që ofron mbulim të përgjegjësive civile me qëllim mbrojtjen ose përfaqësimin e personit të siguruar për çdo ankesë ose procedurë për rastet kur kjo veprimtari zhvillohet njëkohësisht edhe në interes të vetë shoqërisë së sigurimit;

c) me vendim të një shteti anëtar, për veprimtarinë e sigurimit të shpenzimeve ligjore që ndërmerret nga një sigures mbështetës që vepron në pajtim me kushtet e mëposhtme:

I. veprimtaria zhvillohet në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai ku personi i siguruar banon zakonisht;

II. veprimtaria është pjesë e një kontrate që mbulon vetëm asistencën që u jepet personave që hasin vështirësi gjatë udhëtimit, gjatë kohës që janë larg shtëpisë ose vendbanimit të tyre të zakonshëm.

Për qëllimet e germës "c" të nënparagrafit të parë, në kontratë deklarohet qartësisht se mbulimi në fjalë kufizohet vetëm për rrethanat që përmenden në atë germë dhe është në funksion të asistencës.

Neni 199

Kontratat e ndara

Mbulimi i shpenzimeve ligjore është objekt i një kontrate të ndarë nga ajo e lidhur për klasa të tjera të sigurimit ose trajtohet në një seksion të veçantë të një police të vetme ku specifikohet natyra e mbulimit të shpenzimeve, dhe kur e kërkon shteti anëtar, shuma e primit përkatës.

Neni 200

Trajtimi i dëmeve

1. Shteti anëtar i origjinës sigurohet që shoqëritë e sigurimit të miratojnë, në përputhje me opsionin e zgjedhur nga shteti anëtar, ose me zgjedhjen e tyre, kur shteti anëtar bie dakord, të paktën një prej metodave për trajtimin e dëmeve, të cilat përcaktohen në paragrafët 2, 3 dhe 4.

Cilado zgjidhje që të miratohet, interesi i personave për të cilët mbulohe shpenzimet ligjore konsiderohen si të mbrojtur në një mënyrë ekuivalente sipas këtij seksioni.

2. Shoqëritë e sigurimit sigurohen që asnjë anëtar i stafit që ka lidhje me trajtimin e dëmeve për shpenzimet ligjore ose me këshillimin ligjor në lidhje me këto dëme të mos zhvillojë njëkohësisht një veprimtari të ngjashme në një shoqëri tjetër që ka lidhje financiare, tregtare ose

administrative me shoqërinë e parë të sigurimit që ndërmerr ose zhvillon një ose më shumë klasa të tjera sigurimi, që përcaktohen në shtojcën I.

Shoqëritë e përbëra të sigurimit sigurohen që asnjë anëtar i stafit që ka lidhje me trajtimin e dëmeve për shpenzimet ligjore ose me këshillimin ligjor në lidhje me këto dëme të mos zhvillojë njëkohësisht një veprimtari të ngjashme për një klasë tjetër sigurimi që ofrojnë këto shoqëri.

3. Shoqëria e sigurimit ia beson trajtimin e dëmeve në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore një shoqërie që ka personalitet juridik të veçantë. Kjo shoqëri përmendet në një kontratë të veçantë ose në një seksion të veçantë që përmendet në nenin 199.

Kur shoqëria me personalitet juridik të veçantë ka lidhje me një shoqëri sigurimi që kryen një ose më shumë klasa sigurimi që përmenden në pjesën A të shtojcës I, anëtarët e stafit të shoqërisë me personalitet juridik të veçantë të cilët merren me trajtimin e dëmeve ose me këshillimin ligjor në lidhje me këtë trajtim nuk duhet të zhvillojnë njëkohësisht një veprimtari të njëjtë ose të ngjashme në një shoqëri sigurimi tjetër. Shtetet anëtare mund të vendosin të njëjtat kërkesa për anëtarët e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës.

4. Kontrata parashikon që personat e siguruar të mund të udhëzojnë një avokat që e zgjedhin vetë, ose deri në masën që e lejon legjislacioni i brendshëm, çdo person tjetër të kualifikuar, që nga momenti që këta persona të siguruar kanë ndonjë pretendim për këtë kontratë.

Neni 201

Liria për të zgjedhur avokatin

1. Çdo kontratë për sigurimin e shpenzimeve ligjore duhet të parashikojë shprehimisht se:

a) në rastet kur është e nevojshme t'i drejtohet një avokati ose një personi tjetër të kualifikuar sipas legjislacionit të brendshëm me qëllim që ky avokat ose person tjetër të mbrojë, përfaqësojë ose të shërbejë në interes të personit të siguruar për çdo ankesë ose procedurë, ky person i siguruar është i lirë që të zgjedhë këtë avokat ose person tjetër.

b) personat e siguruar janë të lirë të zgjedhin një avokat, ose, në rastet kur ata preferojnë dhe deri në masën e lejuar nga legjislacioni i brendshëm, çdo person tjetër që ka kualifikimin e duhur, për të shërbyer në interesat e tyre sa herë që lind një konflikt interesi.

2. Për qëllimet e këtij seksioni, "avokat" është çdo person që ka të drejtën të zhvillojë veprimtaritë e tij profesionale sipas një prej emërtimeve që përcaktohen në Direktivën e Këshillit 77/249/KEE, datë 22 mars 1977, "Për lehtësimin e ushtrimit efektiv të lirisë së avokatëve për të ofruar shërbime".

Neni 202

Përrjashtim nga liria për të zgjedhur avokatin

1. Shtetet anëtare mund të parashikojnë përjashtim nga neni 201, paragrafi 1, për sigurimin e shpenzimeve ligjore nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) sigurimi kufizohet me rastet që lindin nga përdorimi i automjeteve në territorin e shtetit anëtar në fjalë;

b) sigurimi lidhet me kontratën për të ofruar asistencë në rast aksidenti ose defekti që përfshin një automjet;

c) as shoqëria e sigurimit që mbulon shpenzimet ligjore dhe as siguruesi që ofron asistencën nuk zhvillojnë asnjë klasë të sigurimit të përgjegjësive;

d) merren masa që këshillimi ligjor dhe përfaqësimi i secilës prej palëve në një mosmarrëveshje të kryhet nga avokatë krejtësisht të pavarur kur palët janë të siguruara për shpenzimet ligjore nga e njëjta shoqëri sigurimi.

2. Përjashtimi i bërë sipas paragrafit 1 nuk ndikon në zbatimin e nenit 200.

Neni 203

Arbitrazhi

Për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet shoqërisë së sigurimit të shpenzimeve ligjore dhe personit të siguruar dhe pa cenuar asnjë të drejtë apelimi përpara një organi gjyqësor, e drejtë e cila mund të parashikohet nga legjislacioni i brendshëm, shtetet anëtare parashikojnë procedura arbitrazhi ose të tjera të cilat ofrojnë garanci të krahasueshme objektiviteti.

Kontrata e sigurimit parashikon të drejtën e personit të siguruar për të shfrytëzuar procedura të tilla.

Neni 204

Konflikti i interesit

Sa herë që lind një konflikt interesi ose nuk bihet dakord për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, siguruesi i shpenzimeve ligjore, ose, sipas rastit, zyra për trajtimin e dëmeve informon personin e siguruar për të drejtën që përmendet në nenin 201, paragrafi 1 dhe për mundësinë e përdorimit të procedurës që përmendet në nenin 203.

Neni 205

Shfuqizimi i specializimit të sigurimit të shpenzimeve ligjore

Shtetet anëtare shfuqizojnë të gjitha dispozitat të cilat i ndalojnë një shoqërie sigurimi që të ofrojnë njëkohësisht brenda territorit të tyre sigurim të shpenzimeve ligjore dhe klasa të tjera sigurimi.

SEKSIONI 5

SIGURIMI I SHËNDETIT

Neni 206

Sigurimi i shëndetit si alternativë e sigurimeve shoqërore

1. Shtetet anëtare në të cilat kontratat që mbulojnë rreziqet e klasës 2 në pjesën A të shtojcës I mund të shërbejnë si alternativë e pjesshme ose e plotë për sigurimin e shëndetit që ofrohet nga sistemi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore mund të kërkojnë që:

a) këto kontrata të jenë në pajtim me dispozitat ligjore specifike të miratuara nga ai shtet anëtar për të mbrojtur të mirën e përgjithshme për atë klasë sigurimi;

b) kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të atij sigurimi t'i komunikohen autoriteteve mbikëqyrëse të atij shteti anëtar përpara se të përdoren.

2. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që sistemi i sigurimit të shëndetit që përmendet në paragrafin 1 të funksionojë mbi një bazë teknike të ngjashme me sigurimin e jetës, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) primet e paguara llogariten mbi bazën e tabelave të sëmundjes dhe të dhënave të tjera statistikore të shtetit anëtar ku ndodhet rreziku në përputhje me metodat matematikore që përdoren në fushën e sigurimeve;

b) krijohet një rezervë për moshën në rritje;

c) siguruesi mund të anulojë kontratën vetëm brenda një periudhe fikse të përcaktuar nga shteti anëtar ku ndodhet rreziku;

d) kontrata parashikon që primet mund të rriten ose pagesat mund të ulen, edhe për kontratat aktuale;

e) kontrata parashikon që mbajtësit e policës mund të ndryshojnë kontratën ekzistuese dhe të bëjnë një kontratë të re në përputhje me paragrafin 1, me të njëjtën shoqëri sigurimi ose me të njëjtën degë dhe duke marrë në konsideratë të drejtat që ata kanë fituar.

Në rastin e përmendur në germën "e" të nënparagrafit të parë merren parasysh rezervat për moshën në rritje dhe mund të kërkohet një ekzaminim i ri mjekësor vetëm për këtë mbulim të rritur.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar përkatës publikojnë tabelat e sëmundjes dhe të dhënat e tjera statistikore që përmenden në germën "a" të nënparagrafit të parë dhe ia transmetojnë ato autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës.

Primet duhet të jenë të mjaftueshme, sipas supozimeve të arsyeshme aktuaristike, në mënyrë që shoqëritë e sigurimit të arrijnë të përmbushin angazhimet e tyre duke marrë në

konsideratë të gjitha aspektet e gjendjes së tyre financiare. Shteti anëtar i origjinës kërkon që përpara se produkti të hidhet në qarkullim, autoriteteve të tij mbikëqyrëse t'i komunikohet baza teknike mbi të cilën janë llogaritur primet.

Në rastet e modifikimit të kontratave zbatohen edhe nënparagrafi i tretë dhe i katërt.

SEKSIONI 6

SIGURIMI NGA AKSIDENTET NË PUNË

Neni 207

Sigurimi i detyrueshëm nga aksidentet në punë

Shtetet anëtare mund të kërkojnë që çdo shoqëri sigurimi e cila, me rrezikun e vet, ofron sigurim të detyrueshëm nga aksidentet në punë brenda territoreve të tyre të veprojë në pajtim me dispozitat specifike të legjislacionit të tyre të brendshëm në lidhje me këtë sigurim, përveç dispozitave në lidhje me mbikëqyrjen financiare, e cila është përgjegjësi ekskluzive e shtetit anëtar të origjinës.

KAPITULLI III

DISPOZITA SPECIFIKE PËR SIGURIMIN E JETËS

Neni 208

Ndalimi i cedimit të detyrueshëm të një pjese të rrezikut të marrë në sigurim

Shtetet anëtare nuk duhet t'i kërkojnë shoqërive të sigurimit jetë që të cedojnë një pjesë të veprimtarive të marrjes në sigurim që radhiten në nenin 2, paragrafi 3 drejt një organizate ose drejt organizatave të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Neni 209

Primet për biznesin e ri

Primet për biznes të ri duhet të jenë të mjaftueshme, sipas supozimeve të arsyeshme aktuaristike, që t'i mundësojnë shoqërive të sigurimit që të përmbushin të gjitha angazhimet e tyre dhe, në veçanti, të krijojnë provigjone teknike të mjaftueshme.

Për këtë arsye mund të merren në konsideratë të gjitha aspektet e gjendjes financiare të një shoqërie sigurimi jetë, me përjashtim të inputit nga burime të tjera përveç primeve dhe të ardhurave të fituara prej tyre kur ato janë sistematike dhe të përhershme në atë masë sa mund të rrezikojnë aftësinë paguese të shoqërisë në fjalë në një afat të gjatë.

KAPITULLI IV

RREGULLAT SPECIFIKE PËR RISIGURIMIN

Neni 210

Risigurimi me afat të përcaktuar

1. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që lidhin kontrata risigurimi me afat të përcaktuar dhe zhvillojnë veprimtari risigurimi me afat të përcaktuar janë në gjendje të identifikojnë, matin, monitorojnë, administrojnë, kontrollojnë dhe raportojnë siç duhet rreziqet që lindin nga këto kontrata ose veprimtari.

2. Për të garantuar përdorimin e një qasje të harmonizuar në lidhje me veprimtaritë e risigurimit me afat të përcaktuar, Komisioni mund të miratojë masat zbatuese që specifikojnë dispozitat e paragrafit 1 në lidhje me monitorimin, menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve që lindin nga veprimtaritë e risigurimit me afat të përcaktuar.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj direktive, ndër të tjera, duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore, sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, risigurim me afat të përcaktuar është risigurim sipas të cilit potenciali i qartë maksimal i humbjes, i shprehur si rreziku ekonomik maksimal i transferuar, që lind nga një rrezik i konsiderueshëm i marrë në risigurim dhe transferimi i rrezikut të kohës, tejkalon primin përgjatë kohëzgjatjes së kontratës me një shumë të kufizuar por të konsiderueshme, së bashku me të paktën një prej veçorive të mëposhtme:

- a) konsiderim i qartë dhe material i vlerës së parasë në kohë;
- b) dispozitat kontraktuale për të moderuar ekuilibrin e përvojës ekonomike ndërmjet palëve me kalimin e kohës për të arritur transferimin e synuar të rrezikut.

Neni 211

Shoqëritë e qëllimit të veçantë

1. Pas miratimit të autoriteteve mbikëqyrëse shtetet anëtare lejojnë krijimin brenda territorit të tyre të shoqërive të qëllimit të veçantë.

2. Për të garantuar një qasje të harmonizuar në lidhje me shoqëritë e qëllimit të veçantë, Komisioni miraton masat zbatuese që përcaktojnë sa më poshtë:

- a) objektin e autorizimit;
- b) kushtet e detyrueshme që duhet të përfshihen në të gjitha kontratat e lëshuara;
- c) kërkesat e përshtatshme siç përmenden në nenin 42 për personat që drejtojnë shoqërinë e qëllimit të veçantë;
- d) kërkesat e përshtatshme për aksionarët ose anëtarët që kanë pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e qëllimit të veçantë;

e) procedurat e sigurta administruese dhe të kontabilitetit, mekanizmat e përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe kërkesat për menaxhimin e rrezikut;

f) kërkesat e kontabilitetit, kërkesat e kujdesshme dhe kërkesat për informacionin statistikor;

g) kërkesat për aftësi paguese.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj direktive, ndër të tjera, duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore, sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

3. Shoqëritë e qëllimit të veçantë që janë autorizuar përpara datës 31 tetor 2012 duhet të jenë objekt i legjislacionit të shtetit anëtar që ka autorizuar shoqërinë e qëllimit të veçantë. Megjithatë, çdo veprimtari e re që nisat nga kjo shoqëri e qëllimit të veçantë pas kësaj date duhet të jetë objekt i paragrafëve 1 dhe 2.

TITULLI III

MBIKËQYRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT NË NJË GRUP

KAPITULLI I

MBIKËQYRJA E GRUPIT: PËRKUFIZIME, RASTET E ZBATIMIT, FUSHA E ZBATIMIT DHE NIVELET

SEKSIONI 1

PËRKUFIZIME

Neni 212

Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij titulli vlejnë përkufizimet e mëposhtme:

a) "shoqëri pjesëmarrëse" është një shoqëri e cila është ose shoqëri mëmë ose një shoqëri që zotëron një pjesëmarrje, ose një shoqëri që lidhet me një tjetër sipas një marrëdhënieje që përcaktohet në nenin 12, paragrafi 1 të Direktivës 83/349/KEE;

b) "shoqëri e lidhur" është ose filiali i një shoqërie ose një shoqëri tjetër në të cilën zotërohet një pjesëmarrje, ose një shoqëri që lidhet me një tjetër sipas një marrëdhënieje që përcaktohet në nenin 12, paragrafi 1 të Direktivës 83/349/KEE;

c) "grup" është një grup shoqërish që:

I. përbëhet nga një shoqëri pjesëmarrëse, filialet e saj dhe subjektet në të cilat shoqëria pjesëmarrëse ose filialet e saj zotërojnë një pjesëmarrje si edhe shoqëritë që lidhen me njëra

tjetrën nëpërmjet një marrëdhënieje që përcaktohet në nenin 12, paragrafi 1 të Direktivës 83/349/KEE; ose

II. bazohet në krijimin e marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme financiare, kontraktuale ose të tjera, ndërmjet këtyre shoqërive dhe kjo mund të përfshijë shoqatat e ndërsjella, me kusht që:

— një nga këto shoqëri ushtron në mënyrë efikase, nëpërmjet koordinimit të centralizuar, një influencë dominuese në vendimet, duke përfshirë vendimet financiare, të shoqërive që janë pjesë e grupit; dhe,

— krijimi dhe zgjidhja e këtyre marrëdhënieve për qëllimet e këtij titulli i nënshtrohen miratimit paraprak nga mbikëqyrësi i grupit,

në rastet kur shoqëria që ushtron koordinimin e centralizuar konsiderohet si shoqëri mëmë dhe shoqëritë e tjera konsiderohen si filiale;

d) "mbikëqyrës grupi" është autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrjen e grupit, i përcaktuar në përputhje me nenin 247;

e) "kolegj i mbikëqyrësve" është një strukturë e përhershme, por fleksibël për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare përkatëse;

f) "shoqëri sigurimi kontrolluese" është një shoqëri mëmë, e cila nuk është një shoqëri financiare kontrolluese me veprimtari të përzier sipas kuptimit të Direktivës 2002/87/KE dhe veprimtaria kryesore e së cilës është të blejë dhe të zotërojë pjesëmarrje në shoqëri filiale, kur këto shoqëri filiale janë ekskluzivisht ose kryesisht shoqëri sigurimi ose risigurimi, ose shoqëri sigurimi ose risigurimi të vendeve të treta, ku të paktën një prej këtyre shoqërive filiale është një shoqëri sigurimi ose risigurimi.

g) "shoqëri sigurimi kontrolluese me veprimtari të përzier" është një shoqëri mëmë, e ndryshme nga një shoqëri sigurimi, një shoqëri sigurimi e vendit të tretë, një shoqëri risigurimi, një shoqëri risigurimi e vendit të tretë, një shoqëri sigurimi kontrolluese ose një shoqëri financiare kontrolluese me veprimtari të përzier sipas kuptimit të Direktivës 2002/87/KE, e cila përfshin në shoqëritë e saj filiale të paktën një shoqëri sigurimi ose risigurimi.

2. Për qëllimet e këtij titulli, autoritetet mbikëqyrëse gjithashtu konsiderojnë si shoqëri mëmë çdo shoqëri e cila, sipas mendimit të autoriteteve mbikëqyrëse, ushtron me efikasitet një influencë dominuese mbi një shoqëri tjetër.

Ata gjithashtu konsiderojnë si shoqëri filiale çdo shoqëri mbi të cilën, sipas mendimit të autoriteteve mbikëqyrëse, ushtrohet me efikasitet një influencë dominuese nga një shoqëri mëmë.

Ata gjithashtu konsiderojnë si pjesëmarrje zotërimin, direkt ose indirekt, të të drejtave të votës ose kapitalit në një shoqëri mbi të cilën, sipas mendimit të autoriteteve mbikëqyrëse, ushtrohet me efikasitet një influencë e konsiderueshme.

SEKSIONI 2

RASTET E ZBATIMIT DHE FUSHA E ZBATIMIT

Neni 213

Rastet e zbatimit dhe mbikëqyrja e grupit

1. Në përputhje me këtë titull shtetet anëtare parashikojnë mbikëqyrjen, në nivel grupi, të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, të cilat janë pjesë e një grupi.

Dispozitat e kësaj direktive, të cilat përcaktojnë rregullat për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit të marra individualisht duhet të vazhdojnë të zbatohen për këto shoqëri, përveç se kur ky titull e parashikon ndryshe.

2. Shtetet anëtare sigurohen që mbikëqyrja në nivel grupi të zbatohet si në vijim:

a) për shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit, të cilat janë shoqëri pjesëmarrëse në të paktën një shoqëri sigurimi, një shoqëri risigurimi, një shoqëri sigurimi të vendit të tretë ose një shoqëri risigurimi të vendit të tretë, në përputhje me nenet 218 deri në 258;

b) për shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit, shoqëria mëmë e të cilave është një shoqëri sigurimi kontrolluese me zyrë kryesore në Komunitet, në përputhje me nenet 218 deri në 258;

c) për shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit, shoqëria mëmë e të cilave është një shoqëri sigurimi kontrolluese me zyrë kryesore jashtë Komunitetit, ose një shoqëri sigurimi ose risigurimi e vendit të tretë, në përputhje me nenet 260 deri në 263;

d) për shoqëritë e sigurimit ose të risigurimit, shoqëria mëmë e të cilave është një shoqëri sigurimi kontrolluese me veprimtari të përzier në përputhje me nenin 265.

3. Në rastet e përmendura në geramat "a" dhe "b" të paragrafit 2, kur shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose risigurimit ose shoqëria kontrolluese e sigurimit që ka zyrën kryesore në Komunitet është një shoqëri e lidhur me një subjekt të rregulluar ose një shoqëri financiare kontrolluese me veprimtari të përzier, e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes plotësuese në përputhje me nenin 5, paragrafi 2, të Direktivës 2002/87/KE, mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse, mund të vendosë që, në nivelin e asaj shoqërie pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit, ose në nivelin e asaj shoqërie kontrolluese sigurimi, të mos kryejë mbikëqyrjen e përqendrimit të rrezikut, siç përmendet në nenin 244 të kësaj direktive, mbikëqyrjen e transaksioneve ndërmjet grupit, siç përmendet në nenin 245 të kësaj direktive, ose asnjërën prej tyre.

Neni 214

Fusha e zbatimit të mbikëqyrjes së grupit

1. Ushtrimi i mbikëqyrjes së grupit në përputhje me nenin 213 nuk nënkupton se autoriteteve mbikëqyrëse u kërkohet që të luajnë një rol mbikëqyrës në lidhje me shoqërinë e

sigurimit të një vendi të tretë, shoqërinë e risigurimit të një vendi të tretë, shoqërinë kontrolluese të sigurimit ose shoqërinë kontrolluese të sigurimit me veprimtari të përzier të marra individualisht, pa cenuar nenin 257 në lidhje me shoqëritë kontrolluese të sigurimit.

2. Mbikëqyrësi i grupit, rast pas rasti, mund të vendosë të mos përfshijë një shoqëri të trupit në mbikëqyrjen e përmendur në nenin 213 në rastet kur:

a) shoqëria ndodhet në një vend të tretë ku ka pengesa ligjore për transferimin e informacionit të nevojshëm, pa cenuar dispozitat e nenit 229;

b) shoqëria që duhet të përfshihet ka një interes të papërfillshëm në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes së grupit; ose

c) përfshirja e shoqërisë do të ishte e papërshtatshme ose keqinformuese në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes së grupit.

Megjithatë, kur disa shoqëri të të njëjtit grup, të marra individualisht, mund të përjashtohen sipas germës "b" të nënparagrafit të parë, ato gjithsesi duhet të përfshihen nëse, të marra kolektivisht, përfaqësojnë një interes të konsiderueshëm.

Kur mbikëqyrësi i grupit është i mendimit se një shoqëri sigurimi ose risigurimi nuk duhet të përfshihet në mbikëqyrjen e grupit në zbatim të germave "b" dhe "c" të nënparagrafit të parë, ai duhet të konsultohet me autoritetet e tjera anëtare përpara se të marrë një vendim.

Kur mbikëqyrësi i grupit nuk përfshin një shoqëri sigurimi ose risigurimi në mbikëqyrjen e grupit në zbatim të germës "b" ose "c" të nënparagrafit të parë, autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku ndodhet ajo shoqëri mund t'i kërkojnë shoqërisë që kryeson grupin ndonjë informacion që mund të lehtësojë mbikëqyrjen e kësaj shoqërie sigurimi ose risigurimi nga ana e tyre.

SEKSIONI 3

NIVELET

Neni 215

Shoqëria mëmë kryesore në nivel Komuniteti

1. Kur shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose e risigurimit ose shoqëria kontrolluese e sigurimit që përmendet në nenin 213, paragrafi 2, germa "a" dhe "b" është vetë një shoqëri filiale e një shoqërie tjetër sigurimi ose risigurimi ose e një tjetër shoqërie kontrolluese sigurimi që ka zyrën kryesore në Komunitet, nenet 218 deri në 258 zbatohen vetëm në nivel të shoqërisë mëmë kryesore të sigurimit ose risigurimit ose shoqërisë kontrolluese të sigurimit që ka zyrën kryesore në Komunitet.

2. Kur shoqëria mëmë kryesore e sigurimit ose risigurimit ose një shoqëri kontrolluese sigurimi që ka zyrën kryesore në Komunitet, e përmendur në paragrafin 1, është një shoqëri filiale e një shoqërie, e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes plotësuese në përputhje me nenin 5,

paragrafi 2, të Direktivës 2002/87/KE, mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse, mund të vendosë që, në nivelin e asaj shoqërie mëmë kryesore, të mos kryejë mbikëqyrjen e përqendrimit të rrezikut, siç përmendet në nenin 244, mbikëqyrjen e transaksioneve ndërmjet grupit, siç përmendet në nenin 245, ose asnjërën prej tyre.

Neni 216

Shoqëria mëmë kryesore në nivel kombëtar

1. Kur shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose risigurimit ose shoqëria kontrolluese e sigurimit me zyrë kryesore në Komunitet, siç përmendet në nenin 213, paragrafi 2, germa "a" dhe "b", nuk ka zyrën kryesore në të njëjtin shtet anëtar me shoqërinë mëmë kryesore në nivel Komunitet, siç përmendet në nenin 215, shtetet anëtare mund të lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrjes që, pas konsultimit me mbikëqyrësin e grupit dhe shoqërinë mëmë kryesore në nivel Komuniteti, të vendosin që të përfshijnë në mbikëqyrjen e grupit shoqërinë mëmë kryesore të sigurimit ose risigurimit ose shoqërinë kontrolluese të sigurimit në nivel kombëtar.

Në këtë rast, autoriteti mbikëqyrës ia shpjegon vendimin e tij mbikëqyrësit të grupit dhe shoqërisë mëmë kryesore në nivel Komuniteti.

Nenet 218 deri në 258 zbatohen rast pas rasti, sipas dispozitave që përcaktohen në paragrafët 2 deri në 6.

2. Autoriteti mbikëqyrës mund të kufizojë mbikëqyrjen e grupit për shoqërinë mëmë kryesore në nivel kombëtar për një ose disa nga seksionet e kapitullit II.

3. Kur autoriteti mbikëqyrës vendos që për shoqërinë mëmë kryesore në nivel kombëtar të zbatojë kapitullin II, seksionin 1, zgjedhja e metodës që bëhet në përputhje me nenin 220 nga mbikëqyrësi i grupit për shoqërinë mëmë kryesore në nivel Komuniteti, siç përmendet në nenin 215, pranohet si përcaktuese dhe zbatohet nga autoriteti mbikëqyrës në shtetin anëtar në fjalë.

4. Kur autoriteti mbikëqyrës vendos që për shoqërinë mëmë kryesore në nivel kombëtar të zbatojë kapitullin II, seksionin 1, dhe kur shoqëria mëmë kryesore në nivel Komuniteti, siç përmendet në nenin 215, ka marrë leje, në përputhje me nenin 231 ose nenin 233, paragrafi 5, për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese për grupin si edhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit në grup, bazuar në një model të brendshëm, ky vendim pranohet si përcaktues dhe zbatohet nga autoriteti mbikëqyrës në shtetin anëtar përkatës.

Në një situatë të tillë, kur autoriteti mbikëqyrës gjykon se profili i rrezikut të shoqërisë mëmë kryesore në nivel kombëtar ka devijim të konsiderueshëm nga modeli i brendshëm i miratuar në nivel Komuniteti dhe për sa kohë që kjo shoqëri nuk trajton siç duhet shqetësimet e autoritetit mbikëqyrës, ky autoritet mbikëqyrës mund të marrë një vendim për një shtim kapital për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit të kësaj shoqërie që rrjedh nga zbatimi i këtij modeli, ose, në rrethana përjashtimore, kur ky shtim kapital do të ishte i papërshtatshëm, i kërkon shoqërisë që të llogarisë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit sipas formulës standarde.

Autoriteti mbikëqyrës ia shpjegon këto vendime si shoqërisë ashtu edhe mbikëqyrësit të grupit.

5. Kur autoriteti mbikëqyrës vendos që të zbatojë kapitullin II, seksioni 1 për shoqërinë mëmë kryesore në nivel kombëtar, kësaj shoqërie nuk i lejohej që të paraqesë, në përputhje me nenet 236 ose 243, një aplikim për leje që ndonjë prej filialeve të saj t'i nënshtrohet neneve 238 ose 239.

6. Kur shtetet anëtare lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse që të marrin vendimin e përmendur në paragrafin 1, ata parashikojnë që asnjë vendim i tillë të mos merret ose mbahet në fuqi kur shoqëria mëmë kryesore në nivel kombëtar është një filial i një shoqërie mëmë kryesore në nivel Komuniteti, siç përmendet në nenin 215, dhe kjo e fundit ka marrë leje, në përputhje me nenet 237 ose 243, që ky filial t'i nënshtrohet neneve 238 dhe 239.

7. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që specifikojnë rrethanat në të cilat mund të merret vendimi i përmendur në paragrafin 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 217

Shoqëria mëmë që mbulon disa shtete anëtare

1. Kur shtetet anëtare lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse që të marrin vendimin e përmendur në nenin 216, ata gjithashtu i lejojnë ata që të vendosin të lidhin një marrëveshje me autoritetet mbikëqyrëse në shtete të tjera anëtare ku është prezente një shoqëri tjetër kryesore në nivel kombëtar, me qëllim që të kryejnë mbikëqyrjen e grupit në nivel nëngrupi duke mbuluar disa shtete anëtare.

Kur këto autoritete mbikëqyrëse kanë lidhur marrëveshjen e përmendur në nënparagrafin e parë, mbikëqyrja e grupit nuk kryhet në nivel të asnjë shoqërie mëmë kryesore, siç përmendet në nenin 216, që është prezente në shtete anëtare të ndryshme nga shteti anëtar ku ndodhet nëngrupi i përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

2. Neni 216, paragrafët 2 deri në 6 zbatohet rast pas rasti.

3. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që specifikojnë rrethanat në të cilat mund të merret vendimi i përmendur në paragrafin 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

KAPITULLI II

POZICIONI FINANCIAR

SEKSIONI 1

AFTËSIA PAGUESE E GRUPIT

NËNSEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 218

Mbikëqyrja e aftësisë paguese të grupit

1. Mbikëqyrja e aftësisë paguese të grupit kryhet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, nenin 246 dhe kapitullin III.

2. Në rastin e përmendur në nenin 213, paragrafi 2, germa "a", shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit që të garantojnë se grupi ka në dispozicion fonde të veta të pranueshme të cilët janë gjithmonë të paktën të barabarta me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit, e llogaritur në përputhje me nënseksionet 2, 3 dhe 4.

3. Në rastin e përmendur në nenin 213, paragrafi 2, germa "b", shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive të sigurimit ose risigurimit të një grupi që të garantojnë se grupi ka në dispozicion fonde të veta të pranueshme të cilët janë gjithmonë të paktën të barabarta me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit, e llogaritur në përputhje me nënseksionin 5.

4. Kërkesat e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 i nënshtrohen rishikimit mbikëqyrës nga mbikëqyrësi i grupit, në përputhje me kapitullin III. Neni 136 dhe neni 138, paragrafët 1 deri në 4 zbatohen rast pas rasti.

5. Sapo shoqëria pjesëmarrëse të vëzhgojë dhe të informojë mbikëqyrësin e grupit se kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e grupit nuk përmbushet më ose se ekziston rreziku i papajtueshmërisë në tre muajt e ardhshëm, mbikëqyrësi i grupit informon autoritetet e tjera anëtare të kolegjit të mbikëqyrësve, të cilët analizojnë situatën e grupit.

Neni 219

Shpeshtësia e llogaritjes

1. Mbikëqyrësi i grupit sigurohet që llogaritjet e përmendura në nenin 218, paragrafi 2 dhe 3 të kryhen të paktën një herë në vit, ose nga shoqëritë pjesëmarrëse të sigurimit ose të risigurimit ose nga shoqëria kontrolluese e sigurimit.

Të dhënat përkatëse dhe rezultatet e kësaj llogaritjeje i dorëzohen mbikëqyrësit të grupit nga shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose e risigurimit, ose, në rastet kur grupi nuk kryesohet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nga shoqëria kontrolluese e sigurimit ose nga shoqëria e grupit që identifikohet nga mbikëqyrësi i grupit pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë grupin.

2. Shoqëria e sigurimit dhe e risigurimit dhe shoqëria kontrolluese e sigurimit monitorojnë vazhdimisht kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit. Kur profili i rrezikut të grupit ka devijim të konsiderueshëm nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të grupit që është raportuar për herë të fundit, kërkesa për kapital dhe aftësi paguese të grupit llogaritet sërish menjëherë dhe i raportohet mbikëqyrësit të grupit.

Kur ka prova që sugjerojnë se profili i rrezikut të grupit ka pësuar ndryshime të konsiderueshme që nga data e raportimit të fundit të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese të grupit, mbikëqyrësi i grupit mund të kërkojë përsëritjen e llogaritjes së kërkesës për kapital dhe aftësi paguese të grupit.

NËNSEKSIONI 2

ZGJEDHJA E METODËS SË LLOGARITJES DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 220

Zgjedhja e metodës

1. Llogaritja e aftësisë paguese në nivelin e grupit të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, siç përmendet në nenin 213, paragrafi 2, germa "a" kryhet në përputhje me parimet teknike dhe një prej metodave të përcaktuara në nenet 221 deri në 233.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që llogaritja e aftësisë paguese në nivelin e grupit të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, siç përmendet në nenin 213, paragrafi 2, germa "a" të kryhet në përputhje me metodën 1, e cila përcaktohet në nenet 230 deri në 232.

Megjithatë, shtetet anëtare lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse, kur ata marrin rolin e mbikëqyrësit të grupit për një grup të caktuar, që të vendosin, pasi të konsultohen me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë grupin, që për këtë grup të zbatojnë metodën 2, e cila përcaktohet në nenet 233 dhe 234 ose një kombinim të metodave 1 dhe 2, kur vetëm zbatimi i metodës 1 do të ishte i papërshtatshëm.

Neni 221

Përfshirja e aksioneve proporcionale

1. Llogaritja e aftësisë paguese të grupit merr në konsideratë aksionet proporcionale që zotërohen nga shoqëria pjesëmarrëse në shoqëritë e lidhura me të.

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, aksionet proporcionale përfshijnë një nga pikat e mëposhtme:

a) kur përdoret metoda 1, përqindjet e përdorura për krijimin e llogarive të konsoliduara; ose

b) kur përdoret metoda 2, përqindjen e kapitalit të nënshkruar që zotërohet, direkt ose indirekt, nga shoqëria pjesëmarrëse.

Megjithatë, pavarësisht metodës së përdorur, kur shoqëria e lidhur është një filial ose nuk ka fonde të veta të pranueshme që mjaftojnë për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, merret në konsideratë deficiti total i aftësisë paguese të filialit.

Nëse sipas mendimit të autoriteteve mbikëqyrëse, përgjegjësia e shoqërisë mëmë që zotëron një pjesë të kapitalit kufizohet vetëm me atë pjesë të kapitalit, mbikëqyrësi i grupit, gjithsesi, mund të lejojë që deficiti i aftësisë paguese së filialit të merret në konsideratë në mënyrë proporcionale.

2. Mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë grupin, përcakton aksionet proporcionale që merren në konsideratë në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ka lidhje kapitali ndërmjet disa prej shoqërive të grupit;

b) kur një autoritet mbikëqyrës ka vendosur se zotërimi, direkt ose indirekt, i të drejtave të votës ose i kapitalit në një shoqëri cilësohet si pjesëmarrje, sepse, sipas mendimit të tij, mbi këtë shoqëri ushtrohet një influencë e konsiderueshme dhe efikase;

c) kur një autoritet mbikëqyrës ka vendosur se një shoqëri është shoqëria mëmë e një shoqërie tjetër, sepse, për mendimin e këtij autoriteti mbikëqyrës, ajo ushtron një influencë dominuese mbi shoqërinë tjetër.

Neni 222

Eliminimi i përdorimit të dyfishtë të fondeve të veta të pranueshme

1. Nuk lejohet përdorimi i dyfishtë i fondeve të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ndërmjet shoqërive të ndryshme të sigurimit ose risigurimit, të cilat janë marrë në konsideratë në atë llogaritje.

Për këtë qëllim, kur llogaritet aftësia paguese e grupit dhe kur diçka e tillë nuk parashikohet nga metodat e përshkruara në nënseksionin 4, përjashtohen shumatat e mëposhtme:

a) vlera e çdo aktivi të shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit që përfaqëson financimin e fondeve të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të njëjës prej shoqërive të sigurimit ose risigurimit që kanë lidhje me të;

b) vlera e çdo aktivi të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që ka lidhje me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit, e cila përfaqëson financimin e fondeve të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të kësaj shoqërie pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit;

c) vlera e çdo aktivi të shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që ka lidhje me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit, e cila përfaqëson financimin e fondeve të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të çdo shoqërie tjetër sigurimi ose risigurimi që ka lidhje me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit.

2. Pa cenuar paragrafin 1, pikat e mëposhtme mund të përfshihen në llogaritje vetëm deri në masën që ato pranohen për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë së lidhur:

a) fondet shtesë që përfshihen në nenin 91, paragrafi 2, që krijohen në një shoqëri sigurimi ose risigurimi jete të lidhur me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit;

b) çdo kapital i nënshkruar, por i papaguar i një shoqërie sigurimi ose risigurimi të lidhur me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit;

Megjithatë, për çdo rast, pikat e mëposhtme përjashtohen nga llogaritja:

I. kapitali i nënshkruar i papaguar i cili përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e shoqërisë pjesëmarrëse;

II. kapitali i nënshkruar i papaguar i shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit, i cili përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e një shoqërie sigurimi ose risigurimi të lidhur me të;

III. kapitali i nënshkruar i papaguar i shoqërisë së lidhur të sigurimit ose risigurimit, i cili përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e një shoqërie sigurimi ose risigurimi të lidhur me të njëjtën shoqëri pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit;

3. Kur autoritetet mbikëqyrëse gjykojnë se disa fonde të veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të një shoqërie sigurimi ose risigurimi të lidhur, të ndryshme nga ato që përmenden në paragrafin 2, nuk mund të vihen në dispozicion për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose të risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit, këto fonde të veta mund të përfshihen në llogaritje vetëm deri në masën që janë të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë së lidhur.

4. Shuma e fondeve të veta që përmenden në paragrafët 2 dhe 3 nuk duhet të tejkalojë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë së lidhur të sigurimit ose risigurimit.

5. Të gjitha fondet e veta të pranueshme të një shoqërie sigurimi ose risigurimi që ka lidhje me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit, të cilat i nënshtrohen autorizimit paraprak nga autoriteti mbikëqyrës në përputhje me nenin 90, përfshihen në llogaritje vetëm deri në masën që janë autorizuar nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë së lidhur.

Neni 223

Eliminimi i krijimit të kapitalit brenda grupit

1. Kur llogaritet aftësia paguese e grupit, nuk merren në konsideratë fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, të cilat janë krijuar nga financimi reciprok ndërmjet shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit dhe si më poshtë:

a) një shoqërie të lidhur;

b) një shoqërie pjesëmarrëse;

c) një shoqërie tjetër të lidhur me ndonjë prej shoqërive të saj pjesëmarrëse.

2. Kur llogaritet aftësia paguese e grupit nuk merren në konsideratë fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të një shoqërie sigurimi ose risigurimi të lidhur me shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit, kur këto fonde të veta krijohen nga financimi reciprok me ndonjë shoqëri tjetër të lidhur me atë shoqëri pjesëmarrëse sigurimi ose risigurimi.

3. Financimi reciprok konsiderohet se ekziston të paktën kur një shoqëri sigurimi ose risigurimi, ose ndonjë nga shoqëritë e lidhura me të, zotëron aksione në, ose jep kredi për një shoqëri tjetër, e cila, direkt ose indirekt, zotëron fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë së parë.

Neni 224

Vlerësimi

Vlera e aktiveve dhe pasiveve vlerësohet në përputhje me nenin 75.

NËNSEKSIONI 3

ZBATIMI I METODAVE TË LLOGARITJES

Neni 225

Shoqëritë e lidhura të sigurimit dhe të risigurimit

Kur shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ka më shumë se një shoqëri sigurimi ose risigurimi të lidhur me të, llogaritja e aftësisë paguese të grupit kryhet duke përfshirë secilën prej këtyre shoqërive të lidhura të sigurimit ose risigurimit.

Shtetet anëtare mund të parashikojnë që kur shoqëria e lidhur e sigurimit ose risigurimit ka zyrën kryesore në një shtet anëtar të ndryshëm nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit për të cilën llogaritet aftësia paguese e grupit, për sa i përket shoqërisë së lidhur, në llogaritje përfshihet kërkesa për kapital dhe aftësi paguese dhe fondet e veta në mbulim të kësaj kërkesë, siç përcaktohet në shtetin tjetër anëtar.

Neni 226

Shoqëritë kontrolluese të ndërmjetme të sigurimit

1. Kur llogaritjet aftësia paguese e grupit për një shoqëri sigurimi ose risigurimi që zotëron një pjesëmarrje në një shoqëri sigurimi të lidhur, një shoqëri risigurimi të lidhur, një shoqëri sigurimi të një vendi të tretë ose një shoqëri risigurimi të një vendi të tretë, nëpërmjet një shoqërie kontrolluese sigurimi, merret në konsideratë situata e kësaj shoqërie kontrolluese të sigurimit.

Vetëm për qëllimet e llogaritjes, shoqëria kontrolluese e ndërmjetme e sigurimit trajtohet si të ishte një shoqëri sigurimi ose risigurimi që i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1, 2 dhe 3 në lidhje me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe sikur t'i nënshtrohej të njëjtave kushte që përcaktohen në titullin I, kapitulli VI, seksioni 3, nënseksionet 1, 2 dhe 3 në lidhje me fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

2. Në rastet kur një shoqëri kontrolluese e ndërmjetme sigurimi zotëron borxh të varur ose fonde të tjera të veta që janë objekt kufizimi në përputhje me nenin 98, ato njihen si fonde të veta të pranueshme deri në shumat e llogaritura duke zbatuar kufijtë e përcaktuar në nenin 98 për totalin e fondeve të veta të pranueshme të papaguara në nivel grupi krahasuar me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në nivel grupi.

Të gjitha fondet e veta të pranueshme të një shoqërie kontrolluese të ndërmjetme sigurimi, për të cilat kërkohet autorizimi paraprak i autoritetit mbikëqyrës në përputhje me nenin 90 nëse ato zotërohen nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, mund të përfshihen në llogaritjen e aftësisë paguese të grupit deri në masën që janë autorizuar nga mbikëqyrësi i grupit.

Neni 227

Shoqëritë e lidhura të sigurimit dhe të risigurimit në vende të treta

1. Kur llogaritjet aftësia paguese e grupit, në përputhje me nenin 233, për një shoqëri sigurimi ose risigurimi e cila është pjesëmarrëse në një shoqëri sigurimi ose risigurimi në një vend të tretë, kjo e fundit, vetëm për qëllimet e llogaritjes, trajtohet si një shoqëri e lidhur sigurimi ose risigurimi.

Megjithatë, kur vendi i tretë ku kjo shoqëri ka zyrën qendrore e bën shoqërinë objekt autorizimi dhe vendos për atë një regjim të aftësisë paguese të paktën ekuivalent me atë që përcaktohet në titullin I, kapitulli VI, shtetet anëtare mund të parashikojnë që, në lidhje me këtë shoqëri, në llogaritje të merret në konsideratë kërkesa për aftësi paguese dhe kapital dhe fondet e veta që mbulojnë këtë kërkesë, siç përcaktohet nga vendi i tretë në fjalë.

2. Me kërkesë të shoqërisë pjesëmarrëse ose me iniciativën e vet, mbikëqyrësi i grupit verifikon nëse regjimi i vendi të tretë është të paktën ekuivalent.

Gjatë këtij verifikimi mbikëqyrësi i grupit konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe CEIOPS përpara se të marrë një vendim për ekuivalencën.

3. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që specifikojnë kriteret mbi të cilat vlerësohet nëse regjimi i aftësisë paguese në një vend të tretë është ekuivalent me atë që përcaktohet në titullin I, kapitulli VI.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

4. Pasi të konsultohet me Komitetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve dhe në përputhje me procedurën rregullatore që përmendet në nenin 301, paragrafi 2 dhe duke marrë në konsideratë kriteret e miratuara në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Komisioni mund të miratojë një vendim nëse regjimi i aftësisë paguese në një vend të tretë është ekuivalent me atë që përcaktohet në titullin I, kapitulli VI.

Këto vendime rishikohen rregullisht për të marrë në konsideratë çdo ndryshim të regjimit të aftësisë paguese që përcaktohet në titullin I, kapitulli VI dhe të regjimit të aftësisë paguese në vendin e tretë.

5. Kur në përputhje me paragrafin 4 Komisioni miraton një vendim për ekuivalencën e aftësisë paguese në një vend të tretë, paragrafi 2 nuk zbatohet.

Kur vendimi i miratuar nga Komisioni në përputhje me paragrafin 4 përcakton se regjimi i aftësisë paguese në një vend të tretë nuk është ekuivalent, opsioni që përmendet në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 për të marrë në konsideratë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe fondet e veta të pranueshme, siç përcaktohen nga vendi i tretë, nuk zbatohet dhe shoqëritë e sigurimit ose risigurimit të vendit të tretë trajtohen ekskluzivisht në përputhje me nënparagrafin e parë të paragrafit 1.

Neni 228

Institucionet e lidhura të kreditit, firmat e lidhura të investimit dhe institucionet e lidhura financiare

Kur llogaritet aftësia paguese e grupit për një shoqëri sigurimi ose risigurimi që është shoqëri pjesëmarrëse në një institucion krediti, firmë investimi ose institucion financiar, shtetet anëtare u lejojnë shoqërive pjesëmarrëse të sigurimit dhe të risigurimit që të zbatojnë metodën 1 ose 2 që përcaktohen në shtojcën I të Direktivës 2002/87/KE rast pas rasti. Megjithatë, metoda 1 që përcaktohet në atë shtojcë zbatohet vetëm kur mbikëqyrësi i grupit është i bindur për nivelin e menaxhimit të integruar dhe kontrollit të brendshëm në lidhje me subjektet që do të përfshiheshin në objektin e konsolidimit. Metoda e zgjedhur zbatohet në një mënyrë konsistente përgjatë kohës.

Megjithatë, shtetet anëtare lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse, kur ata veprojnë në cilësinë e mbikëqyrësit të grupit në lidhje me një grup të caktuar, që të vendosin, me kërkesën e shoqërisë pjesëmarrëse ose me iniciativën e tyre, që të zbresin çdo pjesëmarrje që përmendet në paragrafin e parë nga fondet e veta të pranueshme për aftësinë paguese të grupit të shoqërisë pjesëmarrëse.

Neni 229

Mungesa e informacionit të nevojshëm

Kur informacioni i nevojshëm për llogaritjen e aftësisë paguese të grupit të një shoqërie sigurimi ose risigurimi, në lidhje me një shoqëri të lidhur që ka zyrën kryesore në një shtet anëtar ose një vend të tretë nuk është i disponueshëm për autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, vlera kontabël e kësaj shoqërie në shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit zbritet nga fondet e veta të pranueshme për aftësinë paguese të grupit.

Në këtë rast, fitimet e perealizuara në lidhje me këtë pjesëmarrje nuk njihen si fonde të veta të pranueshme për aftësinë paguese të grupit.

NËNSEKSIONI 4

METODAT E LLOGARITJES

Neni 230

Metoda 1 (metodë e paracaktuar): Metoda e kontabilitetit bazuar në konsolidim.

1. Llogaritja e aftësisë paguese të grupit për shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit bëhet mbi bazën e llogarive të konsoliduara.

Aftësia paguese e grupit për shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit është ndryshesa mes zërave të mëposhtëm:

a) fondeve të veta të pranueshme për të mbuluar kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara;

b) kërkesa për kapital dhe aftësi paguese në nivel grupi e llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara.

Për të llogaritur fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në nivel grupi bazuar në të dhënat e konsoliduara zbatohen rregullat e përcaktuara në titullin I, kapitulli VI, seksioni 3, nënseksionet 1, 2 dhe 3 dhe në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1, 2 dhe 3.

2. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese në nivel grupi bazuar në të dhënat e konsoliduara (kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e konsoliduar për të gjithë grupin) llogaritet ose sipas formulës standarde ose sipas një modeli të brendshëm të miratuar, në pajtim me parimet e përgjithshme që parashtrohen në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1 dhe 2 dhe në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1 dhe 3.

Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e konsoliduar për të gjithë grupin është minimalisht shuma e zërave të mëposhtëm:

a) kërkesa për kapital minimal, siç përmendet në nenin 129, për shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit;

b) përqindja proporcionale e kërkesës për kapital minimal e shoqërive të lidhura të sigurimit dhe risigurimit.

Ky minimum mbulohet nga fondet e veta bazë të pranueshme, siç përcaktohen në nenin 98, paragrafi 4.

Për të përcaktuar nëse këto fonde të veta mjaftojnë për të mbuluar kërkesën minimale për kapital dhe aftësi paguese të konsoliduar për të gjithë grupin, parimet e përcaktuara në nenet 221 deri në 229 zbatohen rast pas rasti. Neni 139, paragrafi 1 dhe 2, zbatohet rast pas rasti.

Neni 231

Modeli i brendshëm i grupit

1. Në rastin e një aplikimi për leje për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të konsoliduar për grupin, si edhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit brenda grupit, bazuar në një model të brendshëm të dorëzuar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit ose shoqëritë e lidhura me të, ose bashkërisht nga shoqëritë e lidhura të një shoqërie sigurimi kontrolluese, autoritetet mbikëqyrëse në fjalë bashkëpunojnë për të vendosur nëse duhet ose jo të jepet kjo leje dhe për të përcaktuar kushtet, nëse ka, të cilave duhet t'i nënshtrohet kjo leje.

Aplikimi i përmendur në nënparagrafin e parë i dorëzohet mbikëqyrësit të grupit.

Mbikëqyrësi i grupit informon menjëherë autoritetet mbikëqyrëse përkatëse.

2. Këto autoritete mbikëqyrëse bëjnë gjithçka që kanë në dorë për të arritur një vendim të përbashkët për aplikimin brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së aplikimit të plotë nga mbikëqyrësi i grupit.

Mbikëqyrësi i grupit ia përcjell menjëherë aplikimin e plotë autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse.

3. Gjatë periudhës së përmendur në paragrafin 2, mbikëqyrësi i grupit dhe çdo autoritet tjetër mbikëqyrës i përfshirë mund të konsultohen me CEIOPS. Konsultimi me CEIOPS kryhet edhe kur këtë e kërkon shoqëria pjesëmarrëse.

Gjatë kohës së konsultimit me CEIOPS informohen të gjitha autoritetet mbikëqyrëse të përfshira dhe periudha e përmendur në paragrafin 2 shtyhet me 2 muaj.

4. Kur nuk janë bërë konsultime me CEIOPS në përputhje me nënparagrafin e parë të paragrafit 3 dhe në mungesë të një vendimi të përbashkët të autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së aplikimit të plotë nga mbikëqyrësi i grupit, mbikëqyrësi i grupit i kërkon CEIOPS që, brenda një periudhe tjetër dy mujore, të këshillojë të gjitha autoritetet e tjera mbikëqyrëse të përfshira. Mbikëqyrësi i grupit merr një vendim brenda tre javësh pas transmetimit të kësaj këshille, duke e marrë atë plotësisht në konsideratë.

5. Pavarësisht nëse ka pasur ose jo konsultime me CEIOPS, në vendimin e mbikëqyrësit të grupit deklarohen arsyet e plota dhe merren në konsideratë pikëpamjet e shprehura nga autoritetet mbikëqyrëse të përfshira.

Mbikëqyrësi i grupit ia shpërndan këtë vendim aplikantit dhe autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira.

Këto autoritete mbikëqyrëse veprojnë në pajtim me këtë vendim.

6. Në mungesë të një vendimi të përbashkët brenda periudhave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, mbikëqyrësi i grupit e merr vetë vendimin për aplikimin.

Gjatë marrjes së vendimit mbikëqyrësi i grupit merr siç duhet në konsideratë sa më poshtë:

a) çdo pikëpamje dhe rezervë që autoritetet e tjera mbikëqyrëse kanë shprehur gjatë periudhës së zbatueshme;

b) kur ka pasur konsultime me CEIOPS, këshillat e këtij të fundit.

Në vendim shprehen arsyet e plota dhe përfshihet një shpjegim për çdo devijim të konsiderueshëm nga qëndrimi i shprehur nga CEIOPS.

Mbikëqyrësi i grupit ia përcjell vendimin aplikuesit dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse.

Ky vendim pranohet si përcaktues dhe zbatohet nga autoritetet mbikëqyrëse përkatëse.

7. Kur ndonjë nga autoritetet mbikëqyrëse gjykon se profili i rrezikut të një shoqërie sigurimi ose risigurimi që ata mbikëqyrin devijon në mënyrë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin modelin e brendshëm të miratuar në nivel grupi dhe për sa kohë që kjo shoqëri nuk ka trajtuar siç duhet shqetësimet e autoritetit mbikëqyrës, ky autoritet, në përputhje me nenin 37, mund të vendosë një shtim kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese për këtë shoqëri sigurimi ose risigurimi që rezulton nga zbatimi i këtij modeli të brendshëm.

Në rrethana përjashtimore, kur shtimi i kapitalit do të ishte i papërshtatshëm, autoriteti mbikëqyrës mund t'i kërkojë shoqërisë në fjalë që të llogarisë kërkesën e saj për kapital dhe aftësi paguese sipas formulës standarde që përmendet në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1 dhe 2. Në përputhje me nenin 37, paragrafi 1, germa "a" dhe "c", autoriteti mbikëqyrës mund të vendosë një shtim kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të kësaj shoqërie sigurimi ose risigurimi që rezulton nga zbatimi i formulës standarde.

Autoriteti mbikëqyrës duhet t'i shpjegojë shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit si edhe mbikëqyrësit të grupit çdo vendim që përmendet në nënparagrafin e parë dhe të dytë.

Neni 232

Shtimi i kapitalit të grupit

Për të përcaktuar nëse kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e konsoliduar për të gjithë grupin pasqyron siç duhet profilin e rrezikut të grupit, mbikëqyrësi i grupit i kushton vëmendje të veçantë çdo rasti ku mund të krijohen në nivel grupi rrethanat që përmenden në nenin 37, paragrafi 1, germa "a" deri në "c", veçanërisht kur:

a) një rrezik specifik që ekziston në nivel grupi nuk do të mbulohen sa duhet nga përdorimi i formulës standarde ose modelit të brendshëm, për shkak se është e vështirë të përcaktohet përmasa e tij;

b) autoritetet mbikëqyrëse të përfshira vendosin një shtim të kapitalit për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërive të lidhura të sigurimit ose risigurimit, në përputhje me nenet 37 dhe 231, paragrafi 7.

Kur profili i rrezikut të grupit nuk është pasqyruar siç duhet, mund të vendoset një shtim kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese e konsoliduar për të gjithë grupin.

Neni 37, paragrafi 1 deri në 5, së bashku me masat zbatuese të marra në përputhje me nenin 37, paragrafi 6 zbatohen rast pas rasti.

Neni 233

Metoda 2 (metodë alternative): Metoda e zbritjes dhe agregimit

1. Aftësia paguese e grupit për shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit duhet të jetë ndryshesa mes zërave të mëposhtëm:

a) fondeve të veta të agreguara të grupit, siç parashikohet në paragrafin 2;

b) vlerës së shoqërive të lidhura të sigurimit ose të risigurimit në shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose të risigurimit dhe kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e agreguar për grupin, siç parashikohet në paragrafin 3.

2. Fondet e veta të agreguara të grupit janë shuma e zërave të mëposhtëm:

a) fondeve të veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit;

b) përqindjes proporcionale të shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit në fondet e veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërisë së lidhur të sigurimit ose risigurimit.

3. Kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e agreguar për grupin është shuma e zërave të mëposhtëm:

a) kërkesës për kapital dhe aftësi paguese së shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit;

b) përqindja proporcionale e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese e shoqërive të lidhura të sigurimit dhe risigurimit.

4. Kur pjesëmarrja në shoqëritë e lidhura të sigurimit ose risigurimit përbëhet, plotësisht ose pjesërisht, nga një zotërim indirekt, vlera e shoqërive të lidhura të sigurimit ose risigurimit në shoqërinë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit përfshin vlerën e këtij zotërimi indirekt, duke

marrë në konsideratë interesat pasues përkatës dhe zërat e përmendur në paragrafin 2, germa "b" dhe paragrafin 3, germa "b" përfshijnë pjesëmarrjet proporcionale përkatëse të fondeve të veta për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërive të lidhura të sigurimit ose të risigurimit dhe të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese të shoqërive të lidhura të sigurimit ose risigurimit.

5. Në rastin e një aplikimi për leje për të llogaritur kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit në një grup mbi bazën e një modeli të brendshëm, të dorëzuar nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe shoqëritë e lidhura me të, ose bashkërisht nga shoqëritë e lidhura të një shoqërie kontrolluese sigurimi, neni 231 zbatohet rast pas rasti.

6. Për të përcaktuar nëse kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e agreguar e grupit, e llogaritur sipas paragrafit 3, pasqyron siç duhet profilin e rrezikut të grupit, autoritetet mbikëqyrëse të përfshira i kushtojnë vëmendje të veçantë çdo rreziku specifik që ekziston në nivel grupi i cili nuk do të mbulohet mjaftueshëm për shkak se është e vështirë të përcaktohet përmasa e tij.

Kur profili i rrezikut të grupit devijon në mënyrë të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të agreguar të grupit, mund të vendoset një shtim kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të agreguar të grupit.

Neni 37, paragrafi 1 deri në 5, së bashku me masat zbatuese të marra në përputhje me nenin 37, paragrafi 6 zbatohen rast pas rasti.

Neni 234

Masat zbatuese

Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë parimet dhe metodat teknike që përcaktohen në nenet 220 deri në 229 dhe zbatimin e neneve 230 deri në 233 për të garantuar zbatimin uniform brenda Komunitetit.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

NËNSEKSIONI 5

MBIKËQYRJA E AFTËSISË PAGUESE TË GRUPIT PËR SHOQËRITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT QË JANË FILIALE TË NJË SHOQËRIE SIGURIMI KONTROLLUESE

Neni 235

Aftësia paguese e grupit për një shoqëri sigurimi kontrolluese

Kur shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit janë filiale të një shoqërie sigurimi kontrolluese, mbikëqyrësi i grupit sigurohet që llogaritja e aftësisë paguese të grupit të kryhet në nivelin e shoqërisë kontrolluese të sigurimit duke zbatuar nenin 220, paragrafi 2, deri në nenin 233.

Për qëllimet e kësaj llogaritjeje, shoqëria mëmë trajtohet si të ishte një shoqëri sigurimi ose risigurimi që i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në titullin I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksionet 1, 2 dhe 3 në lidhje me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe sikur t'i nënshtrohej të njëjtave kushte që përcaktohen në titullin I, kapitulli VI, seksioni 3, nënseksionet 1, 2 dhe 3 në lidhje me fondet e veta që mbulojnë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

NËNSEKSIONI 6

MBIKËQYRJA E AFTËSISË PAGUESE TË GRUPIT PËR GRUPET ME MENAXHIM TË CENTRALIZUAR TË RREZIKUT

Neni 236

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: kushtet

Shtetet anëtare parashikojnë që rregullat e përcaktuara në nenet 238 dhe 239 të zbatohen për çdo shoqëri sigurimi ose risigurimi e cila është filial i një shoqërie sigurimi ose risigurimi, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) filiali, në lidhje me të cilin mbikëqyrësi i grupit nuk ka marrë një vendim në zbatim të nenit 214, paragrafi 2, përfshihet në mbikëqyrjen e grupit që kryhet nga mbikëqyrësi i grupit në nivelin e shoqërisë mëmë në përputhje me këtë titull;

b) proceset e menaxhimit të rrezikut dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm të shoqërisë mëmë përfshijnë filialin dhe shoqëria mëmë bind autoritetet mbikëqyrëse përkatëse për administrimin e kujdesshëm të filialit;

c) shoqëria mëmë ka marrë dakordësinë e përmendur në nënparagrafin e tretë të nenit 246, paragrafi 4;

d) shoqëria mëmë ka marrë dakordësinë e përmendur në nenin 256, paragrafi 2;

e) shoqëria mëmë ka dorëzuar një aplikim për leje që t'i nënshtrohet neneve 238 dhe 239 dhe për këtë aplikim është marrë një vendim miratues në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 237.

Neni 237

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: vendimi për aplikimin

1. Në rastin e aplikimeve për leje për t'iu nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenet 238 dhe 239, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse punojnë së bashku brenda kolegjit të mbikëqyrësve, duke u konsultuar gjerësisht, për të vendosur nëse duhet të jepet ose jo leja e kërkuar dhe për të përcaktuar kushtet e tjera, nëse ka, të cilave duhet t'i nënshtrohet kjo leje.

Aplikimi i përmendur në nënparagrafin e parë i dorëzohet vetëm autoritetit mbikëqyrës që ka autorizuar filialin. Ky autoritet mbikëqyrës menjëherë informon dhe i përcjell aplikimin e plotë autoriteteve të tjera mbikëqyrëse brenda kolegjit të mbikëqyrësve.

2. Autoritetet mbikëqyrëse të përfshira bëjnë gjithçka që kanë në dorë për të arritur një vendim të përbashkët për aplikimin brenda tre muajve nga data e marrjes së aplikimit të plotë nga të gjithë autoritetet mbikëqyrëse që janë pjesë e kolegjit të mbikëqyrësve.

3. Gjatë periudhës së përmendur në paragrafin 2, në rast se ka pikëpamje të ndryshme për miratimin e aplikimit të përmendur në paragrafin 1, mbikëqyrësi i grupit ose secili prej autoriteteve të tjera mbikëqyrëse mund të konsultohet me CEIOPS. Gjatë kohës së konsultimit me CEIOPS informohen të gjitha autoritetet mbikëqyrëse të përfshira dhe periudha e përmendur në paragrafin 2 shtyhet me një muaj.

Kur janë bërë konsultime me CEIOPS, autoritetet mbikëqyrëse të përfshira marrin në konsideratë si duhet këshillën e tij përpara se të marrin vendimin e tyre të përbashkët.

4. Autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin i jep aplikantit vendimin e përbashkët që përmendet në paragrafët 2 dhe 3, ku përfshihen arsyet e plota dhe, kur është konsultuar CEIOPS, një shpjegim i devijimeve të konsiderueshme nga qëndrimi i mbajtur nga CEIOPS. Vendimi i përbashkët pranohet si përcaktues dhe zbatohet nga autoritetet mbikëqyrëse përkatëse.

5. Në mungesë të një vendimi të përbashkët të autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse brenda periudhave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, mbikëqyrësi i grupit e merr vetë vendimin për aplikimin.

Gjatë marrjes së vendimit, mbikëqyrësi i grupit merr siç duhet në konsideratë sa më poshtë:

a) çdo pikëpamje dhe rezervë që autoritetet mbikëqyrëse përkatëse kanë shprehur gjatë periudhës së zbatueshme;

b) çdo rezervë që autoritetet e tjera mbikëqyrëse që janë pjesë e kolegjit të mbikëqyrësve kanë shprehur gjatë periudhës së zbatueshme;

c) kur ka pasur konsultime me CEIOPS, këshillat e këtij të fundit.

Në vendim shprehen arsyet e plota dhe përfshihet një shpjegim për çdo devijim të konsiderueshëm nga rezervat e shprehura nga autoritetet mbikëqyrëse përkatëse dhe nga këshilla e CEIOPS. Mbikëqyrësi i grupit i dërgon një kopje të këtij vendimi aplikantit dhe autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse.

Neni 238

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: përcaktimi i kërkesës për kapital dhe aftësi paguese

1. Pa cenuar nenin 231, kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e filialit llogaritet siç përcaktohet në paragrafët 2, 4 dhe 5 të këtij neni.

2. Kur kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e një filiali llogaritet sipas një modeli të brendshëm të miratuar në nivel grupi në përputhje me nenin 231 dhe kur autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin gjykon se profili i tij i rrezikut ka devijime të konsiderueshme nga ky model i brendshëm, dhe për sa kohë që shoqëria nuk trajton si duhet shqetësimet e autoritetit mbikëqyrës, ky autoritet mbikëqyrës, në rastet e përmendura në nenin 37, mund të propozojë një paketë për shtimin e kapitalit për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese për këtë filial që rezulton nga zbatimi i këtij modeli, ose në rrethana përjashtimore kur ky shtim kapitali do të ishte i papërshtatshëm, ai mund t'i kërkojë shoqërisë që të llogarisë kërkesën për kapital dhe aftësi paguese sipas formulës standarde. Autoriteti mbikëqyrës e diskuton propozimin e tij brenda kolegjit të mbikëqyrësve dhe i komunikon filialit dhe kolegjit të mbikëqyrësve arsyet ku bazohet ky propozim.

3. Kur kërkesa për kapital dhe aftësi paguese e filialit llogaritet sipas formulës standarde dhe autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin gjykon se profili i tij i rrezikut ka devijime të konsiderueshme nga supozimet që mbështesin formulën standarde dhe për sa kohë që shoqëria nuk trajton siç duhet shqetësimet e autoritetit përgjegjës, ky autoritet, në rrethana përjashtimore, mund të propozojë që shoqëria të zëvendësojë një nëngrup të parametrave që janë përdorur në llogaritjen e formulës standarde me parametra specifike për këtë shoqëri gjatë llogaritjes së rrezikut të marrjes në sigurim për modulet e sigurimit jetë, jo-jetë dhe sigurimit të shëndetit, siç përcaktohet në nenin 110, ose në rastet e nenit 37, të caktojë një shtim kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të këtij filiali.

Autoriteti mbikëqyrës e diskuton propozimin e tij brenda kolegjit të mbikëqyrësve dhe i komunikon filialit dhe kolegjit të mbikëqyrësve arsyet ku bazohet ky propozim.

4. Kolegji i mbikëqyrësve bën gjithçka ka në dorë për të rënë dakord për propozimin e autoritetit mbikëqyrës që ka autorizuar filialin ose për masa të tjera të mundshme.

5. Kur autoriteti mbikëqyrës dhe mbikëqyrësi i grupit nuk bien dakord, brenda një muaji nga propozimi i autoritetit mbikëqyrës, çështja paraqitet për konsultim përpara CEIOPS, i cili jep këshillat e tij brenda dy muajve.

Përpara se të marrë vendimin e tij të prerë, autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar atë filial merr siç duhet në konsideratë këto këshilla.

Në vendim shprehen arsyet e plota dhe merren në konsideratë pikëpamjet dhe rezervat e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse që janë pjesë e kolegjit të mbikëqyrësve dhe këshilla nga CEIOPS.

Vendimi i dorëzohet filialit dhe kolegjit të mbikëqyrësve.

Neni 239

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: papajtueshmëria me kërkesat për aftësinë paguese dhe për kapitalin minimal

1. Në rast papajtueshmërie me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese dhe pa cenuar nenin 138, autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin i përcjell menjëherë kolegjit të mbikëqyrësve planin e rikuperimit të dorëzuar nga filiali me qëllim që, brenda gjashtë muajve nga vëzhgimi i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, të arrihet rivendosja e nivelit të pranueshëm të fondeve të veta ose ulja e profilit të rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Kolegji i mbikëqyrësve bën gjithçka që ka në dorë për të rënë dakord për propozimin e autoritetit mbikëqyrës në lidhje me miratimin e planit të rikuperimit brenda katër muajve nga data në të cilën është vëzhguar për herë të parë papajtueshmëria me kërkesën për kapital dhe aftësi paguese.

Në mungesë të dakordësisë, autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin, duke marrë në konsideratë pikëpamjet dhe rezervat e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse që janë pjesë e kolegjit të mbikëqyrësve, vendos nëse plani i rikuperimit duhet të miratohet.

2. Kur autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin, në përputhje me nenin 136 identifikon kushte financiare të përkeqësuar ai njofton menjëherë kolegjin e mbikëqyrësve për masat e propozuara që duhet të merren. Përveç se në situata emergjente, masat që duhet të merren diskutohen brenda kolegjit të mbikëqyrësve.

Kolegji i mbikëqyrësve bën gjithçka ka në dorë për të rënë dakord për masat e propozuara që duhet të merren brenda një muaji nga njoftimi.

Në mungesë të dakordësisë, autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin, duke marrë në konsideratë pikëpamjet dhe rezervat e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse që janë pjesë e kolegjit të mbikëqyrësve, vendos nëse masat e propozuara duhet të miratohet.

3. Në rast papajtueshmërie me kërkesën për kapital minimal dhe pa cenuar nenin 139, autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar filialin i përcjell menjëherë kolegjit të mbikëqyrësve skemën financiare afatshkurtër të dorëzuar nga filiali me qëllim që, brenda tre muajve nga vëzhgimi për herë të parë i papajtueshmërisë me kërkesën për kapital minimal, të arrihet rivendosja e nivelit të pranueshëm të fondeve të veta që mbulojnë kërkesën për kapital minimal ose ulja e profilit të rrezikut për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesën për kapital minimal. Kolegji i mbikëqyrësve gjithashtu informohet për çdo masë të marrë për të zbatuar kërkesën për kapital minimal në nivelin e filialit.

Neni 240

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: përfundimi i shfuqizimeve për një filial

1. Rregullat e parashikuara në nenet 238 dhe 239 reshtin së zbatuari kur:

a) nuk përmbushet kushti i përmendur në nenin 236, germa "a";

b) nuk përmbushet kushti i përmendur në nenin 236, germa "b" dhe grupi nuk rivendos pajtueshmërinë me këtë kusht brenda një periudhe kohore të përshtatshme;

c) nuk përmbushen më kushtet e përmendura në nenin 236, germa "c" dhe "c".

Në rastin e përmendur në germën "a" të nënparagrafit të parë, kur mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me kolegjin e mbikëqyrësve, vendos të mos përfshijë më filialin në mbikëqyrjen e grupit që ai kryen, ai informon menjëherë autoritetin mbikëqyrës përkatës dhe shoqërinë mëmë.

Për qëllimet e nenit 236, germa "b", "c" dhe "d", shoqëria mëmë është përgjegjëse për të garantuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me kushtet. Në rast papajtueshmërie, ajo informon menjëherë mbikëqyrësin e grupit dhe mbikëqyrësin e filialit në fjalë. Shoqëria mëmë paraqet një plan për rikuperimin e pajtueshmërisë brenda një periudhe kohore të përshtatshme.

Pa cenuar nënparagrafin e tretë, mbikëqyrësi i grupit verifikon të paktën një herë në vit, me iniciativën e tij, se vazhdon pajtueshmëria me kushtet e përmendura në nenin 236, germa "b", "c" dhe "d". Mbikëqyrësi i grupit e bën këtë verifikim edhe me kërkesë të autoritetit mbikëqyrës përkatës, kur ky i fundit paraqet shqetësime të konsiderueshme në lidhje me pajtueshmërinë e vazhdueshme me këto kushte.

Kur verifikimi identifikon pika të dobëta, mbikëqyrësi i grupit i kërkon shoqërisë mëmë të paraqesë një plan për rikuperimin e pajtueshmërisë brenda një periudhe kohore të përshtatshme.

Kur mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me kolegjin e mbikëqyrësve, vendos se plani i përmendur në nënparagrafin e tretë ose të pestë nuk mjafton ose nuk po zbatohet në vijim brenda periudhës kohore të rënë dakord, mbikëqyrësi i grupit del në përfundimin se nuk ka më pajtueshmëri me kushtet e përmendura në nenin 236, germa "b", "c" dhe ai informon menjëherë autoritetin mbikëqyrës përkatës.

2. Kur shoqëria mëmë dorëzon një aplikim të ri dhe merr një vendim mbështetës në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 237, regjimi i parashikuar në nenet 238 dhe 239 bëhet sërish i zbatueshëm.

Neni 241

Filialet e një shoqërie sigurimi ose risigurimi: masat zbatuese

Për të garantuar zbatimin uniform të neneve 236 deri në 240, Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë:

a) kriteret që duhet të zbatohen kur vlerësohet nëse janë përmbushur kushtet e përmendura në nenin 236;

b) kriteret që duhet të zbatohen kur vlerësohet se çfarë duhet të konsiderohet një situatë emergjente në zbatim të nenit 239, paragrafi 2; dhe

c) procedurat që duhet të ndjekin autoritetet mbikëqyrëse gjatë shkëmbimit të informacionit, ushtrimit të të drejtave të tyre dhe përmbushjes së detyrave të tyre në përputhje me nenet 237 deri në 240.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 242

Rishikimi

1. Përpara datës 31 tetor 2014 Komisioni vlerëson aplikimin e titullit III, në veçanti për sa i përket bashkëpunimit të autoriteteve mbikëqyrëse që janë pjesë të kolegjit të mbikëqyrësve dhe funksionalitetit të këtij të fundit, statusit ligjor të CEIOPS dhe praktikave mbikëqyrëse në lidhje me përcaktimin e shtimeve të kapitalit dhe i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të shoqëruar, sipas rastit, me propozime për ndryshimin e kësaj direktive.

2. Përpara datës 31 tetor 2015 Komisioni vlerëson përfitimet nga përmirësimi i mbikëqyrjes së grupit dhe menaxhimit të kapitalit brenda një grupi të shoqërive të sigurimit ose risigurimit, duke përfshirë një referencë për COM (2008)0119 dhe i raporton Komitetit për Çështjet Ekonomike dhe Monetare të Parlamentit Evropian për propozimin e datës 16 tetor 2008 (A6-0413/2008). Ky vlerësim përfshin masat e mundshme për të përmirësuar administrimin e mirë ndërkuftar të grupeve të sigurimit, kryesisht për rreziqet dhe menaxhimin e aktivitetit. Në vlerësimin e tij Komisioni, ndër të tjera, merr në konsideratë zhvillimet e reja dhe progresin në lidhje me:

- a) një kuadër të harmonizuar për ndërhyrjen e hershme;
- b) praktikat për menaxhimin e centralizuar të rrezikut në grup dhe funksionimin e modeleve të brendshme të grupit, duke përfshirë stres testet;
- c) transaksionet brenda grupit dhe përqendrimit e rrezikut;
- d) efektet e diversifikimit dhe përqendrimit me kalimin e kohës;
- e) një kuadër ligjor detyrues për ndërmjetësimin në mosmarrëveshjet mbikëqyrëse;
- f) një kuadër të harmonizuar për transferueshmërinë e aktiveve, paaftësinë paguese dhe procedurat e likuidimit që eliminojnë barrierat në ligjin kombëtar për shoqëritë tregtare ose ligjin për korporatat për sa i përket transferueshmërisë së aktiveve;
- g) një nivel ekuivalent mbrojtjeje për mbajtësit e policave dhe përfituesit e shoqërive të të njëjtit grup, veçanërisht në situata krize;
- h) një zgjidhje mbarevropiane e harmonizuar dhe e financuar siç duhet për skemat e garancive të sigurimit;

i) një kuadër i harmonizuar dhe me fuqi ligjore ndërmjet autoriteteve kompetente, bankave qendrore dhe ministrive të financës në lidhje me menaxhimin e krizës, ristrukturimin dhe ndarjen e barrës fiskale, i cili harmonizon kompetencat mbikëqyrëse me përgjegjësitë fiskale.

Komisioni i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të shoqëruar, sipas rastit, me propozimet për ndryshimin e kësaj direktive.

Neni 243

Filialet e një shoqërie kontrolluese sigurimi

Nenet 236 deri në 242 zbatohen rast pas rasti për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që janë filiale të një shoqërie kontrolluese sigurimi.

SEKSIONI 2

PËRQENDRIMI I RREZIKUT DHE TRANSAKSIONET BRENDA GRUPIT

Neni 244

Mbikëqyrja e përqendrimit të rrezikut

1. Mbikëqyrja e përqendrimit të rrezikut në nivel grupi kryhet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, nenin 246 dhe kapitullin III.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit ose shoqërive kontrolluese të sigurimit që t'i raportojnë rregullisht dhe të paktën një herë në vit mbikëqyrësit të grupit për çdo përqendrim rreziku të konsiderueshëm në nivel grupi.

Informacioni i nevojshëm i dorëzohet mbikëqyrësit të grupit nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit që kryeson grupin, ose, në rastet kur grupi nuk kryesohet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nga shoqëria kontrolluese e sigurimit ose nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit që identifikohet nga mbikëqyrësi i grupit pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë grupin.

Përqendrimet e rrezikut i nënshtrohen rishikimit mbikëqyrës nga mbikëqyrësi i grupit.

3. Mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me grupin, identifikon llojet e rreziqeve që shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit të një grupi të caktuar duhet të raportojnë në të gjitha rrethanat.

Kur përcakton ose jep mendimin për llojin e rreziqeve, mbikëqyrësi i grupit dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse marrin në konsideratë grupin specifik dhe strukturën e menaxhimit të rrezikut brenda grupit.

Për të identifikuar përqendrimin e rrezikut të konsiderueshëm që duhet të raportohet, mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me grupin, vendos

caqet e përshtatshme bazuar në kërkesat për kapital dhe aftësi paguese, provigjionet teknike ose të dyja.

Gjatë shqyrtimit të përqendrimeve të rrezikut, mbikëqyrësi i grupit monitoron në veçanti shpërndarjen e rrezikut nëpërmjet efektit zinxhir brenda grupit, rrezikun e konfliktit të interesave dhe nivelin ose volumin e rreziqeve.

4. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese në lidhje me përkufizimin dhe identifikimin e një përqendrimi të konsiderueshëm të rrezikut dhe raportimin e këtij përqendrimi të rrezikut, për qëllimet e paragrafëve 2 dhe 3.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 245

Mbikëqyrja e transaksioneve brenda grupit

1. Mbikëqyrja e transaksioneve brenda grupit ushtrohet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, nenin 246 dhe kapitullin III.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të sigurimit dhe risigurimit ose shoqërive kontrolluese të sigurimit që t'i raportojnë rregullisht dhe të paktën një herë në vit mbikëqyrësit të grupit të gjitha transaksionet e konsiderueshme brenda grupit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që ka grupi, duke përfshirë transaksionet me një person fizik që ka lidhje të ngushta me një nga shoqëritë e grupit.

Gjithashtu, shtetet anëtare kërkojnë që transaksionet shumë të rëndësishme brenda grupit të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Informacioni i nevojshëm i dorëzohet mbikëqyrësit të grupit nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit që kryeson grupin, ose, në rastet kur grupi nuk kryesohet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nga shoqëria kontrolluese e sigurimit ose nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit brenda grupit që identifikohet nga mbikëqyrësi i grupit pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë grupin.

Transaksionet brenda grupit i nënshtrohen rishikimit mbikëqyrës nga mbikëqyrësi i grupit.

3. Mbikëqyrësi i grupit, pasi konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me grupin, identifikon llojet e transaksioneve brenda grupit që shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit brenda grupit duhet të raportojnë në çdo rrethanë. Neni 244, paragrafi 3, zbatohet rast pas rasti.

4. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese në lidhje me përkufizimin dhe identifikimin e një transaksioni të rëndësishëm brenda grupit dhe për raportimin në lidhje me këtë transaksion, për qëllimet e paragrafëve 2 dhe 3.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

SEKSIONI 3

MENAXHIMI I RISKUT DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

Neni 246

Mbikëqyrja e sistemit rregullator

1. Kërkesa e përcaktuara në titullin I, kapitulli IV, seksioni 2 zbatohen rast pas rasti në nivel grupi.

Pa cenuar nënparagrafin 1, sistemet e menaxhimit të rrezikut dhe ato të kontrollit të brendshëm, dhe procedurat e raportimit zbatohen në mënyrë konsistente për të gjitha shoqëritë e përfshira në objektin e mbikëqyrjes në grup sipas nenit 213, paragrafi 2, gjerat "a" dhe "b", në mënyrë që këto sisteme dhe procedura të raportimit të mund të kontrollohen në nivel grupi.

2. Pa cenuar paragrafin 1, mekanizmat e kontrollit të brendshëm në grup duhet të përfshijnë të paktën të mëposhtmet:

a) mekanizma të përshtatshëm në lidhje me aftësinë paguese të grupit për të identifikuar të gjitha rreziqet materiale të marra përsipër dhe për t'i lidhur siç duhet fondet e veta me rreziqet;

b) procedura të sigurt raportimi dhe kontabiliteti për të monitoruar dhe menaxhuar transaksionet brenda grupit dhe përqendrimin e rrezikut.

3. Sistemet dhe procedurat e raportimit, të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, i nënshtrohen rishikimit mbikëqyrës të mbikëqyrësit të grupit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin III.

4. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë pjesëmarrëse të sigurimit ose risigurimit ose shoqërisë kontrolluese të sigurimit që të kryejë në nivel grupi vlerësimin që kërkohet në nenin 45. Vlerësimi i rrezikut të vet dhe i aftësisë paguese që kryhet në nivel grupi i nënshtrohen rishikimit mbikëqyrës nga mbikëqyrësi i grupit, në përputhje me kapitullin III.

Kur llogaritja e aftësisë paguese në nivel grupi kryhet në përputhje me metodën 1, siç përmendet në nenin 230, shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose risigurimit ose shoqëria kontrolluese e sigurimit i shpjegon mbikëqyrësit të grupit ndryshimin ndërmjet shumës së kërkesave për kapital dhe aftësi paguese të të gjitha shoqërive të lidhura të sigurimit ose risigurimit që përfshin grupi dhe kërkesën për kapital dhe aftësi paguese të konsoliduar për të gjithë grupin.

Kur shoqëria pjesëmarrëse e sigurimit ose risigurimit e shikon të përshtatshme dhe me miratim të mbikëqyrësit të grupit, ajo mund të bëjë çdo vlerësim që kërkohet nga neni 45 në nivel grupi dhe në nivel të çdo filiali të grupit në të njëjtën kohë dhe mund të përgatisë një dokument të vetëm që mbulon të gjitha vlerësimet.

Përpara se të japë miratimin në përputhje me nënparagrafin e tretë, mbikëqyrësi i grupit konsultohet me anëtarët e kolegjit të mbikëqyrësve dhe merr siç duhet në konsideratë pikëpamjet dhe rezervat e tyre.

Kur grupi ushtron opsionin e parashikuar në nënparagrafin e tretë, ai ia dorëzon dokumentin njëkohësisht të gjitha autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira. Ushtrimi i këtij opsioni nuk i përjashton filialet në fjalë nga detyrimi për të garantuar përmbushjen e kërkesave të nenit 45.

KAPITULLI III

MASAT QË LEHTËSOJNË MBIKËQYRJEN E GRUPIT

Neni 247

Mbikëqyrësi i grupit

1. Nga autoritetet mbikëqyrëse të përcaktuara në shtetet anëtare përkatëse zgjidhjet një mbikëqyrës i vetëm i cili është përgjegjës për koordinimin dhe ushtrimin e mbikëqyrjes së grupit (mbikëqyrësi i grupit)

2. Kur i njëjti autoritet mbikëqyrës është kompetent për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit të një grupi, detyra e mbikëqyrësit të grupit ushtrohet nga ai autoritet mbikëqyrës.

Në raste të tjera dhe në zbatim të paragrafit 3, detyra e mbikëqyrësit të grupit ushtrohet:

a) kur grupi kryesohet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nga autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar këtë shoqëri;

b) kur grupi nuk kryesohet nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nga autoriteti mbikëqyrës i identifikuar në përputhje me sa më poshtë:

I. kur shoqëria mëmë e një shoqërie sigurimi ose risigurimi është një shoqëri kontrolluese sigurimi, nga autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar atë shoqëri sigurimi ose risigurimi;

II. kur më shumë se një shoqëri sigurimi ose risigurimi me zyrë kryesore në Komunitet kanë si shoqëri mëmë të njëjtën shoqëri kontrolluese sigurimi, dhe njëra prej këtyre shoqërive është autorizuar në shtetin anëtar ku shoqëria kontrolluese e sigurimit ka zyrën kryesore, nga autoriteti mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit të autorizuar në atë shtet anëtar;

III. kur grupi kryesohet nga më shumë se një shoqëri kontrolluese sigurimi me zyrë kryesore në shtete të ndryshme anëtare dhe ka një shoqëri sigurimi ose risigurimi në secilin prej atyre shteteve anëtare, na autoriteti mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që ka bilancin total më të madh;

IV. kur më shumë se një shoqëri sigurimi ose risigurimi me zyrë kryesore në Komunitet kanë si shoqëri mëmë të njëjtën shoqëri kontrolluese sigurimi, dhe asnjëra prej këtyre shoqërive nuk është autorizuar në shtetin anëtar ku shoqëria kontrolluese e sigurimit ka zyrën kryesore, nga autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar shoqërinë e sigurimit ose risigurimit me bilancin total më të madh;

V. kur grupi është grup pa shoqëri mëmë, ose në çdo rrethanë që nuk përmendet në pikat I deri në IV, nga autoriteti mbikëqyrës që ka autorizuar shoqërinë e sigurimit ose risigurimit me buxhetin total më të madh.

3. Në raste të veçanta, autoritetet mbikëqyrëse të interesuara, me kërkesë të secilës prej autoriteteve, të marrë vendimin e përbashkët për të shfuqizuar nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 2, në të cilin rast zbatimi i tyre do ishte i papërshtatshëm, duke marrë parasysh strukturën e grupit dhe rëndësinë përkatëse të aktiviteteve të sipërmarrjeve të sigurimeve në shtete të ndryshme, si dhe për të dizajnuar një autoritet të ndryshëm mbikëqyrës si mbikëqyrës grupi.

Për këtë qëllim, secili nga autoritetet mbikëqyrëse të interesuara mund të kërkojë hapjen e diskutimeve mbi përshtatshmërinë e kriterëve të përmendura në paragrafin 2. Një diskutim i tillë nuk duhet të ndodhë më shpesh se një herë në vit.

Autoritetet mbikëqyrëse të përfshira bëjnë gjithçka kanë në dorë për të arritur një vendim të përbashkët për zgjedhjen e mbikëqyrësit të grupit brenda tre muajve nga kërkesa për diskutim. Përpara se të marrin vendimin, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse i japin grupit mundësinë që të shprehë mendimin e tij.

4. Gjatë periudhës tre mujore që përmendet në nënparagrafin e tretë të paragrafit 3, secili prej autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse mund të kërkojë që të bëhet një konsultim me CEIOPS. Në rast se bëhet konsultim me CEIOPS, kjo periudhë shtyhet me dy muaj.

5. Në rast se bëhet konsultim me CEIOPS, përpara se të marrin vendimin e tyre të përbashkët autoritetet mbikëqyrëse përkatëse marrin në konsideratë këshillën e CEIOPS. Në vendimin e përbashkët shprehen arsyet e plota dhe përfshihet një shpjegim për çdo devijim të konsiderueshëm nga këshilla e dhënë nga CEIOPS.

6. Në mungesë të një vendimi të përbashkët, duke shfuqizuar nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 2, detyra e mbikëqyrësit të grupit ushtrohet nga autoriteti mbikëqyrës i identifikuar në përputhje me paragrafin 2.

7. CEIOPS informon Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin, të paktën një herë në vit, për çdo vështirësi madhore në zbatimin e paragrafëve 2, 3 dhe 6.

Në rast se lindin vështirësi madhore në zbatimin e kriterëve të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, Komisioni miraton masa zbatuese që specifikojnë këto kriterë.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të intërsishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

8. Kur një shtet anëtar ka më shumë se një autoritet mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kujdeshme të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, ai merr masat e nevojshme për të garantuar koordinim ndërmjet këtyre autoriteteve.

Neni 248

Të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit të grupit dhe mbikëqyrësve të tjerë të kolegjit të mbikëqyrësve

1. Të drejtat dhe detyrimet që i caktohen mbikëqyrësit të grupit në lidhje me mbikëqyrjen e grupit përfshijnë sa më poshtë:

a) koordinimi i mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të rëndësishëm ose thelbësor për vijimësinë e punës dhe situatat emergjente, duke përfshirë shpërndarjen e informacionit me rëndësi për detyrën mbikëqyrëse të autoritetit mbikëqyrës;

b) shqyrtimi dhe vlerësimi mbikëqyrës i gjendjes financiare të grupit;

c) vlerësimi i pajtueshmërisë së grupit me rregullat për aftësinë paguese dhe i përqendrimit të rrezikut dhe transaksionet brenda grupit, siç përcaktohen në nenet 218 deri në 245;

d) vlerësimi i sistemit rregullator të grupit, siç përcaktohet në nenin 246 dhe i faktit nëse anëtarët e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të shoqërisë pjesëmarrëse i përmbushin ose jo kërkesat e përcaktuara në nenet 42 dhe 257;

e) planifikimi dhe koordinimi, nëpërmjet takimeve të rregullta që organizohen çdo vit ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme, i veprimtarive mbikëqyrëse gjatë vijimësisë së punës si edhe në situata emergjente, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse dhe duke marrë në konsideratë natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve që përfshijnë veprimtaritë e të gjitha shoqërive që janë pjesë e grupit;

f) detyra, masa dhe vendime të tjera që i jepen mbikëqyrësit të grupit nga kjo direktivë ose që lindin nga zbatimi i kësaj direktive, në veçanti ato që lidhen me kryesimin e procesit të vlerësimit të çdo modeli të brendshëm në nivel grupi, siç përcaktohet në nenet 231 dhe 233 dhe me kryesimin e procesit për të lejuar zbatimin e regjimit të përcaktuar në nenet 237 deri në 240.

2. Për të lehtësuar ushtrimin e detyrave të mbikëqyrjes së grupit që përmenden në paragrafin 1, duhet të ngrihet një kolegji mbikëqyrësish, i kryesuar nga mbikëqyrësi i grupit.

Kolegji i mbikëqyrësve sigurohet që bashkëpunimi, shkëmbimi i informacionit dhe proceset e konsultimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse që janë anëtarë të kolegjit të mbikëqyrësve të zbatohen siç duhet në përputhje me titullin III, me qëllim që të nxitet konvergjenca ndërmjet vendimeve dhe veprimtarive të tyre përkatëse.

3. Anëtarësia e kolegjit të mbikëqyrësve përfshin mbikëqyrësin e grupit dhe autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha shteteve anëtare ku ndodhen zyrat kryesore të të gjitha shoqërive filiale.

Autoritetet mbikëqyrëse të degëve të rëndësishme dhe shoqërive të lidhura gjithashtu lejohen që të marrin pjesë në kolegjin e mbikëqyrësve. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre kufizohet në arritjen e objektivit për një shkëmbim efikas të informacionit.

Funksionimi efikas i kolegjit të mbikëqyrësve mund të kërkojë që disa veprimtari të kryhen nga një numër më i vogël i autoriteteve mbikëqyrëse që janë pjesë e tij.

4. Pa cenuar asnjë nga masat e miratuara sipas kësaj direktive, ngritja dhe funksionimi i kolegjit të mbikëqyrësve bazohet në marrëveshjet e koordinimit të lidhura ndërmjet mbikëqyrësit të grupit dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të përfshira.

Në rast se ka pikëpamje të ndryshme në lidhje me marrëveshjet e koordinimit, çdo anëtar i kolegjit të mbikëqyrësve mund t'ia paraqesë çështjen CEIOPS.

Pasi konsultohet me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, mbikëqyrësi i grupit, përpara se të marrë vendimin e tij të prerë, merr në konsideratë çdo këshillë që CEIOPS ka dhënë brenda dy muajve nga marrja e kësaj këshille. Në vendim shprehen arsyet e plota dhe përfshihet një shpjegim për çdo devijim të konsiderueshëm nga këshilla e dhënë nga CEIOPS. Mbikëqyrësi i grupit ia përcjell vendimin autoriteteve të tjera mbikëqyrëse.

5. Pa cenuar asnjë nga masat e miratuara në zbatim të kësaj direktive, marrëveshjet e koordinimit që përmenden në paragrafin 4 specifikojnë procedurat për:

a) procesin e vendimmarrjes ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira në përputhje me nenet 231, 232 dhe 247;

b) konsultimit sipas paragrafit 4 të këtij neni dhe sipas nenit 218, paragrafi 5.

Pa cenuar të drejtat dhe detyrimet që i jep kjo direktivë mbikëqyrësit të grupit dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse, marrëveshjet e koordinimit mund t'i caktojnë detyra të tjera mbikëqyrësit të grupit ose autoriteteve të tjera mbikëqyrëse, kur kjo do të çonte në një mbikëqyrje më efikase të grupit dhe nuk do të pengonte veprimtaritë mbikëqyrëse të anëtarëve të kolegjit të mbikëqyrësve në lidhje me përgjegjësitë e tyre individuale.

Gjithashtu, marrëveshjet e koordinimit mund të përcaktojnë procedurat për:

a) konsultimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira, në veçanti siç përmendet në nenet 213 deri në 217, 219 deri në 221, 227, 244 deri në 246, 250, 256, 260 dhe 262;

b) bashkëpunimin me autoritetet e tjera mbikëqyrëse.

6. CEIOPS shtjellon udhëzimet për funksionimin operacional të kolegeve të mbikëqyrësve mbi bazën e rishikimeve gjithëpërfshirëse të punës së tyre me qëllim që të vlerësojë nivelin e konvergencës ndërmjet tyre. Këto rishikime kryhen të paktën çdo tre vjet. Shtetet anëtare sigurohen që mbikëqyrësi i grupit t'i transmetojë CEIOPS informacionin për funksionimin e kolegeve të mbikëqyrësve dhe për çdo vështirësi të hasur në lidhje me këto rishikime.

7. Komisioni miraton masat zbatuese për koordinimin e mbikëqyrjes së grupit për qëllimet e paragrafëve 1 deri në 6, duke përfshirë përkufizimin për "degë e rëndësishme".

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 249

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse

1. Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e shoqërive individuale të sigurimit dhe të risigurimit në një grup dhe mbikëqyrësi i grupit bashkëpunojnë ngushtë, veçanërisht në rastet kur një shoqëri sigurimi ose risigurimi has vështirësi financiare.

Me qëllim për të garantuar që autoritetet mbikëqyrëse, duke përfshirë mbikëqyrësin e grupit, kanë të njëjtën sasi informacioni në dispozicion, pa cenuar përgjegjësitë e tyre përkatëse, dhe pavarësisht nëse ata janë themeluar ose jo në të njëjtin shtet anëtar, ata ndajnë me njëri tjetrin informacionet përkatëse që lejojnë dhe lehtësojnë ushtrimin e detyrave mbikëqyrëse të autoriteteve të tjera në zbatim të kësaj direktive. Për këtë qëllim, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse dhe mbikëqyrësi i grupit i komunikojnë menjëherë njëri tjetrit të gjitha informacionet përkatëse sapo ata i marrin ato. Informacioni i përmendur në këtë nënparagraf përfshin, por nuk kufizohet me, informacionin për veprimet e grupit dhe autoriteteve mbikëqyrëse dhe informacionin e dhënë nga grupi.

2. Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e shoqërive individuale të sigurimit dhe risigurimit në një grup dhe mbikëqyrësi i grupit individualisht kërkojnë menjëherë një mbledhje të autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira në mbikëqyrjen e grupit të paktën në rrethanat e mëposhtme:

a) kur ata vihen në dijeni të një shkeljeje të konsiderueshme të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese ose të një shkeljeje të kërkesës për kapital minimal nga ana e një shoqërie individuale sigurimi ose risigurimi;

b) kur ata vihen në dijeni të një shkeljeje të konsiderueshme të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese në nivel grupi e llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara ose të kërkesës për kapital dhe aftësi paguese e agreguar për grupin, në përputhje me cilëndo metodë llogaritjeje që përdoret në përputhje me titullin III, kapitulli II, seksioni 1, nënseksioni 4;

c) kur po ndodhin ose kanë ndodhur rrethana të tjera përjashtimore.

3. Komisioni miraton masat zbatuese që përcaktojnë zërat që duhet të mblidhen, në mënyrë sistematike, nga mbikëqyrësi i grupit dhe t'i shpërndahen autoriteteve të tjera mbikëqyrëse ose t'i transmetohen mbikëqyrësit të grupit nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse.

Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë zërat thelbësore ose me rëndësi për mbikëqyrjen në nivel grupi me qëllim për të përmirësuar konvergjencën e raportimit mbikëqyrës.

Masat e përmendura në këtë paragraf, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore, sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 250

Konsultimi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse

1. Pa cenuar nenin 248, kur një vendim është me rëndësi për detyrat mbikëqyrëse të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse, përpara se të marrin këtë vendim autoritetet mbikëqyrëse konsultohen me njëri tjetrin brenda kolegjit të mbikëqyrësve në lidhje me sa më poshtë:

a) ndryshimet në strukturën e aksionarëve, strukturën organizative ose drejtuese të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit në grup, të cilat kërkojnë miratimin ose autorizimin e autoriteteve mbikëqyrëse; dhe

b) sanksionet madhore ose masat përjashtimore të marra nga autoritetet mbikëqyrëse, duke përfshirë vendosjen e një shtimi kapitali për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese në zbatim të nenit 37 dhe vendosjen e ndonjë kufizimi për përdorimin e një modeli të brendshëm për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese sipas titullit I, kapitulli VI, seksioni 4, nënseksioni 3.

Për qëllimet e germës "b", gjithmonë bëhen konsultime me mbikëqyrësin e grupit.

Gjithashtu, kur një vendim bazohet në informacionin e marrë nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, përpara se ta marrin këtë vendim autoritetet mbikëqyrëse përkatëse konsultohen me njëri tjetrin.

2. Pa cenuar nenin 248, autoriteti mbikëqyrës mund të vendosë të mos konsultohet në raste urgjente ose kur këto konsultime mund të cenojnë efikasitetin e vendimit. Në këtë rast, autoriteti mbikëqyrës informon menjëherë autoritetet mbikëqyrëse përkatëse.

Neni 251

Kërkesat që mbikëqyrësi i grupit i drejton autoriteteve të tjera mbikëqyrëse

Mbikëqyrësi i grupit mund të ftojë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku një shoqëri mëmë ka zyrën e saj kryesore dhe që vetë nuk kryejnë mbikëqyrje të grupit sipas nenit 247, që t'i kërkojnë shoqërisë mëmë çdo informacion që do të ishte me rëndësi për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të saj koordinuese, siç përcaktohen në nenin 248, dhe që t'ia transmetojnë këtë informacion mbikëqyrësit të grupit.

Mbikëqyrësi i grupit, kur ka nevojë për informacionin e përmendur në nenin 254, paragrafi 2, i cili tashmë i është dhënë një autoriteti tjetër mbikëqyrës, kontakton atë autoritet sapo të ketë mundësi me qëllim që të parandalojë dublikimin e raportimit tek autoritete të ndryshme të përfshirë në mbikëqyrje.

Neni 252

Bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse për institucionet e kreditit dhe firmat e investimit

Nëse shoqëria e sigurimit ose e risigurimit dhe, qoftë një institucion krediti, siç përkufizohet në Direktivën 2006/48/KE ose një firmë investimi, siç përkufizohet në Direktivën 2004/39/KE, ose të dyja bashkë, lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose kanë një shoqëri pjesëmarrëse të përbashkët, autoritetet mbikëqyrëse të interesuar dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre shoqërive të tjera bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet tyre.

Pa cenuar përgjegjësitë e tyre përkatëse, këto shkëmbejnë mes tyre çdo informacion që mund të thjeshtësojë detyrën e tyre, në veçanti atë që përcaktohet në këtë titull.

Neni 253

Sekreti profesional dhe konfidencialiteti

Shtetet anëtare autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve të tyre mbikëqyrëse dhe ndërmjet autoriteteve të tyre mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera, siç përmendet në nenet 249 deri në 252.

Informacioni i marrë në kuadër të mbikëqyrjes së grupit dhe në veçanti, çdo shkëmbim informacioni midis autoriteteve mbikëqyrëse dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera që parashikohet në këtë titull i nënshtrohet dispozitave të nenit 295.

Neni 254

Aksesi në informacion

1. Shtetet anëtare sigurohen që personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në objektin e mbikëqyrjes së grupit dhe shoqëritë e lidhura dhe shoqëritë pjesëmarrëse të tyre kanë mundësi ë të shkëmbejnë çdo informacion që do të ishte me rëndësi për qëllimet e mbikëqyrjes së grupit.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetet e tyre përgjegjëse për të ushtruar mbikëqyrjen e grupit të kenë qasje në çdo informacion me rëndësi për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje pavarësisht natyrës së shoqërisë në fjalë. Neni 35 zbatohet rast pas rasti.

Autoritetet mbikëqyrëse përkatëse mund t'i drejtohen direkt shoqërive të grupit për të marrë informacionin e nevojshëm vetëm kur ky informacion është kërkuar nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit në zbatim të mbikëqyrjes së grupit dhe nuk e kanë marrë atë brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

Verifikimi i informacionit

1. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre mbikëqyrëse të mund të kryejnë brenda territorit të tyre, ose direkt ose me ndërmjetësimin e personave që ata emërojnë për këtë qëllim, verifikimin në terren të informacionit që përmendet në nenin 254 në ambientet e njërës prej shoqërive në vijim:

- a) shoqërisë së sigurimit ose risigurimit që është objekt i mbikëqyrjes së grupit;
- b) shoqërive të lidhura të kësaj shoqërie sigurimi ose risigurimi;
- c) shoqërive mëmë të kësaj shoqërie sigurimi ose risigurimi;
- d) shoqërive të lidhura të një shoqërie mëmë të kësaj shoqërie sigurimi ose risigurimi.

2. Kur autoritetet mbikëqyrëse dëshirojnë që në raste specifike të verifikojnë informacionin në lidhje me një shoqëri, e rregulluar ose jo, e cila është pjesë e një grupi dhe ndodhet në një shtet tjetër anëtar, ata i kërkojnë autoriteteve mbikëqyrëse të atij shteti anëtar që të kryejë këtë verifikim.

Autoritetet që marrin një kërkesë të tillë, brenda kuadrit të kompetencave të tyre, veprojnë sipas kësaj kërkesë ose duke kryer verifikimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose duke lejuar një auditues ose ekspert që ta kryejë atë, ose duke lejuar autoritetin që ka bërë kërkesën që ta kryejë vetë verifikimin. Mbikëqyrësi i grupit informohet për veprimin e ndërmarrë.

Nëse ai nuk e kryen verifikimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, autoriteti mbikëqyrës që ka bërë kërkesën, nëse dëshiron, mund të marrë pjesë në verifikim.

Raport për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare të grupit

1. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive pjesëmarrëse të sigurimit dhe risigurimit ose shoqërive kontrolluese të sigurimit që të bëjnë publik, çdo vit, një raport për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare në nivel grupi. Nenet 51 dhe 53 deri në 55 zbatohen rast pas rasti.

2. Kur një shoqëri pjesëmarrëse e sigurimit ose e risigurimit ose një shoqëri kontrolluese sigurimi e shikon të përshtatshme dhe me miratim të mbikëqyrësit të grupit, ajo mund të përgatisë një raport të vetëm për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare, i cili përfshin:

- a) informacionin në nivel grupi, i cili duhet të bëhet publik në përputhje me paragrafin 1;
- b) informacionin për secilën nga filialet brenda grupit, i cili duhet të identifikohet individualisht dhe të bëhet publik në përputhje me nenet 51 dhe 53 deri në 55.

Përpara se të japë miratimin në përputhje me nënparagrafin e parë, mbikëqyrësi i grupit konsultohet me dhe merr në konsideratë çdo pikëpamje dhe rezervë të shprehur nga anëtarët e kolegjit të mbikëqyrësve.

3. Kur raporti i përmendur në paragrafin 2 nuk përfshin informacionin që autoriteti mbikëqyrës, i cili ka autorizuar një filial brenda grupit, i kërkon shoqërive të krahasueshme që të japin dhe kur informacioni i munguar është i konsiderueshëm, autoriteti mbikëqyrës përkatës ka autoritetin që t'i kërkojë filialit në fjalë që të publikojë informacionin e nevojshëm shtesë.

4. Komisioni miraton masat zbatuese që specifikojnë më tej informacionin që duhet nxjerrë dhe mënyrat me anë të së cilave duhet bërë diçka e tillë për sa i përket raportit të vetëm për aftësinë paguese dhe gjendjen financiare.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 257

Organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë kontrolluese të sigurimit.

Shtetet anëtare kërkojnë që të gjithë personat që drejtojnë shoqërinë kontrolluese të sigurimit të jenë të përshtatshëm për të kryer detyrat e tyre.

Neni 42 zbatohet rast pas rasti.

Neni 258

Masat për zbatim

1. Kur shoqëritë e sigurimit ose risigurimit në një grup nuk pajtohen me kërkesat e përmendura në nenet 218 deri në 246 ose kur kërkesat përmbushen por aftësia paguese gjithsesi mund të jetë në rrezik ose kur kërkesat brenda grupit ose përqendrimet e rrezikut mbeten një kërcënim për gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit ose risigurimit, institucionet në vijim kërkojnë marrjen e masave të nevojshme për të korrigjuar sa më parë këtë situatë:

- a) mbikëqyrësi i grupit në lidhje me shoqërinë kontrolluese të sigurimit;
- b) autoritetet mbikëqyrëse në lidhje me shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit.

Kur, në rastin e përmendur në germën "a" të nënparagrafit të parë, mbikëqyrësi i grupit nuk është një prej autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku shoqëria kontrolluese e sigurimit ka zyrën e saj kryesore, mbikëqyrësi i grupit njofton këto autoritete mbikëqyrëse për gjetjet e tij me qëllim që ata të mund të marrin masat e nevojshme.

Kur, në rastin e përmendur në germën "b" të nënparagrafit të parë, mbikëqyrësi i grupit nuk është një prej autoriteteve mbikëqyrëse të shtetit anëtar ku shoqëria e sigurimit ose

risigurimit ka zyrën e saj kryesore, mbikëqyrësi i grupit njofton këto autoritete mbikëqyrëse për gjetjet e tij me qëllim që ata të mund të marrin masat e nevojshme.

Pa cenuar paragrafin 2, shtetet anëtare përcaktojnë masat që mund të merren nga autoritetet e tyre mbikëqyrëse në lidhje me shoqëritë kontrolluese të sigurimit.

Autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, duke përfshirë mbikëqyrësin e grupit, sipas rastit, koordinojnë masat e tyre zbatuese.

2. Pa cenuar dispozitat e të drejtës së tyre penale, shtetet anëtare sigurohen që për shoqëritë kontrolluese të sigurimit që shkelin ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të miratuara për të zbatuar këtë titull, ose për personat që drejtojnë këto shoqëri të mund të vendosen sanksione ose të merren masa. Autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar që këto sanksione ose masa të jenë efikase, veçanërisht kur administrata qendrore ose selia e një shoqërie kontrolluese sigurimi nuk ndodhet në zyrën e saj kryesore.

3. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për koordinimin e masave të zbatimit që përmenden në paragrafët 1 dhe 2.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

Neni 259

Raportimi i CEIOPS

1. CEIOPS çdo vit paraqitet në Parlamentin Evropian për një seancë të përgjithshme dëgjimore në komisionin parlamentar. Kur kjo pjesëmarrje përkon me kërkesën për raportim nga CEIOPS në zbatim të nenit 71, paragrafi 3, kjo kërkesë përmbushet, për sa i përket Parlamentit Evropian, nga pjesëmarrja e CEIOPS në seancën dëgjimore.

2. Në seancën dëgjimore që përmendet në paragrafin 1, CEIOPS raporton, ndër të tjera, për të gjitha përvojat e rëndësishme të veprimtarive mbikëqyrëse dhe për bashkëpunimin ndërmjet mbikëqyrësve në kuadër të titullit III dhe në veçanti për:

a) procesin e emërimit të mbikëqyrësit të grupit, numrin e mbikëqyrësve të grupit dhe shpërndarjen gjeografike të tyre;

b) punimet e kolegjit të mbikëqyrësve, në veçanti përfshirjen dhe angazhimin e autoriteteve mbikëqyrëse, kur ata nuk janë mbikëqyrës të grupit.

3. Për qëllimet e paragrafit 1, CEIOPS mund të raportojë edhe për mësimet kryesore që janë nxjerrë nga rishikimet e përmendura në nenin 248, paragrafi 6, sipas rastit.

KAPITULLI IV

VENDET E TRETA

Shoqëritë mëmë jashtë komunitetit: verifikimi i ekuivalencës

1. Në rastin e përmendur në nenin 213, paragrafi 2, germa "c", autoritetet mbikëqyrëse përkatëse verifikojnë nëse shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëria mëmë e të cilave ka zyrën kryesore jashtë Komunitetit, i nënshtrohen mbikëqyrje, nga një autoritet mbikëqyrës i vendit të tretë, e cila është ekuivalente me mbikëqyrjen që parashikohet në këtë titull që parashikon mbikëqyrjen në nivel grupi të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, siç përmenden në nenin 213, paragrafi 2, germa "a" dhe "b".

Verifikimi kryhet nga autoriteti mbikëqyrës që do të ishte mbikëqyrës i grupit nëse do të zbatoheshin kriteret e përcaktuara në nenin 247, paragrafi 2, me kërkesë të shoqërisë mëmë ose të çdo shoqërie sigurimi dhe risigurimi të autorizuar në Komunitet, ose me iniciativën e vet, përveç se kur Komisioni ka dalë më parë në një përfundim në lidhje me ekuivalencën e vendit të tretë përkatës. Gjatë këtij verifikimi autoriteti mbikëqyrës konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe CEIOPS përpara se të marrë një vendim.

2. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që specifikojnë kriteret mbi të cilat vlerësohet nëse regjimi i kujdesshëm në një vend të tretë për mbikëqyrjen e grupeve është ekuivalent me atë që përcaktohet në këtë titull. Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të përmendur në nenin 301, paragrafi 3.

3. Pasi të konsultohet me Komitetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve dhe në përputhje me procedurën rregullatore që përmendet në nenin 301, paragrafi 2 dhe duke marrë në konsideratë kriteret e miratuara në përputhje me paragrafin 2, Komisioni mund marrë një vendim nëse regjimi i kujdesshëm për mbikëqyrjen e grupeve në një vend të tretë është ekuivalent me atë që përcaktohet në këtë titull.

Këto vendime rishikohen rregullisht për të marrë në konsideratë çdo ndryshim në regjimin e kujdesshëm për mbikëqyrjen e grupeve që përcaktohet në këtë titull dhe në regjimin e kujdesshëm në vendin e tretë për mbikëqyrjen e grupeve dhe çdo ndryshim tjetër në rregullim që mund të ndikojë në vendimin për ekuivalencën.

Kur Komisioni ka miratuar një vendim në përputhje me nënparagrafin e parë në lidhje me një vend të tretë, ky vendim njihet si përcaktues për qëllimet e verifikimit që përmendet në paragrafin 1.

Shoqëritë mëmë jashtë komunitetit: ekuivalenca

1. Në rastin e mbikëqyrjes ekuivalente që përmendet në nenin 260, shtetet anëtare mbështeten në mbikëqyrjen ekuivalente të grupit që ushtrohet nga autoritetet mbikëqyrëse të vendit të tretë, në përputhje me paragrafin 2.

2. Nenet 247 deri në 258 zbatohen rast pas rasti për bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta.

Neni 262

Shoqëritë mëmë jashtë komunitetit: mungesa e ekuivalencës

1. Në mungesë të mbikëqyrjes ekuivalente që përmendet në nenin 260, për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit shtetet anëtare zbatojnë ose nenet 218 deri në 258, rast pas rasti dhe me përjashtim të neneve 236 deri në 243, ose një prej metodave të përcaktuara në paragrafin 2.

Parimet dhe metodat e përgjithshme që përcaktohen në nenet 218 deri në 258 zbatohen në nivelin e shoqërisë kontrolluese të sigurimit, shoqërisë së sigurimit të një vendi të tretë ose shoqërisë së sigurimit të një vendi të tretë.

Vetëm për të llogaritur aftësinë paguese të grupit, shoqëria mëmë trajtohet sikur të ishte një shoqëri sigurimi ose risigurimi që i nënshtrohet të njëjtave kushte që përcaktohen në titullin I, kapitulli VI, seksioni 3, nënseksionet 1, 2 dhe 3 për sa i përket fondeve të veta të pranueshme për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese ose për sa më poshtë:

a) një kërkesë për kapital dhe aftësi paguese të përcaktuar në përputhje me parimet e nenit 226 në rastin e një shoqërie kontrolluese sigurimi;

b) një kërkesë për kapital dhe aftësi paguese të përcaktuar në përputhje me parimet e nenit 227, në rastin e një shoqërie sigurimi të një vendi të tretë ose një shoqërie risigurimi të një vendi të tretë.

2. Shtetet anëtare lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse që të zbatojnë metoda të tjera që garantojnë mbikëqyrjen e përshtatshme të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit në një grup. Këto metoda duhet të miratohen nga mbikëqyrësi i grupit pas konsultimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të përfshira.

Autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë në veçanti themelimin e një shoqërie kontrolluese sigurimi me zyrë kryesore në Komunitet dhe të zbatojnë këtë titull për shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit që janë pjesë e grupit të kryesuar nga kjo shoqëri kontrolluese sigurimi.

Metodat e zgjedhura duhet të garantojnë arritjen e objektivave për mbikëqyrjen e grupit, siç përcaktohen në këtë titull, dhe duhet t'i njoftohen autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të përfshira dhe Komisionit.

Neni 263

Shoqëritë mëmë jashtë komunitetit: nivelet

Kur shoqëria mëmë që përmendet në nenin 260 është në vetvete një filial i një shoqërie kontrolluese sigurimi me zyrë kryesore jashtë komunitetit ose i një shoqërie sigurimi ose risigurimi të një vendi të tretë, shtetet anëtare bëjnë verifikimin e parashikuar në nenin 260 vetëm

në nivelin e shoqërisë mëmë kryesore që është një shoqëri kontrolluese sigurimi e një vendi të tretë, një shoqëri sigurimi e një vendi të tretë ose një shoqëri risigurimi e një vendi të tretë.

Megjithatë, shtetet anëtare, në mungesë të mbikëqyrjes ekuivalente që përmendet në nenin 260, lejojnë autoritetet e tyre mbikëqyrëse që të vendosin të kryejnë një verifikim të ri në një nivel më të ulët kur shoqëritë e sigurimit ose risigurimit kanë një shoqëri mëmë, qoftë kjo një shoqëri kontrolluese sigurimi në një vend të tretë, një shoqëri sigurimi në një vend të tretë ose një shoqëri risigurimi në një vend të tretë.

Në këtë rast, autoriteti mbikëqyrës që përmendet në nënparagrafin e dytë të nenit 260, paragrafi 1 duhet t'i shpjegojë grupit vendimin e tij.

Neni 262 zbatohet rast pas rasti.

Neni 264

Bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të vendit të tretë

1. Komisioni mund t'i dorëzojë Këshillit propozime për negocimin e marrëveshjeve me një ose më shumë vende të treta në lidhje me mjetet për ushtrimin e mbikëqyrjes në grup për:

a) shoqëritë e sigurimit ose risigurimit që kanë, si shoqëri pjesëmarrëse, shoqëri sipas kuptimit të nenit 213, që kanë zyrën kryesore në një vend të tretë; dhe

b) shoqëritë e sigurimit të një vendi të tretë ose shoqëritë e risigurimit të një vendi të tretë që kanë, si shoqëri pjesëmarrëse, shoqëri sipas kuptimit të nenit 213, që kanë zyrën kryesore në Komunitet.

2. Marrëveshjet e përmendura në paragrafin 1 duhet të garantojnë, në veçanti, që:

a) autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen në nivel grupi të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që kanë zyrën kryesore në Komunitet dhe që kanë filiale ose zotërojnë pjesëmarrje në shoqëri jashtë Komunitetit; dhe

b) autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen në nivel grupi të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit të vendeve të treta që kanë zyrën kryesore në territoret e tyre dhe që kanë filiale ose zotërojnë pjesëmarrje në shoqëri që ndodhen në një ose më shumë shtete anëtare.

3. Pa cenuar nenin 300, paragrafi 1 dhe 2 të Traktatit, Komisioni, me ndihmën e Komitetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve, shqyrton rezultatin e negociatave të përmendura në paragrafin 1.

KAPITULLI V

SHOQËRI KONTROLLUESE SIGURIMI ME VEPRIMTARI TË PËRZIER

Neni 265

Transaksionet brenda grupit

1. Kur shoqëria mëmë e një ose më shumë shoqërive të sigurimit ose risigurimit është një shoqëri kontrolluese sigurimi me veprimtari të përzier, shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre shoqërive të sigurimit ose risigurimit të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme të transaksioneve ndërmjet këtyre shoqërive të sigurimit ose risigurimit dhe shoqërisë kontrolluese të sigurimit me veprimtari të përzier dhe shoqërive të lidhura me të.

2. Nenet 245, 249 deri në 255 dhe neni 258 zbatohen rast pas rasti.

Neni 266

Bashkëpunimi me vende të treta

Për sa i përket bashkëpunimit me vende të treta, neni 264 zbatohet rast pas rasti.

TITULLI IV

RIORGANIZIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

KAPITULLI I

FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 267

Fusha e zbatimit të këtij titulli

Ky titull zbatohet për masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit në lidhje me ato si më poshtë:

- a) shoqëritë e sigurimit;
- b) degët e shoqërive të sigurimit të vendeve të treta që ndodhen në territorin e Komunitetit.

Neni 268

Përkufizime

1. Për qëllimin e këtij titulli vlejné përkufizimet e mëposhtme:

- a) "autoritete kompetente" janë autoritetet administrative ose gjyqësore të shteteve anëtare, që janë kompetente për qëllimet e masave të riorganizimit ose për procedurat e likuidimit;

b) "degë" është një zyrë e përhershme e një shoqërie të sigurimit në territorin e një shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, e cila zhvillon veprimtari sigurimi;

c) "masa riorganizimi" janë masat që përfshijnë çdo ndërhyrje nga ana e autoriteteve kompetente të cilat synojnë të ruajnë ose rikthejnë gjendjen financiare të një shoqërie sigurimi dhe që ndikojnë të drejtat paraprake të palëve, përveç vetë shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, masat që përfshijnë mundësinë e pezullimit të pagesave, pezullimit të masave të zbatimit ose reduktimit të dëmeve;

d) "procedurat e likuidimit" janë procedurat kolektive që përfshijnë realizimin e aktiveve të një ndërmarrjeje të sigurimit dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmjet kreditorëve, aksionarëve ose anëtarëve, sipas rastit, që përfshijnë domosdoshmërisht çdo ndërhyrje nga autoritetet kompetente, duke përfshirë rastin kur procedimet kolektive përfundojnë përmes përbërjes ose çdo mase tjetër analoge, qoftë kur ato bazohen në likuidimin ose janë vullnetare ose të detyrueshme;

e) "administrator" është personi ose organi i emëruar nga autoritetet kompetente për qëllimet e administrimit të masave të riorganizimit;

f) "likuidues" është personi ose organi i emëruar nga autoritetet kompetente ose nga organet qeverisëse të një shoqërie sigurimi, për qëllimet e administrimit të procedurave të likuidimit;

g) "dëm në sigurime" është shuma që shoqëria e sigurimit i detyrohet personave të siguruar, mbajtësve të policave, përfituesve ose çdo pale të dëmtuar që ka të drejtë direkte për veprim kundër shoqërisë së sigurimit dhe që lind nga kontrata e sigurimit ose nga një operacion që parashikohet në nenin 2, paragrafi 3, germa "b" dhe "c", në veprimtaritë e sigurimit të drejtpërdrejtë, duke përfshirë shumën e ndarë mënjantë për këto persona, kur disa elemente të borxhit nuk dihen ende.

Premiumi në pronësi të një ndërmarrjeje të sigurimit, si rezultat i mospërfshirjes ose anulimit të një kontrate të sigurimit ose të operacionit të përmendur në germën g të nënparagrafit të parë, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për këtë kontratë ose operacion, përpara hapjes së procedurave të falimentimit, gjithashtu do të konsiderohet një dëmshpërblim i sigurimit.

2. Për qëllimin e zbatimit të këtij titulli për masat e riorganizimit dhe për procedurat e falimentimit, në lidhje me degën e ndodhur në një shtet anëtar të një ndërmarrjeje sigurimi të vendit të tretë, zbatohen përkufizimet si më poshtë:

a) "shtet anëtar i origjinës" është shteti anëtar ku dega ka marrë autorizimin në përputhje me nenet 145 deri në 149;

b) "autoritete mbikëqyrëse" janë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës;

c) "autoritete kompetente" janë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës.

KAPITULLI II

MASAT E RIORGANIZIMIT

Neni 269

Miratimi i ligjit të zbatueshëm për masat e riorganizimit

1. Vetëm autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës duhet të kenë të drejtën të vendosin për masat e riorganizimit në lidhje me shoqërinë e sigurimit, duke përfshirë degët e saj.
2. Masat e riorganizimit nuk përjashtojnë hapjen e procedurave të likuidimit nga shteti anëtar i origjinës.
3. Masat e riorganizimit rregullohen nga ligjet, rregulloret dhe procedurat e zbatueshme në shtetin anëtar të origjinës, përveç se kur parashikohet ndryshe në nenet 285 deri në 292.
4. Masat e riorganizimit së bashku me legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës duhet të zbatohen plotësisht në të gjithë Komunitetin pa formalitete të mëtejshme, duke përfshirë edhe kundër palëve të treta në shtete të tjera anëtare, edhe kur legjislacioni i atyre shteteve të tjera anëtare nuk parashikon këto masa riorganizimi ose për zbatimin e tyre vendos kushte të cilat nuk janë përmbushur.
5. Sapo masat e riorganizimit hyjnë në fuqi në shtetin anëtar të origjinës, ato duhet të hyjnë në fuqi në të gjithë Komunitetin.

Neni 270

Informacioni për autoritetet mbikëqyrëse

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar, në lidhje me vendimin e tyre për ndonjë masë riorganizimi, kur është e mundur, përpara miratimit të kësaj mase, dhe në pamundësi të kësaj, menjëherë pas miratimit të saj.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha shteteve të tjera anëtare mbi vendimin për miratimin e masave të riorganizimit, duke përfshirë ndikimet e mundshme praktike të këtyre masave.

Neni 271

Publikimi i vendimeve në lidhje me masat e riorganizimit

1. Kur në shtetin anëtar të origjinës ekziston mundësia për të apeluar një masë riorganizimi, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, administratori ose çdo person që ka të drejtën që ta bëjë diçka të tillë në shtetin anëtar të origjinës bën publik vendimin për një masë riorganizimi në përputhje me procedurat e publikimit që parashikohen në shtetin anëtar të origjinës dhe më pas publikon, sa më shpejt që të jetë e mundur, në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian një ekstrakt nga dokumenti që përcakton masën e riorganizimit.

Autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera anëtare që janë informuar për vendimin për një masë riorganizimi në përputhje me nenin 270 mund të sigurojnë publikimin e këtij vendimi brenda territorit të tyre sipas mënyrës që ata gjykojnë të përshtatshme.

2. Publikimet e parashikuara në paragrafin 1 specifikojnë autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, ligjin e zbatueshëm, siç parashikohet në nenin 269, paragrafi 3, dhe administratorin e emëruar, nëse ka. Publikimet bëhen në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar ku publikohet informacioni.

3. Masat e riorganizimit zbatohen pavarësisht dispozitave për publikimin që përcaktohen në paragrafët 1 dhe 2 dhe hyjnë plotësisht në fuqi kundrejt kreditorëve, përveç se kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose ligji i atij shteti anëtar e parashikon ndryshe.

4. Kur masat e riorganizimit ndikojnë ekskluzivisht të drejtat e aksionarëve, anëtarëve ose punonjësve të një shoqërie sigurimi, të konsideruar në këto cilësi, paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen përveç se kur ligji i zbatueshëm për masat e riorganizimit e parashikon ndryshe.

Autoritetet kompetente përcaktojnë mënyrën në të cilën palët e përmendura në nënparagrafin e parë duhet të informohen në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Neni 272

Informacioni për kreditorët e njohur për të drejtën e tyre për të paraqitur pretendime

1. Kur legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës kërkon që një pretendim duhet të paraqitet me qëllim që ai të njihet ose parashikon njoftimin e detyrueshëm të një mase riorganizimi të kreditorët me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në atë shtet anëtar, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose administratori informojnë kreditorët e njohur me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në një shtet tjetër anëtar, në përputhje me nenin 281 dhe nenin 283, paragrafi 1.

2. Kur legjislacioni i shtetit anëtar parashikon të drejtën e kreditorëve me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në atë shtet anëtar që të paraqesin pretendime ose të dorëzojnë vëzhgime në lidhje me pretendimet e tyre, kreditorët me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në një shtet tjetër anëtar gëzojnë të njëjtën të drejtë në përputhje me nenin 282 dhe nenin 283, paragrafi 2.

KAPITULLI III

PROCEDURAT E LIKUIDIMIT

Neni 273

Hapja e informacionit mbi procedurat e likuidimit për autoritetet mbikëqyrëse

1. Vetëm autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës duhet të kenë të drejtën për marrjen e një vendimi lidhur me hapjen e procedurave të likuidimit në lidhje me shoqëritë e

sigurimit, duke përfshirë degët në shtetet e tjera anëtare. Ky vendim mund të merret në mungesë ose në vijim të masave të riorganizimit.

2. Një vendim në lidhje me hapjen e procedurave të likuidimit të një shoqërie sigurimi, duke përfshirë degët e saj në shtetet e tjera anëtare, e miratuar në përputhje me legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës, njihet pa formalitet të mëtejshëm në të gjithë Komunitetin dhe hyjnë në fuqi menjëherë pasi vendimi të hyjë në fuqi në shtetin anëtar në të cilin hapen procedurat.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar në lidhje me vendimin e hapjes së procedurave të likuidimit, kur është e mundur, përpara hapjes së procedurave, dhe në pamundësi të kësaj, menjëherë pas hapjes së tyre.

Autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha shteteve të tjera anëtare mbi vendimin për hapjen e procedurave të likuidimit, duke përfshirë ndikimet e mundshme praktike të këtyre procedurave.

Neni 274

Ligji i zbatueshëm

1. Vendimi për hapjen e procedurave të likuidimit në lidhje me shoqërinë e sigurimit, këto të fundit dhe ndikimet pasuese rregullohen nga ligjet e zbatueshme në shtetin anëtar të origjinës, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenet 285 deri në 292.

2. Legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës përcakton të paktën sa më poshtë:

a) aktivet që janë pjesë e pronave të patundura dhe trajtimin e aktiveve të marra nga ose që i transferohen shoqërisë së sigurimit pas hapjes së procedurave të likuidimit;

b) kompetencat përkatëse të shoqërisë së sigurimit dhe likuduesit;

c) kushtet sipas të cilave mund të kërkohet kompensim;

d) efektet e procedurave të likuidimit në kontratat aktuale në të cilat shoqëria e sigurimit është palë;

e) efektet e procedurave të likuidimit mbi procedurat e nisura nga kreditorët individualë, me përjashtim të padive të pezulluara që përmenden në nenin 292;

f) pretendimet që duhet të ngrihen kundrejt pronave të patundura të shoqërisë së sigurimit dhe trajtimin e pretendimeve që lindin pas hapjes së procedurave të likuidimit;

g) rregullat që rregullojnë paraqitjen, verifikimin dhe pranimin e pretendimeve;

h) rregullat që rregullojnë shpërndarjen e procedurave nga realizimi i aktiveve, radhitja e pretendimeve dhe të drejtat e kreditorëve që janë plotësuar pjesërisht pas hapjes së procedurave të likuidimit nëpërmjet të drejtës sendore (in rem) ose nëpërmjet një kompensimi;

i) kushtet për dhe efektet e mbylljes së procedurave të likuidimit, në veçanti nëpërmjet shlyerjes së pjeshme të borxhit;

j) të drejtat e kreditorëve pas mbylljes së procedurave të likuidimit;

k) palën që do të mbulojë koston dhe shpenzimet e procedurave të likuidimit; dhe

l) rregullat që lidhen me pavlefshmërinë, mundësinë e anulimit dhe pazbatueshmërinë e akteve ligjore në dëm të të gjithë kreditorëve.

Neni 275

Trajtimi i dëmeve në sigurime

1. Shtetet anëtare sigurohen që dëmet në sigurime të kenë përparësi kundrejt të gjitha pretendimeve të tjera kundër shoqërisë së sigurimit nëpërmjet njërës ose të dyja mënyrave të mëposhtme:

a) në lidhje me aktivet që përfaqësojnë provigjonet teknike, dëmet në sigurime kanë përparësi absolute mbi çdo pretendim tjetër kundër shoqërisë së sigurimit; ose

b) në lidhje me tërësinë e aktiveve të shoqërisë së sigurimit, dëmet në sigurime kanë përparësi mbi çdo pretendim tjetër kundër shoqërisë së sigurimit, vetëm me përjashtim të sa më poshtë:

I. pretendimet e punonjësve që lindin nga kontratat e punësimit dhe marrëdhëniet e punësimit;

II. pretendimet nga organet publike për tatimet;

III. pretendimet nga sistemet e sigurimeve shoqërore;

IV. pretendimet për aktivet që i nënshtrohen të drejtës sendore (in rem).

2. Pa cenuar paragrafin 1, shtetet anëtare mund të parashikojnë që të gjitha ose një pjesë e shpenzimeve që lindin nga procedurat e likuidimit, siç përcaktohen nga legjislacioni i tyre i brendshëm, të kenë përparësi mbi dëmet në sigurime.

3. Shtetet anëtare që kanë zgjedhur opsionin e parashikuar në paragrafin 1, germa "a", i kërkojnë shoqërive të sigurimit që të krijojnë dhe të mbajnë të përditësuar një regjistër të veçantë në përputhje me nenin 276.

Neni 276

Regjistri i veçantë

1. Çdo shoqëri sigurimi duhet të mbajë në zyrën kryesore një regjistër të veçantë të aktiveve që përdoren për të mbuluar provigjonet teknike të llogaritura dhe të investuara në përputhje me legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës.

2. Kur një shoqëri sigurimi kryen veprimtari të sigurimit jetë dhe jo-jetë, ajo duhet të mbajë në zyrën e saj kryesore regjistra të ndarë për secilin nga llojet e veprimtarive.

Megjithatë, kur një shtet anëtar autorizon shoqëritë e sigurimit që të mbulojnë sigurimin e jetës dhe rreziqet e përfshira në klasat 1 dhe 2 të pjesës A të shtojcës I, ai mund të parashikojë që këto shoqëri sigurimi të jenë të detyruara të mbajnë një regjistër të vetëm për të gjitha veprimtaritë e tyre.

3. Vlera totale e aktiveve të regjistruara, të vlerësuara në përputhje me legjislacionin e zbatuar në shtetin anëtar të origjinës nuk duhet të jetë asnjëherë më e vogël se vlera e provigjoneve teknike.

4. Kur një aktiv i regjistruar në regjistër i nënshtrohet të drejtës sendore (in rem) në favor të një kreditori ose një pale të tretë, dhe për rrjedhojë ajo pjesë e vlerës së aktivit nuk është e disponueshme për të mbuluar angazhimet, ky fakt regjistrohet në regjistër dhe shuma e padisponueshme nuk përfshihet në vlerën totale që përmendet në paragrafin 3.

5. Trajtimi i një aktivi në rastin e likuidimit të një shoqërie sigurimi në lidhje me opsionin e parashikuar në nenin 275, paragrafi 1, germa "a", përcaktohet nga legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës, përveç se kur për këtë aktiv zbatohen nenet 286, 287 ose 288, në rastet kur:

a) aktivi që përdoret për të mbuluar provigjonet teknike i nënshtrohet të drejtës sendore (in rem) në favor të një kreditori ose një pale të tretë, pa plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin 4;

b) ky aktiv i nënshtrohet marrjes së pronësisë në favor të një kreditori ose një pale të tretë; ose

c) kreditori ka të drejtën të kërkojë kompensim për pretendimin e tij kundër shoqërisë së sigurimit.

6. Sapo procedurat e likuidimit të hapen, përbërja e aktiveve të regjistruara në regjistër, në përputhje me paragrafët 1 deri në 5 nuk ndryshohet dhe nuk bëhet asnjë korrigjim tjetër në regjistër përveç regjistrimit të gabimeve ortografike, përveç se me autorizim të autoritetit kompetent.

Megjithatë, likuiduesit i shtojnë këtyre aktiveve fitimet që merren prej tyre dhe vlerën e primeve të pastra të marra në lidhje me klasën përkatëse të sigurimit nga hapja e procedurave të likuidimit deri në kohën e pagesës së dëmeve në sigurime ose deri sa të bëhet ndonjë transferim i portofolit.

7. Kur produkti i realizimit të aktiveve është më i vogël se vlera e tyre e parashikuar në regjistra, likuiduesit duhet t'ia justifikojnë këtë autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare të origjinës.

Neni 277

Transferimi në një skemë garancie

Shteti anëtar i origjinës mund të parashikojë që, në rastet kur të drejtat e kreditorëve në sigurime janë transferuar në një skemë garancie të krijuar në atë shtet anëtar, pretendimet nga kjo skemë nuk përfitojnë nga dispozitat e nenit 275, paragrafi 1.

Neni 278

Përfaqësimi i pretendimeve preferenciale me aktiveve

Shtetet anëtare që zgjedhin opsionin e përcaktuar në nenin 275, paragrafi 1, germa "b" i kërkojnë çdo shoqërie sigurimi që të garantojë se pretendimet që mund të kenë përparësi mbi çdo dëme në sigurime sipas nenit 275, paragrafi 1, germa "b" dhe që janë regjistruar në llogaritë e shoqërisë së sigurimit, të përfaqësohen, në çdo kohë dhe pavarësisht nga ndonjë likuidim i mundshëm, me aktive.

Neni 279

Tërheqja e autorizimit

1. Kur vendoset hapja e procedurave të likuidimit në lidhje me një shoqëri sigurimi, autorizimi i kësaj shoqërie tërhiqet në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 144, deri në masën që nevojitet për qëllimet e paragrafit 2.

2. Tërheqja e autorizimit sipas paragrafit 1 nuk e ndalon likuiduesin ose çdo person të emëruar nga autoritetet kompetente, që të ndjekë disa prej aktiviteteve ose sipërmarrjeve të sigurimit, për sa kohë është e nevojshme ose e përshtatshme për qëllime të likuidimit.

Shteti anëtar i origjinës mund të sigurojë ndjekjen e këtyre aktiviteteve, me miratim dhe sipas mbikëqyrjes së autoriteteve mbikëqyrëse të atij shteti anëtar.

Neni 280

Botimi i vendimeve për procedurat e likuidimit

1. Autoriteti kompetent, likuiduesi ose çdo person tjetër i emëruar për këtë qëllim nga autoriteti kompetent publikon vendimin për të hapur procedurat e likuidimit në përputhje me procedurat e publikimit të parashikuara në shtetin anëtar të origjinës dhe gjithashtu publikon një ekstrakt të vendimit të likuidimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha shteteve të tjera anëtare që janë informuar për vendimin për hapjen e procedurave të likuidimit në përputhje me nenin 273, paragrafi 3, mund të sigurojnë publikimin e këtij vendimi brenda territorit të tyre sipas mënyrës që ata gjykojnë të përshtatshme.

2. Publikimi i përmendur në paragrafin 1 specifikon autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, ligjin e zbatueshëm dhe likuiduesin e emëruar. Ai bëhet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar ku publikohet informacioni.

Neni 281

Informacioni për kreditorët e njohur

1. Kur hapen procedurat e likuidimit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, likuiduesi ose çdo person i emëruar për këtë qëllim nga autoritetet kompetente informon menjëherë në mënyrë individuale, me anë të një njoftimi me shkrim, çdo kreditor të njohur me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në një shtet tjetër anëtar.

2. Njoftimi i përmendur në paragrafin 1 përfshin afatet kohore, sanksionet e vendosura në lidhje me këto afate kohore, organin ose autoritetin kompetent për të pranuar pretendimet ose vëzhgimet në lidhje me pretendimet dhe me çdo masë tjetër.

Njoftimi tregon nëse kreditorët me pretendime preferenciale ose të siguruara nga e drejta sendore (in rem) duhet të paraqesin pretendimet e tyre.

Në rastin e dëmeve në sigurime, njoftimi duhet të tregojë më tej ndikimet e përgjithshme të procedurave të likuidimit mbi kontratat e sigurimit, në veçanti datën në të cilën kontratat e sigurimit ose operacionet nuk do të kenë më efekte e nuk do të mbulojnë më të drejtat dhe detyrimet e personave të siguruar, në lidhje me kontratën ose operacionin.

Neni 282

E drejta për të paraqitur pretendime

1. Çdo kreditor, duke përfshirë autoritetet publike të shteteve anëtare me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, kanë të drejtë të paraqesin pretendime ose të dorëzojnë komente me shkrim në lidhje me pretendimet.

2. Pretendimet e të gjithë kreditorëve të përmendur në paragrafin 1 trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe i jepet i njëjti vlerësim si pretendimet me natyrë ekuivalente që mund të jenë paraqitur nga kreditorët me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në shtetin anëtar të origjinës. Për rrjedhojë, autoritetet kompetente operojnë pa diskriminim në nivel Komunitet.

3. Përveç rasteve kur legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës e lejon ndryshe, kreditori i dërgon autoritetit kompetent kopje të çdo dokumenti mbështetës dhe tregon sa më poshtë:

a) natyrën dhe sasinë e dëmit;

b) datën kur është shkaktuar dëmi;

c) nëse ai pretendon preferencë, të drejtë sendore ose të drejtë pronësie në lidhje me dëmin;

d) sipas rastit, çfarë aktivesh mbulohen nga titulli i tij.

Nuk është nevoja që të tregohet përparësia që i jepet dëmeve në sigurime nga nenin 275.

Neni 283

Gjuha dhe formulari

1. Informacioni në njoftimin e përmendur në nenin 281, paragrafi 1, jepet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar të origjinës.

Për këtë qëllim përdoret një formular që mban të paktën njërin prej titujve të mëposhtëm në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian:

a) "Ftesë për të paraqitur një pretendim; afatet kohore që duhet të respektohen"; ose

b) kur legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës parashikon dorëzimin e komenteve në lidhje me pretendimet, "Ftesa për të dorëzuar komente në lidhje me një pretendim: afatet kohore që duhet të respektohen".

Megjithatë, kur një kreditor i njohur është përfituesi i një dëmi në sigurim, informacioni në njoftimin e përmendur në nenin 281, paragrafi 1, jepet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar ku kreditori ka vendbanimin e zakonshëm, vendbanimin e përhershëm ose zyrën kryesore.

2. Kreditorët me vendbanim të zakonshëm, vendbanim të përhershëm ose zyrë kryesore në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës mund të paraqesin pretendimet e tyre ose të dorëzojnë komente në lidhje me pretendimet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të atij shteti anëtar.

Megjithatë, në këto raste, paraqitja e pretendimeve të tyre ose dorëzimi i komenteve për pretendimet, sipas rastit, duhet të ketë titullin "Paraqitje pretendimi" ose "Dorëzim i komenteve në lidhje me pretendimet", sipas rastit, në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar të origjinës.

Neni 284

Informacioni i rregullt për kreditorët

1. Likuiduesit informojnë rregullisht kreditorët për ecurinë e likuidimit.

2. Autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare mund të kërkojnë informacion për zhvillimet e procedurës së likuidimit nga autoritetet mbikëqyrëse të shtetit anëtar të origjinës.

KAPITULLI IV

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 285

Ndikimet mbi disa kontrata dhe të drejta

Duke shfuqizuar nenet 269 dhe 274, ndikimet e hapjes së masave të riorganizimit ose të procedurave të falimentimit rregullohen si në vijim:

a) në lidhje me kontratat e punësimit dhe marrëdhëniet e punësimit, ekskluzivisht nga legjislacioni i shtetit anëtar që zbatohet për kontratën e punësimit dhe marrëdhënien e punësimit;

b) në lidhje me kontratat që akordojnë të drejtën për të shfrytëzuar ose përfituar pronë të paluajtshme, ekskluzivisht nga legjislacioni i shtetit anëtar ku ndodhet prona e paluajtshme; dhe

c) në lidhje me të drejtat e shoqërisë së sigurimit për pronën e paluajtshme, anijen ose një mjet fluturimi që i nënshtrohet regjistrimit në një regjistër publik, ekskluzivisht nga legjislacioni i shtetit anëtar në zbatim të së cilit mbahet regjistri.

Neni 286

E drejta in rem dhe palët e treta

1. Hapja e masave të riorganizimit ose të procedurave të likuidimit nuk ndikon të drejtën in rem të kreditorëve ose palëve të treta në lidhje me aktivet e trupëzuara ose të patrupëzuara, pronat e luajtshme ose të paluajtshme - si aktivet specifike edhe koleksionet të aktiveve të papërcaktuara në tërësi që ndryshojnë herë pas here - që i përkasin shoqërisë së sigurimit dhe që ndodhen në territorin e një shteti tjetër anëtar në kohën e hapjes së këtyre masave ose procedurave.

2. Të drejtat që përmenden në paragrafin 1 përfshijnë të paktën:

a) të drejtën për t'u çliruar nga aktivet ose për t'i kërkuar dikujt që ta bëjë diçka të tillë dhe për të dalë të kënaqur nga procedurat ose të ardhurat në lidhje me këto aktive, në veçanti nëpërmjet një garancie pagese ose një hipoteke.

b) të drejtën ekskluzive për të përmbushur një pretendim, në veçanti një të drejtë të garantuar me garanci pagese në lidhje me pretendimin ose duke e përfshirë pretendimin në një garanci;

c) të drejtën për të kërkuar aktivet nga ose për të kërkuar rikthimin e tyre nga kushdo që i ka në zotërim ose në përdorim në kundërshtim me vullnetin e palës që e ka këtë të drejtë;

d) të drejtën për përdorimin e dobishëm të aktiveve.

3. E drejta e regjistruar në një regjistër publik dhe që është e zbatueshme kundër palëve të treta, sipas të cilës mund të përfitohet një e drejtë in rem sipas kuptimit të paragrafit 1, konsiderohet se është e drejtë in rem.

4. Paragrafi 1 nuk pengon veprimet për pavlefshmërinë, për mundësinë e anulimit dhe pazbatueshmërinë që përmendet në nenin 274, paragrafi 2, pika 1.

Neni 287

Rezervimi i titullit të pronësisë

1. Hapja e masave të riorganizimit ose të procedurave të likuidimit kundrejt një shoqërie sigurimi që blen një aktiv nuk ndikon në të drejtat e një shitësi, që bazohen në një rezervim të titullit të pronësisë, kur në kohën e hapjes së këtyre masave ose procedurave, aktivi ndodhet brenda territorit të një shteti anëtar të ndryshëm nga ai në të cilin janë hapur këto masa ose procedura.

2. Hapja, pas lëvrimit të aktivit, e masave të riorganizimit ose e procedurave të likuidimit kundër një shoqërie sigurimi që po shet një aktiv nuk shërbejnë si arsye për të shfuqizuar ose ndërprerë shitjen dhe nuk e pengojnë blerësin që të blejë titullin e pronësisë kur në kohën e hapjes së këtyre masave ose procedurave aktivi i shitur ndodhet brenda territorit të një shteti anëtar të ndryshëm nga ai në të cilin janë hapur këto masa ose procedura.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk pengojnë veprimet për pavlefshmërinë, për mundësinë e anulimit dhe pazbatueshmërinë që përmendet në nenin 274, paragrafi 2, pika 1.

Neni 288

Kompensimi

1. Hapja e masave të riorganizimit ose procedurave të likuidimit nuk prek të drejtën e kreditorëve për të kërkuar kompensim të pretendimeve të tyre kundrejt pretendimeve të shoqërisë së sigurimit kur ky kompensim lejohet nga ligji i zbatueshëm për pretendimin e shoqërisë së sigurimit.

2. Paragrafi 1 nuk pengon veprimet për pavlefshmërinë, për mundësinë e anulimit dhe pazbatueshmërinë që përmendet në nenin 274, paragrafi 2, pika 1.

Neni 289

Tregjet e rregulluara

1. Pa cenuar nenin 286, ndikimet e një mase riorganizimi ose të hapjes së procedurave të likuidimit mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve në një treg të rregulluar rregullohen vetëm për legjisllacionin që zbatohet për atë treg.

2. Paragrafi 1 nuk pengon veprimet për pavlefshmërinë, anulimin ose pazbatueshmërinë që përmenden në nenin 274, paragrafi 2, pika 1, që mund të ndërmerren për të shmangur pagesat ose transaksionet në zbatim të legjislacionit për këtë treg.

Neni 290

Aktet dëmtuese

Neni 274, paragrafi 2, pika 1 nuk zbatohen kur një person, i cili ka përfituar nga një akt ligjor që është në dëm të të gjithë kreditorëve, paraqet prova se ky akt i nënshtrohet legjislacionit të një shteti anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës dhe prova se legjislacioni nuk lejon asnjë mënyrë për të kundërshtuar këtë akt në rastin përkatës.

Neni 291

Mbrojtja e palëve të treta blerëse

Legjislacioni në vijim bëhet i zbatueshëm, nëpërmjet një akti të hartuar pas miratimit të një mase riorganizimi ose pas hapjes së procedurave të likuidimit, kur një shoqëri sigurimi i drejtohet, për shqyrtim, njërit prej sa më poshtë:

a) në lidhje me pasurinë e paluajtshme, legjislacionit të shtetit anëtar ku ndodhet pasuria e paluajtshme;

b) në lidhje me anijet dhe aeroplanit që i nënshtrohen regjistrimit në një regjistër publik, legjislacionit të shtetit anëtar në zbatim të së cilit mbahet regjistri;

c) në lidhje me titujt e transferueshëm ose tituj të tjerë, ekzistenca ose transferimi i të cilëve presupozon regjistrimin në një regjistër ose në një llogari të krijuar sipas legjislacionit ose të vendosur në një sistem qendror depozitash që rregullohet nga legjislacioni i një shteti anëtar, legjislacionit të shtetit anëtar në zbatim të së cilit mbahet regjistri, llogaria ose sistemi.

Neni 292

Paditë në pritje

Ndikimet e masave të riorganizimit ose procedurave të likuidimit në një padi në pritje në lidhje me një aktiv ose një të drejtë nga e cila është zhveshur shoqëria e sigurimit rregullohet vetëm nga legjislacioni i shtetit anëtar ku ekziston kjo padi në pritje.

Neni 293

Administratorët dhe likuiduesit

1. Emërimi i administratorit ose likuiduesit vërtetohet me një kopje të noterizuar të vendimit origjinal të emërimit ose nga ndonjë vërtetim tjetër i lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës.

Shteti anëtar ku administratori ose likuiduesi dëshiron të veprojë mund të kërkojë përkthimin në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të atij shteti anëtar. Nuk duhet të kërkohet asnjë njehsim formal me origjinalin dhe as formalitete të tjera të ngjashme për përkthimin.

2. Administratorët dhe likuiduesit kanë të drejtë të ushtrojnë, brenda territorit të të gjitha shteteve anëtare, të gjitha kompetencat që kanë të drejtë që të ushtrojnë brenda territorit të shtetit anëtar të origjinës.

Gjatë masave të riorganizimit ose procedurave të likuidimit, specifikisht, me qëllim që t'i ndihmojnë në kapërcimin e vështirësive që hasin kreditorët në atë shtet, në përputhje me legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës, mund të emërohen persona për të ndihmuar ose përfaqësuar administratorët dhe likuiduesit.

3. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sipas legjislacionit të shtetit anëtar të origjinës, administratorët ose likuiduesit duhet të veprojnë në pajtim me legjislacionin e shtetit anëtar ku ata dëshirojnë të veprojnë, në veçanti në lidhje me procedurat për realizimin e aktiveve dhe informimin e punonjësve.

Këto kompetenca nuk përfshijnë përdorimin e forcës ose të drejtën për të dhënë vendim për procedurat ose mosmarrëveshjet ligjore.

Neni 294

Regjistrimi në një regjistër publik

1. Administratori, likuiduesi ose çdo autoritet tjetër ose person tjetër që ka kompetencat e duhura në shtetin anëtar të origjinës mund të kërkojë që një masë riorganizimi ose vendimi për hapjen e procedurave të likuidimit të regjistrohen në regjistrin publik përkatës që mbahet në shtetin tjetër anëtar.

Megjithatë, kur një shtet anëtar parashikon regjistrimin e detyrueshëm, autoriteti ose personi që përmendet në nënparagrafin e parë duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar këtë regjistrim.

2. Kostot e regjistrimit konsiderohen si kosto dhe shpenzime që i përkasin procedurave.

Neni 295

Sekreti profesional

Të gjithë personat të cilëve u kërkohet që të marrin ose të nxjerrin informacion në lidhje me procedurat e përcaktuara në nenet 270, 273 dhe 296 janë të detyruar të zbatojnë dispozitat për sekretin profesional, siç përcaktohen në nenet 64 deri në 69, me përjashtim të ndonjë autoriteti gjyqësor për të cilët zbatohen dispozitat ekzistuese kombëtare.

Neni 296

Trajtimi i degëve të shoqërive të vendeve të treta

Kur një shoqëri e një vendi të tretë ka degë të themeluara në më shumë se një shtet anëtar, secila nga degët trajtohet në mënyrë të pavarur për sa i përket zbatimit të këtij titulli.

Autoritetet kompetente dhe autoritetet mbikëqyrëse të këtyre shteteve anëtare duhet të bëjnë përpjekje për të koordinuar veprimet e tyre.

Edhe administratorët dhe likuiduesit bëjnë përpjekje për të koordinuar veprimet e tyre.

TITULLI V

DISPOZITA TË TJERA

Neni 297

E drejta për t'u ankuar në gjykatë

Shtetet anëtare sigurohen që vendimet e marra në lidhje me një shoqëri sigurimi ose risigurimi sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në zbatim të kësaj direktive, t'i nënshtrohen të drejtës së ankimit në gjykatë.

Neni 298

Bashkëpunimi mes shteteve anëtare dhe Komisionit

1. Shtetet anëtare bashkëpunojnë me njëri tjetrin me qëllim që të lehtësojnë mbikëqyrjen e sigurimeve dhe risigurimeve brenda Komunitetit dhe zbatimin e kësaj direktive.

2. Komisioni dhe autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtë me njëri tjetrin për qëllimin e lehtësimit të mbikëqyrjes së sigurimeve dhe risigurimeve brenda Komunitetit dhe të shqyrtimit të çdo vështirësie që mund të lindë në zbatimin e kësaj direktive.

3. Shtetet anëtare informojnë Komisionin për çdo vështirësi madhore që lind nga zbatimi i kësaj direktive.

Komisioni dhe autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare në fjalë shqyrtojnë këto vështirësi sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.

Neni 299

Euro

Kur kjo direktivë përmend monedhën euro, vlera e këmbimit valutor në monedhat kombëtare që duhet të përdoret që nga data 31 dhjetor i çdo viti është vlera që zbatohet në ditën e fundit të tetorit paraardhës kur vlerat e këmbimit valutor për monedhën euro janë të disponueshme në të gjitha monedhat e Komunitetit.

Neni 300

Rishikimi i shumave të shprehura në euro

Shumat e shprehura në euro në këtë direktivë rishikohen çdo pesë vjet, duke rritur shumën bazë në euro sipas ndryshimit të përqindjes në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të të gjitha shteteve anëtare, siç publikohet nga Eurostat duke nisur nga data 31 tetor 2012 deri në datën e rishikimit dhe e rrumbullakosur me 100 000 euro.

Nëse ndryshimi i përqindjes që nga rishikimi i fundit është më pak se 5%, shumat nuk rishikohen.

Komisioni publikon shumat e rishikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Shumat e rishikuara zbatohen nga shtetet anëtare brenda 12 muajve nga publikimi i tyre në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 301

Procedura e Komitetit

1. Komisioni asistohet nga Komiteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve.
2. Aty ku përmendet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
3. Aty ku përmendet ky paragraf, zbatohet neni 5/a, paragrafët 1 deri në 4 dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Neni 302

Njoftimet e dorëzuara përpara hyrjes në fuqi të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që nevojiten për pajtueshmërinë me nenet 57 deri në 63

Procedura e vlerësimit, që zbatohet për blerjet e propozuara për të cilat autoritetet kompetente kanë marrë njoftimet e përmendura në nenin 57 përpara hyrjes në fuqi të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që nevojiten për pajtueshmërinë me nenet 57 deri në 63, kryhen në përputhje me legjislacionin e shtetit anëtar që është në fuqi në kohën e njoftimit.

Neni 303

Ndryshimet e Direktivës 2003/41/KE

Direktiva 2003/41/KE ndryshohet si më poshtë:

1. Neni 17, paragrafi 2 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:
"2. Për qëllime të llogaritjes së shumës minimale të aktiveve shtesë, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenet 17/a deri në 17/d."

2. Janë shtuar nenet e mëposhtme:

"Neni 17a

Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese

1. Çdo shtet anëtar i kërkon të gjitha institucioneve që përmenden në nenin 17, paragrafi 1, të cilët ndodhen në territorin e tij një nivel të disponueshëm të përshtatshëm të aftësisë paguese për të gjitha veprimtaritë e tyre gjatë gjithë kohës, i cili duhet të jetë të paktën i barabartë me kërkesat e kësaj direktive.

2. Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese përbëhet nga aktivet e institucionit që duhet të jenë të lira nga çdo përgjegjësi e parashikueshme minus zërat e patrupëzuara, duke përfshirë:

a) kapitalin aksionar të paguar, ose, në rastin e një institucioni që merr formën e një shoqërie të ndërsjellët, fondet fillestare plus çdo llogari të anëtarëve të shoqërisë së ndërsjellët që përmbushin kriteret e mëposhtme:

I. akti i themelimit dhe statuti duhet të parashikojnë që pagesat mund të bëhen nga këto llogari për anëtarët e shoqërisë së ndërsjellët vetëm deri në masën që kjo nuk bën që niveli i disponueshëm i aftësisë paguese të bjerë nën nivelin e kërkuar, ose pas shpërbërjes së shoqërisë, kur të gjitha borxhet e tjera të shoqërisë të jenë paguar;

II. akti i themelimit dhe statuti duhet të parashikojnë se, në lidhje me ndonjë pagesë që përmendet në pikën I për arsye të ndryshme, përveç shkaputjes individuale të anëtarësisë nga shoqëria e ndërsjellët, autoritetet kompetente duhet të njoftohen të paktën një muaj më përpara dhe mund të ndalojnë pagesën brenda kësaj periudhe; dhe

III. dispozitat përkatëse të aktit të themelimit dhe statutit mund të ndryshohen vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar se nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin, pa cenuar kriteret e përcaktuara në pikat I dhe II;

b) rezervat (statutore dhe të lira) që nuk korrespondojnë me përgjegjësitë e marrjes në sigurim;

c) fitimin ose humbjen e shkaktuar pas zbritjes së dividendëve që duhet të paguhet; dhe

d) deri në masën e autorizuar nga legjislacioni i brendshëm, rezervat e fitimit që shfaqen në bilanc, kur ato mund të përdoren për të mbuluar çdo humbje që mund të lindë dhe kur nuk janë vënë në dispozicion për t'iu shpërndarë anëtarëve dhe përfituesve.

Niveli i disponueshëm i aftësisë paguese ulet me shumën e aksioneve të veta që zotërohen direkt nga institucioni.

3. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mund të përfshijë gjithashtu:

a) kapitali aksionar preferencial kumulativ dhe kapitali kreditor i varur deri në 50% të shkallës më të vogël të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, ku jo më shumë se 25% e të cilit përbëhet nga kreditë e varura me maturim fiks, ose kapital aksionar preferencial kumulativ me afat fiks, me kusht që të ekzistojnë marrëveshje detyruese sipas të cilave, në rast falimentimi ose likuidimi të institucionit, kapital kreditor i varur ose kapital aksionar preferencial të radhitet pas pretendimeve të të gjithë kreditorëve të tjerë dhe të mos shlyhet derisa të jenë paguar të gjitha borxhet e tjera të papaguara;

b) titujt pa datë maturimi të specifikuar, ose instrumente të tjera, duke përfshirë aksionet preferenciale kumulative të ndryshme nga ato që përmenden në germën "a", deri në një maksimum prej 50% të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese, ose nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, cilado qoftë më e ulët, për totalin e këtyre titujve dhe kapitalin kreditor të varur që përmendet në germën "a", me kusht që ata të përmbushin kushtet e mëposhtme:

I. ato nuk duhet të shlyhen me nismën e mbajtësit ose pa miratimin paraprak të autoritetit kompetent;

II. kontrata e emetimit duhet t'i mundësojë institucionit që të shtyjë pagesën e interesit të kredisë;

III. pretendimet e huadhënësit për institucionin duhet të radhiten pas pretendimeve të të gjithë kreditorëve jo të varur;

IV. dokumentet që rregullojnë emetimin e titujve duhet të parashikojnë kapacitetin e borxhit dhe interesit të papaguar për të përballuar humbjen, ndërkohë që i mundësojnë institucionit që të vazhdojë veprimtarinë e tij; dhe

V. duhet të merren në konsideratë vetëm shumat e paguara plotësisht.

Për qëllimet e germës "a", kapitali kreditor i varur duhet të përmbushë edhe kushtet e mëposhtme:

I. duhet të merren në konsideratë vetëm fondet e paguara plotësisht.

II. për kreditë me afat maturimi fiks, maturimi fillestar duhet të jetë të paktën pesë vjet. Jo më vonë se një vit pas datës së shlyerjes, institucioni i dorëzimit autoriteteve kompetente për miratim një plan ku tregon se si niveli i disponueshëm i aftësisë paguese do të mbahet ose do të sillet në nivelin e kërkuar përpara maturimit, përveç se kur shkalla në të cilën kredia mund të radhitet si komponent i nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese ulet gradualisht të paktën gjatë pesë viteve përpara datës së shlyerjes. Autoritetet kompetente mund të autorizojnë shlyerjen e hershme të këtyre kredive nëse bëhet një aplikim nga institucioni emetues dhe nëse niveli i disponueshëm i aftësisë paguese nuk bie nën nivelin e kërkuar;

III. kreditë me afat të papërcaktuar duhet të shlyhen vetëm duke iu nënshtuar një njoftimi pesë vjeçar, përveç se kur kreditë nuk konsiderohen më si komponent i nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese ose përveç se kur për shlyerjen e hershme kërkohet specifikisht miratimi paraprak i autoriteteve kompetente. Në rastin e fundit institucioni njofton autoritetet kompetente të paktën gjashtë muaj përpara datës së shlyerjes së propozuar, duke specifikuar

nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese si përpara edhe pas shlyerjes. Autoritetet kompetente autorizojnë shlyerjen vetëm kur niveli i disponueshëm i aftësisë paguese të institucionit nuk bie nën nivelin e kërkuar;

IV. marrëveshja e kredisë nuk përfshin asnjë klauzolë që parashikon se në rrethana specifike, përveç likuidimit të institucionit, borxhi duhet të shlyhet përpara datave të miratuara të shlyerjes; dhe

V. marrëveshja e kredisë mund të ndryshohet vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar se nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin.

4. Pasi institucioni bën aplikimin, me provat mbështetëse, tek autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës dhe me miratimin e këtij autoriteti kompetent, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese gjithashtu mund të përfshijë:

a) kur nuk përdoret zilmerizimi, ose, kur përdoret, ai është më i ulët se ngarkesa e kostove të blerjes të përfshira në prim, ndryshimin ndërmjet një provigjoni matematikor të pazilmerizuar ose pjesërisht të zilmerizuar dhe një provigjoni matematikor të zilmerizuar në një nivel të barabartë me ngarkesën e kostove të blerjes të përfshira në prim.

b) çdo rezervë neto të fshehur që lind nga vlerësimi i aktiveve, deri në masën që këto rezerva neto të fshehura nuk kanë një natyrë përjashtimore;

c) gjysmën e kapitalit aksionar të papaguar ose fondit fillestar, pasi pjesa e paguar të arrijë në 25% të këtij kapitali aksionar ose fondi, deri në 50% të nivelit të disponueshëm ose të kërkuar të aftësisë paguese, cilido të jetë më e ulët.

Shuma e përmendur në germën "a" nuk duhet të tejkalojë 3,5% të shumës së ndryshesave ndërmjet shumave përkatëse të kapitalit për veprimtaritë e sigurimit të jetës dhe provigjonet e pensionit dhe provigjonet matematikore për të gjitha policat që mund të zilmerizohen. Nga ndryshesa zbritet shuma e të gjitha kostove të pazhvierësuar të blerjes, të regjistruara si aktiv.

5. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese në lidhje me paragrafët 2 deri në 4 për të marrë në konsideratë zhvillimet që justifikojnë axhustimin teknik të elementeve të pranueshme për nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore, sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 21/b.

Neni 17/b

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese

1. Në zbatim të nenit 17/c, niveli i kërkuar i aftësisë paguese përcaktohet sipas paragrafëve 2 deri në 6 në përputhje me përgjegjësitë e marra në sigurim.

2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë i barabartë me shumën e rezultateve të mëposhtme:

a) rezultati i parë:

një fraksion prej 4% i provigjoneve matematikore në lidhje me veprimtaritë e drejtpërdrejta dhe pranimet në risigurim pa zbritur cedimet në risigurim shumëzohet me raportin, jo më të ulët se 85%, për vitin e mëparshëm ushtrimor, e provigjoneve matematikore neto nga cedimet e risigurimit ndaj totalit të provigjoneve matematikore bruto;

b) rezultati i dytë:

për policat për të cilat kapitali i rrezikuar nuk është shifër negative, një fraksion prej 0,3% i këtij kapitali të marrë në sigurim nga institucioni shumëzohet me raportin, jo më të ulët se 50% për vitin e mëparshëm ushtrimor, të totalit të kapitalit të rrezikuar që mbahet si përgjegjësi e institucionit pas cedimeve dhe retrocedimeve në risigurim ndaj totalit të kapitalit të rrezikuar pa zbritur risigurimet.

Për sigurimin e përkohshëm në rast vdekjeje me një afat maksimal prej tre vjetësh, ky fraksion duhet të jetë 0,1%. Për sigurime të tilla me afat më të madh se tre vjet, por jo më shumë se pesë vjet, ky fraksion duhet të jetë 0,15%.

3. Për sigurimet plotësuese të përmendura në nenin 2, paragrafi 3, germa "a", pika III, të Direktivës 2009/138/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2009, "Për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit (Aftësia paguese II)"³⁷, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë i barabartë me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese sipas udhëzimeve të përcaktuara në nenin 17/d.

4. Për operacionet e kompensimit me kapital që përmenden në nenin 2, paragrafi 3, germa "b", pika II të Direktivës 2009/138/KE, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë i barabartë me fraksionin 4% të provigjoneve matematikore të llogaritura në përputhje me paragrafin 2, germa "a".

5. Për operacionet që përmenden në nenin 2, paragrafi 3, germa "b", pika I, të Direktivës 2009/138/KE, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë i barabartë me 1% të aktiveve të tyre.

6. Për sigurimet që mbulohen nga neni 2, paragrafi 3, germa "a", pika I, i Direktivës 2009/138/Ke në lidhje me fondet e investimit dhe për operacionet që përmenden në nenin 2, paragrafi 3, germa "b", pika III, IV, dhe V, të Direktivës 2009/138/KE, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë i barabartë me shumën e:

a) deri në masën që institucioni mbart një rrezik investimi, një fraksion prej 4% të provigjoneve teknike, i llogaritur në përputhje me paragrafin 2, germa "a";

b) deri në masën që institucioni nuk mbart asnjë rrezik investimi, por alokimi për të mbuluar shpenzimet e administrimit është caktuar për një periudhë që tejkalon pesë vite, një fraksion prej 1% të provigjoneve teknike, i llogaritur në përputhje me paragrafin 2, germa "a";

c) deri në masën që institucioni nuk mbart asnjë rrezik investimi dhe alokimi për të mbuluar shpenzimet e administrimit nuk është caktuar për një periudhë që tejkalon pesë vite, një shumë të barasvlershme me 25% të shpenzimeve administrative gjatë vitit ushtrimor të mëparshëm në lidhje me këto veprimtari;

d) deri në masën që institucioni mbulon një rrezik vdekjeje, një fraksion prej 0,3% të kapitalit të rrezikuar, i llogaritur në përputhje me paragrafin 2, germa "b";

Neni 17/c

Fondi i garancisë

1. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që një e treta e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, siç specifikohet në nenin 17/b, të përbëjë fondin e garancisë. Fondi përfshin zërat e radhitur në nenin 17/a, paragrafi 2 dhe 3, dhe, duke iu nënshtruar miratimit të autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës, në nenin 17/a, paragrafi 4, germa "b".

2. Fondi i garancisë nuk duhet të jetë më i ulët se 3 milion euro. Çdo shtet anëtar mund të parashikojë një ulje prej 25% të fondit minimal të garancisë në rastin e shoqërive të ndërsjella.

Neni 17d

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për qëllimin e nenit 17/b, paragrafi 3.

1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese përcaktohet ose mbi bazën e shumës vjetore të primeve ose kontributeve, ose mbi bazën e barrës mesatare të dëmeve për tre vitet e fundit ushtrimore.

2. Shuma e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese duhet të jetë e barabartë me rezultatin më të lartë, nga dy rezultatet që përcaktohen në paragrafët 3 dhe 4.

3. Baza e primeve llogaritet duke përdorur vlerën më të lartë të primeve të shkruara bruto ose kontributeve siç janë llogaritur në vijim, dhe primeve të fituara bruto ose kontributeve.

Primet ose kontributet (duke përfshirë tarifatat shtesë për primet ose kontributet) që duhet të paguhet në lidhje me veprimtaritë e drejtpërdrejta gjatë vitit ushtrimor të mëparshëm duhet të agregohen.

Kësaj shume i shtohet shuma e primeve të pranuar për të gjitha risigurimet gjatë vitit ushtrimor të mëparshëm.

Më pas nga kjo shumë zbritet shuma totale e primeve ose kontributeve të anuluar gjatë vitit ushtrimor të mëparshëm si edhe shuma totale e tatimeve dhe detyrimeve në lidhje me primet ose kontributet e agreguara.

Më pas kjo shumë e përfshirë ndahet në dy pjesë, e para deri në 50 milion euro, e dyta përfshin pjesën e mbetur; 18% e pjesës së parë dhe 16% e pjesës së dytë mbledhen së bashku.

Shuma e përftuar shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve ushtrimore paraardhëse ndërmjet shumës së dëmeve që mbeten për t'u mbuluar nga institucioni pas zbritjes së shumave të rikuperueshme nga risigurimi dhe shumës bruto të dëmeve. Ky raport nuk duhet të jetë më i ulët se 50%.

4. Baza e dëmeve llogaritet si në vijim:

Shuma e dëmeve të paguara në lidhje me veprimtaritë e drejtpërdrejta (pa asnjë zbritje të dëmeve që mbulohen nga risiguresit dhe retroceduesit) gjatë periudhave të specifikuara në paragrafin 1 agregohen.

Kësaj shume totale i shtohet shuma e dëmeve të paguara në lidhje me risigurimet dhe retrocedimet e pranuar gjatë të njëjtës periudhë dhe shuma e provigjoneve për dëmet e papaguara e përcaktuar në përfundim të vitit ushtrimor të mëparshëm si për veprimtaritë e drejtpërdrejta edhe për pranimet në risigurim.

Nga kjo shumë zbritet shuma e rikuperimeve të bëra gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 1.

Nga shuma e mbetur zbritet më pas shuma e provigjoneve për dëmet e papaguara të përcaktuara në fillim të vitit të dytë ushtrimor që paraprin vitin ushtrimor të fundit për të cilin ka llogari, si për veprimtaritë e drejtpërdrejta edhe për pranimet në risigurim.

Një e treta e shumës së përftuar ndahet në dy pjesë, e para deri në 35 milion euro dhe e dyta përfshin pjesën e mbetur; 26 % e pjesës së parë dhe 23 % e pjesës së dytë mblidhen së bashku.

Shuma e përftuar shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve ushtrimore paraardhëse ndërmjet shumës së dëmeve që mbeten për t'u mbuluar nga institucioni pas zbritjes së shumave të rikuperueshme nga risigurimi dhe shumës bruto të dëmeve. Ky raport nuk duhet të jetë më i ulët se 50%.

5. Kur niveli i kërkuar i aftësisë paguese, siç llogaritet në paragrafët 2 deri në 4, është më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të vitit paraardhës, niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të jetë të paktën i barabartë me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese për vitin paraardhës, shumëzuar me raportin ndërmjet shumës së provigjoneve teknike për dëmet e papaguara në fund të vitit të fundit ushtrimor dhe shumës së provigjoneve teknike për dëmet e papaguara në fillim të vitit ushtrimor paraardhës. Në këto llogaritje provigjonet teknike llogariten neto pa risigurimet, por raporti nuk mund të jetë më i lartë se 1.

3. Janë shtuar nenet e mëposhtme:

"Neni 21/a

Rishikimi i shumës së fondit të garancisë

1. Shuma në euro, siç përcaktohet në nenin 17/c, paragrafi 2, rishikohet çdo vit duke nisur nga data 31 tetor 2012, për të marrë në konsideratë ndryshimet në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të të gjitha shteteve anëtare, siç është publikuar nga Eurostat.

Kjo shumë përshtatet në mënyrë automatike, duke rritur shumën bazën në euro sipas ndryshimit të përqindjes në atë indeks përgjatë periudhës ndërmjet datës 31 dhjetor 2009 dhe datës së rishikimit dhe e rrumbullakosur me një shumëfish të 100 000 euro.

Nëse ndryshimi i përqindjes që nga përshtatja e fundit është më i vogël se 5%, nuk bëhet asnjë përshtatje.

2. Komisioni informon Parlamentin Evropian dhe Këshillin çdo vit për rishikimin dhe për shumën e përshtatur që përmendet në paragrafin 1.

Neni 21/b

Procedura e Komitetit

1. Komisioni asistohet nga Komiteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve, i themeluar me Vendimin e Komisionit 2004/9/KE³⁸.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, zbatohet neni 5/a, paragrafët 1 deri në 4 dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Neni 304

Nënmoduli i rrezikut të kapitalit të vet sipas kohëzgjatjes

1. Shtetet anëtare mund të autorizojnë shoqëri të sigurimit jetë që ofrojnë:

a) veprimtari për ofrimin e pensionit profesional në përputhje me nenin 4 të Direktivës 2003/41/KE, ose

b) përfitime nga pensioni që paguhen në lidhje me arritjen, ose me parashikimin për të arritur, pensionin kur primet e paguara për këto përfitime i nënshtrohen zbritjes së tatimeve që autorizohet për mbajtësit e policës në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit anëtar që ka autorizuar shoqërinë;

ku:

I. të gjitha aktivet dhe pasivet përkatëse të veprimtarisë duhet të jenë të mbrojtura përmes ndarjes, të administrohen dhe organizohen të ndara nga veprimtaritë e tjera të shoqërive të sigurimit, pa pasur mundësinë e transferimit;

II. veprimtaritë e shoqërisë që lidhen me germat "a" dhe "b" në lidhje me të cilat zbatohet qasja e përmendur në këtë paragraf, zhvillohen vetëm në shtetin anëtar ku është autorizuar shoqëria; dhe

III. kohëzgjatja mesatare e pasiveve që përkojnë me veprimtaritë, të zotëruara nga shoqëritë, tejkalojnë një mesatare prej 12 vjetësh;

për të zbatuar një nënmodul të rrezikut të kapitalit të vet për kërkesën për kapital dhe aftësi paguese, e cila kalibrohet nëpërmjet masës së vlerësimit të rrezikut, përgjatë një periudhe kohore, masë e cila është konsistente me periudhën tipike të zotërimit të investimeve të kapitalit të vet për shoqërinë në fjalë, me një nivel konfidence që i siguron mbajtësve të policave dhe përfituesve një nivel mbrojtjeje ekuivalent me atë që përcaktohet në nenin 101, ku qasja e parashikuar në këtë nen përdoret vetëm në lidhje me aktivet dhe pasivet e përmendura në pikën I. Për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe aftësi paguese këto aktive dhe pasive merren plotësisht në konsideratë me qëllim vlerësimin e efekteve të diversifikimit, pa cenuar nevojën për të mbrojtur interesat e mbajtësve të policave dhe përfituesve në shtete të tjera anëtare.

Duke iu nënshtruar miratimit të autoriteteve mbikëqyrëse, qasja e përcaktuar në nënparagrafin e parë përdoret vetëm kur pozicioni i aftësisë paguese dhe likuiditetit si edhe strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit që ka shoqëria në fjalë në lidhje me administrimin e aktiveve dhe pasiveve janë të tilla që të garantojnë, në mënyrë të vazhdueshme, aftësinë e saj për zotëruar investime të kapitalit të vet për një periudhë që përkon me periudhën tipike të zotërimit të investimeve të kapitalit të vet për shoqërinë në fjalë. Shoqëria duhet të jetë në gjendje t'i vërtetojë autoritetit mbikëqyrës se kjo gjendje është verifikuar sipas nivelit të konfidencës së nevojshme për t'i siguruar mbajtësve të policave dhe përfituesve një nivel mbrojtjeje ekuivalent me atë që përcaktohet në nenin 101.

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit nuk mund t'i rikthehen përdorimit të qasjes së përcaktuar në nenin 105, përveç se në situatat e justifikuara siç duhet dhe duke iu nënshtruar miratimit të autoriteteve mbikëqyrëse.

2. Komisioni i dorëzon Komitetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve dhe Parlamentit Evropian, përpara datës 31 tetor 2015, një raport për zbatimin e qasjes së përcaktuar në paragrafin 1 dhe praktikën e autoriteteve mbikëqyrëse të miratuara sipas paragrafit 1 të shoqëruara, sipas rastit, me propozimet e përshtatshme. Raporti trajton, në veçanti, ndikimet ndërkufitare të përdorimit të kësaj qasjeje me qëllim për të parandaluar arbitrazhin rregullator nga ana e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit.

TITULLI VI

DISPOZITA TË PÛRKOHSHME DHE PÛRFUNDIMTARE

KAPITULLI I

DISPOZITA KALIMTARE

SEKSIONI 1

SIGURIMET

Neni 305

Shfuqizimi i masave kufizuese

1. Shtetet anëtare mund të përjashtojnë shoqëritë e sigurimit jo-jetë, të cilat më datën 31 janar 1975, nuk ishin në pajtim me kërkesat e neneve 16 dhe 17 të Direktivës 73/239/KEE, të cilat më 31 korrik 1978 kishin të ardhura vjetore nga primet ose kontributet më të ulëta se gjashtëfishi i shumës së fondit minimal të garancisë që kërkohet në zbatim të nenit 17, paragrafi 2 të Direktivës 73/239/KEE, nga kërkesa për të krijuar këtë fond minimal garancie përpara përfundimit të vitit ushtrimor në lidhje me të cilin të ardhurat nga primet ose kontributet janë sa gjashtëfishi i fondit minimal të garancisë. Pas marrjes në konsideratë të rezultateve të shqyrtimit të parashikuar në nenin 298, paragrafi 2, Këshilli vendos në mënyrë unanime për një propozim nga Komisioni, kur ky përjashtim duhet të shfuqizohet nga shtetet anëtare.

2. Shoqëritë e sigurimit jo-jetë të themeluara në Mbretërinë e Bashkuar sipas Kartës Mbretërore ose nëpërmjet një ligji privat ose një ligji të veçantë publik mund të vazhdojnë të zhvillojnë veprimtaritë e tyre në formën ligjore në të cilën ato janë krijuar më 31 qershor 1973 për një periudhë të pakufizuar.

Shoqëritë e sigurimit jetë të themeluara në Mbretërinë e Bashkuar sipas Kartës Mbretërore ose nëpërmjet një ligji privat ose një ligji të veçantë publik mund të zhvillojnë veprimtaritë e tyre në formën ligjore në të cilën ato janë krijuar më 15 mars 1979 për një periudhë të pakufizuar.

Mbretëria e Bashkuar duhet të hartojë një listë të shoqërive që përmenden në nënparagrafët e parë dhe të dytë dhe t'ia komunikojë atë shteteve të tjera anëtare dhe Komisionit.

3. Shoqëritë e regjistruara në Mbretërinë e Bashkuar në zbatim të Ligjeve për Shoqëritë Miqësore mund të vazhdojnë veprimtaritë e sigurimit të jetës dhe operacionet e kursimit, të cilat ato zhvillojnë, në përputhje me objektet e tyre, që nga data 15 mars 1979.

4. Me kërkesë të shoqërive të sigurimit jo-jetë që veprojnë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në titullin I, kapitulli VI, seksionet 2, 4 dhe 5, shtetet anëtare duhet të reshtin së zbatuari masa kufizuese të tilla si ato që lidhen me kreditë hipotekore, depozitat dhe titujt.

Neni 306

Të drejtat e përfuara nga degët dhe shoqëritë e sigurimit ekzistuese.

1. Degët që kanë filluar veprimtaritë, në përputhje me dispozitat në fuqi në shtetin anëtar ku ndodhet ajo degë, përpara datës 1 qershor 1994 supozohen se i janë nënshtruar procedurës së përcaktuar në nenet 145 dhe 146.

2. Nenet 147 dhe 148 nuk prekin të drejtat e fituara nga shoqëritë e sigurimit që kryejnë veprimtari sipas lirisë për të ofruar shërbime përpara datës 1 qershor 1994.

SEKSIONI 2

RISIGURIMI

Neni 307

Periudha kalimtare për nenet 57, paragrafi 3, dhe 60, paragrafi 6, të Direktivës 2005/68/KE

Një shtet anëtar mund të shtyjë zbatimin e dispozitave të nenit 57, paragrafi 3, të Direktivës 2005/68/KE, duke ndryshuar nenin 15, paragrafi 3, të Direktivës 73/239/KEE dhe të dispozitës së nenit 60, paragrafi 6, të Direktivës 2005/68/KE deri më 10 dhjetor 2008.

Neni 308

E drejta e përftuar nga shoqëritë ekzistuese të risigurimit

1. Shoqëritë e risigurimit që i nënshtrohen kësaj direktive, të cilat janë autorizuar ose kanë marrë të drejtën për të kryer veprimtari risigurimi në përputhje me dispozitat e shteteve anëtare ku ata kanë degët kryesore përpara datës 10 dhjetor 2005, konsiderohen si të autorizuara në përputhje me nenin 14.

Megjithatë, ato janë të detyruara që të veprojnë në pajtim me dispozitat e kësaj direktive në lidhje me zhvillimin e veprimtarive të risigurimit dhe në pajtim me kërkesat e përcaktuara në germa "b" dhe "d" deri në "g" të nenit 18, paragrafi 1, nenet 19, 20 dhe 24 dhe titullin I, kapitulli VI, seksionet 2, 3 dhe 4.

2. Shtetet anëtare mund t'i japin kohë shoqërive të risigurimit që përmenden në paragrafin 1, të cilat më 10 dhjetor 2005 nuk ishin në pajtim me nenin 18, paragrafi 1, germa "b", nenin 19 dhe 20 dhe titullin I, kapitulli VI, seksionet 2, 3 dhe 4, deri më 10 dhjetor 2008 që të veprojnë në pajtim me këto kërkesa.

KAPITULLI II

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 309

Transpozimi

1. Shtetet anëtare futin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të vepruar në pajtim me nenet 4, 10, 13, 14, 18, 23, 26-32, 34-49, 51-55, 67, 68, 71, 72, 74-85, 87-91, 93-96, 98,100-110, 112, 113, 115-126, 128, 129, 131-134, 136-142, 144, 146, 148, 162-167, 172, 173, 178, 185, 190, 192, 210-233, 235-240, 243-258, 260-263, 265, 266, 303 dhe 304 dhe shtojcat III dhe IV përpara datës 31 tetor 2012.

Kur miratohen nga shtetet anëtare, këto masa përmbajnë një referencë për këtë direktivë ose shoqërohen me një referencë të tillë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Gjithashtu, ato përfshijnë një deklaratë se referencat në ligjet, rregulloret dhe aktet administrative ekzistuese për direktivën e shfuqizuar nga kjo direktivë, interpretohen si referencë për këtë direktivë. Mënyra sesi bëhet kjo referencë dhe formulimi i deklaratës përcaktohet nga vetë shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit të brendshëm që ato miratojnë në fushën që mbulohet nga kjo direktivë.

Neni 310

Shfuqizimi

Direktivat 64/225/KEE, 73/239/KEE, 73/240/KEE, 76/580/KEE, 78/473/KEE, 84/641/KEE, 87/344/KEE, 88/357/KEE, 92/49/KEE, 98/78/KE, 2001/17/KE, 2002/83/KE dhe 2005/68/KE, ndryshuar nëpërmjet akteve të radhitura në pjesën A të shtojcës VI shfuqizohen që nga data 1 nëntor 2012, pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin e direktivave të përcaktuara në pjesën B të shtojcës VI.

Referencat për direktivat e shfuqizuara interpretohen si referenca për këtë direktivë dhe lexohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë në shtojcën VII.

Neni 311

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nenet 1-3, 5-9, 11, 12, 15-17, 19-22, 24, 25, 33, 56-66, 69, 70, 73, 143, 145, 147, 149-161, 168-171, 174-177, 179-184, 186-189, 191, 193-209, 267-300, 302, 305-308 dhe shtojcat I dhe II, V, VI dhe VII zbatohen duke nisur nga data 1 nëntor 2012.

Neni 312

Marrësit

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 25 nëntor 2009

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

J. BUZEK

Për Këshillin

Presidenti

Åsa TORSTENSSON

SHTOJCA I

KLASAT E SIGURIMIT JOJETË

A. Klasifikimi i rreziqeve sipas klasave të sigurimit

1. Aksidentet (duke përfshirë lëndimet industriale dhe sëmundjet profesionale):

- përfitimet monetare fikse
- përfitime në natyrën e dëmshpërblimit,
- kombinime të të dyve,
- lëndimi i pasagjerëve,

2. Sëmundjet:

- përfitimet monetare fikse
- përfitime në natyrën e dëmshpërblimit,
- kombinime të të dyve,

3. Mjetet tokësore (përveç mjeteve hekurudhore)

Të gjitha dëmet ndaj ose humbjet e:

- mjeteve motorike tokësore,
- mjeteve tokësore, të ndryshme nga ato motorike,

4. Mjetet hekurudhore

Të gjitha dëmet ndaj ose humbjet e mjeteve hekurudhore.

5. Mjetet e fluturimit

Të gjitha dëmet ndaj ose humbjet e mjeteve të fluturimit.

6. Anijet (mjete lundrimi në det, liqen, lum dhe kanale)

Të gjitha dëmet ndaj ose humbjet e:

- mjeteve të lundrimit në lum dhe kanal,
- mjeteve të lundrimit në liqen,
- mjeteve të lundrimit në det,

7. Mallrat gjatë transportit (duke përfshirë mallrat tregtare, bagazhin dhe të gjitha mallrat e tjera)

Të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazheve, pavarësisht formës së transportit

8. Zjarri dhe forcat natyrore

Të gjitha dëmtimet ndaj dhe humbjen e pronës (e ndryshme nga prona që përfshihet në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7) e shkaktuara nga:

- zjarri,
- shpërthimet,
- stuhitë,
- forca të tjera natyrore përveç stuhisë,
- energjia bërthamore,
- rrëshqitja e dheut,

9. Dëme të tjera të pronës

Të gjitha dëmet ose humbjet e pronës (e ndryshme nga prona e përfshirë në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7) e shkaktuara nga breshëri ose ngrica dhe çdo ngjarje tjetër si vjedhja, përveç atyre që përfshihen në klasën 8.

10. Përgjegjësia për mjetet motorike

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i mjeteve motorike që ecin mbi tokë (duke përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

11. Përgjegjësia e mjeteve të fluturimit

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i mjeteve të fluturimit (duke përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

12. Përgjegjësia për anijet (mjete lundrimi në det, liqen, lum dhe kanale)

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve, mjeteve të lundrimit ose varkave në det, liqene, lumenj ose kanale (duke përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

13. Përgjegjësia e përgjithshme

Të gjitha përgjegjësitë të ndryshme nga ato që përmenden në klasat 10, 11 dhe 12.

14. Kredia:

- paaftësia paguese (e përgjithshme),
- kredi për eksport,
- kredi me këste,

— kredi hipotekore,

— kredi bujqësore,

15. Garancitë:

— garancia (e drejtpërdrejtë),

— garancia (jo e drejtpërdrejtë),

16. Humbje financiare të ndryshme:

— rreziqet e punësimit,

— pamjaftueshmëri të ardhurash (të përgjithshme),

— moti i keq,

— humbja e përfitimeve,

— shpenzime të përgjithshme të vazhdueshme,

— shpenzime tregtare të paparashikuara,

— humbja e vlerës së tregut,

— humbja e qirasë ose të ardhurave,

— humbje të tjera tregtare jo të drejtpërdrejta,

— humbje të tjera financiare jotregtare,

— forma të tjera të humbjes financiare,

17. Shpenzimet ligjore

Shpenzimet ligjore dhe kostoja e çështjeve gjyqësore.

18. Asistenca

Asistencë për personat që hasin në vështirësi gjatë udhëtimit, gjatë kohës që janë larg shtëpisë ose vendbanimit të tyre të zakonshëm.

B. Përshkrimi i autorizimeve të dhëna për më shumë se një klasë sigurimi

Emrat e mëposhtëm i jepen autorizimeve që mbulojnë njëkohësisht klasat e mëposhtme:

a) Klasat 1 dhe 2: "Sigurimi i shëndetit dhe nga aksidentet";

b) Klasat 1 (ndarja e katërt), 3, 7 dhe 10: "Sigurimi motorik";

- c) Klasat 1 (ndarja e katërt), 4, 6, 7 dhe 12: "Sigurimi detar dhe i transportit";
- d) Klasat 1 (ndarja e katërt), 5, 7 dhe 11: "Sigurimi i avionit";
- e) Klasat 8 dhe 9: "Sigurimi nga zjarri dhe dëmet e tjera ndaj pronës";
- f) Klasat 10, 11, 12 dhe 13: "Sigurimi i detyrimit";
- g) Klasat 14 dhe 15: "Sigurimi i kredisë dhe garancisë";
- h) Të gjitha klasat, sipas zgjedhjes së shteteve anëtare, të cilët duhet të njoftojnë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin për zgjedhjen e tyre.

SHTOJCA II

KLASAT E SIGURIMIT JETË

- I. Sigurimi i jetës që përmendet në germën "a", pika I., II. dhe III. të nenit 2, paragrafi 3, duke përjashtuar ato që përmenden në pikën II dhe III;
- II. Sigurimi i martesës, sigurimi i lindjes;
- III. Sigurimi që përmendet në germën "a", pika I dhe II, të nenit 2, paragrafi 3, që lidhen me fondet e investimit;
- IV. Sigurimi i përhershëm i shëndetit që përmendet në germën "a", pika IV, të nenit 2, paragrafi 3;
- V. Planet e investimit që përmenden në germën "b", pika I, të nenit 2, paragrafi 3;
- VI. Operacionet e kompensimit me kapital që përmendet në germën "b", pika II, të nenit 2, paragrafi 3;
- VII. Administrimi i fondeve të pensionit në grup që përmendet në germën "b", pika III dhe IV, të nenit 2, paragrafi 3;
- VIII. Operacionet që përmenden në germën "b", pika V, të nenit 2, paragrafi 3;
- IX. Operacionet që përmenden në nenin 2, paragrafi 3, germa "c".

SHTOJCA III

FORMAT JURIDIKE TË SHOQËRIVE

- A. Format e shoqërisë së sigurimit jo-jetë:

1. në rastin e Mbretërisë së Belgjikës: "société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/commanditaire vennootschap op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringsvereniging", "société coopérative/coöperatieve vennootschap", "société mutualiste/maatschappij van onderlinge bijstand";

2. në rastin e Republikës së Bullgarisë: 'акционерно дружество';

3. në rastin e Republikës së Çekisë: "akciová společnost", "družstvo";

4. në rastin e Mbretërisë së Danimarkës: "aktieselskaber", "gensidige selskaber";

5. në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "Öffentlich-rechtliches Wettbewerbsversicherungsunternehmen";

6. në rastin e Republikës së Estonisë: "aktsiaselts";

7. në rastin e Irlandës: shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar ose me garanci ose të pakufizuara;

8. në rastin e Republikës Helene: "ανώνυμη εταιρία", "αλληλασφαλιστικός συνεταιρισμός";

9. në rastin e Mbretërisë së Spanjës: "sociedad anónima", "sociedad mutua", "sociedad cooperativa";

10. në rastin e Republikës së Francës: "société anonyme", "société d'assurance mutuelle", "institution de prévoyance régie par le code de la sécurité sociale", "institution de prévoyance régie par le code rural", "mutuelles régies par le code de la mutualité";

11. në rastin e Republikës së Italisë: "società per azioni", "società cooperativa", "mutua di assicurazione";

12. në rastin e Republikës së Qipros: "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης με μετοχές", "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης χωρίς μετοχικό κεφάλαιο";

13. në rastin e Republikës së Letonisë: "apdrošināšanas akciju sabiedrība", "savstarpējās apdrošināšanas kooperatīvā biedrība";

14. në rastin e Republikës së Lituanisë: "akcinė bendrovė", "uždaroji akcinė bendrovė";

15. në rastin e Dukatës së Madhe të Luksemburgut: "société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative";

16. në rastin e Republikës së Hungarisë: "biztosító részvénytársaság", "biztosító szövetkezet", "biztosító egyesület", "külföldi székhelyű biztosító magyarországi fióktelepe";

17. në rastin e Republikës së Maltës: "limited liability company/kumpanija b' responsabbilta' limitata";

18. në rastin e Mbretërisë së Holandës: "naamloze vennootschap", "onderlinge waarborgmaatschappij";

19. në rastin e Republikës së Austrisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit";

20. në rastin e Republikës së Polonisë: "spółka akcyjna", "towarzystwo ubezpieczeń wzajemnych";

21. në rastin e Republikës së Portugalisë: "sociedade anónima", "mútua de seguros";

22. në rastin Rumanisë: "societăți pe acțiuni", "societăți mutuale";

23. në rastin e Republikës së Sllovenisë: "delniška družba", "družba za vzajemno zavarovanje";

24. në rastin e Republikës së Sllovakisë: "akciová spoločnosť";

25. në rastin e Republikës së Finlandës: "keskinäinen vakuutusyhtiö/ömsesidigt försäkringsbolag", "vakuutusosakeyhtiö/försäkringsaktiebolag", "vakuutusyhdistys/försäkringsförening";

26. në rastin e Mbretërisë së Suedisë: "försäkringsaktiebolag", "ömsesidiga försäkringsbolag", "understödsföreningar";

27. në rastin e Mbretërisë së bashkuar: "companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies registered under the Friendly Societies Acts", "the association of underwriters known as Lloyd's";

28. për çdo rast dhe si alternativë e formave të shoqërive të sigurimit jo-jetë të radhitura në pikat 1 deri në 27, forma e një Shoqërie evropiane (SHE), siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001³⁹.

B. Format e shoqërisë së sigurimit të jetës:

1. në rastin e Mbretërisë së Belgjikës: "société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/commanditaire vennootschap op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringvereniging", "société coopérative/coöperatieve vennootschap";

2. në rastin e Republikës së Bullgarisë: "акционерно дружество", "взаимозастрахователна кооперация";

3. në rastin e Republikës së Çekisë: "akciová společnost", "družstvo";

4. në rastin e Mbretërisë së Danimarkës: "aktieselskaber", "gensidige selskaber", "pensionskasser omfattet af lov om forsikringsvirksomhed (tværgående pensionskasser)";

5. në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "öffentlich-rechtliches Wettbewerbsversicherungsunternehmen";

6. në rastin e Republikës së Estonisë: "aktsiaselts";

7. në rastin Irlandës: "incorporated companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies registered under the Friendly Societies Acts";

8. në rastin e Republikës Helene: "ανώνυμη εταιρία";

9. në rastin e Mbretërisë së Spanjës: "sociedad anónima", "sociedad mutua", "sociedad cooperativa";

10. në rastin e Republikës së Francës: "société anonyme", "société d'assurance mutuelle", "institution de prévoyance régie par le code de la sécurité sociale", "institution de prévoyance régie par le code rural", "mutuelles régies par le code de la mutualité";

11. në rastin e Republikës së Italisë: "società per azioni", "società cooperativa", "mutua di assicurazione";

12. në rastin e Republikës së Qipros: "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης με μετοχές", "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης με εγγύηση";

13. në rastin e Republikës së Letonisë: "apdrošināšanas akciju sabiedrība", "savstarpējās apdrošināšanas kooperatīvā biedrība";

14. në rastin e Republikës së Lituanisë: "akcinė bendrovė", "uždaroji akcinė bendrovė";

15. në rastin e Dukatës së Madhe të Luksemburgut: "société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative";

16. në rastin e Republikës së Hungarisë: "biztosító részvénytársaság", "biztosító szövetkezet", "biztosító egyesület", "külföldi székhelyű biztosító magyarországi fióktelepe";

17. në rastin e Republikës së Maltës: "limited liability company/kumpanija b' responsabbilta' limitata";

18. në rastin e Mbretërisë së Holandës: "naamloze vennootschap", "onderlinge waarborgmaatschappij";

19. në rastin e Republikës së Austrisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit";

20. në rastin e Republikës së Polonisë: "spółka akcyjna", "towarzystwo ubezpieczeń wzajemnych";

21. në rastin e Republikës së Portugalisë: "sociedade anónima", "mútua de seguros";

22. në rastin Rumanisë: "societăți pe acțiuni", "societăți mutuale";

23. në rastin e Republikës së Sllovenisë: "delniška družba", "družba za vzajemno zavarovanje";

24. në rastin e Republikës së Sllovakisë: "akciová spoločnosť";

25. në rastin e Republikës së Finlandës: "keskinäinen vakuutusyhtiö/ömsesidigt försäkringsbolag", "vakuutusosakeyhtiö/försäkringsaktiebolag", "vakuutusyhdistys/försäkringsförening";

26. në rastin e Mbretërisë së Suedisë: "försäkringsaktiebolag", "ömsesidiga försäkringsbolag", "understödsföreningar";

27. në rastin e Mbretërisë së bashkuar: "companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies registered or incorporated under the Friendly Societies Acts", "the association of underwriters known as Lloyd's";

28. për çdo rast dhe si alternativë e formave të shoqërive të sigurimit të jetës të radhitura në pikat 1 deri në 27, forma e një Shoqërie evropiane (SHE), siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001³⁹.

C. Format e shoqërisë së risigurimit:

1. në rastin e Mbretërisë së Belgjikës: "société anonyme/naamloze vennootschap", "société en commandite par actions/commanditaire vennootschap op aandelen", "association d'assurance mutuelle/onderlinge verzekeringvereniging", "société coopérative/coöperatieve vennootschap";

2. në rastin e Republikës së Bullgarisë, "акционерно дружество";

3. në rastin e Republikës së Çekisë: "akciová společnost";

4. në rastin e Mbretërisë së Danimarkës: "aktieselskaber", "gensidige selskaber";

5. në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "Öffentlich-rechtliches Wettbewerbsversicherungsunternehmen";

6. në rastin e Republikës së Estonisë: "aktsiaselts";

7. në rastin e Irlandës: shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar ose me garanci ose të pakufizuara;

8. në rastin e Republikës Helene: "ανώνυμη εταιρία", "αλληλασφαλιστικός συνεταιρισμός";

9. në rastin e Mbretërisë së Spanjës: "sociedad anónima";

10. në rastin e Republikës së Francës: "société anonyme", "société d'assurance mutuelle", "institution de prévoyance régie par le code de la sécurité sociale", "institution de prévoyance régie par le code rural", "mutuelles régies par le code de la mutualité";

11. në rastin e Republikës së Italisë: "società per azioni";

12. në rastin e Republikës së Qipros: "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης με μετοχές", "εταιρεία περιορισμένης ευθύνης με εγγύηση";

13. në rastin e Republikës së Letonisë: "akciju sabiedrība", "sabiedrība ar ierobežotu atbildību";

14. në rastin e Republikës së Lituaniës: "akcinė bendrovė", "uždaroji akcinė bendrovė";

15. në rastin e Dukatës së Madhe të Luksemburgut: "société anonyme", "société en commandite par actions", "association d'assurances mutuelles", "société coopérative";

16. në rastin e Republikës së Hungarisë: "biztosító részvénytársaság", "biztosító szövetkezet", "harmadik országbeli biztosító magyarországi fióktelepe";

17. në rastin e Republikës së Maltës: "limited liability company/kumpanija të responsabbiltà limitata";

18. në rastin e Mbretërisë së Holandës: "naamloze vennootschap", "onderlinge waarborgmaatschappij";

19. në rastin e Republikës së Austrisë: "Aktiengesellschaft", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit";

20. në rastin e Republikës së Polonisë: "spółka akcyjna", "towarzystwo ubezpieczeń wzajemnych";

21. në rastin e Republikës së Portugalisë: "sociedade anónima", "mútua de seguros";

22. in the case of Romania 'societate pe actiuni';

23. në rastin e Republikës së Sllovenisë: "delniška družba";

24. në rastin e Republikës së Sllovakisë: "akciová spoločnosť";

25. në rastin e Republikës së Finlandës: "keskinäinen vakuutusyhtiö/ömsesidigt försäkringsbolag", "vakuutusosakeyhtiö/försäkringsaktiebolag", "vakuutusyhdistys/försäkringsförening";

26. në rastin e Mbretërisë së Suedisë: "försäkringsaktiebolag", "ömsesidigt försäkringsbolag";

27. në rastin e Mbretërisë së bashkuar: "companies limited by shares or by guarantee or unlimited", "societies registered under the Industrial and Provident Societies Acts", "societies

registered or incorporated under the Friendly Societies Acts", "the association of underwriters known as Lloyd's";

28. për çdo rast dhe si alternativë e formave të shoqërive të risigurimit të radhitura në pikat 1 deri në 27, forma e një Shoqërie evropiane (SHE), siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001.

SHTOJCA IV

FORMULA STANDARDE E KËRKESËS PËR KAPITAL DHE AFTËSI PAGUESE (SCR)

1. Llogaritja e kërkesës bazë për kapital dhe aftësi paguese

Kërkesa bazë për kapital dhe aftësi paguese e përcaktuar në nenin 104, paragrafi 1, duhet të jetë e barabartë me sa më poshtë:

kur SCRi tregon modulën e rrezikut "i" dhe SCRj tregon modulën e rrezikut "j", ku "i, j" nënkupton se shumica e afateve të ndryshme duhet të mbulojë të gjitha kombinimet e mundshme të "i" dhe "j". Gjatë llogaritjes, SCRi dhe SCRj zëvendësohen me sa më poshtë:

- SCR jo-jetë tregon modulën e rrezikut të sigurimit jo-jetë,
- SCR jetë tregon modulën e rrezikut të sigurimit të jetës,
- SCR shëndet tregon modulën e rrezikut të sigurimit të shëndetit,
- SCR treg tregon modulën e rrezikut të tregut,
- SCR e paracaktuar tregon modulën e rrezikut të paracaktuar të kundërpalës,

Faktori Corr i_j tregon zërin e vendosur në rreshtin "i" dhe në kolonën "j" të matricës së mëposhtme të përputhshmërisë:

j

i Tregu E paracaktuar Jeta Shëndeti Jojeta

Tregu 1 0,25 0,25 0,25 0,25

E paracaktuar 0,25 1 0,25 0,25 0,5

Jeta 0,25 0,25 1 0,25 0

Shëndeti 0,25 0,25 0,25 1 0

Jojeta 0,25 0,5 0 0 1

2. Llogaritja e marrjes në sigurim për modulën jo-jetë

Moduli i rrezikut të sigurimit jo-jetë, i përcaktuar në nenin 105, paragrafi 2, duhet të jetë e barabartë me sa më poshtë:

kur SCRi tregon nënmodulin "i" dhe SCRj tregon nënmodulin "j", ku "i, j" nënkupton se shuma e afateve të ndryshme duhet të mbulojë të gjitha kombinimet e mundshme të "i" dhe "j". Gjatë llogaritjes, SCRi dhe SCRj zëvendësohen me sa më poshtë:

— SCR primi dhe rezerva jj tregon nënmodulin e rrezikut të primeve dhe rezervave për sigurimin jo-jetë,

— SCR katastrofa jj tregon modulin e rrezikut nga katastrofat për sigurimin jo-jetë,

3. Llogaritja e modulit të rrezikut për sigurimin jetë

Moduli i rrezikut të sigurimit të jetës, i përcaktuar në nenin 105, paragrafi 3, duhet të jetë i barabartë me sa më poshtë:

kur SCRi tregon nënmodulin "i" dhe SCRj tregon nënmodulin "j", ku "i, j" nënkupton se shuma e afateve të ndryshme duhet të mbulojë të gjitha kombinimet e mundshme të "i" dhe "j". Gjatë llogaritjes, SCRi dhe SCRj zëvendësohen me sa më poshtë:

— SCR vdekshmëri tregon nënmodulin e rrezikut të vdekshmërisë,

— SCR jetëgjatësi tregon nënmodulin e rrezikut të jetëgjatësisë,

— SCR aftësi e kufizuar tregon nënmodulin e rrezikut të aftësisë së kufizuar/sëmundshmërisë,

— SCR shpenzime jetësore tregon nënmodulin e rrezikut të shpenzimeve jetësore,

— SCR rishikim tregon nënmodulin e rrezikut të rishikimit,

— SCR ndërprerje tregon nënmodulin e rrezikut të ndërprerjes,

— SCR katastrofa jetësore tregon nënmodulin e rrezikut të katastrofave jetësore,

4. Llogaritja e modulit të rrezikut të tregut

Struktura e modulit të rrezikut të tregut

Moduli i rrezikut tregut, i përcaktuar në nenin 105, paragrafi 5, duhet të jetë i barabartë me sa më poshtë:

kur SCRi tregon nënmodulin "i" dhe SCRj tregon nënmodulin "j", ku "i, j" nënkupton se shuma e afateve të ndryshme duhet të mbulojë të gjitha kombinimet e mundshme të "i" dhe "j". Gjatë llogaritjes, SCRi dhe SCRj zëvendësohen me sa më poshtë:

— SCR norma e interesit tregon nënmodulin e rrezikut të normës së interesit,

- SCR kapitali i vet tregon nënmodulin e rrezikut të kapitalit të vet,
- SCR pronë tregon nënmodulin e rrezikut të pronës,
- SCR përhapje tregon nënmodulin e rrezikut të përhapjes,
- SCR përqendrim tregon nënmodulin e përqendrimeve të rrezikut të tregut,
- SCR monedha tregon nënmodulin e rrezikut të monedhës,

SHTOJCA V

GRUPET E KLASAVE TË SIGURIMIT JOJETË PËR QËLLIMET E NENIT 159

1. Aksidentet dhe sëmundja (klasat 1 dhe 2 të shtojcës I),
2. mjetet motorike (klasat 3, 7 dhe 10 të shtojcës I, shifrat për klasën 10, duke përjashtuar përgjegjësinë e transportuesve, e cila jepet veçmas
3. zjarri dhe dëme të tjera të pronës (klasat 8 dhe 9 të shtojcës I),
4. Aviacioni, mjetet detare dhe transporti (klasat 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12 të shtojcës I),
5. përgjegjësia e përgjithshme (klasa 13 e shtojcës I),
6. kredia dhe garancia (klasat 14 dhe 15 të shtojcës I),
7. klasa të tjera (klasat 16, 17 dhe 18 të shtojcës I).

SHTOJCA VI

PJESA A

DIREKTIVAT E SHFUQIZUARA ME LISTËN E NDRYSHIMEVE TË TYRE VIJUESE

(përmendur në nenin 310)

Direktiva e Këshillit 64/225/KEE

Akti i Aderimit, 1973, neni 29, shtojca I, pika III(G)(1)

Direktiva e Parë e Këshillit 73/239/KEE

Akti i Aderimit, 1994, neni 29, shtojca I(XI)(B)(II)(1)

(Gazeta Zyrtare C 241, 29.8.1994, f. 197).

(zëvendësohen me Vendim të Këshillit 95/1/KE)

Akti i Aderimit, 2003, neni 20, shtojca II(3)(1)

Akti i Aderimit, 1985, neni 26, shtojca I(II)(c)(1)(a)

Direktivë e Këshillit 76/580/KEE vetëm neni 1

Direktivë e Këshillit 84/641/KEE vetëm nenet 1 deri në 14

Direktivë e Këshillit 87/343/KEE vetëm neni 1 dhe shtojca

Direktivë e Këshillit 87/344/KEE vetëm neni 9

Direktivë e Këshillit 88/357/KEE vetëm nenet 9, 10 dhe 11

Direktiva e Këshillit 90/618/KEE vetëm nenet 2, 3 dhe 4

Direktivë e Këshillit 92/49/KEE vetëm nenet 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 13, 14, 17, 18, 24, 32, 33 dhe 53

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 95/26/KE vetëm neni 1, neni 2, paragrafi 2, ndarja e tretë dhe neni 3, paragrafi 1

Direktiva 2000/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 8

Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1

Direktiva 2002/87/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 22

Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 4

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 57

Direktiva 2006/101/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1 dhe shtojca, pika 1

Direktiva e Këshillit 73/240/KEE

Direktiva e Këshillit 76/580/KEE

Direktiva e Këshillit 78/473/KEE

Direktiva e Këshillit 84/641/KEE

Direktiva e Këshillit 87/344/KEE

Direktiva e Dytë e Këshillit 88/357/KEE

Direktivë e Këshillit 90/618/KEE vetëm nenet 5 deri në 10

Direktiva e Këshillit 92/49/KEE vetëm nenet 12, paragrafi 1, neni 19, 23, 27, 30, paragrafi 1, neni 34, 35, 36, 37, neni 39, paragrafi 1, neni 40, paragrafi 1, neni 42, paragrafi 1, neni 43, paragrafi 1, neni 44, paragrafi 1, neni 45, paragrafi 1, dhe neni 46, paragrafi 1

Direktiva 2000/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 9

Direktiva 2005/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 3

Direktiva e Këshillit 92/49/KEE

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 95/26/KE vetëm neni 1, ndarja e dytë, neni 2, paragrafi 1, ndarja e parë, neni 4, paragrafët 1, 3 dhe 5 dhe neni 5, ndarja e dytë

Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 2

Direktiva 2002/87/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 24

Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 6

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 58

Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1

Direktivë 98/78/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Direktiva 2002/87/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 28

Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 7

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 59

Direktivë 2001/17/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Direktivë 2002/83/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Direktiva e Këshillit 2004/66/KE vetëm pika II e shtojcës

Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 8

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 60

Direktiva 2006/101/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1 dhe pika 3 e shtojcës

Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 2

Direktiva 2008/19/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1

Direktivë 2005/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 4

Direktiva 2008/19/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1

Direktiva 2008/37/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit vetëm neni 1

PJESA B

Lista e afateve kohore për transpozim në legjislacionin e brendshëm

(përmendur në nenin 310)

Direktiva Afati kohor për transpozim Afati kohor për zbatim

64/225/KEE 26 gusht 1965

73/239/KEE 27 janar 1975 27 janar 1976

73/240/KEE 27 janar 1975

76/580/KEE 31 dhjetor 1976

78/473/KEE 2 dhjetor 1979 2 qershor 1980

84/641/KEE 30 qershor 1987 1 janar 1988

87/343/KEE 1 janar 1990 1 korrik 1990

87/344/KEE 1 janar 1990 1 korrik 1990

88/357/KEE 30 dhjetor 1989 30 qershor 1990

90/618/KEE 20 maj 1992 20 nëntor 1992

92/49/KEE 31 dhjetor 1993 1 qershor 1994

95/26/KEE 18 korrik 1996 18 korrik 1996

98/78/KE 5 qershor 2000

2000/26/KE 20 korrik 2002 20 janar 2003

2000/64/KE 17 nëntor 2002

2001/17/KE 20 prill 2003

2002/13/KE 20 shtator 2003

2002/83/KE 17 nëntor 2002, 20 shtator 2003, 19 qershor 2004 (në varësi të dispozitave të veçanta)

2002/87/KE 11 gusht 2004

2004/66/KE 1 maj 2004

2005/1/KE 13 maj 2005

2005/14/KE 11 qershor 2007

2005/68/KE 10 dhjetor 2007

2006/101/KE 1 janar 2007

2008/19/KE Nuk zbatohet

2008/37/KE Nuk zbatohet

SHTOJCA VII

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Direktiva 73/239/KEE Direktiva 78/473/KEE Direktiva 87/344/KEE Direktiva 88/357/KEE Direktiva 92/49/KEE Direktiva 98/78/KE Direktiva 2001/17/KE Direktiva 2002/83/KE Direktiva 2005/68/KE Direktiva 2007/44/KE Kjo direktivë

Neni 1, paragrafi 1 Neni 2 Neni 1, paragrafi 1 Neni 2, fjalia e parë Neni 1, paragrafi 1
Neni 1. Neni 2, paragrafi 2, neni 2, paragrafi 3 dhe neni 267

Neni 1, paragrafi 2, Neni 2, paragrafi 2

Neni 1, paragrafi 3 —

Neni 2, paragrafi 1, germat "a" deri në "c" —

Neni 2, paragrafi 1, germa "d", Neni 3, paragrafi 4, Neni 3

Neni 2, paragrafi 1, germa "e" —

Neni 2, paragrafi 2, germa "a", Neni 5, paragrafi 1

Neni 2, paragrafi 2, germa "b", Neni 5, paragrafi 2

Neni 2, paragrafi 2, germa "c", Neni 5, paragrafi 3

Neni 2, paragrafi 2, germa "d", Neni 5, paragrafi 4

Neni 2, paragrafi 3, nënparagrafi i parë deri tek i katërti, Neni 6

Neni 2, paragrafi 3, nënparagrafi i pestë, Neni 15, paragrafi 4

Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi i parë dhe i dytë —

Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi i tretë, Neni 4, paragrafi 5

Neni 3, paragrafi 2, Neni 7

Neni 4, fjalia e parë, Neni 8, fjalia e parë

Neni 4, germa "a", Neni 8, paragrafi 2

Neni 4, germa "b" —

Neni 4, germa "c", Neni 8, paragrafi 3

Neni 4, germa "e" —

Neni 4, germa "f", Neni 8, paragrafi 1

Neni 4, germa "g", Neni 8, paragrafi 4

Neni 5 germa "a" —

Neni 5, germa "b", Neni 1, paragrafi 1, germa "o"

Neni 5, germa "c", Neni 1, paragrafi 1, germa "p" neni 134, paragrafi 1

Neni 5, germa "d" —

Neni 6 Neni 4 Neni 4 Neni 3 Neni 14, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, germat "a" dhe "b"

Neni 7, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë Neni 5, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë Neni 5, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë Neni 15, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë

Neni 7, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germa "a" neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germa "a" Neni 15, paragrafi 3, nënparagrafi i parë

Neni 7, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germa "b" Neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germa "b" —

Neni 8, paragrafi 1, germa "a" Neni 6, paragrafi 1, germa "a" Neni 6, paragrafi 1, germa "a" Shtojca I Shtojca IIIA dhe B

Neni 8, paragrafi 1, germa "a", paragrafi i fundit Neni 5, paragrafi 2 Neni 17, paragrafi 2

Neni 8, paragrafi 1, germa "b" Neni 6, paragrafi 1, germa "b" Neni 6, paragrafi 1, germa "b" Neni 6, germa "a" Neni 18, paragrafi 1, germa "a"

Neni 6, germa "a" Neni 18, paragrafi 1, germa "b"

Neni 8, paragrafi 1, germa "c" Neni 6, paragrafi 1, germa "c" Neni 6, paragrafi 1, germa "c" Neni 6, germa "b" Neni 18, paragrafi 1, germa "c"

Neni 8, paragrafi 1, germa "d" Neni 6, paragrafi 1, germa "d" Neni 6, paragrafi 1, germa "c" Neni 6, germa "c" Neni 18, paragrafi 1, germa "d"

Neni 8, paragrafi 1, germa "e" Neni 6, paragrafi 1, germa "e" Neni 6, paragrafi 1, germa "e" Neni 6, germa "d" Neni 18, germa "g"

Neni 8, paragrafi 1, germa "f" Neni 18, germa "h"

Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi i parë deri tek i katërti Neni 6, paragrafi 2 Neni 7 Neni 19

Neni 8, paragrafi 1a Neni 6, paragrafi 3 Neni 8 Neni 20

Neni 8, paragrafi 2 Neni 6, paragrafi 2 Neni 6, paragrafi 4 Neni 18, paragrafi 2

Neni 8, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 6, paragrafi 5, nënparagrafi i tretë Neni 9, paragrafi 1 Neni 21, paragrafi 4

Neni 8, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë dhe neni 29, nënparagrafi i parë, fjalia e parë Neni 6, paragrafi 5, nënparagrafi i parë Neni 9, paragrafi 2 Neni 21, paragrafi 1, nënparagrafi i parë

Neni 8, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë dhe neni 29, nënparagrafi i dytë Neni 21, paragrafi 2

Neni 8, paragrafi 3, nënparagrafi i katërt Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i katërt Neni 21, paragrafi 3

Neni 8, paragrafi 4 Neni 6, paragrafi 4 Neni 6, paragrafi 6 Neni 10 Neni 22

Neni 9, germat "a" - "d" Neni 7, germat "a" - "d" Neni 7, germat "a" - "d" Neni 11, paragrafi 1, germat "a", "c", "d" dhe "e" Neni 23, paragrafi 1, germat "a", "c", "d" dhe "e"

Neni 9, germat "e" dhe "f" Neni 7, germat "e" dhe "f" Neni 11, paragrafi 2, germat "a" dhe "b" Neni 23, paragrafi 2, germa "e"

Neni 9, germat "g" dhe "h" Neni 7, germat "b" dhe "h" Neni 7, germat "f" dhe "g" Neni 11, paragrafi 2, germat "c" dhe "d" Neni 23, paragrafi 2, germat "a" dhe "d"

Neni 10, paragrafi 1 Neni 32, paragrafi 1 Neni 40, paragrafi 1 Neni 145, paragrafi 1, nënparagrafi i parë

Neni 10, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 32, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 40, paragrafi 2 Neni 145, paragrafi 2

Neni 10, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 32, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 145, paragrafi 3

Neni 10, paragrafi 3 Neni 32, paragrafi 3 Neni 40, paragrafi 3 Neni 146, paragrafi 1 dhe 2

Neni 10, paragrafi 4 Neni 32, paragrafi 4 Neni 40, paragrafi 4 Neni 146, paragrafi 3

Neni 10, paragrafi 5 Neni 32, paragrafi 5 Neni 40, paragrafi 5 Neni 146, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë

Neni 10, paragrafi 6 Neni 32, paragrafi 6 Neni 40, paragrafi 6 Neni 145, paragrafi 4

Neni 11 Neni 33 —

Neni 12 Neni 56 Neni 9 Neni 13 Neni 25, nënparagrafi i dytë

Neni 12a Neni 9a Nenet 14 dhe 60, paragrafi 2 Neni 26

Neni 13, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë Neni 9, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë Neni 10, paragrafi 1, fjalia e parë dhe paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 15, paragrafi 1, nënparagrafi i parë dhe paragrafi 2 Neni 30, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë

Neni 13, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 30, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë

Neni 10, paragrafi 1, fjalia e dytë dhe e tretë Neni 15, paragrafi 1, nënparagrafi 2 Neni 30, paragrafi 3

Neni 13, paragrafi 2, nënparagrafi i tretë Neni 10, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 60, paragrafi 3 Neni 32, paragrafi 1

Neni 13, paragrafi 3 Neni 9, paragrafi 3 Neni 10, paragrafi 3 Neni 15, paragrafi 4 —

Neni 14 Neni 10 Neni 11 Neni 16 Neni 33

Neni 15, paragrafi 1, 2 dhe 3, nënparagrafi i dytë Neni 17 Neni 20, paragrafi 1-3 dhe 4, nënparagrafi i dytë Neni 32, paragrafi 1 dhe 3 Nenet 76 deri në 86

Neni 15, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 20, paragrafi 4, nënparagrafi i parë Neni 32, paragrafi 2 Neni 134, paragrafi 2 dhe neni 173

Neni 15a Neni 18 Neni 33 —

Neni 16 Neni 27 Nenet 35, 36, 60, paragrafi 8 Nenet 87-99

Neni 16a Neni 28 Nenet 37-39, 60, paragrafi 9 Nenet 100-127

Neni 17, paragrafi 1 Neni 29, paragrafi 1 Neni 40, paragrafi 1 Nenet 128 dhe 129, paragrafi 1, germa "a" - "c" dhe paragrafi 2

Neni 17, paragrafi 2 Neni 29, paragrafi 2 Neni 40, paragrafi 2 Neni 129, paragrafi 1, germa "d"

Neni 17/a Neni 30 Neni 41 —

Neni 17/b Nenet 28 dhe 28, germa "a" Neni 60, paragrafi 10 —

Neni 18 Neni 31 —

Neni 14 Neni 11 Neni 16 Neni 33

Neni 19, paragrafi 2 Neni 11, paragrafi 2 Neni 13, paragrafi 2 Neni 17, paragrafi 2 Neni 35

Neni 19, paragrafi 3, nënparagrafi i parë dhe i dytë, germa "a" dhe "b" Neni 10 Neni 11, paragrafi 3, nënparagrafi i parë dhe i dytë, germa "a" dhe "b" Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi i parë dhe i dytë, paragrafi 1 dhe 2, germa "a" dhe "b" Neni 17, paragrafi 3 dhe 4, nënparagrafi i parë, germa "a" dhe "b" Neni 34, paragrafi 1-3, 5, 6 dhe 7

Neni 19, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë, germa "c" Neni 10 Neni 11, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë, germa "c" Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë, germa "c" Neni 17, paragrafi 4, nënparagrafi i parë, germa "c" Neni 34, paragrafi 8

Neni 19, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë Neni 10 Neni 11, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë Neni 17, paragrafi 4, nënparagrafi i dytë Neni 35, paragrafi 2, germa "b"

Neni 20, paragrafi 1 Neni 37, paragrafi 1 Neni 42, paragrafi 1 Neni 137

Neni 20, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 13, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 37, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 42, paragrafi 2, nënparagrafi i parë

Neni 20, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 13, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 37, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 42, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 138, paragrafi 5

Neni 20, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 37, paragrafi 3, nënparagrafi i parë Neni 42, paragrafi 3, nënparagrafi i parë

Neni 20, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë Neni 37, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë Neni 42, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë Neni 139, paragrafi 3

Neni 20, paragrafi 4 Neni 13, paragrafi 4 —

Neni 20, paragrafi 5 Neni 13, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe paragrafi 5 Neni 37, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe paragrafi 5 Neni 42, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe paragrafi 4 Neni 138, paragrafi 5

Neni 20a, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia e parë Neni 38, paragrafi 1, fjalia e parë Neni 43, paragrafi 1 Neni 138, paragrafi 2 dhe neni 139, paragrafi 2

Neni 20a, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia e dytë, germet "a" - "e" Neni 38, paragrafi 1, fjalia e dytë, germet "a" - "e" Neni 43, paragrafi 2, germet "a" - "e" Neni 142, paragrafi 1

Neni 20/a, paragrafi 2 Neni 38, paragrafi 2 Neni 141

Neni 20/a, paragrafi 3 Neni 38, paragrafi 3 Neni 43, paragrafi 4 Neni 140, paragrafi 2

Neni 20/a, paragrafi 4 Neni 38, paragrafi 4 Neni 43, paragrafi 5 —

Neni 20/a, paragrafi 5 Neni 38, paragrafi 5 Neni 43, paragrafi 6 Neni 142, paragrafi 2

Neni 21 Neni 11, paragrafi 1

Neni 22, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, germet "a", "b" dhe "d" Neni 14 Neni 39, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, germet "a", "b" dhe "d" Neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, germet "a", "b" dhe "d" Neni 144, paragrafi 1, germet "a", "b" dhe "c"

Neni 22, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia e parë Neni 39, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia e parë Neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë Neni 144, paragrafi 2, nënparagrafi i parë

Neni 22, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia e dytë Neni 39, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia e dytë Neni 144, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë

Neni 22, paragrafi 2 Neni 39, paragrafi 2 Neni 44, paragrafi 2 Neni 144, paragrafi 3

Neni 23, paragrafi 1 Neni 51, paragrafi 1 Neni 162, paragrafi 1

Neni 23, paragrafi 2, germa "a" - "g" Neni 51, paragrafi 2 Neni 162, paragrafi 2, germet "a" - "f" dhe "h"

Neni 23, paragrafi 2, germa "h" Neni 162, paragrafi 2, germa "g"

Neni 24, nënparagrafi i parë, fjalia e parë Neni 54, nënparagrafi i parë, fjalia e parë Neni 165, fjalia e parë

Neni 24, nënparagrafi i parë, fjalia e dytë dhe nënparagrafi i tretë neni 54, nënparagrafi i parë, fjalia e dytë, nënparagrafi i tretë —

Neni 25 Neni 55 Neni 166

Neni 26 Neni 56 Neni 167

Neni 27, nënparagrafi i parë Neni 52, paragrafi 2, nënparagrafi i parë Neni 168, nënparagrafi i parë

Neni 27, nënparagrafi i dytë Neni 52, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë Neni 168, nënparagrafi i dytë

Neni 28 Neni 52, paragrafi 3 Neni 170

Neni 28a Neni 53 Neni 53 Neni 164

Neni 29 Neni 57 Neni 171

Neni 29a neni 58 Neni 176, nënparagrafi i parë deri tek i treti

Neni 29/b, paragrafi 1 dhe 2 Neni 59, paragrafi 1 dhe 2 Neni 52, paragrafi 1 dhe 2 Neni 177, paragrafi 1 dhe 2

Neni 29/ b, paragrafët 3-6 Neni 59, paragrafët 3-6 Neni 52, paragrafi 3 dhe 4 —

Neni 30, paragrafi 1 dhe 2, germa "a" —

Neni 30, paragrafi 2, germa "b" Neni 305, paragrafi 1

Neni 30, paragrafi 4 Neni 305, paragrafi 2

Neni 30, paragrafi 5 Neni 305, paragrafi 4

Neni 31 —

Neni 32 —

Neni 33 Neni 28 Neni 62 Neni 54, paragrafi 2 Neni 298, paragrafi 2 dhe 3

Neni 34 Neni 9 Neni 29 Neni 11, paragrafi 5 Neni 6, paragrafi 5, nënparagrafi i katërt Neni 6 —

Neni 35 Neni 10 Neni 10 Neni 32 Neni 57, paragrafi 1 Neni 11, paragrafët 1-3 Neni 31, paragrafi 1 dhe 2 Neni 69, paragrafët 1-4 Neni 64, paragrafi 1 Neni 7, paragrafi 1 Neni 309, paragrafi 1

Neni 36 Neni 11 Neni 11 Neni 33 Neni 57, paragrafi 2 Neni 11, paragrafi 4 Neni 31, paragrafi 3 Neni 70 Neni 64, paragrafi 2 Neni 7, paragrafi 2 Neni 309, paragrafi 2

Neni 37 Neni 34 —

Neni 38 Neni 12 Neni 12 Neni 35 Neni 58 Neni 13 Neni 33 Neni 74 Neni 66 Neni 9 Neni

Shtojca, pjesa A Neni 15, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe shtojca I, pjesa A

Shtojca, pjesa A, B Shtojca 1, pjesa A dhe B

Shtojca, pjesa C Neni 16

Shtojca, pjesa D —

Neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi i parë Neni 190, paragrafi 1

Neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë Neni 190, paragrafi 2

Neni 1, paragrafi 2 —

Neni 2, paragrafi 1 Neni 190, paragrafi 1

Neni 2, paragrafi 2 Neni 190, paragrafi 3

Neni 3 Neni 191

Neni 4, paragrafi 1 Neni 192, nënparagrafi i parë dhe i dytë

Neni 4, paragrafi 2 —

Neni 5 Neni 193

Neni 6 Neni 195

Neni 7 Neni 194

Neni 8 Neni 196

Neni 1 —

Neni 2 Neni 198

Neni 3, paragrafi 1 Neni 199

Neni 3, paragrafi 2, nënparagrafi i parë, fjalia e parë Neni 200, paragrafi 1, nënparagrafi i parë

Neni 3, paragrafi 2, germa "a" - "c" Neni 200, paragrafi 2 - 4

Neni 3, paragrafi 3 Neni 200, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë

Neni 4 Neni 201

Neni 5 Neni 202

Neni 6 Neni 203

Neni 7 Neni 204

Neni 8 Neni 205

Neni 9 Neni 16, paragrafi 2

Neni 1 —

Neni 2, germat "a" "b" dhe "e" —

Neni 2, germa "c" Neni 1, paragrafi 1, germa "c" Neni 2, paragrafi 1, germa "e" —

Neni 2, germa "d" Neni 13, paragrafi 13

Neni 2, germa "f" Neni 1, germa "e" Neni 1, paragrafi 1, germa "h" —

Neni 3 Neni 1, germa "b", fjalia e dytë Neni 145, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë

Neni 4 Neni 187

Neni 6 —

Neni 7, paragrafi 1, germat "a" - "e" —

Neni 7, paragrafi 1, germa "f" Neni 27 —

Neni 7, paragrafi 1, germa "g" dhe paragrafi 3 —

Neni 8, paragrafi 1 dhe 2 Neni 179, paragrafi 1 dhe 2

Neni 8, paragrafi 3 —

Neni 8, paragrafi 4, germat "a" dhe "c" Neni 30, paragrafi 1 —

Neni 8, paragrafi 4, germa "d" Neni 179, paragrafi 3

Neni 8, paragrafi 5 Neni 179, paragrafi 4

Neni 12 —

Neni 12a, paragrafët 1- 3 Neni 150

Neni 12a, paragrafi 4, nënparagrafi i parë Neni 151

Neni 12a, paragrafi 4, nënparagrafi i parë deri tek i gjashti Neni 152

Neni 14 Neni 34 Neni 41 Neni 147

Neni 16, paragrafi 1, paragrafi i parë dhe i dytë Neni 35 Neni 42 Neni 148

Neni 16, paragrafi 1, nënparagrafi i tretë Neni 35 Neni 148, paragrafi 2

Neni 17 Neni 36 Neni 43 Neni 149

Neni 26 —

Neni 27 —

Neni 31 Neni 299

Neni 31 Neni 68, paragrafi 2 Neni 300

Shtojca I Neni 23 Shtojca II —

Shtojca 2A —

Shtojca 2B —

Nenet 5, 9, 10, 11 —

Neni 1, germa "a" Neni 1, germa "a" Neni 2, germa "a" Neni 1, paragrafi 1, germa "a"
Neni 13, paragrafi 1

Neni 1, germa "b" Neni 1, paragrafi 1, germa "b" Neni 2, paragrafi 1, germa "d" Neni 13,
paragrafi 11

Neni 1, germa "c" Neni 2, germa "e" Neni 1, paragrafi 1, germa "e" Neni 2, paragrafi 1,
germa "f" Neni 13, paragrafi 8, germa "a"

Neni 1, germa "d" Neni 1, paragrafi 1, germa "f" Neni 2, paragrafi 1, germa "g" —

Neni 1, germa "f" Neni 1, paragrafi 1, germa "i" Neni 2, paragrafi 1, germa "i" Neni 13,
paragrafi 18

Neni 1, germa "g" Neni 1, paragrafi 1, germa "j" Neni 2, paragrafi 1, germa "j" Neni 13,
paragrafi 21 Neni 24, paragrafi 2 dhe neni 63

Neni 1, germa "h" Neni 1, germa "d" Neni 1, paragrafi 1, germa "k" Neni 2, paragrafi 1,
germa "k" Neni 13, paragrafi 15

Neni 1, germa "i" Neni 1, germa "e" Neni 1, paragrafi 1, germa "l" Neni 2, paragrafi 1,
germa "l" Neni 13, paragrafi 16

Neni 1, germa "j" Neni 1, paragrafi 1, germa "m" Neni 13, paragrafi 22

Neni 1, germa "k" Neni 1, germa "k" Neni 2, germa "h" Neni 1, paragrafi 1, germa "n"
Neni 2, paragrafi 1, germa "m" Neni 13, paragrafi 10

Neni 1, germa "l" Neni 1, paragrafi 1, germa "r" Neni 2, paragrafi 1, germa "n" Neni 13, paragrafi 17

Neni 1, germa "l" dhe "a" Neni 1, germa "f" Neni 1, paragrafi 1, germa "r" dhe "i" Neni 2, paragrafi 1, germa "n" dhe "i" Neni 13, paragrafi 20

Neni 1, germa "l" dhe "b" Neni 1, paragrafi 1, germa "r", pika "ii" Neni 2, paragrafi 1, germa "n", pika "ii" Neni 13, paragrafi 18

Neni 3 Neni 188

Neni 8 Neni 12 Neni 24, paragrafi 1

Neni 12, paragraf 2 Neni 14, paragrafi 1 Neni 18 Neni 39, paragrafi 1

Neni 12, paragrafët 3 - 6 Neni 14, paragrafët 2 - 5 Neni 39, paragrafët 2 - 6

Neni 15, paragrafi 1 dhe 2 Neni 15, paragrafi 1 dhe 2 Neni 19, paragrafi 1 Neni 57

Neni 15, paragrafi 3 Neni 15, paragrafi 3 Neni 22 Neni 61

Neni 15, paragrafi 4 Neni 15, paragrafi 4 Neni 23 Neni 62

Neni 15a Neni 15a Neni 19, paragrafët 2 - 8 Neni 58, paragrafët 1 - 7

Neni 15b Neni 15b Neni 19a Neni 59

Neni 15c Neni 15c Neni 20 Neni 60

Neni 16, paragrafi 1 Neni 16, paragrafi 1 Neni 24 Neni 64

Neni 16, paragrafi 2 Neni 16, paragrafi 2 Neni 25 Neni 65

Neni 16, paragrafi 3 Neni 16, paragrafi 3 Neni 26 Neni 66

Neni 16, paragrafi 4 Neni 16, paragrafi 4 Neni 27 Neni 67

Neni 16, paragrafi 5 Neni 16, paragrafi 5 Neni 28, paragrafi 1 Neni 68, paragrafi 1

Neni 16, paragrafi 5b, nënparagrafi i parë deri tek i katërti neni 16, paragrafi 7, nënparagrafi i parë deri tek i katërti neni 28, paragrafi 3, nënparagrafi i parë deri tek i katërti neni 68, paragrafi 3

Neni 16, paragrafi 5/b, nënparagrafi i pestë Neni 16, paragrafi 7, nënparagrafi i pestë Neni 28, paragrafi 3, nënparagrafi i pestë neni 68, paragrafi 4

Neni 16, paragrafi 3 Neni 66

Neni 16, paragrafi 5/c Neni 16, paragrafi 8 Neni 29 Neni 70

Neni 16, paragrafi 5/a Neni 16, paragrafi 6 Neni 28, paragrafi 2 Neni 68, paragrafi 2

Neni 16/a, paragrafi 1, germa "a" Neni 17, paragrafi 1, germa "a" Neni 31, paragrafi 1, nënparagrafi i parë Neni 72, paragrafi 1, germat "a" - "c"

Neni 16/a, paragrafi 1, germa "b" Neni 17, paragrafi 1, germa "b" Neni 31, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë Neni 72, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë

Neni 16/a, paragrafi 2 Neni 17, paragrafi 2 Neni 31, paragrafi 2 Neni 72, paragrafi 2

Neni 20 Neni 22 —

Neni 21 Neni 23 neni 34, paragrafët 1 - 3 —

Neni 22 Neni 24 Neni 34, paragrafi 4 —

Neni 25 —

Neni 28 Neni 33 Neni 180

Neni 29 Neni 181, paragrafët 1 dhe 3

Neni 30, paragrafi 2 Neni 181, paragrafi 2

Neni 31 Neni 183

Neni 38 Neni 44 Neni 153

Neni 39, paragrafi 2 dhe 3 Neni 45 Neni 154

Neni 40, paragrafi 2 Neni 46, paragrafi 1 Neni 155, paragrafi 8

Neni 40, paragrafi 3 Neni 46, paragrafi 2 Neni 155, paragrafi 1

Neni 40, paragrafi 4, paragrafët 6 - 8 dhe paragrafi 10 Neni 46, paragrafi 3, paragrafët 5 - 7 dhe paragrafi 9 Neni 155, paragrafi 2, paragrafët 4 - 6 dhe paragrafi 9

Neni 40, paragrafi 5 Neni 46, paragrafi 4 Neni 155, paragrafi 3

Neni 40, paragrafi 9 Neni 46, paragrafi 8 Neni 155, paragrafi 7

Neni 41 Neni 47 Neni 156

Neni 42, paragrafi 2 Neni 48 Neni 160

Neni 43, paragrafët 2 dhe 3 Neni 184

Neni 44, paragrafi 2 Neni 49 Neni 159 dhe shtojca V

Neni 45, paragrafi 2 Neni 189

Neni 46, paragrafi 2, nënparagrafi i parë dhe i tretë Neni 50, paragrafi 1, nënparagrafi i parë dhe i tretë dhe paragrafi 2 Neni 157

Nenet 47 - 50 —

Neni 51 Neni 64 Neni 56 —

Neni 51, ndarja e fundit Neni 1, paragrafi 4 Neni 58, paragrafi 8

Neni 52 —

Neni 54 Neni 206

Neni 55 Neni 207

Nenet 24 dhe 26 —

Neni 12, paragrafi 1, nenet 19, 33, 37, 39, paragrafi 1, neni 40, paragrafi 1, neni 42, paragrafi 1, neni 43, paragrafi 1, neni 44, paragrafi 1, neni 45, paragrafi 1, neni 46, paragrafi 1 —

Neni 1, germa "b" Neni 13, paragrafi 3

Neni 1, germa "c" Neni 1, paragrafi 1, germa "s" Neni 2, paragrafi 1, germa "c" Neni 13, paragrafi 4

Neni 1, germa "g" Neni 212, paragrafi 1, germa "a"

Neni 1, germa "h" Neni 212, paragrafi 1, germa "b"

Neni 1, germa "i" Neni 59, paragrafi 2, germa "a", pika i Neni 210, paragrafi 1, germa "f"

Neni 1, germa "j" Neni 59, paragrafi 2, germa "a" dhe "j" Neni 210, paragrafi 1, germa "g"

Neni 1, germa "l" Neni 59, paragrafi 2, germa "b" Neni 13, paragrafi 6

Neni 2 Neni 59, paragrafi 3 Neni 214, paragrafi 1

Neni 3 Neni 59, paragrafi 3 Neni 214, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi i parë dhe i dytë

Neni 4 Neni 59, paragrafi 3 Neni 247, paragrafi 1

Neni 5, paragrafi 1 Neni 59, paragrafi 4 Neni 246

Neni 5, paragrafi 2 Neni 254, paragrafi 1

Neni 6 Neni 59, paragrafi 5 Neni 254, paragrafi 2 Neni 255, paragrafi 1 dhe 2

Neni 7 Neni 59, paragrafi 5 Neni 249, paragrafi 1, neni 252, neni 253

Neni 8 Neni 59, paragrafi 5 Nenet 245, 246, 258, paragrafi 1

Neni 9 Neni 59, paragrafi 6 Nenet 218, 219, 258, paragrafi 1

Neni 10 Neni 59, paragrafi 7 Nenet 218, 219, 258, paragrafi 1, nenet 260 - 263

Neni 10/a Neni 59, paragrafi 8 Neni 264

Neni 10/b Neni 257

Neni 12 Neni 32 Neni 73 Neni 65 Neni 8, paragrafi 1 Neni 311

Shtojca I Neni 59, paragrafi 9 dhe shtojca II Nenet 213-215, 218-246

Shtojca II Neni 59, paragrafi 9 dhe shtojca II Nenet 215-217, 220-243

Neni 1, paragrafi 2 Neni 267

Neni 2, germa "b" Neni 268, paragrafi 1, germa "b"

Neni 2, germa "c" Neni 268, paragrafi 1, germa "c"

Neni 2, germa "d" Neni 268, paragrafi 1, germa "d"

Neni 2, germa "f" Neni 2, paragrafi 1, germa "h" Neni 13, paragrafi 9

Neni 2, germa "g" Neni 268, paragrafi 1, germa "a"

Neni 2, germa "i" Neni 268, paragrafi 1, germa "e"

Neni 2, germa "j" Neni 268, paragrafi 1, germa "f"

Neni 2, germa "k" Neni 268, paragrafi 1, germa "g"

Neni 3 —

Neni 4 Neni 269

Neni 5 Neni 270

Neni 6 Neni 271

Neni 7 Neni 272

Neni 8 Neni 273

Neni 9 Neni 274

Neni 10 Neni 275

Neni 11 Neni 277

Neni 12 Neni 278

Neni 13 Neni 279

Neni 14 Neni 280

Neni 15 Neni 281

Neni 16 Neni 282

Neni 17 Neni 283

Neni 18 Neni 284

Neni 19 Neni 285

Neni 20 Neni 286

Neni 21 Neni 287

Neni 22 Neni 288

Neni 23 Neni 289

Neni 24 Neni 290

Neni 25 Neni 291

Neni 26 Neni 292

Neni 27 Neni 293

Neni 28 Neni 294

Neni 29 Neni 295

Neni 30, paragrafi 1 Neni 268, paragrafi 2

Neni 30, paragrafi 2 Neni 296

Shtojca Neni 276

Neni 1, paragrafi 1, germa "d"

Neni 1, paragrafi 1, germa "g" Neni 13, paragrafi 14

Neni 1, paragrafi 1, germa "q"

Neni 1, paragrafi 2 Neni 2, paragrafi 3 —

Neni 2, paragrafi 1 Neni 2, paragrafi 3

Neni 3, paragrafët 2, 3 dhe 8 Neni 9

Neni 3, paragrafët 5 dhe 7 Neni 10

Neni 3, paragrafi 6 —

Neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe i tretë Neni 15, paragrafi 2, nënparagrafi i tretë dhe paragrafi 3, nënparagrafi i dytë

Neni 6, paragrafi 5, nënparagrafi i parë dhe i dytë Neni 21, paragrafi 1

Neni 7, germa "e" Neni 23, paragrafi 2, germa "f"

Neni 8 Neni 12 Neni 24, paragrafi 1

Neni 12 Neni 208

Neni 16, paragrafi 9 Neni 30 Neni 69

Neni 18, paragrafi 1 deri tek 6 Neni 73

Neni 18, paragrafi 7 —

Neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, ndarja e parë Neni 74, paragrafi 1

Neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, ndarja e dytë Neni 74, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë

Neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, paragrafi 2 dhe 3 Neni 74, paragrafi 4 - 7

Neni 21 Neni 209

Neni 25 —

Neni 26 —

Neni 32 —

Neni 34 Neni 182

Neni 35 Neni 186

Neni 36, paragrafi 1 Neni 185, paragrafi 1

Neni 36, paragrafi 2 Neni 185, paragrafi 4, fjalia e parë
Shtojca III(A) Neni 185, paragrafi 6
Neni 36, paragrafi 3 Neni 185, paragrafi 7
Neni 41 Neni 147
Neni 42, paragrafët 1 deri në 3 Neni 148, paragrafët 1, 3 dhe 4
Neni 43 Neni 149
Neni 45 —
Neni 48 Neni 160
Neni 49 Neni 159
Neni 51, paragrafi 2, germat "a" deri në "g" Neni 162, paragrafi 2, germat "a" - "e", "g"
dhe "h"
Neni 51, paragrafët 3, 4 Neni 163
Neni 52, paragrafi 1 Neni 169
Neni 55, paragrafët 1 dhe 2 Neni 166, paragrafët 1 dhe 2
Neni 56 Neni 167
Neni 59, paragrafët 1 dhe 2 Neni 52, paragrafët 1 dhe 2 Neni 177, paragrafët 1 dhe 2
Neni 59, paragrafët 3 dhe 6 Neni 52, paragrafët 3 dhe 4 —
Neni 60, paragrafi 1 Neni 305, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë dhe i tretë
Neni 60, paragrafi 2 Neni 305, paragrafi 3
Neni 31 Neni 61 Neni 43
Neni 65 Neni 55 Neni 301, paragrafët 1 dhe 3
Neni 66 Neni 308
Neni 67 Neni 53 Neni 297
Neni 68, paragrafi 1 —
Neni 71 —
Neni 72 Neni 310

Shtojca I Shtojca II

Shtojca III Neni 185, paragrafi 2, germat "a" - "c", paragrafi 3 dhe paragrafi 5, nënparagrafi i parë

Shtojca IV —

Shtojca V Shtojca VI

Shtojca VI Shtojca VII

Neni 1, paragrafi 2, germa "d" Neni 11

Neni 2, paragrafi 1, germa "a" Neni 13, paragrafi 7

Neni 2, paragrafi 1, germa "b" —

Neni 2, paragrafi 1, germa "h" Neni 13, paragrafi 9

Neni 2, paragrafi 1, germa "o" Neni 13, paragrafi 25

Neni 2, paragrafi 1, germa "p" Neni 13, paragrafi 26

Neni 2, paragrafi 1, germa "q" Neni 210, paragrafi 3

Neni 2, paragrafi 2 —

Neni 4, paragrafi 2 Neni 15, paragrafi 5

Neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi i parë dhe paragrafi 2 Neni 17, paragrafët 1 dhe 2, shtojca IIIC;

Neni 9, paragrafi 1 Neni 21, paragrafi 4

Neni 11, paragrafi 1, germa "b" Neni 23, paragrafi 1, germa "b"

Neni 15, paragrafi 3 Neni 32, paragrafi 2

Neni 21 —

Neni 45 —

Neni 46 Neni 211, paragrafët 1 dhe 2

Neni 47 Neni 158

Neni 48 Neni 161

Neni 50 Neni 175

Neni 51 Neni 176

Neni 54, paragrafi 1 Neni 298, paragrafi 1

Neni 61 Neni 308

Neni 62 Neni 12

Neni 63 Neni 307

Nenet 57, 58, 59 dhe 60, shtojca II, —

Neni 1, paragrafi 4, neni 2, paragrafi 4 dhe neni 4, paragrafi 6 Neni 58, paragrafi 8

Neni 8, paragrafi 2 Neni 312
